

Jusuf BUXHOVI

TRILOGJIA GJERMANE

1

Kujtimet e zonjës von Braun

Redaktor:
Ramadan Musliu

(Prozë që merret si vazhdim i romanit „Vdekja e Kolonelit”)

I

Atë mbrëmje të freskët shtatori Skulptori kishte pritur thirrjen e Helenores dhe kishte qenë i bindur se telefoni do të binte pikërisht në orën nëntë, si ngaherë, kur posta e Vjenës do ta njoftonte se në lidhje kishte Berlinin dhe pastaj, si një pyetje që nuk pret përgjigjen, do të rridhnin ato fjalët e përhershme e të përgjithësuara rreth dashurisë, me të cilat fillonin dhe mbaronin bisedat, pa marrë parasysh kahun dhe përmbajtjen e tyre.

Por, kur tiktaku i orës kishte rënë nëntë herë dhe pasi kishte lënë jehun e tingujve që ngadalë shuheshin duke u përplasur lehtas në hapësirën e ateliesë, të rrudhur nga punimet e shumta dhe thuajse të harruara, sesi u mbërthye nga njëfarë parandjenje se thirrja mund të mungonte, madje-madje edhe të mos dëgjohej më dhe kështu të merrnin fund njëherë e përgjithmonë bisedat e tyre, të cilat për nëntë vjet e nëntë ditë kishin vazhduar përditë, në të njëjtën kohë, që po ashtu, sipas një rregulli të pashkruar, të cilin e kishte vënë ajo dhe i ishte përmbajtur me përpikëri të çuditshme, ato kishin zgjatur nëntë minuta dhe nuk kishin qenë vetëm pjesë e një shprehje të kaluar në një gjë të rëndomtë që përsëritet përditë, porse edhe më shumë se kaq: një shqetësim, i cili kishte përshkuar shumë gjëra nga jeta e tyre, me rënie dhe përfundime të ngjashme.

„Kur nuk bie zilja e telefonit megjithatë nuk merr fund e gjitha, veçse gjendja e përkohësisë së mundimshme, me gjithë ato përsëritjet e vazhdueshme, zëvendësohet me sprovën e përhershme të dashurisë dhe me thirrjen e saj të pandalshme, të cilën janë në gjendje ta dëgjojnë vetëm ata që njëherë e përgjithmonë e varrosin urrejtjen...”

Kështu i kishte thënë ajo kohë më parë, pasi nga nipi Gynter Hajer Skulptori tërthorazi kishte marrë njëfarë njoftimi për gjendjen e keqësuar shëndetësore dhe që ia kishte përshkuar me vështirësi të shpeshtuara të frymëmarrjes, të cilat ishin astmatike. Dhe, për ta kursyer nga

mundimi i bisedimeve, pyetjeve të shtruara ai sadopak u kishte bishtnuar, duke ua rrudhur përgjigjet, por ajo me të shpejtë e kishte hetuar dhe i kishte thënë se bisedat që bënin plotësonin atë zbrazëtinë, në të cilën ishin përfshirë nga mungesa e dashurisë dhe që ishte e domosdoshme të mbushej me kuptimin, por edhe me ndijimin e saj, më se të nevojshme për ato rrethana, të cilat ajo i quante të mjera pikërisht pse u mungonte dashuria, e kështu me radhë, duke i holluar dhe stërholluar gjithnjë, për t'i kthyer aty ku dukej se as nisinin dhe as sosnin.

Natyrisht, ato që thoshte ajo nuk kishte si të mos ia përkujtonin frymën e shkrimeve të Kolonelit të lëna gjatë mbylljes në teqenë e Leqes, ku edhe kishte pritur vdekjen nga ai plumbi i pasqaruar, për të cilin telegrafisti Bruner i kishte thënë se i kishte ardhur si prej qiellit, (por që më vonë këtë hamendje e kishte hequr me konstatimin se plumbi që e kishte qëlluar për vdekje ia kishte prodhuar koka që edhe i ishte shkrepur prej saj) dhe ç'është e vërteta, ai e kishte pritur, që vrasjen e paralajmëruar dhe gjithë ato fatkeqësi të pafundme të botës shqiptare, disi t'i nxirrte nga zhvlerësimi dhe nënçmimi, ku ishin dhe që mund të mbeteshin të tilla përgjithmonë, e për t'u dhënë kuptime të caktuara dhe për t'i ngritur deri në një qëllim madhor, me të cilin lidhej ideja e bërjes së Shqipërisë Shqipëri...

Në të vërtetë, bisedat e tyre me telefon - të filluara para nëntë vjetësh e nëntë ditësh dhe të vazhduara çdo ditë në të njëjtën kohë dhe që fillonin me atë pyetjen e përgjithësuar „si i kemi punët me dashurinë“, të cilën ajo e shtronte pa kërkuar përgjigje të drejtpërdrejtë e të cilën gjatë katër vjetëve të parë ai nuk kishte denjuar ta jepte prerazi - pra ato nuk kishin qenë tjetër pos pjesë e një shqyrtimi të pasosur rreth Kolonelit, me kujtimet e të cilit ishte ndërlidhur e djeshmja e tyre, duke u shmangur fare ajo që u rrinte në mes dhe ajo e quante edhe „kohë pa dashuri“ që, ndonëse me një shtirje të dyanshme, sikur ishte përjashtuar qëllimisht çastin që Skulptori për herë të parë e kishte takuar në Berlin tetë vjet pasi kishte përfunduar Lufta e Parë Botërore dhe dy vjet pasi ishte kthyer ajo nga qëndrimi gjashtëvjeçar në Francë, kur ai ia kishte dorëzuar shkrimet që Koloneli i kishte lënë gjatë mbylljes njëzet e pesëditëshe në teqenë e Leqes, të cilat së bashku me kujtimet „*Një besë për Shqipërinë*“, i kishte nga telegrafisti Bruner me ç'rast ai i kishte treguar edhe gjëra të tjera, nga të cilat i ishte rrëqethur koka.

E mbërthyer nga shkallmime të herëpashershme shpirtërore që ia kishte lënë koha e gjatë e internimit dhe e thyer nga zhvillimet e ndodhura më pas, rreth të cilave shumë e shumë herë gjatë atyre bisedave prej nëntë minutash të zhvilluara për nëntë vjet e nëntë ditë kishte përsëritur se assesi t'i merrte me mend se do të ishin të tilla, pra „pa dashuri, por me urrejtje të madhe“, Zonja von Braun shkrimet e Kolonelit i kishte pranuar sikur t'i njihte dhe sikur të ishin të sajat. Madje, madje shpeshherë i kishte thënë se i bëhej sikur ishte bashkautor e këtyre shkrimeve, ngaqë herë-herë kishte ngulmuar se në to mrekullisht i ishin ndërlidhur përjetimet dhe ato që u takojnë ndijimeve të veçanta, të cilat nuk mund t'i shprehë si duhet as fjala më e hapur, edhe pse gjithnjë me to ngoje i kishte përsëritur e përsëritur dhe në atë përpëlitse të pandalshme nëpër kufje të telefonit ato kishin krijuar përshtypjen e një rikrijimi. Dhe si do të shihet nga kujtimet e lëna, të cilat tri ditë pasi kishte vdekur dhe ishte varrosur nën pllakën e granitit të zi me vargjet „*Ndjehem i huaj pa ty /Ndjehem i vetmuar me ty...*“ të nxjerra nga shënimet e Kolonelit me porosinë: përgjithmonë ta shoqëronin, do t'i vinë me postë të nisura nga Berlini nga i nipi Gynter Hajer, pra ato nuk kishin paraqitur tjetër pos vazhdimësinë e përpëlitseve të Kolonelit dhe shkrimeve të tij, të ngjashme me atë të kohës së mbylljes njëzet e pesë ditësh në teqenë e Leqes, në pritje të plumbit, i cili do ta gjente, mbyllje kjo që mund të thuhet se Zonja von Braun i kishte zgjatur plot nëntë vjet e nëntë ditë, me të vetmin ndryshim se Koloneli kishte përjashtuar plotësisht jashtësinë dhe përmasat e saj duke iu kthyer në tërësi së ardhmes së pashkëputshme që kalonte nëpër shpirt dhe mendje si pjesë e një përfytyrimi thujse halucinacioni me një qëllim madhor, siç ishte ai i bërjes së Shqipërisë Shqipëri, ndërkohë ajo, me bisedat telefonike, që kishte zhvilluar me të çdo mbrëmje në të njëjtën kohë, duke e ndërlidhur çdo gjë me dashurinë dhe ndijimin e saj të veçantë, kishte bërë

përpyjekje ta kthente atë në një shkëputje të lidhshme me ato, të cilat nuk dëshironte t'i pranonte dhe i shihte shkaktare të fatkeqësisë së saj dhe asaj të përgjithshmes. Së këtejmi, mund të thuhet se përjashtimi i tyre paraqiste një ideal të njëlojtë, i cili i duhej një ribërje tjetër, dhe ndonëse mbeteshin të lidhura me bërjen e Shqipërisë Shqipëri, siç përfytyrohej prej Kolonelit, me ato që thuheshin për nevojën e dashurisë dhe mbizotërimit të saj, dhe përsëriteshin dhe përsëriteshin thuajse pranë secilit mendim dhe qëndrim, e tëra bartej te fusha e një ndërgjegjësimi të lartë civilizues, me të cilin bota mund të shpëtonte nga ato që tashmë i kërcënoheshin seriozisht dhe mund ta sillnin buzë një shkatërrimi të përgjithshëm...

“Kemi qenë pjesë e të njëjtit shqetësim të madh dhe do të mbesim bashkë në të për të ndjekur të njëjtat shtigje, të cilat çojnë nëpër ndijimin e dashurisë dhe vetëm të dashurisë, e cila, për fat të mirë, nuk ka të sosur...”

Kështu i kishte folur Zonja von Braun, me një përkushtim të jashtëzakonshëm, gjatë takimit të parë, që paksa e kishte këndellur nga shkallmimi, të cilin ia pasqyronte dukja dhe shpirti. Njëjtë do t'i thotë edhe gjatë takimit të dytë dhe të fundit që kishte pasur katër vjet më vonë, kur pas një udhëtimi të gjatë me tren nga Vjena deri në Berlin, i cili i qe dukur i bezdisshëm dhe sikur të kalonte nëpër një botë, e cila i shfaqej gjithnjë më e huaj, ia kishte sjellë kopjen e kujtimeve „Zot-imi-Shqipëri“, e gjetur rastësisht gjatë meremetimit të teqesë së Leqes, me ç'rast urdhri i bektashinjve në Shqipëri Kolonelin e kishte shpallur „shiit të vatanit“, ndërkohë që mbretëria shqiptare e kishte dekoruar me medaljen e pavarësisë së rendit të parë...

Edhe pse për letrat e fundit të Kolonelit Zonja von Braun kishte thënë se “vetëm ata që janë vullkan i dashurisë mund të qesin në pah gjëra të tilla, me të cilat ndonjëherë bota mund të ndryshohet për të mirë...”, megjithatë atë ditë të gjatë shtatori me rreze vezulluese, të cilat gjelbërimit të dendur përreth liqenit i kishin dhënë një shkëlqim të veçantë, pasi që një kohë të gjatë kishin ndenjur pranë njëri-tjetrit të ngrirë dhe me bindjen e përbashkët se ato mund të ishin porositë e fundit të Kolonelit, si të ishte në prag të një sosje të gjithmonshme i kishte thënë se „Koloneli nuk ka kujt t'i shkruajë më“, fjalë këto që atij ia kishin krijuar përshtypjen e një tundimi të brendshëm me shtrëngesa të mëdha, me ç'gjë paralajmërohet sjellja nëpër një labirint të gjatë, në të cilin ishin të gjykuar të mbeteshin ata që kishin sharruar në hapësirën e pakapërcyeshme të rrethit, ku edhe kredhja nëpër andrallat më të papërmbajtshme kthehet në ankth të rëndë...

Sikur ta kuptonte se me ato që kishte thënë mbase kishte pranuar një gjykim, i cili përfundimisht do t'i zhvishte nga çdo gjë, po së paku nuk duhej pranuar ashtu, Zonja von Braun atë stepjen e përbashkët e kishte thyer me fjalët „se sidoqoftë Koloneli nuk do të mbetej pa letrat që i meritonte dhe do t'i niseshin, pa marrë parasysh se cila pjesë e hiçit i lironte“, të cilat i kishte arsyetuar me pandehmën „se ajo sjellje përkonte me frymën e dashurisë, së cilës i besonte ai dhe që vetëm ashtu mund të mbahej e ndezur siç e meritonte, me kusht që të shtereshin edhe mbetjet e saj më të pahetueshme, të strukur në errësirën e shpirtit, të cilave u duhej një guxim dhe mundim i madh të nxirreshin së andejmi...“, e të tjera porosi si këto, me të cilat ai nuk kishte pasur bindjen se ashtu shmangej rënia, e cila tashmë i kishte përfshirë (pa marrë parasysh sa dhe si e shihnin dhe e përjetonin), përveçse e gjithë kjo ia kishte forcuar dyshimin se ndodheshin njësoj përballë asaj thyerjeje të pandalshme shpirtërore, që nuk kishin si të mos ia pranonin shkallimin në të cilin kahmot ishin përfshirë, por çështje ishte sa do t'u zgjaste zvarritja nëpër të, kur nuk ishin në gjendje me asgjë ta ndikonin e aq më pak ta parandalonin.

Sidoqoftë, përshtypja e atij shkallmimi që kishte ndier atë ditë shtatori me rreze të ndritshme në Berlin, në verandën e drunjte buzë liqenit - kur ajo i kishte folur me ndjenjën e një dëshpërimi të thellë, e cila pastaj edhe më shumë i ishte sforcuar me heshtjen e ngrirë që e kishte përfshirë si për të kërkuar që paksa të mbrohej nga rrënimi që nuk mund t'ia fshihnin as ato, të cilat pareshtur i thoshte për dashurinë dhe nevojën e saj që të kërkohej e të kërkohej edhe kur dukej e pamundshme dhe të mbahej dhe të thellohej - nuk i ishte ndarë as kur ishte

kthyer në Vjenë dhe kur kishte ndier se ishte larguar nga një botë tjetër, së cilës nuk ia njihte as fundin as fillimin dhe nuk i ishte ndarë as pasi kishin filluar ato bisedat e tyre të përditshme telefonike prej nëntë minutash, të cilat kishin vazhduar për nëntë vjet e nëntë ditë... Jehu i asaj përshtypje të rëndë shkallmuese madje nuk i ishte ndarë as më vonë, kur ato kishin pushuar dhe ai kishte mbetur me kujtimet e saj të shkruara, të cilat pas tri ditësh i kishin mbërritur me postë pa paralajmërim dhe pa kurrfarë porosish a sqarimesh rreth tyre.

Por bazuar në ato të cilat mes tyre ishin thënë për nëntë vjet e nëntë ditë të përjetuara thuajse njësoj, dhe që përshkoheshin nga një mbushje-zbrazje e përsëritshme, e cila dukej se nuk do të kishte fund dhe si të tillë do t'i bënte të paqenë fare sa t'i kthente në tinguj të thatë që silleshin dëshpërueshëm nga njëri kënd i telit të tjetri, megjithatë asnjëherë nuk ia kishte marrë mendja se ato tek ajo kishin rrjedhur me aq përkushtim, rregull dhe mbikëqyrje sa që nganjëherë ia kishin krijuar bindjen se ajo mund të kishte bërë një jetë dyshe, siç i kishte shkruar mendja se e ngjashme kishte qenë edhe ajo e Kolonelit, së cilës i ishte dashur mbyllja dhe vetmia e thellë e përcjellë me një ndjenjë fataliteti të pashmangshëm të vrasjes së paralajmëruar për t'u pasqyruar aq thellësisht dhe denjësisht gjithë ato që paraqesin më shumë se përjetime të atij që ballafaqohet me vdekjen dhe, në pamundësi të ikjes, flet çmos për ta mundur frikën.

Përkundrazi, kur atë mbrëmje të freskët shtatori, pas nëntë vjetësh e nëntë ditësh, pikërisht në orën nëntë, nuk ishte dëgjuar zilha e telefonit, kur ai shurdhim i pashpjegueshëm për pak ishte prishur me nëntë të rrahurat e tiktakut të orës, jehona e të cilave sakaq ishte fashitur në hapësirën e ateliesë, kishte kuptuar se jo vetëm kishte mbetur vetëm, por pikërisht ndodhej në atë labirintin e njëjtë, siç e kishte përfytyruar para nëntë vjetësh e nëntë ditësh gjatë takimit të fundit me të në Berlin, kur ia kishte dorëzuar letrat e fundit të Kolonelit, ndërsa ajo gjithë dëshpërim i kishte thënë se „Ai nuk kishte kujt t'i shkruante më...”

Pas një kohe, kur i vetmuar priste fundin dhe kishte përshtypjen se ai mund të ishte i ngjashëm vetëm po qe se do të përkonte me fillimin e një lufte tjetër të madhe botërore, të tretës me radhë, (pasi që e para kishte filluar ditën kur do të vritet Koloneli, ndërkohë e dyta kishte nisur ditën kur do të vdiste Zonja von Braun), që, siç do të shihet, fillimin e saj ai e kishte parë diku në malet e Kosovës, kur flaka e një kryengritjeje të shqiptarëve kundër shtypjes së Beogradit, të vetmes lëvizje që ishte bërë haptas kundër vendimeve të Versajës, (ndonëse ishte shuar dhunshëm dhe thuhej se nuk kishte kurrfarë gjasash të përndizej), megjithatë, atij ajo flakë do t'i mbetej i hapur, me bindjen e thellë se vetëm me anën e saj, thuajse mrekullisht mund të ndreqeshin ato prishjet e mëdha, me të cilat do të rivendosej ajo, e cila kishte qenë aq e vlefshme në botë, e të tjera, e të tjera, të cilat Skulptori do të pranojë se në atë pjesë të jetës që e kishte quajtur „mbetje të tepërt“, pa qenë në gjendje të bëjë gjë prej gjëje, pra atë kotësi ishte përpjekur ta përmbushte me përfytyrimin e ndryshimit të realiteteve në përputhje me ëndrrat, të cilat i kishte pasur edhe Koloneli dhe më vonë Zonja von Braun, veçori kjo që nuk paraqiste vetëm ngushëllim, por edhe një ushqim krijues, pa të cilin nuk bën, e që megjithatë tek ai nuk kishin shkruar tutje shfrimeve thuajse të megjulluara dhe ishin sjellë midis mllefrit dhe urrejtjes për të mbetur vetëm si duf me turre, ndonëse ndonjëherë dukeshin si të pambikëqyrura fare, të cilave u ishte dhënë fund e krye.

Në pahintikën e asaj përpëlitseje me vetminë që e kishte pushtuar gjithnjë më shumë dhe që kishte bindjen se herët a vonë do ta hidhte në mbërthimin e një askundje shpirtërore, (në të cilën edhe kishte sharruar gjatë atyre gjashtë vjetëve dhe tetë muajve të vetëngujimit të plotë në atelie në pritje të atij fundi, i cili do ta gjente ditën e nëntë të majit, kur shikimi i lodhur do t'ia kapte ushtarët sovjetikë se si derdheshin nëpër qendrën e dikurshme perandorake me flamuj të kuq në dorë dhe çirrijet për botën proletare), megjithatë nuk i kishte munguar bindja se nga ai rrënim disi mund të mbrohej me anën e përfytyrimit të çfarëdo ndërlihdjeje me Kolonelin dhe Zonjën, të ngjashme me ato të viteve të Vjenës, kur zhvillimi i tragjedisë shqiptare dhe atyre që kishin filluar me të, sikur të ishin paralajmërim i një oguri të madh, i cili medoemos do t'i gjente për t'i ballafaquar me një rrënim të përgjithshëm nga ato

që ajo në kujtimet e veta do t'i quajë „si mungesë e vullnetit për dashuri“, i kishte afruar, i kishte bashkuar dhe i kishte vënë në kërkim të ngritjes së zërit kundër asaj që vinte, por edhe të veprimit të parandalimit të saj, siç ishte përcaktimi për mbledhjen e vullnetarëve që do të shkonin në Shqipëri në mbrojtje të Qeverisë së Përkohshme dhe të mbretit të caktuar nga jashtë, me çka shpresohet, që së paku, një të keqeje do t'i ndalej turri.

Por ç'ë do që edhe kujtimet e shkëputura të asaj kohe, të kapura me vështirësi, të cilat do t'i merrte për çaste të kujtimeve të ngrohta, sikur i ishin fanitur dhe, të ndërldhura me përfytyrime të shkapërderdhura, të cilat assesi t'i mbikëqyrte, i shfaqeshin me ngjyrimin e mllefrit dhe të urrejtjes ndaj asaj që i ishte rrënuar aq papritmas, por furishëm, sikur të ishin pjesë të një shembjeje të papërmbajtshme, e cila do të vazhdonte e do të vazhdonte pandalshëm dhe pafundësisht përderisa të rrëronte secilën krijesë dhe çdo vlerë...

Dhe, në atë katrahurë, në të cilën ishte katandisur dhe nuk kishte si t'i ikte, i bëhej sikur Koloneli e shihte t'i fliste për atë mashtrimin që lidhej me shpëtimin e Shqipërisë, në vend se të mendohej për bërjen e një Shqipërie të atillë, siç i kishte folur dikur në Guras nën degët e manit të gërmuqur, atë natën e fundit që ishin ndarë përgjithmonë, kur ishte nisur për në liman të zinte anijen e parë në thirrje të mobilizimit të shpallur nga monarkia në prag të luftës me Serbinë, ndërsa ai ia kthente se lufta e madhe, e cila ishte në prag, mund të paraqiste shpresën e vetme që të merrte fund gjakderdhja e brendshme shqiptare, e cila kishte shpërthyer dhe kishte shkretuar vendin, sa në saje të prapaskenave të ndërkombëtarëve që kishin marrë zotimin ta mbronin po që bënin të kundërtën, sa nga çmendia e shqiptarëve kundër vetvetes. Kjo gjithsesi do të ishte një mrekulli e shkuar mrekullisë në atë fatkeqësi kombëtare, së cilës nuk i shihej fundi.

Koloneli sikur qeshte me ato që ia thoshte ai për shpresën që lufta e madhe shuan luftërat e vogla dhe ia përkujtonte se kishte filluar një rrënim i madh, një prishje tepër e madhe, mbase e pandreqshme, që botës i vinte si ndëshkim pikërisht nga mëkatet që kishte kundërt Shqipërisë, të cilat, siç thoshte ai, nuk do t'i ndaheshin gjithë derisa ajo të njihej e tillë siç ishte, pra Shqipëri, të cilën e quante „një të mirë civilizimi“, e cila u duhej që të gjithëve për t'iu shmangur kurtheve të sherreve, në të cilat kishin rënë ngaherë, madje qëllimisht... Kështu fliste me bindje të patundur, duke shpalosur edhe të tjera histori, ndërkohë që atij edhe më tutje i bëhej se po ndiqte përfitimin e ndonjë ëndrrë të lehtë dhe të këndshme vere, nëpër një perde të mjegullt, në të cilën vazhdonte të shihte luftën e re të madhe si shpëtimtare, si shpresëdhënëse dhe madje të lutej që ajo të bëhej sa më parë, të ndodhte sa më parë dhe kështu, me mendje të sorollatur e me dalldisje, thurte e ç'nuk thurte sipas qejfit që ta shuante jo vetëm tragjedinë shqiptare, por njëherësh edhe lajthitjen e vet bashkë me atë grumbull andrallash, që u ishin kthyer në kob. Në atë përplasje midis tij dhe Kolonelit i ishte dukur se kishte ndërhyrë edhe Zonja von Braun me fjalët se duhej të merrnin fund qeshje-përqeshjet e panevojshme, ngaqë shpëtimin duhej kërkuar vetëm te dashuria dhe që kishte thënë se duhet të jetë e pafund dhe e përhershme.

“Atyre që u mungon dashuria mund të jenë vrasës dhe gjithçka ...“

„O zot, po ç'hyn në punë betimi i dashurisë aty ku ajo mungon dhe bëhet e paarritshme, qoftë ngaqë nuk hetohet, ose që luftohet“, i kishte thënë vetes Skulptori dhe kjo sikur i kishte ndihmuar të lirohej nga ajo perde e mjegullt dhe sakaq i ra ndër mend se të njëjtën pyetje ia kishte shtruar vetes edhe para nëntë vjetësh dhe nëntë ditësh, pikërisht me rastin e bisedës së parë telefonike me Zonjën von Braun, kur ajo kishte thirrur nga Berlioni dhe saktësisht në orën nëntë të mbrëmjes posta e Vjenës e kishte bërë me dije se në lidhje kishte kryeqytetin e rajhut gjerman dhe ajo, thuajse pa fillim e mbarim, i kishte folur për domosdonë e ndijimit të dashurisë, për kthimin e përhershëm drejt saj dhe për ta kërkuar e krijuar, si dhe gjëra të tjera të ngjashme, të cilat pastaj ia kishte përsëritur dhe ripërsëritur gjatë gjithë kohës me një përkushtim të jashtëzakonshëm sikur të rikrijonte diçka që ishte e domosdoshme në atë kohë rrënimtare...

Që përsiatja për dashurinë, e cila duhej të shihej dhe të ndihej gjithkund, asaj mund t'i jetë qepur si njëfarë mënyre tjetër e të menduarit, me të cilën ishte detyruar të kalonte mundimet e internimit, që i kishte mbetur si pasojë, pra si siklet shpirti, e kishte hetuar që nga takimi i parë, tetë vjet pas mbarimi të luftës, kur ia kishte dhënë letrat e Kolonelit, të lëna gjatë kohës së mbylljes në dhomën e madhe të ziçrit në teqenë e Leqes, së bashku me ato të memoareve të kosovarëve „*Nji besë për Shqipninë*“ që edhe më tutje mbanin gjurmë gjaku të studentit Zenel Xhema, të vrarë nga forcat e Haxhi Qamilit. Dhe ajo, me atë rast, pos të tjerash, pasi i kishte marrë dhe i kishte shtrënguar me një ndjeshmëri të jashtëzakonshme, që vështirë përshkruhet, i kishte thënë se „fatkeqësitë e mëdha dhe të gjitha tragjeditë bëhen edhe më të mëdha kur u mungon dashuria“. Ai e kishte pohuar këtë me kokë, pa denjuar të thoshte gjë, nga përshtypja se në kohë të rënda dhe mundime përftimi dhe thirrja e dashurisë mund të shërbente si ngushëllim i bëftë, por edhe si njëfarë trysnie e natyrshme kundër urrejtjes, që assesi nuk do t'ia dëshironte vetes. Madje-madje, më vonë, gjatë asaj vetëmbylljeje të shurdhët prej gjashtë vjetësh e tetë muajsh në atelienë e harruar në Rudolfpllaz, ku do ta presë fundin e pashmangshëm, fryma e urrejtjes dhe mllefi i saj (të vetmet që i kishin mbetur), kishin qenë në gjendje t'ia ushqenin zvarritjen, nëpër të cilën kishte kaluar mundimshëm derisa ditën e nëntë të atij maji e gjitha i kishte marrë fund me atë ngrirjen e përhershme të parakalimit të trupave sovjetike me flamuj të kuq në Ballpplaz, që i kishte mbetur në bebëza si ndëshkim...

Megjithatë, ato që ajo kishte thënë pareshtur për dashurinë dhe nevojën e ndijimit të saj, të cilat i kishte përsëritur e ripërsëritur çdo mbrëmje gjatë atyre bisedave telefonike që kishin zgjatur nëntë vjet dhe nëntë ditë dhe kishte përshtypjen se ngjashëm do t'ia thoshte edhe nëntëdhjetë e nëntë të tjera dhe do t'ia thoshte përgjithmonë madje, kishin qenë më shumë se ndrydhje e dufit të urrejtjes a e hakmarrjes, me të cilën mendohet se mund të shpëtohet shpirti përballë rrënimeve të pandalshme. Si do të shihet nga kujtimet e shkruara me dorë, që gjithsej ishin nëntëdhjetë e nëntë sosh, të përfshira në dyqind e nëntëdhjetë e nëntë faqe me rreshta të imët, kuptimi i dashurisë dhe gjithë ajo që lidhej me të, jo vetëm që duken se kryekreje vihen në shërbim të të menduarit të Kolonelit për idealin (ai këtë ideal e lidhte me bërjen e Shqipërisë Shqipëri, si një domosdoshmëri qytetërimi dhe nevojë që, si thoshte, „t'u mbyllet rruga luftërave të tjera, të cilat nuk do të kishin të ndalur pa bërjen e saj“ dhe shumëçka të ngjashme, të cilat si përsiatje i ishin kthyer në një përndjekje të pandalshme mendore), por ato disi shënojnë një përpjekje të jashtëzakonshme, ku ndjenja e dashurisë, e hetuar nga brenda, pra nga shpirti, njësohet me atë të një qëllimi madhor, pa të cilin jeta nuk ka kuptim dhe që po mungoi, asaj ia jep kahun e kundërt, me ç'gjë pastaj, si do t'i thotë sa e sa herë gjatë bisedave telefonike, “mund të shpjegohen kohët e çmendisë dhe tragjeditë e tyre...”

Skulptorit do t'i kujtohej se shpjegimi i tillë i dashurisë prej saj pothuajse kishte përfshirë gjithçka, madje edhe gjërat që në e parë dukeshin ndër më të rëndomtat, si shfaqja e ndonjë lagështie në ndonjë stinë kur nuk i shkonte, ose e kundërta, shkaqet e së cilës lidheshin me mungesën e dashurisë. Nga ana e saj kjo theksohej aq natyrshëm saqë fitohej përshtypja se çrregullimet në dashuri pasqyroheshin jo vetëm te sjelljet e njerëzve, por edhe te të gjitha gjësendet e tjera, përfshirë madje edhe ato që dukeshin fare të pamundshme...

“Kështu ndodh kur mungon dashuria...”- thoshte Zonja von Braun dhe prej këtij refreni thuajse nuk hiqte dorë. Këto përsëritje, herë-herë si të nxjerra mundimshëm dhe si të ndrydhura diku në një brendi të errët, i krijonin përshtypjen se mu ato ishin pjesë e çrregullimeve të thella shpirtërore, të cilat nuk i ndaheshin dot, por që për habi ishin më dobiprurëse sesa çfarëdo nxitje ballafaqimi me realitetin, i cili nuk pranohej si i tillë ngaqë nuk mund të ndikohej e as të ndryshohej.

II

Përsiatjet për dashurinë dhe mangësinë e saj - që Zonja von Braun e baraspeshonte me fatkeqësinë më të madhe, në njëfarë mënyre, si meditime të shikuara jashtë rrethanave, të cilat u kanë paraprirë dhe të shkëputura nga përkushtimi dhe që nuk kanë si të mos jenë të lidhura me fatin e saj, por edhe të Kolonelit - lënë përshtypjen, jo vetëm të pamundësimit, por edhe të rrënimit të saj të plotë dhunshëm dhe, po të shikohen ashtu, mund t'u pranohej kufizimi i panevojshëm, madje edhe ajo që mund të krahasohet me iluzionin, i cili i kishte ushqyer dhe mbajtur të tilla.

Në të vërtetë, nga kujtimet e shkruara me një përkujdesje të madhe për nëntë vjet e nëntë ditë - të cilat Skulptori i kishte marrë me postë tri ditë pas vdekjes dhe varrosjes së saj në varrezat lindore të Berlinit, në pjesën përtej liqenit, ku pishat e zeza natyrës ia ruajnë përherë një pjesë të gjelbërimit, i cili nuk i dorëzohet vjeshtës - vërehet një përpjekje e madhe për të qetësuar vetveten, (pa u përmendur se Koloneli ishte i fejuari i saj, se në Berlin dhe Vjenë kishin kaluar së bashku çaste të lumtura, se ishin përcjellë nga të njëjtat preokupime dhe shqetësime rreth fatit të Shqipërisë, e të tjera si këto), me ç'rast mungon çfarëdo shfrimi, i cili edhe do të ishte i natyrshëm në momente të tilla, kur dihej se ç'kah kishin marrë gjërat dhe si ishin zhvilluar, duke qenë të vendosura në hapësirën kohore nga fillimet e Luftës së Parë Botërore, gjatë saj dhe deri te fillimi i së Dytës.

Pra, kur kihen parasysh të gjitha këto, atëherë fitohet përshtypja se Zonja von Braun qëllimisht kishte zgjedhur këtë ligjërim të pazakontë për dashurinë, me një gjuhë thaujse moralizuese, pa fajësime e shfajësime, e cila rrethanave të tilla të shembjeve të mëdha u duhej më shumë se kurrë, që jo vetëm të ruhej baraspesha e brendshme, aq e domosdoshme, por mbase të gjendej rruga edhe për një ngritje gjithëpërfshirëse, që mund të quhej rifillim, ribërje a diçka e ngjashme me to, ku një të menduar tejet superior, (ai i Kolonelit gjatë mbylljes së plotë e në pritje të atij plumbi që si gjykim i pashmangshëm ditën e njëzetepetë të mbylljes në teqenë e Leqes do t'ia gjente kokën sikur t'i kishte ardhur prej qielli), të plotësohet edhe me frymën e asaj mbidashurie, qoftë si ndijim i përgjithësuar shpirtëror, qoftë si preokupim filozofik dhe të lidhet me një ideal të lartë, (i bërjes së Shqipërisë Shqipëri), me të cilin ajo do të njëjtësohej dhe plotësimin e saj do ta shikojë si „pjesë të përmbushjes së një dashurie të madhe...“, me të cilën shton se „po ashtu përfundon një urrejtje e madhe...“

Këtu mbase duhet kërkuar edhe arsyet pse gjatë gjithë kohës Kolonelit do t'i afrohet si shpirt i lartësuar brenda një fryme të gjithëhershme, që Skulptorit ia kishin krijuar bindjen se në përputhje me rrënimin që nuk kishte qenë e mundur t'i ikej, të ndërli dhej plotësisht me përcaktimin që edhe dështimi më i rëndë të mos merrej si humbje, por të kthehej në një bindje se asgjë nuk është e humbur nëse nuk pranohet mungesa e dashurisë, në ç'mënyrë çështjet kthehen te besimi...

Meqë dy vjet të plotë ishte marrë me leximin dhe rileximin e letrave të Kolonelit, qëkur ia kishte sjellë telegrafisti Bruner, me të cilin kishte biseduar njëzet e katër orë pareshtur rreth tyre dhe rrethanave në të cilat ishin krijuar ato, pa harruar edhe imtësitë më të ndryshme, të cilat ishin zënë ngoje me një mallëngjim të madh që nuk kishin si t'i iknin, as atëherë kur ai kishte shqitur kah ndjenja e fajësisë, dhe mund të thuhet se shumë nga ato shfrime thaujse i kishte mësuar përmendsh, (meqë ishte ndërli dhur me to aq sa ndonjëherë i merrte edhe si të vetat dhe i quante edhe të tilla), pra në përputhje me këto njohuri Skulptori nuk e kishte pasur të vështirë, qysh nga vështirimi i parë i tyre, të vërente qëllimin që ato meditime, së pari të përvetësohen, e pastaj të plotësohen në një mënyrë tejet të veçantë edhe pa u thirrur në ndihmë ajo, të cilën Zonja von Braun ia kishte thënë me rastin e takimit të tyre të fundit në Berlin para nëntë vjetësh se “kemi qenë pjesë e të njëjtit shqetësim të madh dhe do të mbesim bashkë në të për të ndjekur të njëjtat shtigje, të cilat çojnë nëpër ndijimin e dashurisë dhe vetëm të dashurisë, që nuk ka të sosur dhe është e vetmja që bashkon edhe ato gjëra, të cilat duken fare të pabashkueshme...”

Këto fjalë të shqiptuara në verandën e drunjtë para liqenit i kishin ngjarë si pjesë e shkallimit që përfshin ata, të cilët kanë nevojë të ushqehen me atë e cila, ndonëse nuk kthehet, së paku ashtu, lejon t'i ndryshohen kahet dhe përmbajtjet sa të shihet edhe e ndryshueshme, madje gjithnjë në përputhje me qasjen dhe përfytyrimet...

Përkundrazi, duke u ndërlidhur me Kolonelin dhe ato që në çastet e fundit të jetës i kishin kaluar në vetëmbrojtje të fuqishme, fryma e të cilave shumë vjet pasi kishin dalë në dritë do të kuptohej dhe pranohej si një shpresë që duket në thellësinë e terrinës shqiptare, Zonja von Braun, në kujtimet e lëna thuajse në tërësi kishte ndjekur ecurinë e pranimit të dështimit dhe të përballimit me anën e krahassimit midis asaj që Koloneli e quante domosdoshmëri të bërjes së Shqipërisë Shqipëri me një ribërje dhe rilindje, e cila i duhej atij rifillim dhe mundësohej vetëm pasi të kuptohej nevoja e pastrimit nga të gjitha të ligat që për kurorë do të kishin *krijimin e perandorisë së më të mirës* dhe vendosjen e pushtetit të saj të plotë dhe që në mendjen e saj ajo bërje dhe ribërje të paraqitej si *rikthim i dashurive në përbërje të dashurisë së madhe, gjithsesi të mirëfilltë, si një dhunti hyjnore* dhe të tjera të këtilla, me ç'rast thoshte se njëherë e përgjithmonë do të përfundonte urrejtja, e cila ishte pjellë e shumë të ligave dhe do të fillonte koha e dashurisë së pafundme dhe të përhershme, ku mbizotëron prirja për lartësim dhe preokupimi i ngritjes së vazhdueshme drejt majave...

Skulptori kishte krahasuar mendimet e Kolonelit për *krijimin e perandorisë së më të mirës*, ku ai kishte parë Shqipërinë dhe gjithë botën si pjesë të saj, me ato që Zonja von Braun kishte thënë për „*rikthimin e dashurive në përbërje të dashurisë së madhe dhe të përhershme, që paraqet dhunti hyjnore, të cilën duhet hetuar*“ dhe thuajse i ishin dukur si pjesë e iluzioneve të njëjta, të cilat mrekullisht u shkojnë kohëve të rrënimeve të mëdha, në mos për tjetër, atëherë të mos u pranohej depresioni që është më i rrezikshëm se çfarëdo humbjeje, pa marrë parasysh se ballafaqon me rrezikun që prishjet e tyre të merren si të natyrshme, me të cilat duhet për t'u mësuar, madje edhe për të jetuar, me bindjen se vetvetiu do të ndreqen, e kjo po ashtu është një mashtrim tjetër tejet i madh.

Koloneli shkruante se „*krijimi i perandorisë së më të mirës do ta shpëtonte botën nga grindjet e vogla dhe zënkat e mëdha dhe do ta nxirrte nga përçarjet që ia kanë krijuar ndarjet gjatë një mijë e sa vjetësh, të cilësuarat si Perëndim e Lindje dhe që nuk janë asgjë tjetër pos kufi për mbizotërim me fatkeqësi të pashmangshme, të cilat mjerisht bëhen në emër të librit të shenjtë dhe të porositë të tij...*“

Kështu, në sendërtimin e *perandorisë së më të mirës* ai shihte edhe shpëtimin e Shqipërisë dhe të hapësirës së saj që fatkeqësi kishte pasur pikërisht atë ndarje dhe vijat e saj (sado që thoshte se ishin bërë përpjekje të pareshtura t'i bishtnohej disi me anën e përshtatjeve, me anën e përqaqimit të njërit a tjetrit besim dhe çmos tjetër, po nuk kishin munguar as vasalitetet më të padenja, nënshtrimet e gjata e presione të tjera të gjithfarshme, të cilat ishin arsyetuar me mbijetesën e thjeshtë, e cila nuk kishte paraqitur asgjë tjetër pos ngecje, madje me kthime prapa dhe shkallmim, bile...) Ndërkohë që Zonja von Braun thoshte se „*dashuria e madhe - e cila nuk mund të jetë tjetër pos mbidashuri që shfaqet dhe përqafohet si dhunti hyjnore, e cila duhet të hetohet me anën e ndijimit të thellë dhe të përhershëm - do ta shpëtonte botën nga mallkimet e vogla, të cilat bëhen të mëdha, kështu që jetësimi i saj njëherë e përgjithmonë do të flakte atë që quhet ndasi e qëllimshme e ushqyer me urrejtje, duke e kthyer të tërën në shtresim të përgjithshëm dashurie, ku çdo gjë plotësohet me ndijimin e saj dhe ku nuk do të ketë vend për nënshtrim, nënçmim, përrulje dhe për përrulje të tjera, por vetëm për dëshmim të sigurtë dashurie- dashuri për dashuri...*“

Sintagmat „botë perëndimore“ dhe „botë lindore“, që tekefundit luftojnë për mbizotërim edhe kur duken se ndonjëherë ato nuk paraqesin tjetër pos atë që mund të merret si fërkim i domosdoshëm i qytetërimeve me kahe të ndryshme të krijuara në përputhje me zhvillimet e rrethanave të caktuara, Koloneli do t'i quajë „*një garë e pafundme rrënuese, e cila mund të ndalet vetëm me krijimin e perandorisë së më të mirës*“, nismën e së cilës ai e shihte te bërja e Shqipërisë Shqipëri, së cilës, si pikënisje, i duhet një hapësirë civilizuese, e

ngjashme me atë të antikës kur njerëzimi nuk kishte qenë i robëruar nga kufijtë e herezisë që të menduarit i ishin vu nga librat e mbyllura. Pa hy në atë që Koloneli do ta shohë si „garë e pafundme rrënuese“, Zonja von Braun me cilësimin e „dashurisë hënore“ dhe të „dashurisë diellore“, të cilat do t'i quajë „kundrime të përbashkëta shpirti“, do të anashkalojë gjuhën e ndasisë për t'i parë ato pjesë e asaj *dashurie të përgjithshme, të amshueshme*, e cila buron nga krijimi dhe qenësia, që ia plotësojnë qarkun e kuptimësisë dhe e përmbushin me qëllim e jo për të kundërtën.

„Ata që përfshihen nga dashuria lirohen nga urrejtja dhe shohin vetëm ardhmërinë“, thotë ajo dhe këtë do ta përsërisë thujse pareshtur, sikur të ishte fjala për një vërejtje që si amanet duhet mbajtur parasysh përballë rrezikut të përhershëm që kërcënon e kundërta e saj...

Në përputhje me këtë bindje, Skulptori do të ndeshë edhe pjesë të një shkrimi tejet poetik të një ëndërrimtareje të pavërejtur, të cilave Zonja von Braun përherë u kishte mbetur larg, jo vetëm nga shkaku i një kundrimi të veçantë profesional, që shkrimin ta përdorë për nevojat publicistike, ku me analiza të shumta në „Die Presse“ ajo kishte bërë emër të njohur në hapësirën gjuhësore gjithëgjermane dhe për shumë gjëra kishte ushtruar ndikim, por edhe nga përcaktimi i njohur jetësor: çdo gjë të shprehet me përmbajtje të prajshme, pa u rrëmbyer, qoftë edhe dashuria më e fuqishme po edhe hidhërimi më i rëndë, që si do të shihet më vonë do t'i kthehej në kob, kur pak para se të përfundonte Lufta e Parë Botërore francezët do ta internojnë me akuzën se ishte pjesë e propagandës së luftës.

„Sikur të gjithë jemi ëndërrimtarë të pavërejtur“ - kishte thënë Skulptori në përcjellje të atij shkrimi dhe i kishte ardhur mirë që ashtu ishte, por njëherësh kishte ndier keqardhje pse ndrydhej.

Dhe, vërtet, ai shkrim i lehtë dhe tejet i çiltër i Zonjës von Braun për dashurinë nuk kishte si të mos ndrydhej a të shfaqej si vesa para diellit, kur ajo merrte në trajtim ato që thoshte se „e vrisnin dashurinë“, që „e pamundësonin të bëhej ajo që është dhe duhet të mbetet“ si „e përhershme dhe e madhe...“

Kjo, sipas saj, ngjante nga shkaku i rrudhjes në përputhje me ato që Koloneli aq haptas i quan „përçarje botërore në emër të librave të shenjtë“, ku „një zot vret zotin tjetër“, gjithsesi „të huajin“, i cili shpallet njëanshëm nga ata që u duhet dhe kjo bëhet me një mllef të atillë sa që u mbyllen udhët të gjitha atyre gjërave që paraqesin mirëkuptim. Koloneli edhe këtë do ta marrë pjesë të tragjedisë shqiptare dhe të pengimit të bërjes së Shqipërisë Shqipëri, nga shkaku se në atë hapësirë që vjen nga lashtësia antike, ku për shekuj e shekuj bindja tek hyji dhe nënshtrimi ndaj tij kishte përcaktuar jetën e lirë dhe krijimtarinë e gjithanshme, besimi i lirë ishte zëvendësuar me „garën e shpifur të zotave“, e cila për fat të mirë dhe në saje të mbetjeve të lashtësisë, kishte dëshmuar se mund të kishte vend edhe për besime të ndryshme, se nuk ishte e thënë që „një zot ta luftojë tjetrin“ po që se kuptohet krijuesi dhe fuqia e tij dhe pranohet ndërlidhja me të në përputhje me të menduarit për të dhe drejt tij dhe jo me ngarendjen pas urdhrave që për pikënisje kanë librat e mbyllur, të cilët përjashtojnë librin e hapur dhe tërë kësaj pastaj i ishte paguar një haraç i madh i kryqëzatave dhe i nënshtrimeve, të cilat çdoherë ishin munduar ta zhvendosnin atë vijën e puqjeve, me synimin që të merrej fundi i njëres dhe fillimi i tjetres dhe që do të përcaktohet nga forca e përdorur dhe derdhja e fuqisë së më të fortit, e jo nga mirëkuptimi i ndërsjellë i asaj që quhet shprehje e lirë e mendësisë...

Koloneli i kishte shtruar ato me ndijimin e atij, i cili sheh nga lartësia dhe mundohet t'i arsyetojë me anën e atyre që për dy mijë e sa vjet kishin ndodhur në ato hapësira nga i kishte rënë fati të shtrihej edhe bota shqiptare, e cila ishte ndarë mbi këto përçarje pa qenë në gjendje ta marrë veten dot dhe në përputhje me të cilat edhe më tutje ndahej dhe copëtohej pamëshirshëm, duke u dënuar njëherësh tepër rëndë pse ishte „edhe e tillë edhe e këtillë“ e pse „nuk ishte e tillë dhe vetëm e tillë“. E, kur kjo zbërthehej, dilte se mallkohej pse ishte çfarë ishte, pse megjithatë përballë atyre rrethanave tepër të vështira kishte mbijetuar, e shumë e shumë meditime të tjera të pafundme, që përsëriten dhe ripërsëriten tek ato njëzet e

dy shkrimet e lëna gjatë mbylljes në teqenë e Leqes, sa nganjëherë nga vlimet e tyre të duken të shkapërderdhura fare, pjesë e ndonjë rrëmuje, ku megjithatë nga ai shfrenim nxirret në pah një tërësi tejet shumëshiresore e të menduarit të veçantë, së cilës i duhet të kuptuarit e drejtë. Ato, ç'është e vërteta, shungullojnë njësoj edhe te kujtimet e Zonjës von Braun, që po ashtu jo rrallë duken si bredhje poshtë e përpjetë, por mrekullisht plotësojnë të menduarit e Kolonelit dhe çështjet, të cilat ai i ngrit deri te kufijtë e një besimi të ri, të domosdoshëm, në të cilin mbështetet ngrehina e të ashtuquajturës *perandori e më të mirës*, së cilës ai i besonte dhe e shihte si shpresë të vetme me të cilën bota jo vetëm që shpëtohej por kthehej kah e mbara.

Të kundruara nga ky këndvështrim, Skulptorit ato i ishin dukur si një tërësi, e cila ishte ndërthurur çuditërisht nga të njëjtat mendime dhe, ndonëse çështjet shihen nga këndvështrimi i fatkeqësisë së botës shqiptare dhe pasojat e krijuara, ato tejkalonin përmasat e saj, për t'u ngritur deri te një trajtim i përgjithshëm, i përhershëm dhe gjithënjëzësor, nga del vlerësimi se edhe ato që pa të drejtë quhen „çështje të vogla“ dhe mëtojnë të shihen si të tilla, paraqesin thelbin e vlimeve të mëdha, ku mund t'u shihet jo vetëm zanafilla, porse edhe përgjithësimi, së bashku me zhvillimet, të cilat Koloneli do t'i cilësojë „pjesë të fatkeqësive të përbashkëta“, të cilat pastaj Zonja von Braun do t'i baraspeshojë „me të përbashkëtën e pashmangshme të dashurisë“, e cila, kur nuk shihet a nuk dëshirohet të kuptohet, kthehet në fatkeqësi të përgjithshme.

Kësisoj, shfaqjen e „zotit të përçarë“, të atij „tjetrit“, të cilin duhet ndjekur dhe vrarë dhe që madje kjo duhet të bëhet në emër të „zotit të njëmendtë“, të atij të shpallur njëanshëm dhe në përputhje me qëllimet e caktuara, ajo do ta quajë „mëkat të tmerrshëm“, të lindur nga „përrjashtimi i dhunshëm i dashurisë dhe i ndijimit të saj, që pastaj do t'i duhet një urrejtje e tmerrshme, do t'i duhet libri i mbyllur dhe verbësia që të veprohet pamëshirshëm për të përmbushur atë që synohet...“

Në vend se të thotë që e keqja e madhe atje kishte filluar me shfaqjen e luftës së besimeve dhe të përpjekjeve të pareshtura për mbizotërim, që kishte mbetur si mallkim i përhershëm veprues, e që madje, në një vend, ku thuhet „mjerë ajo kohë kur besimi i rremë dhe zoti përdoren për të mbuluar grumbuj mëkatesh“, Kolonelit do t'i kalojë në ofshamë të hapur, Zonja von Braun do të theksojë se „gjithë kjo kishte filluar kur dashuria, jo vetëm që nuk ishte kuptuar si duhet, veçse e para gjë që ishte bërë kishte qenë e lidhur me shmangien e pastaj edhe me përjashtimin e saj të qëllimshëm, si çështje e mëkatit të zanafillës, e që në ato rrethana, kur ajo kishte munguar, vendin e saj e kishte zënë urrejtja, e cila kishte vu në veprim ndjenjat më të ulëta të njeriut për thadrimin e së ligës, e cila ishte zhvilluar në drejtime të ndryshme dhe kishte përfshirë thuajse gjithçka për t'u vënë në shërbim të ndasive të vogla e të mëdha, të cilat kanë pushtuar shpirtin e njeriut dhe sikur nuk lejojnë të lirohet prej tyre...“

„Kush nuk dashuron vret pamëshirshëm...“

Ky mallkim, thotë Zonja von Braun, është kthyer në një kob të madh, i cili përhapet e përhapet pandalshëm dhe thellohet në përputhje me urrejtjen dhe ushtrimin e saj në veprim të hapur dhe mund të parandalohet disi vetëm me kthimin e dashurisë aty ku ishte e assesi ndryshe, kur shpallet qëllim dhe ideal i përhershëm gjithënjëzësor.

“Do të vritemi e do të pritemi, do të asgjësohemi dhe vetasgjësohemi nëse e shpërfillim dashurinë dhe ndijimin e saj“, thotë dhe përkujton se „se e kundërta mund të ndodhë vetëm në rrethanat e krijimit të perandorisë së më të mirës“, për të shtuar se aty dhe ashtu „*perëndesha dashuri*“ përjeton shfaqjen e saj të plotë...“

Skulptorit i kujtohet se *çështjen e perëndeshës dashuri* dhe rikthimit të saj, Zonja von Braun e kishte zënë njëherë ngoje në njërën nga ato bisedat telefonike të bëra gjatë nëntë vjetësh dhe nëntë ditësh, kur për herë të parë e kishte shtruar mëdyshjen se a mund t'i besohej kthimit të saj aty nga ishte ndjekur dhunshëm sikur të ishte mallkim i rëndë, prej të cilit doemos duhej liruar dhe që ai nuk kishte qenë në gjendje t'i jepte farë përgjigjeje, sa nga hutimi që i kishte krijuar shtrimi i çështjes kur më së paku e priste, sa nga pamundësia që të

dallonte gjendjen emocionale, në të cilën ndodhej ajo në atë largësi, ku gjithçka ishte e mundshme, përveç qetësisë së natyrshme.

Sikur të kishte kuptuar hutimin, të cilin mbase edhe e kishte marrë parasysh dhe e kishte paraparë që mund të ishte i tillë në kohët, siç i quante, „pa dashuri dhe me plot urrejtje“, ajo do të ndërhynte shpejt e shpejt me ato që i kishte dhënë si shpjegime se „*perëndesha dashuri* ishte më e rëndësishmja ndër perënditë, më e pranueshmja dhe më e reja, njëherësh më e nderuara, edhe pse mund të thuhej se në të njëjtën kohë kishte mjaft shumë kundërshtarë. Ndodhte kështu, sepse qenia e njeriut për t’u shtuar dhe për ta ruajtur shumëllojshmërinë e domosdoshme të përtëritjes dhe ripërtëritjes, menjëherë pas krijimit, si e bashkuar me tri gjini (mashkull, femër dhe hermafrodit – deledash) ishte shfaqur me mangësi, andaj nga Zeusi ishte ndarë qëllimisht në dy pjesë, të cilat, që atë herë, pandalshëm dhe pashkëputshëm ndiqnin njëra-tjetrën. Në atë ndjekje e përndjekje të vazhdueshme për bashkim, lindi nevoja e dashurisë si ndjenjë hyjnore që bashkimin e gjinive të kundërta ta kthejë në një kuptim, i cili lidhet me ripërtëritjen, fërkim ky i përhershëm i të kundërtave që, kur nuk sendërtohen si duhet, krijon urrejtjen, e cila në shenjë hakmarrjeje ndaj bashkimit të pakryer dashurisë i kthehet në hakmarrje rrënuese, që nuk ndahet dot...”

Një copë herë i kishte folur për atë ndarje, që pak nga pak i ishte lidhur me ato, të cilat dikur i kishin mbetur nga leximi i ndonjë shkrimi nga filozofia antike kaherë të dalë nga mendja, por ajo edhe më tutje i kishte folur për to dhe, sa më shumë që e kishte zgjatur, i ishte dukur se përnjëmend ajo kishte nevojë për atë shfrim të veçantë, qoftë edhe me sorollatje të tilla të pafundme. Kjo e kishte bërë ta dëgjonte me durim nga njëfarë bindjeje se atëbotë ato të cilat i kishin ardhur nga ana tjetër e telit rreth *perëndeshës dashuri* dhe gjërave të tjera, të teleisura e të teleisura sikur të ishin qëndisma të përbotshme, kishte pasur prirjen t’i kuptonte më shumë si një mall të natyrshëm për atë që para së gjithash dashuria është dashuri, për atë që kishte mbetur e pathënë dhe e pa përjetuar midis saj dhe Kolonelit, e cila i kishte munguar, e të ngjashme me to, sesa të ishin çështje e një bindjeje më të gjerë, ku dashuria shfaqet si zotërim i përjetshëm i së mirës, si shtysë e përhershme dhe nxitje për t’u pushtuar lartësia e më të mirës me gjithë majat, të cilën vite më vonë, te kujtimet e lëna, do ta hasë si shqetësim kryesor të të menduarit të saj, të cilit i ishte dhënë gjatë kohës së internimit të gjatë francez për të mos iu ndarë më.

Njëherë tjetër, gjithnjë në përputhje me fuqinë e *perëndeshës dashuri* dhe rrëmbimin e saj, i kujtohej se gjatë gjithë bisedës telefonike, e cila si rëndom kishte zgjatur nëntë minuta, ajo i kishte folur për një vashë dhe një djalë, si dhe për fyellin magjik, me të cilin vasha kishte shprehur dashurinë e saj, por një ditë lumturia e tyre ishte shuar ngaqë vashës papritmas i kishte rënë fyelli në të çarën e ujit shkëmbor dhe ajo nga pikëllimi ishte shndërruar në qyqe për të vajtuar fatin e zi, ndërkohë që djali, në mungesë të dashurisë së vashës së shprehur me tingujt e fyellit ishte kthyer në korb dhe në atë gjendje kishin mbetur gjithë derisa një ditë uji mrekullisht kishte nxjerrë fyellin në sipërfaqe diku larg. Ishin tingujt magjikë të dashurisë së liruar prej tij që vashën e kthyer në qyqe e kishin rikthyer në vashë dhe djalin e kthyer në korb e kishin rikthyer në djalë për t’u bashkuar përgjithmonë...

Skulptorit nuk i kujtohet në i kishte thënë se rrëfimin me ngjyrimet e ndjeshme të legjendave shqiptare e kishte nga Koloneli a nga ndonjë përkthim, që asokohe mund të gjendej nëpër të përkohshmet, të cilat ishin plot e përplot me shënime dhe reportazhe nga vizitorët e rastit nëpër ato hapësira, por edhe nga vrojtimitet e shërbimeve të shumta që bëheshin në emër të hulumtimeve gjithfarëshe. Kjo, madje, madje as që kishte pasur ndonjë rëndësi, përveçse ia kishte forcuar bindjen se ato (edhe si të shkëputura, vite të tëra u ishin sjellë nëpër tel gjatë bisedave), kishin qenë pjesë e plotësimit të kujtimeve të shkruara, të cilat i kishin ardhur me postë tri ditë pas vdekjes së saj, e po kjo njësoj mund të thuhet edhe për shumë e shumë pjesëza të bisedave me Kolonelin gjatë viteve të Vjenës dhe veçmas gjatë atyre gjashtëdhjetë e gjashtë ditëve në Shqipëri, kur me sorollatjet e tyre midis linjave të fronteve fatkëqija shqiptare, në ndjekje të përmbushjeve të pikave të hartës së sjellë nga konti

Sorbah, kishin marrë pjesë në atë që mund të quhej uverturë e fillimit të Luftës së Parë Botërore, e cila kishte pasur për pasojë shkatërrimin e shtetit të përkohshëm shqiptar pa iu dhënë mundësia që të vetëdëshmohej, si thuhej, nëpër kancelaritë europiane të vendimmarrjes dhe siç ishte vendosur në atë Konferencën e Ambasadorëve në Londër, së cilës i ishte dashur loja shqiptare bashkë me tragjedinë e saj, që si e tillë edhe me një fatkeqësi tjetër të madhe ia kishte plotësuar përmasat e rrethit të pakalueshëm, në të cilin ishte futur qëllimisht.

Sidoqoftë, të menduarit rreth dashurisë së sinqertë - si shpëtim për njerëzimin e përçarë, që kalonte nga njëra gjendje e mbizotërimit te tjetra dhe nëpër atë kapërcyell fatkeqësitë sa vinin i shtoheshin dhe i shtoheshin në përputhje me interesat e vendosjes së pushtetit të caktuar - Zonja von Braun ia kishte forcuar edhe më shumë koha e internimit gjashtëvjeçar dhe rrethanat në të cilat kishte ndodhur, kur agjentët francezë, të cilët ishin sjellë në Vjenë gjoja si gazetarë të pavarur, e kishin privuar nga liria me padinë se kishte qenë „pjesë e propagandës së luftës së monarkisë danubiane dhe e shtetit imperialist gjerman...”

Skulptori kishte marrë njoftim për gjendjen e Zonja von Braun në fund të Luftës së Parë Botërore, si pasojë e së cilës kishte ndodhur shkatërrimi i monarkisë austrohungareze dhe shpërbërja e dhembshme e vendit në shumë pjesë, pikërisht ashtu si e kishte paraparë thuajse qortueshëm edhe Koloneli në shkrimet e veta gjatë qëndrimit në teqenë e Leqes dhe ai këtë ngujim e kishte quajtur „dënim nga mëkatet ndaj Shqipërisë, jo vetëm pse nuk ishte bërë Shqipëri, siç e meritonte, por edhe pse mbi kurrizin e saj ishin përgatitur gjithë ato prapaskena të asaj lufte të madhe, me të cilat ishin rrënuar shumë vlera të qytetërimit të përgjithshëm...”

Koloneli kishte tërhequr vërejtjen se ai dënim do të vazhdonte të prodhonte edhe më tej pasoja të rënda nëse vazhdon të ruhet edhe më ecuria - Shqipëria të mos përfillet, ose të rrezikohet, siç kishte ndodhur deri atëherë...

„Bota do të përfshihet nga një zjarr i madh, i cili nuk do t'i ndahet përderisa të bëhet e ndërgjegjshme për gabimet që ka bërë dhe derisa nuk i ndreq si duhet...”

Në kulmin e një depresioni të tillë të thellë, kur çdo gjë i ishte nënshtruar një rrënimi tjetër fizik dhe shpirtëror, e që nuk i shihej fundi, i cili më së miri pasqyrohej me përdhosjen e hapur që i bëhej kryeqytetit të vjetër të monarkisë nga ata, të cilët deri dje kishin qenë pjesë e saj dhe në të kishin pasur mundësi të emancipoheshin po edhe të shprehnin dhe të derdhnin të gjitha prirjet qytetëruese, si veçori kombëtare a fetare, pra, një mëngjes të zymtë gjithë lagështi të ftohtë, kur Ballpllazi dhe ndërtesat e tjera perandorake thuajse ishin shkretuar nga parakalimet e militantëve të papërmbajtur të sllavëve të Jugut, të cilët ndihmoheshin edhe nga llumi tjetër i liru nga paqartësia e asaj mbetjeje, jo edhe papritur, disa agjentë francezë nga ata që silleshin „si gazetarë të pavarur” me detyrën që të gjurmonin dhe të kidnaponin krijuesit, por edhe intelektualët e njohur të vendit me ndikim, ishin futur në atelie në Rudolfpallaz dhe, ngaqë kishin thënë se kishin njoftime për frymën e saj në të kaluarën dhe për ato që ishin luajtur aty, kishin marrë një pjesë të madhe të skulpturave me arsyetimin se edhe ato mund të ishin „pjesë e propagandës së luftës”.

Në të dalë, njëri prej tyre, që shtirej si „dashamir i artit”, me apo pa qëllim, (kjo as që kishte rëndësi), sikur të dëshironte të nxirrte diç nga ato të cilat nuk duhej të thuheshin haptas ngaqë edhe më tutje u takonin „fshehtësive ushtarake”, i kishte thënë se Zonja von Braun, që prej kohësh ndodhej diku në Francë dhe sigurisht se e priste gjyqin që mund t'i bëhej sapo të qartësoheshin linjat e reja shtetërore të dala nga lufta, në ç'mënyrë i ishte bërë me dije se jo gjithçka e atij rrënimi kishte përfunduar dhe ishte formësuar në përputhje me përfytyrimet e fituesve dhe qëllimet e tyre dhe që edhe më tutje ajo që merrej si mbetje e turbullt e trungut monarkik, mund të rrinte e qetë, meqë kishte edhe plane të tjera me të cilat mund t'i vazhdonte gjymtimi i merituar...

Kjo as që e kishte befasuar gjithaq, kur shihej qartë se çfarë zhvillimesh do të pasonin pas humbjes së luftës dhe çfarë fryme rrënuese ishte liru nga ajo që deri dje merrej si shembull tejet i mirë i bashkëjetesës së qytetëruar të popujve të shumtë, e cila në hapësirat

perandorake shekuj të tërë kishte pasur një pasqyrim të lirshëm. Madje, edhe marrja e punimeve, me arsyetimin se ishin pjesë e propagandës së luftës, nuk e kishte hidhëruar kundrejt paraqitjes së mllefrit të tmerrshëm që kishte shpërthyer në gjithë vendin nga militantët e vendeve të sllavëve të Jugut dhe agjentët e tyre të panumërt, të prirë nga ata serbë që, po t'u binin në dorë ato punime, do t'i shkatërronin pamëshirshëm dhe do t'i nënçmonin, siç kishin vepruar tashmë me aq vullnet kohëve të fundit me sjelljen e tyre të egër ndaj monumenteve dhe veprave të tjera publike në kryeqytet dhe në gjithë vendin, kur edhe copërina të tyre nuk kishin ngurrar të përdhosnin egërsisht dhe t'i merrnin për "trofe" të „atij çlirimi“ që kinse u takonte pas kohës së gjatë të robërisë.

Përkundrazi, rrëmbimi i skulpturave të shumta prej agjentëve francezë, përballë asaj çmendie që bëhej hapur dhe pa iu qitur dora nga fitimtarët, sikur e kishte ngushëlluar paksa, ngase e kishte ditur se atyre, për qëllime të pasurimit, mund t'u shlyhej edhe autorësia, madje edhe mund të përvetësoheshin dhe të bëhej me to gjithçka tjetër që nënkupton tregtimi, por me këtë i shpëtonin rrënimit, e kjo për një krijues ishte një lloj ngushëllimi.

Në një mbërthim të këtillë ankthi tepër shkallmues, që i ishte dukur shumë e shumë më i rëndë nga ato, të cilat kishte parë dhe përjetuar në Shqipëri, (ajo fatkeqësi edhe mund të arsyetohej me prapaskenat e jashtme, të cilat sikur qëllimisht në atë vend kishin hapur kutinë e Pandorës për ta nxjerrë frymën e saj që nuk kishte të ndalur, e të ngjashme me të), megjithatë edhe më tepër e kishte tmerruar lajmi për marrjen dhe mbajtjen e Zonja von Braun në internim me arsyetimin „pjesë e propagandës së luftës“, ngaqë e gjithë kjo mund t'i shërbente paralajmërimit se ngjashëm mund të veprohej edhe me të dhe me krijuesit e tjerë, të cilët ruanin atë bindjen e vlerave që kishte krijuar monarkia prej kohësh dhe e merrnin për vlerë të tyre, por edhe si vlerë të përgjithshme.

Dy vjet pas kthimit nga internimi francez, që Zonja von Braun i kishte zgjatur gjashtë vjet, e kishte takuar për herë të parë në Berlin. Takimi kishte ndodhur në saje të një letre të dërguar prej saj, ku i bëhej me dije se dëshironte ta shihte sa më parë, por e kishte habitur arsyetimi se atë takim nuk e kishte nxitur kurrfarë nevojë e ndërlidhjes me të kaluarën dhe me pjesëmarrësit e saj, që e kishin me afri dhe thuajse të përbashkët, po bëhej nga njëfarë bindjeje, të cilën, si thoshte, e kishte për shkakun që „pranonte të bisedonte vetëm me të gjallët e vdekur“. Dhe, ndonëse e kishte bërë me dije se për çfarë e merrte dhe si e shihte (në ato rrethana pranonte vlerësime edhe më të rënda, nëse dikujt i duheshin), me atë qëndrim ajo i kishte përkujtuar të kundërtën e asaj, të cilën Koloneli ia kishte paralajmëruar telegrafistit Bruner në kthesën e Mollasit gjatë rrugës derisa shkonin te teqeja e Leqes, ku do të mbyllej përgjithmonë dhe do të priste edhe atë plumbin që do t'i vinte si prej qiellit dhe do t'i thoshte se „nga ai çast i interesonin vetëm të vdekurit e gjallë...“, pra vetëm ata, të cilët i takonin kujtesës dhe mund t'i shërbenin një shëmbëllese që i duhet çfarëdo fillimi, me të cilin kalohet gjendja e rëndë.

Edhe pse kishte dëshiruar t'i thoshte se pajtohej me qëndrimin që e shihte dhe e merrte si të gjallin e vdekur, se madje ndihej ca edhe më keq, pra, i poshtëruar dhe i turpëruar thellësisht, që edhe po të provonte ta shprehte nuk do të mund të gjente fjalë të përshtatshme me të cilat do të përfshihej e tëra, e të tjera si këto, megjithatë kjo takimit të tyre të parë, pas aq shumë vjetësh, do t'ia jepte peshën e një dëshpërimi tjetër të përbashkët, ku do të dalë në pah por edhe do të shprehet gjendja e të gjallëve të vdekur, e të tjera, ngaqë nuk ua kishte marrë mendja se do të ballafaqoheshin me zhvillime aq të paparashikueshme, të cilat vetëm Koloneli kishte qenë në gjendje t'i parashihte dhe madje të tërhiqte vërejtjen se do të jenë të tilla dhe mund të përsëriten po qe se edhe më tutje do të vazhdojë ajo lojë me Shqipërinë dhe me rrënimin e saj, e të ngjashme me të...

Pra, si për habi, gjatë atij takimi Skulptori kishte ndeshur dhe parë një tjetër Zonja von Braun, e cila me ato që kishte filluar t'i thoshte për dashurinë dhe mungesën e saj, të cilat i kishte sjellë e përsjellë me një qetësi të çuditshme, i ishte dukur sikur i shfaqej as e gjallë as e vdekur, një krijesë që tumirte qëndrimin, në dukje mistik, të Kolonelit rreth shfaqjes së

gjendjeve as me jetë as të vdekshme, të cilat ishin të mundshme edhe aty ku ato duken fare të paimagjinueshme.

Dhe, këtë thyerje Zonja von Braun ia kishte pasqyruar më së miri kur, në vend se t'i fliste për të përjetuarit gjatë viteve të internimit dhe për përjetime të tjera, të cilat atë me siguri që e kishin përcjellë pandërprerë, dhe në vend se të dëgjonte ndonjë fjalë nga ato, të cilat i takonin së kaluarës së përbashkët dhe gjithë atyre të cilat në ato rrethana ua kishin përcaktuar qëndrimet dhe botëkuptimet po edhe veprimet, kur ai i kishte thënë si qëllimisht se kishte mbetur pa shumë nga punimet që i ishin marrë dhunshëm nga agjentët francezë me padinë se ishin pjesë e „propagandës së luftës“, të plotësuar me qëndrimin se ndonëse kishte ndodhur ashtu kjo kishte paraqitur një të keqe më të vogël sesa t'u binin në dorë militantëve serbë dhe të tjerëve, (që ato ditë kishin shkretuar Vjenën dhe gjithë hapësirën e dikurshme të perandorisë dhe që këtë e kishin bërë jo gjithaq në emër të hakmarrjes në luftë, me të cilën çirreshin se u takonte „si fitimtarë“, por më shumë për të pasqyruar vrullin dhe fuqinë e „gjeniut sllav“, e cila në hapësirën e Europës Qendrore shfaqej me një krijesë të re të triumviratit shtetëror serb-kroat-sllloven dhe ishte krijuar edhe me arsyetimin se „si e tillë krishterimit perëndimor do t'ia kthente nderin aty ku para pesëqind vjetësh e kishte humbur“, dhe kështu me radhë), pra kur ia kishte thënë këto dhe kishte pritur që ajo të nxirrte dhe të qartësonte diçka nga pjesa e mbyllur e medaljes së saj dhe me të ashtu t'u hapeshin dyert edhe të tjerave që do t'i nxirrnin, në mos për tjetër, sadopak për t'u ngushëlluar, për habi, Zonja von Braun, gjithnjë me shikimin e saj të ngrirë, të mbetur diku në vesën e liqenit, do t'i thotë se „e gjithë kjo kishte për pasojë mungesën e dashurisë, mbetjet e së cilës duhet hetuar dhe nxjerrë nga thellësitë e errëta, edhe atëherë kur duket e pamundur...“ Dhe këtë madje ia kishte përkujtuar me atë bindjen e patundur që sa e sa herë e kishte përsëritur: „në thellësi të shpirtit gjenden shtresime të panjohura të dashurisë dhe të guximit, të cilat duhet të ndihen dhe të nxirren së andejmi...“

Pa përmendur fare monarkinë dhe fatin e saj të zi, që kishte qenë i tillë siç ia kishte paraparë Koloneli, kur të tjerët mendonin ndryshe, pa zënë ngoje asgjë të drejtpërdrejtë të asaj që dikur aq vrullshëm e kishte ndier dhe përfaqësuar madje në opinion si një model të arritur civilizues që edhe më tutje duhej çuar përpara me ide demokratike dhe me frymë liberale, dhe pa thënë as një gjysmë fjale për atë që kishin përjetuar e mbijetuar dhe që pa mëdyshje kishte ushtruar ndikim po gjithsesi edhe ua kishte ndryshuar dhunshëm jetën bashkë me pikëpamjet dhe qëndrimet, gjithnjë duke kapërcyer mbi to, kishte shtuar se „ajo botë ishte shembur dhe mund të shembej edhe më tutje ngaqë kishte qenë e përfshirë nga mashtrimi i dashurisë“ dhe këtë e kishte arsyetuar me të pandehurën se „çdo fatkeqësi ndodh kur nuk tregohet dashamirësi ndaj dashurisë-mirësisë...“, mendim që e kishte nxjerrë nga meditimimi për t'ia treguar ashtu rëndësinë që kishte, por edhe për t'ia bërë me dije nga duhej të sillej.

“Ka ndodhur një mashtrim i madh, me të cilin një kohë të gjatë është jetuar dhe si i tillë ka bërë të mundur shtresimin e urrejtjes... Sepse, ata që kanë folur për dashurinë, janë shtirur... Ndërsa, shtirja ndaj dashurisë shfaqet si njëri ndër mallkimet e pafalshme që një ditë pa tjetër do të marrë haraçin e vet të rëndë...”

Pastaj, sikur të kishte lexuar qysh më parë shkrimet e Kolonelit rreth prirjes shtazarake te njeriu, që është më e afërta dhe e mundshmja, si dhe prirje të tjera, të cilat ai i kishte zbërthyer me një gjuhë tepër të hollë, të lëna gjatë ditëve të fundit të mbylljes në teqenë e Leqes, në pritje të atij plumbi që telegrafisti Bruner kishte thënë se i kishte ardhur si prej qiellit, çastin kur kishte mbështetur kokën për xhami mu aty ku gjembat e trëndafilave ngaherë ishin kthyer në ferra, thuajse ngjashëm i kishte folur edhe Zonja von Braun që prirja për egërsi, e cila është pjesë e së keqes së mbyllur në thellësi, e që paraqet atë gjysmën e pashmangshme, dhe të ngjashme me të, pra ajo shfaqet edhe si çështje gjenetike, ndonëse nuk është e thënë të ndodhë përherë ashtu, po qe se përfillet thirrja e prirjes për ngritje, të cilën Koloneli e quan „ndjenjë perëndie“, por edhe „dhunti hyjnore“ që shfaqet vetëm në saje të ndijimit të saj si kuptim i thellë dhe assesi ndryshe.

Mu ashtu si shkruan Koloneli që „nuk ka përcaktim tjetër jashtë atij *lart a poshtë*“, ku „i pari çon te maja, te fitorja dhe fitimtari“, ndërsa i dyti „te rrënimi, te e liga dhe egërsia e pandalshme“, edhe Zonja von Braun do të thotë se „mungesa e ndijimit të dashurisë sjell zgjimin e bishës“, e cila vepron dhe rrënon pandalshëm derisa të arrihet ai fundi, që nuk paraqet tjetër veçse vetëshkatërrim, vetëngrënie dhe diçka të ngjashme me këto, e cila lidhet me vetasgjësimin e merituar...

„Ata që për një kohë të gjatë kanë mashtruar dashurinë dhe me këtë kanë bërë një mëkat të jashtëzakonshëm, kanë zgjuar bishën dhe ajo ka vepruar ngado qoftë, duke rrënuar vlera të mëdha, pa ngurruar të nëpërkëmb edhe një krijimtari të tërë... Dhe, kjo nuk duhet të çudit pse ka ndodhur kështu, kur përdezja e urrejtjes u hap udhë shfrimeve të tilla të papërmbajtura, të cilat nuk kanë të ndalur... Kjo është për keqardhje...”

Pas një heshtjeje kishte thënë:

„Duhet pritur që vetëm kthimi i dashurisë dhe mrekullia e saj të mundin urrejtjen në të cilën jemi përfshirë, por kjo nuk vjen vetvetiu...”

Kur kishte folur ashtu dhe ato që kishte nxjerrë aq shtruar i kishte theksuar në shumë, sikur të ishte përfshirë edhe ajo në to, Skulptorit i kishte shkruar mendja te shkallimi shpirtëror që ia kishte lënë internimi dhe tek ato, të cilat kishin ndodhur gjatë dhe pas Luftës së Parë Botërore, veçmas me shkatërrimin e rajhut gjerman, me çka ishte tumir mendimi i kahershëm se edhe popujt më të përpiktë dhe të vyeshëm, në rrethanat e kaosit, të shkaktuara nga dridhjet e tërmeteve të mëdha, shfaqen të papërmbajtshëm dhe me huqe të shumta, që, për t'i përballuar ato, janë në gjendje të pranojnë edhe një rend më të dhunshëm me të cilin pastaj mund të prodhohet tirani dhe tirania më e paparashikueshme...

Me këtë përshtypje ishte larguar edhe nga Berlioni dhe ajo sikur i ishte sforcuar gjithnjë më shumë nga bisedat telefonike me të, të cilat kishin zgjatur për nëntë vjet dhe nëntë ditë derisa ditën e nëntë të shtatorit kishin marrë fund përgjithmonë dhe vetëm atëherë Skulptori kishte kuptuar domethënien e tyre tejet të madhe për të, që më vonë do ta shtojnë të pohojë se vitet pa bisedat e përditshme telefonike me Zonja von Braunin, në të vërtetë, nuk kishin paraqitur veçse një kollofitje të pandalshme nëpër atë gjallim të vdekshëm po megjithatë i kishte ardhur mirë që ajo i kishte shpëtuar dhe kjo kishte ndodhur në sajë të nënshtrimit ndaj atij ndijimi me të cilin në çastet e fundit të jetës ishte përpëlitur edhe Koloneli i mbyllur në teqenë e Leqes në përpjekje që fatkeqësinë shqiptare dhe përmasat e saj të kobshme, nëpër të cilat ishte përfshirë ajo botë, t'i kthente në imazhe realitetesh të reja, nga do të dukej ajo e kapërcyeshme dhe e shërueshme, madje kjo të bëhej në sajë të idealistëve të paepur, të cilët ishin në gjendje të jepnin edhe jetën, pa kërkuar kompensim për asgjë...

Pse Zonja von Braun, kur kishte përqaftuar atë përcaktim, të ngjashëm me të Kolonelit, megjithatë nuk e kishte ndjekur ecurinë e kundërt, pra të vendosjes së lidhjeve „me të vdekurit e gjallë“, të cilëve Koloneli u ishte kthyer me aq pietet saqë edhe vrasjet më të thjeshta dhe të papërligjura, me të cilat Shqipëria atëbotë ishte aq plot e përplot saqë mbytej në to, ishin ngritur në shëmbëllesë, si pjesë e qëllimit, por edhe e idealit me të cilin bëhej Shqipëria Shqipëri, kjo as që e kishte befasuar, ngaqë ajo shpjegimin e të gjitha të këqijave e kishte lidhur me mungesën e dashurisë dhe me shfaqjen e urrejtjes si e kundërt e saj, që për Skulptorin kishte qenë e thjeshtë, por edhe tejet e ndërlikuar njëherësh dhe ia kishte krijuar bindjen se përfundimet përkonin me të veçantën e ndijimit të dashurisë dhe qëndrimit të saj, që përcakton lumturinë a fatkeqësinë, bindje kjo, të cilën në rrethana të natyrshme mbase edhe mund ta kuptonte, por në ato nëpër të cilat kalonin, i ishte dukur më shumë se një ngushëllim mashtrues...

Edhe pse Zonja von Braun në kujtimet e lëna, ndijimin dhe kuptimin e dashurisë sikur e kishte kthyer në një çelës magjik për të gjitha çështjet, ku vetëm me të dhe me anën e saj mund të gjendeshin shpjegimet, sa nganjëherë ngjanin në halucinacione që përjashtojnë çfarëdo realiteti nga pamundësia e përballimit me të, në këtë ikje të pandalshme dhe të paluhatshme fare, megjithatë në atë bredhje ëndërrimtare kishte diçka të dhembshme, veçmas kur çështjet barteshin tek ideali dhe domosdoja e tij, ku ato i zbriste dhe nga përgjithësimet, me të cilat mbështilleshin tej mase, i bënte të atilla saqë nganjëherë të dukeshin si pjesë e uratës që u duhej të thyerve të mbahen ashtu pafundësisht as gjallë as vdekur, por me shpresën se ia vlente të besohej në diçka, qoftë ajo edhe fanitje e pasosur...

Megjithatë, me ato që thoshte rreth domosdoshmërisë së dashurisë, Zonja von Braun mbetej larg kthimit të saj në frymën e mirësisë dhe të asaj, e cila përkon me mëshirën dhe predikimet që mund të merren si çështje religjioze. Përkundrazi, sikurse edhe Koloneli në shënimet e lëna gjatë mbylljes në dhomën e madhe të ziqrit të teqesë së Leqes kur ishte në pritje të atij plumbi, i cili do t'ia gjente kokën ditën e njëzetepestë të mbylljes, edhe ajo, gjithnjë duke bredhur nëpër zigzage të shumta, ku pjesërisht përjashtohej përditshmëria (veçmas ajo nëpër të cilën kalohej), do të dallojë të mirën e dashurisë nga mirësia, po që me asgjë të mos ngatërrohet me mëshirën, së cilës pastaj i duhet shpëtimi dhe shpëtimtari, që njeriun e mbajnë peng të mësimëve të tilla, të cilat lidhen me besime të caktuara, e që doemos shpijnë në pendim dhe falje, ku edhe mëkati është i falshëm, me kusht që të lahet me anën e të rrëfyerit, ndaj të cilave ajo edhe më parë kishte një qëndrim të prerë që me asgjë nuk i afronte.

„E mira e dashurisë buron nga fryma e dashurisë dhe lidhet me ndijimin e dashurisë, për t'u kapur dhe për t'u kuptuar njësoj si diçka e pazëvendësueshme, pa të cilën dashuria nuk bën...“, thoshte ajo. Këtë mendim Skulptori e kishte kuptuar si tumirje të kredos së Kolonelit rreth *perandorisë së më të mirës* dhe vendosjes së pushtetit të saj, që atij i kishte kaluar kjo në bindje, thuajse halucinative, dhe këmbëngulte se vetëm ajo ishte në gjendje ta shpëtonte botën nga shkatërrimi në të cilin ishte përfshirë me atë luftën e madhe, që flaka tashmë i ishte futur në Shqipëri dhe do të mbetej e ndezur derisa të sendërtohej.

Duke iu bashkuar arsyetimeve të Kolonelit, po që ajo i kthente te dashuria dhe domosdoja e ndijimit të gjithanshëm dhe e nënshtrimit të plotë ndaj frymës së saj, me ç'gjë mendonte se përjashtohej urrejtja si parakusht kryesor që ushqen demonin e të ligës drejt së keqes për t'u kthyer në fatkeqësi, Zonja von Braun Shqipërinë e Kolonelit do ta shohë në *përbërje të perandorisë së më të mirës*, me ç'rast në një pjesë të madhe të kujtimeve do të bëjë përpjekje ta arsyetojë pikërisht këtë, gjithnjë në përputhje me përcaktimin e dashurisë dhe iluzionin se fuqia e saj (që tashmë i kishte kaluar në bindje ngërthese marramendëse), dhe vetëm ajo është në gjendje t'u bëjë ballë të gjithave. Në mbështetje të kësaj ajo do të thotë se bërja e Shqipërisë Shqipëri, - refren, të cilin Koloneli që moti e kishte bërë ideal, dhe në ato njëzet e dy shënimet e lëna në teqenë e Leqes, kur ishte në pritje të vrasjes së paralajmëruar, kishte bindjen se me anën e saj i hapej rruga një kthese të mbarë për të gjithë, që e quante rifillim, e herë-herë ribërje dhe rilindje - paraqiste „një hap të rëndësishëm drejt dashurisë“, që ajo e quante „të devotshme“, „të amshueshme“ dhe, kur krahasohej me qëllimet madhore, merrej edhe si mbidashuri, e cila mund të përkufizohej me një perceptim të veçantë filozofik, kuptimet e së cilës thuajse shfaqeshin fare të hapura me rrezikun që të dukeshin pjesë e ndonjë fluturimi ëndërrimtar, të cilat u qepen atyre që përjashtojnë realitetet e hidhura, pikërisht pse janë të papërballueshme dhe të pakalueshme...

Gjithsesi, duke mbajtur parasysh sheshimet që bënin kundrimet e tilla, me atë „hap të rëndësishëm“, ajo parashihte kthesën e madhe, të cilën do ta quajë „dashuria Shqipëri“, me të cilën merrte udhë „dashuria e gjithmonshme dhe gjithënjëzore“, pra ajo që i duhej *krijimit të perandorisë së më të mirës* dhe vendosjes së pushtetit të saj, iluzion që e kishte nga Koloneli, me të cilin ai ishte ushqyer në çastet më të vështira kur priste atë plumbin e paralajmëruar, të cilit asses i t'i ikte (për këtë madje as që i kishte shkruar mendja ndonjëherë), dhe ishte i

kuptueshëm përballë fatkeqësisë së tmerrshme, e cila kishte mbërthyer botën shqiptare dhe gjithçka të saj. Porse, Zonja von Braun, pavarësisht realiteteve të reja, të cilat ishin kushtëzuar me rrënimin e dy perandorive më të mëdha të kohës (austrohungareze dhe osmane), në të cilat mund të thuhej se, pos të tjerash bënte pjesë edhe shteti torzo shqiptar, të cilit, çuditërisht, në sajë të ndërhyrjes amerikane në çastet e fundit arriti t'i ruhej fara e t'i shpëtonte shpërbërjes, siç kishte vepruar në prag të luftërave ballkanike, gjatë tyre po edhe më vonë - kur krijesa e copëtuar Shqipëri ishte vendosur në tryezën e bisedimeve të Konferencës së Londrës dhe aty merreshin masa dhe përvijoheshin plane për ta cunguar edhe më shumë, për të mbetur kështu e gjymtë dhe me patogjenë, të cilët do ta çonin buzë varrit, andaj kishte ngritur zërin në të katër anët e botës që të shpëtohej nga masakrimi duke u njohur shtet i pavarur - ngjashëm do të veprojë edhe në kujtimet e saj. Por, këtë herë, (edhe pse ato kishin nisur të shkruheshin dymbëdhjetë vjet pasi kishte mbaruar ajo Lufta e Parë Botërore e madhe dhe në Ballkan dukej që shumëçka kishte filluar të merrte frymë sikur të ishte harruar gjakosja e deridjeshme, që çështjeve të mos u hiqej velloja e mashtrimit, prapa së cilës kishin kurdisur dredhi e harta të reja për t'u zhytur thellë e më thellë në batakun e padrejtësive), si të ndodhej në një botë tjetër, çdo gjë e kishte kthyer te dashuria, qoftë që ajo duket edhe shpallje publike, me të cilën i përkujtohet domosdoja...

Në të vërtetë, e ashtuquajtura „dashuri-Shqipëri“, që do ta preokupojë aq shumë Zonjën von Braun në ato kujtime të lëna, sa të duket si një shkrim i paparë e i pandalshëm madje, (një si përzierje e çuditshme e vlimeve të mendjes dhe të shpirtit, ëndrra dhe zhgjëndrra të mjegulluara njëkohësisht), nuk është vetëm një thirrje morale për bërjen e saj si një shpagim ndaj një padrejtësie, që botën do ta shpëtojë nga më e keqja, në të cilën ishte katandisur, e me të cilën do të merret aq shumë edhe Koloneli dhe atë do ta kthente në një moto, me të cilën do ta presë edhe atë plumbin i cili do t'i vijë si prej qiellit ditën e njëzetepestë të mbylljes në teqenë e Leqes, por sipas saj, bërja e Shqipërisë Shqipëri, ia kthente qytetërimit të saj muzeun më të çmueshëm si djep i tij...

Duke kaluar nëpër këta rreshta, të cilët sikur nuk kishin fund, Skulptori, i cili asnjëherë nuk kishte qenë në gjendje të pranonte qasjet ditore dhe ecuritë e tyre, e që kjo nganjëherë mbase edhe i ishte kthyer në vështirësi për marrëveshje me mjedisin, kishte mbetur i habitur me aftësinë e Zonja von Braunit që një gjuhë politike tejet të ashpër dhe tejet të drejtpërdrejtë - me të cilën kishte bërë opinion në prag të Luftës së Parë Botërore dhe gjatë saj, duke ndikuar mbi të aq sa francezët ta ndjekin dhe, pasi ta kapin, ta shpallin edhe pjesë të propagandës së luftës dhe ta dënojnë me internim të gjatë - ta kthente në një si traktat etik-filozofik të kapshëm, por edhe të pranueshëm njëherësh, me dashurinë dhe kërkimin e saj si argument të përhershëm që, po të shikohej e thjeshtuar, as vrasësit më të mëdhenj nuk mund ta kundërshtonin a ta përjashtonin...

Kështu, *dashuria-Shqipëri*, do të marrë përmasat e një rrëfimi tejet simbolik, i cili do ta shpjerë në një përgjithësim të paparë, i cili i afrohet jo vetëm ndijimit, por edhe plotësimit, pa të cilin nuk ka pranim, çështje kjo, në mbështetje të së cilës me siguri se ishin bërë hesapet dhe ishte mbajtur parasysh, madje përkundër të dhënës se kujtimet i kishte marrë si personale, të mbyllura, të cilat duhej ta përcillnin në vetminë e përjetshme, e të tjera si kjo, që për fat, nipi Gynter Hajer, (pasi mund të merret me mend se ua kishte lëshuar një sy dhe kishte qenë i vetëdijshëm për rëndësinë e tyre bashkë me nevojën që të mbeteshin porosi e hapur që duheshin për të kuptuar një kohë me plot kthesa, shembje dhe çrregullime gjithfarësoj, çfarë kishin qenë ato të dhjetëvjetëshit të parë dhe të dytë të atij fillim shekulli, të cilat botës i kishin dhënë një dukje tjetër), qëllimisht ia kishte dërguar Skulptorit për një shikim që të liroheshin nga mbërthimi e për t'u bërë publike. Dhe Skulptori, pasi i kishte lexuar disa herë me shumë vëmendje dhe me mall, siç veprohet me gjëra tejet të afërta dhe tejet të çmueshme, i kishte përshkruar dhe origjinalin ia kishte kthyer të nipit në Berlin, me porosinë se nëse nuk do t'ia delte t'i botonte ndonjëherë si kujtime të veçanta, të cilat doemos se duhej të shoqëroheshin me ato të Kolonelit dhe rreth tyre madje të jepej një si shënim përcjellës me

sqarime plotësuese për t'ua parë të veçantat dhe të përbashkëtat e tyre, atëherë t'i dërgonte në Arkivin e Shtetit në dosjen e hapur të Shqipërisë, që të paktën aty të mbeteshin të mbrojtura.

Por, ato të cilat Koloneli do t'i thotë për domosdonë e bërjes së Shqipërisë Shqipëri, që botës t'i shuhet kështu një zjarr, i cili përherë do t'ia mbajë flakën të ndezur dhe kur ngjashëm do të shkruajë se *„është një dashuri e hapur, e cila duhet të ndihet, duhet të përjetohet thellësisht dhe të pranohet si diçka e madhe që buron nga ndijimi hyjnor...“*, Zonja von Braun do t'i baraspeshojë me dashurinë, e cila shfaqet si mbidashuri dhe mund të krahasohet me idealin më të lartë që njëherësh ishte edhe preokupim i Kolonelit, i cili thoshte se *„ai dhe vetëm ai bën të mundshëm ndryshimin e botës për të mirë...“*

Dhe, kur çështjet zbërthehen mirë e mirë, atëherë shihet qartë se fatkeqësia shqiptare nuk mund të ishte tjetër veçse pjesë e fatkeqësive të përgjithshme në shpërthim e sipër, të cilave njësoj u duheshin recetat e përbashkëta të shpëtimit, që atëbotë mund t'ua vinin vetëm nga ata, të cilët ishin në gjendje që pësimeve të mëdha t'ua kuptonin shkaku thelbësor dhe që andej t'i bartnin te domosdoja e mësimit...

Natyrisht se e mbërthyer nga kjo përplasje mendore dhe shpirtërore, njëherësh, që nuk do t'i ndahet dot, thuajse të gjitha arsyet e shtruuara të Kolonelit rreth domosdosë së bërjes së Shqipërisë Shqipëri ngaqë ashtu shpëtonte vetveten.

„Bota do të digjet dhe do të digjet gjithë derisa ta kuptojë se fitili i zjarrit ndodhet në Shqipëri dhe te bërja e saj...“

Ose:

„Në atë rraskapitje me vetveten, një ditë bota do të kuptojë se shpëtimin e gjen vetëm te Shqipëria, së cilës, më në fund, do t'i kërkojë falje dhe ajo duhet t'ia falë zemërgjerësisht të gjitha mëkatet e bëra...“

Këtë qëndrim me të cilën, nga pikëpamja politike, Zonja von Braun, ishte pajtuar deri në pikë të fundit, megjithatë do t'i zbresë te nevoja e dashurisë dhe ndijimi i saj i përhershëm, me çka atë e ngrinte te një çështje e veçantë shpirtërore, që u takonte të gjithëve, madje edhe atyre që punonin kundër saj...

Gazetarja e njohur, e cila aq shumë analiza kishte derdhur në faqet e gazetës „Die Press“ rreth problematikës ballkanike në prag të krizës lindore dhe gjatë kthimit të saj në një luftë të hapur, me theks të veçantë mbi atë shqiptare - duke parë tek ajo gjithë nyjën e çështjes, kur mbi hapësirën e saj do të fillojnë edhe ato dridhjet e mëdha që do të sjellin luftën botërore, të cilën pakkush e kishte pritur të ishte e atillë sa të shembeshin perandoritë më të mëdha të kohës, sikur të mos ishin, për ta zënë vendin e tyre krijesat e paqëndrueshme shtetërore, në radhë të parë ato të sllavëve të Jugut, që më vonë do të shihej të bëheshin shkaktare edhe për atë luftën tjetër botërore, të Dytën me radhë, (të cilën Koloneli në shënimet e lëna të teqesë së Leqes e kishte paraparë pikë për pikë, duke shkruar aq larg me ato që parashihte saqë çështjen e pazgjidhur shqiptare dhe pasojat e saj t'i vendoste në qendër të çrregullimeve të mëtutjeshme botërore, që mund ta përcaktojnë madje edhe atë, të cilën ai do ta quajë „kohë e kryqëzatave bashkëkohore“, e të tjera si këto) - në sajë të atyre që kishte shkruar për dashurinë dhe nevojën e saj, sikur nuk e kishte pasur të vështirë që vlerësimeve të thëna me profeci të jashtëzakonshme t'ua ballafaqonte ato që i detyroheshin asaj të pandehure të qëndrueshme. Dhe, ashtu si kishte vepruar me përjashtimin e kohës si përditshmëri nëpër të cilën kishte kaluar, njësoj kishte anashkaluar edhe ngjarjet dhe të dhënat bashkë me ato që kishin sjellë, për t'i kthyer çështjet te ndijimi i përhershëm shpirtëror i dashurisë dhe domosdoja e saj që me asgjë nuk mund të mashtrohet...

„Bota do të digjet dhe do të digjet përderisa të kuptojë se fitili i zjarrit ndodhet te dashuria ndaj Shqipërisë dhe shpallja e saj, me të cilën ajo pranohet...“ do të thotë Zonja von Braun, për të shtuar se *„në atë rraskapitje me vetveten, një ditë bota do të shohë se shpëtimin e gjen vetëm te dashuria Shqipëri dhe te dashuritë e ngjashme, të cilën duhet ta pranojë dhe t'i pranojë, në ç'mënyrë i marrin fund mëkatet e saj dhe i hapet rruga e dashurisë së përhershme...“*

Shpallja e *dashurisë Shqipëri*, si dhe nevoja e njohjes së saj me siguri se do të ishte e mangët pa u përjetuar thellësisht nga ana e vetë shqiptarëve, të cilët do të duhej t'i nënshtroheshin përherë asaj ndjenje fund e krye, që gjithsesi, ashtu si kërkohej, paraqet shpëlarjen e tyre nga mëkatet që me qëllim apo pa qëllim, me vetëdije apo pa të, kishin bërë kundër saj dhe ishin të shumta e të pafalshme, veçmas gjatë përpjekjeve për t'u bërë e pavarur, natyrisht siç e meritonte.

E dëshpëruar nga ato që kishte lexuar nga Koloneli për "meritat" e vetë shqiptarëve që tragjedia e tyre të bëhej edhe më e madhe dhe që, për fat të keq, kjo ishte pasqyruar me një mllef të jashtëzakonshëm e të papërmbajtur kundër qenies së saj shtetërore, në një kohë kur ajo më së shumti kishte nevojë për atë vetëdëshmim të vështirë, të kushtëzuar djallëzisht nga jashtë, nëpër rrethana të cilat mund të quheshin „me qenë ose mos me qenë“ dhe e njoftuar nga shtypi për sjelljen e pjesës dërrmuese të popullsisë së saj ndaj Qeverisë së Përkohshme dhe ndaj mbretit, të cilit i kishin shkuar në ndihmë edhe vullnetarë nga vende të ndryshme pa kursyer as jetën, ndërkohë që shumë prej shqiptarëve, sikur të ndienin nevojën për një zbrazje të së keqes së paparë e cila u ishte grumbulluar dhe pashmangshëm kërkonte të shkrehej aty ku nuk duhej, e kishin luftuar me mish e me shpirt duke u bërë palë e vrasësve të saj të shumtë që gjendeshin edhe në radhët e Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit, i cili kishte për detyrë ta mbronte deri ta merrte veten, (dhe këtë nuk e kishte bërë), por edhe gjendeshin kudo dhe ngado, të gatshëm ta shpinin bashkërisht te grahma e fundit, pra në atë përpëlitje me mllefin e madh nga jashtë dhe brenda, të bashkuar kundër saj, Zonja von Braun kishte kërkuar që *dashuria Shqipëri* të zinte vend te secili shqiptar. Këtë ajo e kishte shprehur me një thirrje të atillë që vetëkuptonte pikësëpari lirimin nga helmi i urrejtjes që ua kishte mbërthyer shpirtin vazhdimisht, e pastaj t'i flaknin edhe huqet tjera me të cilat ishin pushtuar në saje të mbërthimit të shpirtngushtësisë dhe lakmisë mesquine në vend që t'u jepeshin lartësive...

Mandej, pas atij pastrimi si shërim, kërkonte të pranohej fryma dhe ndijimi i saj i përhershëm, pa të cilin nuk ka as ribërje dhe as rifillim e as rilindje e të tjera si këto, që Kolonelit i kishin kaluar në një përndjekje mendjeje, pikërisht pse e kishte ditur se prishjet dhe rrënimet e mëdha përherë sjellin te ajo që quhet sëmundje e shpirtit, e cila shenjat e para i shfaq me humbjen e aftësisë për ta parë ardhmërinë dhe shpresën, gjë që për pasojë ka gjithë ato shfrime të papërmbajtshme që nuk paraqesin tjetër pos luftë të tmerrshme kundër vetvetes...

Në përputhje me këtë përcaktim, Zonja von Braun kishte bërë atë të cilën nuk e kishte bërë as Koloneli, aq i dhënë pas idealit të bërjes së Shqipërisë Shqipëri, po që nuk e kishte bërë dhe askush tjetër, kur një thyerje të madhe shpirtërore dhe morale të shqiptarëve, që pas të gjitha atyre që kishin ngjarë me ta në prag të Kongresit të Berlinit dhe më vonë, sa dukej që ishin pajtuar me mallkimin të ngjashëm me atë që asokohe një poet shqiptar e kishte shtyrë të nxirrte klithmën „*e mjera Shqipëri*...“ (e cila si thirravaje thuhet në shumë pjesë të botës së shkapërderdhur shqiptare kishte marrë përmasat e një dëshpërimit të madh), pra kur dukej se nuk kishte shpëtim nga ajo rënie, atë kujë dhe atë gjëmë të pandalshme, ajo do ta kthejë në thirrjen: „*e dashura Shqipëri*...“ si një nxitje shpresëdhënëse dhe kuptimplotë dhe, krejt ato veçori të mira, me të cilat ishte stolisur, si „*zonjë e rëndë*“ e të tjera të ngjashme, që i mbante në të kaluarën e saj, do t'i bashkërendojë me të tashmen dhe me të ardhmen e vet...

Moton „*e dashura Shqipëri*“, me të cilën njëherë e mirë ishte përjashtuar gulçima „*e mjera Shqipëri*“, me gjithë barrën e madhe dëshpëruese që e kishte shoqëruar pranimi i asaj gjendje, Zonja von Braun, me ndihmën e po atyre vargje të asaj poezie, do ta kthejë në një manifest të ri, kur thirrjen tashmë të kthyer në metaforë: „*feja e shqiptarit është shqiptaria*“, e cila për fat të keq gjatë ngjarjeve të fundit ishte përdhosur keqas sa të dëshmohet e kundërta, do ta shqiptojë në një dritë të re:

„*F e j a e shqiptarit është d a s h u r i a...*“

Rishikimi, ku një kombëtarizëm, në të cilin gjatë kohë nga elita intelektuale dhe ajo politike ishte derdhur aq shumë mund për t'ua ngritur deri te një manifest i hapur siç ishte rilindja kombëtare, shpallet dashuri, Skulptorin do ta trandë dhe njëherësh do ta mbushë me një ndijim të jashtëzakonshëm, ngaqë nuk ia kishte marrë mendja se mund të shkohej aq larg dhe aq thellë sa të merret guximi dhe e drejta të preket edhe aty ku mbase as Koloneli nuk kishte denjuar të vinte dorë nga frika e keqkuptimit, por edhe e tronditjes që sjell ndryshimi i një përcaktimi që kalon çdo kufi...

Ç'është e vërteta, Skulptori, s'është që nuk kishte hetuar edhe më parë diçka të atij tundimi që aq fuqishëm do t'ia hedhë përpara Zonja von Braun njëzet e pesë vjet pasi ishte larguar nga Shqipëria në përmbushje të thirrjes për bashkimin forcave perandorake në luftë kundër Serbisë, të shpallur nga perandori Franc Jozef më nëntëmbëdhjetë korrik të vitit një mijë e nëntëqind e katërmëdhjetë, vetëm disa ditë pasi princi Ferdinand ishte qëlluar për vdekje në Sarajevë nga plumbat e „dorës së zezë serbe“, (asaj për të cilën kishte njoftime se më vonë kishte vepruar edhe në Kosovë dhe viset tjera shqiptare me detyrën që t'ua humbte fare shqiptarëve), dhe me këtë kishte filluar Lufta e Parë Botërore, e cila prej pakujt në Vjenë dhe në Berlin ishte marrë me mend se do të përfundonte me pasoja të kobshme për monarkinë danubiane, atë të Bosforit dhe për Gjermaninë vilhelmiane. I kujtohej se në njërin nga ato ditë të bredhjeve të pafundme nëpër vijat e fronteve të luftës ndërshqiptare, kur tashmë dukej se forcat e Qeverisë së Përkohshme gjithnjë më shumë po e humbnin dheun nën këmbë para kundërshtarëve të saj - që vinin nga të gjitha anët dhe që betim të përbashkët kishin shkatërrimin e saj sa më parë, në pjesën që hapësirën e Durrësit e lidhte me atë të Tiranës, në një vend as çufrajë as moçalishte, ku thuhej se gjendeshin trupat e Ahmet bej Matit në pritje të kujdesshme që t'i vinin në ndihmë mbretit, (së paku t'i lanin hesapet me forcat e Haxhi Qamilit dhe me fanatikë të tjerë, të cilët në pjesët jashtë mbikëqyrjes qeveritare haptas kishin shpallur flamurin e gjelbër dhe çirreshin „duam babën“, duke u kërcënuar se „e gjithë botës do t'i vihej çevreja jeshile“, që thoshin se „tashmë kishin nisur ta hapnin e ta përhapnin në të gjitha anët...“), pra, në atë pikë të vetme të shpresës së flashkët shqiptare, e cila mund të shfaqej si një mrekulli nëse matjanët do t'ua përmbaheshin zotimeve për ta mbrojtur Qeverinë e Përkohshme (që për habi nuk kishte ndodhur) - në atë farë katandisje të pandalshme, në katundin e vogël dhe të shkretë Fikas, kishin ndeshur gjurmët e para të vëllavrasjes së hapur shqiptare, e cila u kishte dalë përpara me kufoma të shumta, të cilat, të lëna e të shpërndara, nga vapa e madhe e korrikut kundërmonin rëndë. Kjo kishte ndodhur një ditë më parë kur ditën e festës së bajramit të madh dikush kishte përdhosur xhaminë e vogël me kokën e një derri, e që kjo kishte mjaftuar që njëra lagje të mësyjë tjetrën për të nxjerrë hak flakë për flakë për atë poshtërim që i ishte bërë Allahut të tyre, gjuhën e të cilit asnjëherë nuk kishin pasur rastin ta kuptonin si duhej, ngase nuk e merrnin vesh dot, ama kjo nuk u kishte penguar t'ia dëshmonin përkatësinë kur i duhej, ndërkohë që edhe të tjerët, të ardhur nga katundi tjetër, gjithnjë në emër të Krishtit të tyre, njësoj ishin sjellë me ata që i kishin gjetur pranë xhamisë, sado që të gjithë ishin të një fisi, njerëz hallemëdhenj që mezi kishin mbijetuar dhe, ajo që më së paku duhej t'i përçante e t'i yshte kundër njëri-tjetrit, ishte kisha e xhamia, besimi ndaj të cilave thuajse me asgjë nuk ua kishte plotësuar premtimet dhe predikimet se në këtë botë kishte sadopak barazi dhe të mira për të përvuajturit e shumë...

Përballë tmerrit të asaj kasaphane, kur Koloneli kishte urdhëruar jevgjit e Kavajës t'i varrosnin bashkërisht ato kufoma të shkreta, pa u përfillur kryqi e gjysmëhëna, që i kishin varur në qafë, pra duke kaluar nëpër atë ploje të tmerrshme pa qenë në gjendje që me asgjë t'i ndihmohej zbutjes e lërë më kapërcimit të saj, studenti Zenel Xhema, të vetmin ngushëllim kishte vargjet:

*„O moj Shqypni, e mjera Shqypni,
Kush te ka qitë me krye n'hi?...“*

Vargjet, të shoqëruara me shumë e shumë të tjera të ngjashme, të përsëritura e të ripërsëritura dhe të shqiptuara zëshëm si pjesë e një mundimi të rëndë, jo që nuk e lironin nga shqetësimi i përfshirë, porse i ngjante që krejt kjo i kthehej në një shtrëngim zemre dhe në ankth.

Kjo e kishte prekur edhe Kolonelin, i cili ishte munduar disi të përmbahej nga përshtypja e rëndë, të cilën ia kishte krijuar ngjarja, që njëri nga jevgjijt ia kishte përshkruar hollësisht me gjithë tmerrin e asaj që kishte ndodhur ditë më parë, saqë i ishte afruar dhe për pak e kishte marrë ngrykë sikur të kërkonte sa më shumë pjesëmarrje por edhe shpëtim në atë shfrim që për një çast kishte përshtypjen se mund të ishte edhe pjesë e ndonjë zbrazjeje të papërmbajtshme krenarie?...

Por, studenti Zenel Xhema assesi të merrte veten. Klithmën vajtuese *“e mjera Shyqpnj”* e kishte shoqëruar me veçimin e të kundërtës sikur dëshironte të përkujtonte diçka të madhe, që duhet rikthyer:

*“Ti ke pas kenë një zojë e randë,
Burrat e dheut të thirrshin nanë...”*

Ai shqiptim i butë megjithatë Skulptorit ia kishin krijuar njëfarë tingëllimi tërheqës, që sado që nuk e njihte shqipen, i vinte thuajse melodik.

„Është këngë morti“, i kishte thënë studenti Zenel Xhema, kur kishin lënë katundin e shkretët me varrin e përbashkët sipër tij, i cili si kudo nëpër hapësirën e shkretët që ndante linjat e fronteve ndërsqiptare, u mbetej në mbikëqyrje jevgjje të Kavajës, të cilëve që në fillim të bredhjes së tyre nëpër atë hapësirë të askujt, ua kishin dhënë mushkat e vetme që kishin pasur me vete të përkujdeseshin për të vrrarët e shumtë, të lënë ashtu të shpërfillshëm e të nënçmuar, kudo që qëlloheshin para se të bëheshin kërrma...

Më tutje studenti Zenel Xhema i kishte treguar se atë poezi e kishte shkruar një rilindës i njohur, titullar i lartë shqiptar në Perandorinë Osmane, që kishte kërkuar bashkim, porse shpejt ishte dëshpëruar nga e kundërta.

„Mbase ka pritur tepër nga ata, të cilët e kishin pasur të vështirë t’i përballonin aq shpejt ngarkesat e të dy botëve, që u kishin mbetur si barrë tepër e rëndë që prej shekujsh, për t’u përcaktuar ashtu si duhej në prag të shembjes së madhe, të cilën as kishin mundur ta pengonin as të ndikonin përveçse të hiqnin pasojat e rënda të saj...”

Kështu i kishte thënë Skulptori sa për ta ngushëlluar disi edhe pse e dinte se ashtu hapej një çështje e veçantë së cilës i duheshin shqyrtime të gjëra të cilat tek e fundja shpinin te nyja e asaj lufte dhe të tjerave, vlerësime këto që i kishte edhe Kolonelit, i cili, kur merrnin në shqyrtim tronditjet që i kishin paraprirë fatkeqësisë shqiptare, edhe ai, po ashtu, në kërkim të shpjegimeve, sillej në atë drejtim pa qenë në gjendje ta përballonte atë mjegullim.

„Ka pritur vetëm të mos ketë luftë fetare...Asaj më së shumti ia kishte frikën, ngaqë aty shihej fitilin e të gjithave...” i kishte thënë studenti Zenel Xhema tronditshëm.

„Ç’ e do që trysnisë së saj nuk u kanë bërë ballë as të tjerët...” ia kishte kthyer ai gjithnjë me përshtypjen pamjes trishtuese të asaj tragjedie në atë katund të shkretët.

„Ne jemi pak. Jemi në gojë të ujkut...”

Skulptori kishte heshtur ngase çka do që do të thoshte nuk do të mjaftonte për t’ia rrëzuar atë mendim. Ndërkohë, studenti Zenel Xhema kishte filluar t’ia përkthente në gjermanishte disa nga vargjet, po sikur dukej se nuk ua gjente ritmin e brendshëm nga shkaku i rimave që i shkonin tetërrokëshit melodik, të cilin ishte e vështirë ta sajoje, por dikur, në pamundësi që të nxirrte diçka më shumë nga fryma e tyre, kishte bërë një përkthim të lirë kuptimor, ku i kujtohej theksimi i vargjeve rreth asaj që të mos shikohen kisha e xhamia, ngaqë feja e shqiptarit ishte shqiptaria...

„Fjalë tepër të guximshme“, i kishte thënë Skulptori.

„Shumëkush i shesh si çështje të një programi kombëtar, që megjithatë, jashtë rrethanave të dhëna, duken ndryshe...” i kishte thënë studenti Zenel Xhema gjithë mëdyshje dhe kishte shtuar se „deklarimi për përcaktim kombëtar, si program i përbashkët dhe që

tingëllon bukur, nuk mund të përjashtonte sa ora atë që mund të merret edhe si identitet etnik, ku besimi, pa marrë parasysh se çfarë është, sa përqafohet dhe si trajtohet nga brenda, ndonjëherë merret si pjesë parësore e atij identifikimi...”

Natyrisht se ai kishte të drejtë, madje jo vetëm pse i rritur dhe i shkolluar në Vjenë nga prindër që kishin ikur nga krahina e Toplicës gjatë pastrimeve të përgjakshme të bëra nga armata serbe në dimrin e viteve 1877-78, me rastin e pushtimit të tyre, ku kishte vrarë dhe prerë pamëshirshëm popullatën e pambrojtur shqiptare të shtrirë në dyqind e sa vendbanime të vogla e të mëdha në një hapësirë të lidhur me vilajetin e Kosovës prej mbi dhjetë mijë kilometrash katrorë, që për fat të keq vetëm një pjesë e vogël e saj ia kishte dalë të ikte në Kosovë dhe tjetra në Turqi. Pra, përkundër rrethanave të reja, ai ndihej si pjesë e një mozaiku të shkëputur, të cilit tashmë i mungonte platforma dhe kornizat në të cilat mund të qëndronte, siç kishin qenë ato shumëshekullore perandorake, po edhe ngaqë ato shkëputje sikur shkonin andej nga përjashtoheshin fijet që lidhnin civilizimet dhe kultura të tjera, që deri atëherë mu kjo kishte paraqitur tërësinë e saj bashkë me atë brumin që e kishte mbajtur...

„Ne jemi një popull i lashtë, por me tre besime dhe disa nën besime, e pikërisht kjo para të tjerëve na bën të veçantë dhe të lëndueshëm, madje...”

„Si ta marrësh“, i kishte thënë Skulptori, i cili kishte shtuar se bashkëjetesën shqiptare të besimeve e shihte si veçori tejet të mirë, shpresëdhënëse madje edhe për të tjerët, që flet më shumë se për një durim të ndërsjellë, të cilin e kanë kushtëzuar rrethanat nëpër të cilat është kërkuar mbijetimi i domosdoshëm, prej të cilit duhet mësuar dhe marrë shembuj të mirë në vend se të kërkohej e kundërta.

„Shembulli shqiptar duhet t’i shërbejë një ekumenizmi të ri, që botës i duhet më shumë se kurrë për t’u liruar nga përçarjet fetare dhe helmi i tyre aq i madh i derdhur ngado sa t’ia mbajë plagët të hapura vazhdimisht...”

„Pikërisht kjo nuk dëshirohet dhe sikur po u kthehet në kob si ngaherë në prag të shembjeve të mëdha, kur ngado veçohen njëanshëm me atë pjesë që i kthen në kundërshtarë, në mëkatarë dhe armiq, madje, me të cilët duhet larë hesapet sa më parë, edhe pse kanë bërë përpjekje të përhershme, në kuadër të një mbijetimi sado të thjeshtë, t’i pajtojnë të kundërtat për aq sa ka qenë e mundur...” , ia kishte kthyer studenti Zenel Xhema.

Se bashkëjetesa fetare mund t’u kthehet shqiptarëve në fatkeqësi dhe, edhe më tutje do ta bënte të lëndueshme çështjen e tyre pikërisht ashtu si i kishte folur studenti Zenel Xhema, këtë do t’ia thotë atë ditë edhe prifti Gjon Lleshi, gjithë dëshpërim, çastin që kishin varrosur studentin Zenel Xhema, i qëlluar nga një plumb i ardhur nga tabori i forcave të fanatikëve të Haxhi Qamilit, derisa përcillte kosovarët me të cilët ishte biseduar gjerë e gjatë rreth tragjedisë së tyre, e cila assesi të merrte fund, përkundrazi, sa vinte bëhej edhe më e madhe edhe nga sjellja e pakuptueshme e shumëkujt në vend që donte të luftohej Qeveria e Përkohshme dhe mbreti, që për ta do të thoshte mbetje e mëtutjeshme në kasaphanën serbe dhe në ç’ mënyrë edhe Shqipërisë i bëhej varri përgjithmonë ngase sekush e dinte se pa trungun e vet ajo shfaqej si pema pa rrënjë, që shpejt thahet.

„Kështu vritet Shqipëria...” , i kushte thënë prifti me lot në sy.

Prifti Gjon Lleshi do t’i flasë ngjashëm edhe gjashtë vjet pasi kishte përfunduar Lufta e Parë Botërore, gjatë një takimi të vetëm që kishin pasur në Grac, me ç’rast ia kishte dorëzuar memorandumin e kosovarëve „*Nji besë për Shqipërinë*“, të lënë prej tyre pas asaj bisede tepër tronditëse në ditën e dyzet e katërt të bredhjeve nëpër linjat e fronteve shqiptare diku në pjesët e skajshme që hapësirën e Durrësit e lidhnin me ato të Lezhës, kur ishte më se e qartë se edhe më tutje do të mbeteshin midis kudhrës së armiqtësive ndërshtetërore dhe çekiçit serb, që i qëllonte pamëshirshëm dhe për vdekje.

„Së paku këtu gjenden amanetet e asaj fryme, që një ditë do ta bëjë atë, pa marrë parasysh kundërshtarët e shumtë“, i kishte thënë prifti Gjon Lleshi me një tundim të thellë, që Skulptorit ia kishte përkujtuar atë porosinë e Deli Brahës, kur kishte thënë se „bota duhet ta dijë se asht një betim për të cilin vdiset“, fjalë këto, të cilat, si duket, do ta kenë shtyrë në

kujtimet e lëna Zonja von Braunin të thoshte, gjithnjë në përputhje me përcaktimin që ato t'i plotësonte me kuptimin e dashurisë dhe me thirrjen e saj:

„Është një betim i madh dashurie i Kosovës, që duhet të dihet se do të kthehet në dashuri të njëmendë...”

Dhe, me këtë pandehmë, sikur ishte synuar t'i hiqeshin shkrimet makabre një pjese të mirë të shënimeve të Kolonelit të lëna në teqenë e Leqes në pritje të vrasjes së paralajmëruar, e cila do ta gjente ditën e njëzetepestë të mbylljes nga ai plumb, që telegrafisti Bruner me një mëdyshje të hapur, gjatë takimit të parë, i kishte thënë se ia kishte gjetur kokën pranë dritares si t'i kishte ardhur prej qiellit, hamendje kjo prej së cilës përfundimisht ishte ndarë pas njëzet e dy vjetësh, kur vetëm pak ditë para se të vdiste, i kishte shkruar se “plumbi që kishte vrarë Kolonelin nuk ishte shkrehur prej askujt, por kishte qenë koka e tij ajo, e cila ia kishte krijuar dhe së fundi e kishte sjellë në atë shpërthim vdekjeprurës...”

“Kosova është dashuri e madhe, që nuk falet...”, kishte shkruar Zonja von Braun.

Këto fjalë, të cilat ndonëse ndonjëherë duket se prekin edhe kuptimet, të atyre që Koloneli kishte thënë për betimin e kosovarëve për ta bërë Shqipërinë Shqipëri ngaqë nuk kishin nga t'ia mbanin nënkuptonin edhe atë që ata thoshin:

„Me dekë për Shqipninë“.

Se ato nuk kishin qenë fjalë boshe, por edhe veprime të pandalshme, të cilat e kishin ndjekur atë kah ajo kishte njohuri të bollshme. Dinte veçmas për kryengritjet e mëdha të nisura në Drenicë dhe gjetiu në krahinat e Kosovës nga mesi i viteve të njëzeta e tutje, të cilat në Perëndim ishin përcjellë edhe me krijimin e një komiteti që ishte quajtur „Për Mbrojtjen e Kosovës“, ku ishin përfshirë edhe shumë e shumë shqiptarë me banim në Austri, Gjermani, Itali, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Rumuni e gjetiu, po që për fat të keq të shqiptarëve edhe ajo lëvizje ishte dashur të shuhej pikërisht nga shteti shqiptar, i cili kishte marrë zotime se do të ndërpriste çfarëdo veprimesh, të cilat ishin quajtur „irredentiste“, dhe këtë madje do ta bënte në përputhje me konventat ndërkombëtare tashmë të nënshkruara dhe të lidhura me vendet fqinje për mos ndryshimin e kufijve, (Jugosllavinë dhe Greqinë), të cilat edhe më tutje nuk kishin kursyer kufirin shqiptar e as tërësinë e tij po i kishin rënë mes për mes duke e shkelur kur t'u tekej, e të tjera si këto. Por, që realitetit të hidhur shqiptar t'ia zvogëlonte përmasat e kobëve të përsëritura dhe njëherësh t'ia ruante të drejtën që ato ideale t'i mbeteshin të hapura dhe në përputhje me të drejtën e sendërtimit të tyre shpirtëror, të cilat gjithnjë shoqëroheshin me betimin: *„me dekë për Shqipninë“*- Zonja von Braun, pikë për pikë i kishte zëvendësuar: *„me dashunue për Shqipninë...”*, kështu që, edhe ajo të cilën Deli Braha e thoshte *„...ashtë një betim për të cilin vdiset“*, që *„duhet me e ditë bota se mbetet përgjithmonë...”*, kthehet në atë: *„...ashtë një dashuni për të cilën jetohej...”*

Më tutje Zonja von Braun sjell në tërësi ato që Koloneli thotë se „i kishte shkoqur prej kokës së Deli Brahës“:

„Kemi me jetue dhe me d a s h u n u e , por edhe me fitue, që Kosovën me e kthye dhe me e ba Kosovë dhe me e ruajtë për jetë të jetëve Kosovë...”

Kemi me jetue dhe me d a s h n u e , por edhe me fitue, që Kosova me qenë ajo që gjithmonë ka qenë, nyje dhe trung i d a s h n i s ë shqiptare...

Kemi me jetue dhe kemi me punue që Kosovën me e kthye në një d a s h n i të madhe e të përhershme, si ka qenë dhe ka me mbetë përherë vend- d a s h n i ...“

Se Kosova ishte dhe duhej të mbetej *„dashni shqiptare“*, pra pjesë e *„dashurisë së madhe“*, që ajo nuk i ndahej dhe përpiquej ta gjente kudo dhe ngado, edhe aty ku dukej fare e pamundshme, flet edhe njëfarë fragmenti i vogël në kursiv, kur ajo merr në shqyrtim vargjet:

„Bylbyli këndon në Çabrat

Vajzë mos kaj me lot

Se dashnia jote

M'ka nxanë përgjithmonë...”

të cilat përcilleshin me një si fusnotë të vogël të Kolonelit, ku përpiquej të jepej sqarimi „se ato i ishin qepur në pritje të atij plumbi që ia kishte gjetur kokën ditën e njëzetepestë të mbylljes në teqenë e Leqes“ dhe shpjegonte se të atilla si i kishte riprodhuar, kishte bindjen se dikur i kishte dëgjuar të kënduara nga i ati në Saraj-Kapi, kur takohej me farefisën dhe të afërmit e tjerë, e për të cilat thoshte: „ndonëse ishin pjesëza të kujtimeve të ngatërruara“, megjithatë ato „ia lidhnin shkëputjet me vetveten“, gjë që këto Zonja von Braunit i kishin shërbyer të mbështeste mendimin se „dashuria ishte pjesë e shpirtit të tyre“ dhe, ndonëse në ato rrethana tepër tragjike për ta, „kur ndodheshin përballë dilemës të rrosh apo të mos rrosh dhe nga të gjitha anët kërcënoheshin tmerrësisht, nuk kishin hequr dorë prej saj“, ndaj edhe vajin më të thellë dhe brengën më të madhe e shfaqnin si pjesë të dashurisë, e cila shprehej me atë shfrimin të thellë:

„Se dashnia jote

M'ka nxanë përgjithmonë...“

Pikërisht mbi këtë dehje, Zonja von Braun do të mbindërtojë njëfarë shfrimi poetik prej disa vargjes, ku disi do t'i kundërviheshin asaj që ndonjëherë dukej se Koloneli i shfaqej si dëshpërim i thellë, që i vinte në pritje të plumbit, të cilit nuk mund t'i ikte dot. Kështu që, vjershës për „*Rrethin dhe fundin*“ - që Koloneli e shihte si një përsëritje mijëravjeçare të një fataliteti, prej të cilit nuk kishte lirim dhe mund të thuhet se kishte pasur rrezik që shënimeve nga koha e mbylljes në teqenë e Leqes t'u kthehej me një moto të cilën nuk do ta meritonin, me çka edhe vrasja do t'i mbetej fare e rëndomtë dhe jashtë idealit dhe idealistëve që i duheshin bërjes së Shqipërisë Shqipëri - i kundërpërgjigjet me atë që do të quhet „*Dashuria e pafund*“ duke bërë përpjekje që porosia t'i bëhej edhe më e fuqishme, edhe më kuptimplotë, çfarë në të vërtetë edhe e meritonte:

„*Dashuria*

Vetëm dashuria

Nuk ka fund...

Një mijë vjet

Dhe përgjithmonë

Dashuria...

Dhe vetëm dashuria

Mbetet...

Dashuria

Dhe vetëm dashuria

Jeton

Dhe shpëton...

Dashuria

Dashuri...“

Thelbin e asaj *dashurie të pafund*, e cila duhej të kihej parasysh si pjesë e të menduarit, por edhe e shpirtit të tyre, Zonja von Braun do ta shohë edhe tek i gjithë përkushtimi i kosovarëve, atëherë dhe më vonë, të mos pajtoheshin të mbesnin pa „*dashninë e pafund*...“ edhe kur ajo u anatemohej nga shteti shqiptar, që çuditërisht i kishte shpëtuar shkatërrimit në atë luftën botërore, por jo edhe rreziqeve të mbijetimit që i vinin nga të gjitha anët me të cilat ballafaqohej thuajse pareshtur...

Dhe këtij përcaktimi të patundur për t'u bashkuar nuk i ishin ndarë edhe atëherë kur nga jashtë, me atë kushtëzim fatalist „ose Kosovë, ose Shqipëri“ që nuk u ndahej, ai tashmë u ishte kthyer në një peng i cili i mbante varë ata, por edhe shtetin shqiptar, me çka duhej të pranohej gjendja e realiteteve të dhunshme, me të cilën sikur u përligjej gjendja: „as Kosovë, as Shqipëri“, që do të paraqiste njërën ndër fatkeqësitë më të mëdha të tyre, e cila do t'u vinte në emër të një mbijetimi të padenjë.

“Kosova ka dashurinë e vet, pa të cilën nuk mund të jetojë“, do të thotë Zonja von Braun, “siç nuk mund të jetojë as bima pa ujë dhe pa ajër...Andaj, dashuria e saj është e natyrshme, dashuri jetësore...”

Më tutje, do të vazhdojë të shkruajë se „t’i thuash Kosovës harro Shqipërinë për hir të mbijetimit të saj shtet, është njësoj si t’u thuash hiqni dorë nga dashuria për hir të urrejtjes...“, e kjo - duke ndjekur meditim rreth antitezës dashuri-urrejtje dhe urrejtje-dashuri, sikur kishte kaluar në një përsiatje thujse filozofike që pastaj, kur do të thotë se „aty ku dashuria zëvendësohet me urrejtje dhe kjo bëhet qëllimshëm, i hapet udha një krimi të paralajmëruar, i cili një ditë gjithsesi shpërthen dhe merr përmasat e një tragjedie të pa ndalur...” - atë e kishte kthyer në një padi të hapur ndaj atyre, të cilët nuk ngurronin të mbanin të gjallë demonin e shkatërrimit, si diçka që u përplasit të gjithëve, pa marrë parasysh se do të dëshironin ta mbikëqyrnin në pjesë të caktuara...

Por në ndjekje të këtij mendimi, të cilin Zonja von Braun edhe më tutje e kishte përsëritur dhe me ato që kishte thënë „se ata që nuk mbronin dashurinë dhe që e përjashtonin atë dhunshëm, pra ata që urrenin, nuk mund të ishin asgjë tjetër veçse vrasës...“, sikur e kishte kthyer në një tjetër gjykim të padrejtë madje, me të cilin Skulptori jo vetëm nuk ishte pajtuar, por si do të shihet nga ata gjashtë vjetët dhe tetë muajt e fundit, kur kishte mbetur i vetmuar dhe i vetëmbyllur me bindjen e një humbësi që shkonte drejt hiqit nënçmues, e kishte parë aq ndryshe sa të vlerësonte se ishte pikërisht urrejtja ndaj së keqes së madhe, (që ai të tërën e kishte rrudhur te ngjarjet dhe shkaktarët e rrënimit të monarkisë), e cila i duhej dashurisë për t’u kthyer në dashuri dhe kjo mund të ndodhte vetëm pasi prishja e saj të kthehej në një rindreqje, ku çuditërisht të gjithën e kishte lidhur me atë betimin e kosovarëve „*me deke për Shqipërinë*“, që në atë rrëmujën shpirtërore në të cilën ishte mbërthyer dhe assesi të lirohej prej saj, ishte e vetmja, e cila i përkonte me bindjen e tij të pathyeshme „*me deke për monarkinë dhe kundër Versajës...*“, që fundit të tij do t’i jepte njëfarë kuptimi dhe madje do ta krahasonte me atë të Kolonelit?...

Një mënyrë e tillë e të shkruarit, pra ata që urrejnë të shihen si vrasës, nuk përkonte me atë drejtpërdrejtshmërinë, që Zonja von Braun kishte lënë në njërin ndër vlerësimet e fundit dhe të vetmet publicistike, të shfaqura në opinion pas largimit të saj të dhunshëm prej njëzet e një vjetësh, pra kur pas aq e aq vjetësh të heshtjes publike shtronte mëdyshjen se çfarë do të thoshte ajo „*Kosova peng i Shqipërisë*“ dhe „*Shqipëria peng i Kosovës*“, spekulim që vazhdonte të hapej e përhapej aq shumë nëpër kancelari të ndryshme diplomatike në prag të Luftës së Dytë Botërore dhe që për mendimin e saj e gjitha ishte pjesë e prapaskenave, të cilat tashmë dihehin haptas e me të cilën duhej të arsyetohej ajo.

Me theksimin se „t’i thuash dikujt të heqësh dorë nga dashuria për hir të urrejtjes“, është një krim tjetër i pafalshëm, do të shkruajë ajo. Dhe kur thoshte ashtu sikur u binte kambanave që ai krim i paralajmëruar të parandalohet para se të ndodhte, siç kishin qenë edhe ngjarjet, të cilat u kishin paraprirë atyre tragjedive të mëdha që mbi trungun e botës shqiptare ishin përsëritur edhe gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe siç do të përsëriteshin edhe pas përfundimit të saj e edhe më vonë, të cilat Zonja von Braun nuk do t’i përjetonte (mbase për këtë nuk kishte qenë fare e lumtur) ngaqë kishte vdekur pikërisht ditën kur kishte filluar ajo.

Por do të mbetej Skulptori për t’i përjetuar dhe, si do të shihet më vonë, sikur të ishte pjesë e atij mallkimi të madh dhe të pandalshëm, të cilin do ta parashohë Koloneli gjatë mbylljes në teqenë e Leqes në pritje të plumbit që do t’i vinte si prej qiellit, ai do të mbetej edhe dëshmitar i dhunshëm i tyre. Mundim ky që megjithatë do t’i marrë fund ditën e nëntë majit të vitit një mijë e nëntëqind e dyzet e pesë, kur bolshevikët sovjetikë kishin hyrë në Vjenë me tanke dhe armë të tjera të papara deri atëherë andej pari dhe nga atelieja në Rudolfsplatz, me një shikim fare të turbullt - kur ata po e vendosnin flamurin e kuq me yllin pesëcepësh, pikërisht aty ku për qindra vjet kishte qëndruar emblema perandorake e monarkisë së Habsburgëve, të cilën e kishin gjuajtur me një predhë topi të kalibrit M-37, pra në atë ripërsëritje të nënçmimit, të cilin sikur e kishte gjykim të përhershëm që ta përjetonte

gjithnjë më keq - rusët i ishin dukur të njëjtë me militantët serbë të ditëve të trishtueshme të asaj vjeshte të zymtë të një mijë e nëntëqind e tetëmbëdhjetës, që atëbotë kishin përdhosur dhe rrënuar keqas gjithçka të madhështisë perandorake, së cilës për shumë shekuj i kishin takuar, e në atë ankth mbyttës, fjalët e nxjerra me zor dhe të kthyer në psherëtimë : „o zot, kush do të thoshte se do të bëhemi Shqipëri e vitit katërmëdhjetë...“, kishin qenë të fundit...

III

Betimi i njohur i kosovarëve „*me dekë për Shqipninë*“, i ndier prej Zonja von Braunit si një tronditje që i kishte buruar nga plaga e brendshme e shpirtit, e hapur çastin që kishte parë se me shembjen e monarkisë së habsburgëve po i rrënohej edhe ajo që përherë e kishte marrë për atdhe dhe që kjo po bëhej në mënyrën më të vrazhdë nga çirret e egërsive të ndryshme, që ia shkatërronin vlerat më të mira mbi të cilat ajo ishte ngritur dhe kishte qëndruar aq kohë sa të dukej se ishte e përhershme, pra kur ishte kthyer në atë thirrjen „*me dashnue për Shqipninë*“, si e përsëritur dhe e ripërsëritur - sigurisht se ishte ndërlidhur edhe me mallin dhe dhembjen e saj që kishte për perandorinë e humbur përgjithmonë dhe, ndonëse nuk e kishte shprehur haptas, mund të kuptohej i tillë, po megjithatë ajo i takonte asaj që në pjesën e parë të kujtimeve do ta „*quajë pjesë të mashtrimit nga mungesa e dashurisë...*“

Skulptori do të merret një kohë të gjatë me atë shqetësim të Zonja von Braunit dhe njësoj do ta ndiente e përjetonte, por ishte qasja ajo që u ndryshonte, ku atë - në saje të shënimeve të Kolonelit, të lëna në teqenë e Leqes gjatë njëzet e pesë ditëve të fundit të jetës, kur po e priste atë plumbin i cili do ta gjente - e kishte njëjtësuar plotësisht me Shqipërinë dhe me fatin e saj, e këtë do ta bëjë me anën e meditimit që do ta quajë *dashuri* dhe *kërkim të saj*, të cilën do ta kthejë në një kuptim të përhershëm, nga do të marrë përmasat e një përgjithësimi të jashtëzakonshëm, ndërkohë që ai do të mbetej i thyer, i shpërfillshëm dhe në pritje të atyre që vinin, pa qenë në gjendje me asgjë të ndikojë.

Në atë ecejake të pafundme, kur Koloneli dhe Zonja von Braun, njëri me anën e idealit, ndërsa ajo me anën e dashurisë si ideal (që ishin të njëjta), i ishin kthyer asaj ribërjeje thuajse mistike, që lidhej me Shqipërinë, me të cilën pastaj kushtëzohej edhe vendosja e asaj që quhej *perandori e më të mirës*, qoftë si ëndërr qoftë diçka tjetër, që i takon përfytyrimit, pra në atë përpëlitse, e cila i ishte dukur se do të ishte e pafundme, një zvarritje e pa fund, sesi i ishte tekur fundin e vet të mos e lidhte as me ëndrrat e ribërjes, as me idealet e saj, po me përfytyrimin e fundit të asaj gjendjeje të atij rrënimi të përgjithshëm pa perandorinë, fund ky që e kishte parë si të mundshëm me shfaqjen e një prishjeje, të cilën çuditërisht mendja e shkalluar ia thoshte se do të mund të vinte vetëm nga flaka e fikur e kryengritjes së Kosovës dhe rindezja e saj e pashmangshme, me të cilën një ditë gjithsesi mund të ndreqej ajo prishje e filluar me Luftën e Parë Botërore dhe kishte vazhduar me atë të Luftës së Dytë, e të tjera, e të tjera bredhje si këto...

Dhe, si do të shihet më vonë, flaka e kryengritjes së Kosovës do t'i kthehej në një pahintikë të pandalshme, që nuk e kishte ditur se a kishte paraqitur mllef dhe urrejtje të jashtëzakonshme ndaj asaj që kishte ndodhur dhe e merrte për shkaktare të fatkeqësisë së përgjithshme apo shfaqte një dëshirë të tmerrshme për hakmarrje çfarëdo qoftë, pa marrë parasysh se me të nuk kthehej gjë prej gjëje nga ajo që dikur ishte, e cila do ta përcjellë sikur ta kishte gjykim të pashmangshëm derisa e gjitha do të marrë fund atë mëngjesin me diell të nëntë majit të vitit një mijë e nëntëqind e dyzet e pesë, kur trupat ruse do të marshojnë në Ballpallaz dhe aty do të vendosen bashkë me flamujt e tyre të kuq që shoqëroheshin me çirrat për internacionalen proletare, të nxjerra aq kërcënueshëm si një ftohtësi stepesh, ngrica e së cilës sikur kishte nisur ta përfshinte botën për ta rikthyer kohën e akullnajave...

Natyrisht që në atë shpenzim të mundimshëm të vetvetes, i vetëmbyllur përgjithmonë në atelie me shikim të mekur nga sheshi i dikurshëm perandorak dhe në përgjim të asaj që do të vinte, pa qenë në gjendje të krijojë dhe pa qenë në gjendje të vërë çfarëdo lidhjeje me botën që e rrethonte, kishte hetuar se ai tërmeti i madh i quajtur Luftë e Parë Botërore, jo vetëm vazhdonte me rrënimet e pandalshme, porse edhe ia kishte ndarë jetën në dy pjesë të pabarabarta dhe fare të palidhshme, që çuditërisht i kishte quajtur *koha e Shqipërisë* dhe *koha (e pakohë) pas Shqipërisë*...

Mbase këtë ndarje e kishte bërë në përputhje me atë të Kolonelit *para mbylljes në teqe të Leqes* dhe *gjatë mbylljes në teqe*, ku në njërën ndiente se kishte jetuar, se kishte vepruar, kishte pasur qëllime të qarta jetësore dhe krijuese që, edhe po të kishin qenë andralla koti, së paku e kishin lëvizur dika, ndërkohë që në tjetrën kishte mbetur fare i shkëputur, pa kurrfarë qëllimesh, pa farë synimesh, qofshin ato më të thjeshtat, ku i ngjante se ishte pikërisht njëri nga ata që Koloneli kishte thënë se u takonin të vdekurve të gjallë me të cilët thoshte se nuk dëshironte të kishte punë dhe që këtë ia kishte përsëritur edhe Zonja von Braun para nëntë vjetësh dhe nëntë ditësh, kur e kishte ftuar në atë takim in e fundit të Berlinit në verandën e drunjtë të kthyer nga liqeni i qetë...

Pra, i përballur me rropatjen e asaj ndarjeje, së cilës nuk kishte mundur t'i ikte dhe në pritje të atij fundi prej gjashtë vjetësh dhe tetë muajsh, mendja ia kishte thënë se shpëtimin duhej kërkuar me anën e andrallave dhe bredhjeve të ngjashme, pa marrë parasysht çfarë, ku kishte vend për gjithçka, madje edhe për çmendinë. Ose t'i jepej i tëri urrejtjes dhe vetëm urrejtjes, të cilën duhej vënë në veprim të pandalshëm, të shpërthejë sa të jetë e mundur dhe ajo të merret për zbrazje, në vend se të thyente qafën nënçmueshëm, qençe...

Rrugë tjetër nuk shihte...

Por, a thua nuk lypsej guxim, qoftë për të dashuruar, qoftë për të urrejtur?...

I dukej se kësaj mëdyshjeje të brendshme sikur përherë i ishte afruar më shumë nga druajtja që e para, dashuria pra, mund t'ia kthente mashtrimin e kotësisë, me të cilën ngushëllohen humbësit, ndërkohë që e dyta, urrejtja, e fundoste në kotësinë e mashtrimit, me të cilën ushqehen ata që nuk janë për asgjë?...

Zonja von Braun me kohë kishte gjetur *guximin e dashurisë*, me të cilin disi përballonte dështimin e madh dhe shembjen e pandalshme, ndërkohë që Koloneli, për t'u mbrojtur nga plumbi i pashmangshëm, që e priste dhe nuk kishte nga t'i ikte, kishte zgjedhur të menduarit për idealin dhe idealistët, të cilët i duheshin bërjes së Shqipërisë Shqipëri dhe kishte qenë i lumtur madje se atë vrasje të paralajmëruar, e cila do ta gjente ditën e njëzetepestë të mbylljes në teqenë e Leqes, si shumë e shumë të tjera që atëbotë kishin ndodhur nëpër vijat e fronteve ndërsqiptare, mund ta nxirrte nga gjykimi i nënçmimit që e priste, për ta kthyer në një kuptim, i cili do ta çonte deri te shëmbëllesja, e kjo edhe do të ndodhte mrekullisht dhe do të pasqyrohej e tëra me meritat, të cilat ia kishte njohur urdhri i bektashinjve në Tiranë, kur gjashtë vjet pas mbarimit të luftës e kishte shpallur „shiit të vatanit“ dhe me një ziqër të paparë deri atëherë në Shqipëri, e kishin rivarrosur pranë Baba Talit, ndërsa njëmbëdhjetë vjet më vonë, me rastin e gjetjes së kujtimeve „Zot-imi-Shqipëri“, edhe mbretëria shqiptare do ta nderojë me Urdhrin e Pavarësisë të rendit të parë, që ishte një mirënjohje ndër më të mëdhatë, ku së paku për së vdekuri e kishte fituar atdheun dhe nderimin e tij të përmotshëm, edhe pse kishte pasur rastin ta shihte dhe ta përjetonte zi e më zi vetëm për nëntëdhjetë e një ditë të jetës së tij të shkurtër, por me ngritje dhe rënie tepër të mëdha.

Ndërsa ai, pa dashuri dhe me urrejtje të përgjithshme, kishte mbetur vetëm, me ato të cilat nuk i pranonte dhe që sikur e kishin dënuar, për më shumë se një çerekshkulli të jetës së zbrazët, të përjetonte atë që do t'i dukej përsëritje e Shqipërisë së vitit njëmijë e nëntëqind e katërmëdhjetë...

Përballë realiteteve të tilla tepër të vështira, pa bisedat me Zonja von Braun, që për nëntë vjet dhe nëntë ditë thuajse i kishin ndihmuar të mos ndihej gjithaq i vetmuar, me

kujtimet e saj në duar dhe mendje, megjithatë ishte ajo jehona e thirrjes *t'i kthehej dashurisë*, që edhe më tutje i ngjante se i vinte pareshtur nga ana tjetër e telit nga një bisedë e përfytyruar me të, ku herë-herë ajo porosia: „*ktheju dashurisë*“ i vinte sikur t'i thuhej: „*ktheju Shqipërisë*“ dhe se ajo „*dashuri-Shqipëri-dashuri*“ në atë tatëpjetë të pandalshme me vetveten, merrte kahun e një tundimi tepër të rëndë, të ngjashëm me atë që kishte hetuar në të folurit e Deli Brahës kur kishte thënë se „*ishte edhe një besë me dekë për Shqipërinë, që duhet me e ditë bota gjithmonë...*“, që në atë përvijim e ndiente t'i kthehej në togfjalëshin „*besa për Shqipërinë*“, ose „*besa e madhe*“, „*besë-besësh*“ dhe ndryshe-ndryshe, e cila, pasi i sillej e i pështillej, i kalonte pashmangshëm tek ajo „*Besa që vret*“, rreth së cilës kishte përsiatur aq dendur Koloneli në çastet e fundit, derisa e priste plumbin, i cili do ta gjente ditën e njëzetepestë të mbylljes në teqenë e Leqes.

Ngatërrimi i besës, qoftë aso që paraqet *edhe vdekje për Shqipërinë*, pra një si betim fatalist, të cilit i nënshtroheshin të gjitha, siç e shihte Deli Braha, ose *aso që vret*, si e shihte Koloneli çasteve të fundit, kur ia thoshte mendja dhe madje druante se ajo mund t'i kthehej në peng bërjes së Shqipërisë Shqipëri nëse nuk merrte atë kahun tjetër „*me jetue për Shqipërinë*“, të cilën pastaj Zonja von Braun, me togfjalëshin „*me dashunue për Shqipërinë*“, e kishte kthyer në një himn të jashtëzakonshëm jetësor, të cilit askush nuk mund t'i vinte dorë as ta ndryshonte në përputhje me „të fshehtat që mund t'i shiheshin andej ku doemos kërkoheshin“. Pra e gjithë kjo sikur Skulptorin detyrimisht e kthente paksa tek te menduarit rreth asaj që quhet *guximi i dashurisë* - së cilës gjithsesi i paraprinte „*guximi i besimit*“, edhe atëherë kur mungonte, që e lidhte me një bisedë të hershme me Kolonelin, të bërë në Vjenë në prag të nisjes për në Shqipëri me grupin e vullnetarëve, të cilët shkonin për t'i ndihmuar Qeverisë së Përkohshme dhe mbretit që të vetëdëshmoheshin në ato rrethana tepër të vështira kur po ballafaqohej me prapaskena të shumta nga jashtë dhe nga të brendshmet - e cila nuk kishte qenë veçse pararendëse e asaj që shfaqet si *guxim për guxim* dhe përherë duhej kuptuar si të tillë, me çka sheshohen udhët për hapa të tjerë, çfarëdo qofshin, në mos për tjetër, të paktën vdekjen ta bënin të dinjitetshme...

Si rëndom, në ato biseda kishte marrë pjesë edhe Zonja von Braun, e cila ua kishte mbikëqyrur drejtimin. Por, këtu ajo thuajse papritmas kishte shpalosur hamendjen: ç'kishte ndodhur me atë *besën për Shqipërinë*, e dhënë aq zëshëm në Prizren në Kuvendin e Lidhjes Shqiptare e që edhe në shtypin e kohës kishte lexuar se si *besa-besë* ishte kthyer në një betim të përgjithshëm, që shkonte deri atje sa thuhej që „*për Shqipërinë jetën kena me e dhanë...*“, po që ndërkohë zhvillimet që pasuan tregonin të kundërtën, ku për habi kishin qitur në pah një betim gjakësor nga ana e shqiptarëve për ta luftuar Shqipërinë me çdo kusht, madje si ta kishin mallkim, të cilin duhej shporrur sa më parë?...

Pra, kur kishte shtruar këtë çështje kundërtënjese sikur kishte kërkuar që ajo të zhvishej nga tepritë dhe mashtrimet *për ta kthyer te nevoja e besimit*, së cilës Shqipërisë i duhej më shumë se kurrë dhe, me atë ndërhyrje për qartësim, pikërisht kishte shtruar nevojën e *guximit për guxim*, me të cilën rrënoheshin paragjykimet e dëmshme. Kjo ishte e domosdoshme përballë çfarëdo rrethanash.

I kujtohej se atëbotë Koloneli ishte zënë ngushtë, ngaqë nuk kishte shumë njohuri për besën dhe përmasat e saj si institucion moral, pos që dinte se përmbushja e saj familjes së tij i ishte kthyer në njëfarë mallkimi çastin që kushëritit Avdullah Pashë Dreni nga Gjakova, i cili bënte pjesë në Kryesinë e Lidhjes Shqiptare, i kishte hyrë në kullë i dërguari i Portës Maxharr Pasha, i kishte rënë në besë dhe e kishte detyruar ta mbronte (kështu edhe kishte ndodhur, pa marrë parasysh pasojat e kobshme që solli), e që më vonë, në bisedat familjare ishte anashkaluar sa më shumë të ishte e mundur saqë kjo ngjarje ishte rrudhur deri në përmasat e një fati. Por siç shihej, nuk kishte qenë e mundur t'i ikej plotësisht. Madje, madje nganjëherë, kur shënimet e Kolonelit të lëna në teqenë e Leqes lexohen të shkëputura nga tërësia, sikur lënë përshtypjen se pikërisht mallkimi i saj gjen pikësëpari idealistët e përkushtuar për bërjen e Shqipërisë Shqipëri...

„Me siguri se ka edhe realitete të tilla që edukojnë të vdesësh për Shqipërinë, siç ka edhe aso që vrasin për Shqipërinë, po ka edhe të atilla që e vrasin edhe Shqipërinë dhe nuk heqin dorë prej saj...“, kishte thënë Koloneli, pa qenë në gjendje të kapte thelbin e asaj që kërkonte Zonja von Braun, e cila, si duket, atë e kishte drejtuar ashtu që ta kthente te realitet, të cilat mund të quheshin „*besimi për Shqipërinë*“, me çka një kodi moral, që për shumë kohë kishte paraqitur një kushtetutë të brendshme me të cilën ishte rregulluar jeta në rrethanat e pushtimeve të huaja, t’i merrej deklarimi joreal, që si i tejkaluar mund të jetë i paqëndrueshëm, bile dhe i dëmshëm...

Tekefundit, pa këtë zbërthim, as që mund të vinte te „*dashuria për Shqipërinë*“ dhe „*dashuria Shqipëri*“, (preokupim i përhershëm madhor, me të cilin ajo ishte nxjerrë nga lojërat politike dhe të ditës, të cilat hapeshin dhe përhapeshin vullshëm si gogol i rrezikshëm, që jo rrallë edhe përplaseshin mbi të për ta zhbërë), për ta kthyer në një metaforë të pashembullt mirësie, ku fryma e atij ideali të lartë dhe plotësimi i tij shfaqeshin si domosdoshmëri të natyrshme në përputhje me të drejtën jetësore të dashurisë...

Skulptorin, i cili atëbotë po edhe më vonë, nuk kishte qenë në gjendje gjithaq të bënte dallimin midis *besës* e *betimit* dhe rregullave të tyre, e që i ishte dukur si një reminishencë e virtyteve të kalorësisë mesjetare, me siguri se nuk e kishte kënaqur zhveshja e saj në *besim* dhe veçmas heqja e frymës së betimit, të cilën Zonja von Braun e kishte quajtur „*dekor mashtrues*“, ngaqë atij i ishte dukur se ashtu e kthente në kategori religjioze, të ngjashme me predikimet fetare, të cilave nuk ua vinte veshin fare dhe i merrte si një lloj ushqimi për ata, të cilëve u duhej bariu dhe shtaga.

„Pa besim nuk ka dashuri dhe pa dashuri nuk ka besim“, i kishte thënë Zonja von Braun në njërën nga ato bisedat e përditshme telefonike që kishte zhvilluar me të për nëntë vjet e nëntë ditë dhe këtë ia kishte përsëritur dhe ripërsëritur sa e sa herë, sikur ta hetonte dhe, madje ta dinte se tashmë ajo i mungonte, po që në të ardhmen do t’i mungonte edhe më shumë sa një ditë të mbetej fare i paaftë për ndijimin e dashurisë, për kërkimin e saj të përhershëm, me të cilin ajo lidhte çdo gjë, madje edhe shpresën më të vogël, e që po të mos ndodhte kjo atëherë njeriu i nënshtrohej të kundërtës, pra urrejtjes, e cila ishte e pashmangshme në mungesë të dashurisë, dhe atëherë dihej se ku merrte fund kjo...

„Ata që nuk dashurojnë, urrejnë... Kësaj të vërtete nuk mund t’i iket dot...“, i kishte thënë sa e sa herë.

Në një pjesë të atyre kujtimeve, që Skulptorit i ishin dukur se i kishte menduar dhe shkruar për të, ngase e dinte që do t’i duheshin çastin kur do të mbetej vetëm me ankthin e gjendjes as i gjallë as i vdekur, kishte hetuar përpjekjet që besimi i domosdoshëm të lidhej me dashurinë, madje të merrej edhe si parakusht i saj, siç ishte bërë edhe ai përkufizimi madhështor i kthimit të *besës* në *dashuri*, pikërisht në përputhje me qëndrimin e Kolonelit ndaj heqjes së pengut të betimit të saj, që e kishte quajtur të dëmshëm dhe kurth të përhershëm, i cili mund t’i vihet bërjes së Shqipërisë Shqipëri me përmasa jetësore dhe qytetëruese.

Natyrisht se Zonja von Braun, e cila thua se çdo gjë në kujtimet e lëna - të cilat Skulptorit i kishin ardhur si ushqim shpirtëror që nuk do t’i ndahej kurrë dhe sa më shumë kishte kaluar koha për t’iu afruar atyre çasteve, të cilat do ta shpinë tek ai fundi kur shikimi i mekur në Ballpallaz do t’ia kapte ushtarët sovjetikë duke valëvitur flamurin e kuq aty ku për shekuj kishte qëndruar emblema e madhe perandorake - i kishte matur mirë e mirë që ato të shfaqeshin edhe si udhërrëfim për kapërcimin e atij labirinti në të cilin ngatërrohen ata të cilët kanë fatin e keq të kalojnë nëpër të njëjtat rrugë, e që mund të përsëriten dhe të ripërsëriten dhunshëm, pa marrë parasysh se ndërrohen aktorët dhe bartësit e tyre, të cilët e pësojnë njëjtë. Së këtëjmi, kishte bërë përpjekje të duhura që vlerësimet e drejtpërdrejta - të cilat lidheshin me *dashurinë Shqipëri*, me *besimin Shqipëri* dhe me ato që ajo i merrte si pjesë të asaj dashurie të madhe, me të cilën njëjtësohej me mendimet e Kolonelit dhe gjithsesi i duheshin jetësimit të perandorisë së më të mirës dhe vendosjes së pushtetit të saj - të ndiqnin kahun e

përgjithësimave dhe ashtu të lidheshin me çështje të cilat ishin pjesë e të menduarit gjithënjëzësor dhe gjithëkohor dhe që paraqiteshin si një e përcaktimeve civilizuese, pa të cilat nuk do të kishte asgjë, e që Koloneli i ishte kthyer në njëfarë kredoje me të cilën ai kishte përvijuar kahet kryesore: *lart-poshtë*, *perëndi-vrasës*, të cilat i kishin shërbyer për të bërë përkufizime ndër më të veçantat, por edhe të përgjithësuara, ku ajo *lart* çonte te *perëndia*, ndërsa ajo *poshtë* sillte rënie, shfrime të egërsisë, rrënim, vrasës...

Dhe, ishte për t'u pritur se tek ajo, e para të zëvendësohej me *dashurinë*, ndërsa e dyta me *urrejtjen*, që t'i kishte si udhërrëfim mbijetimi edhe në rrethanat më të rënda dhe më nënçmuese, të cilat Skulptori me të drejtë do t'i quajë përsëritje e Shqipërisë së katërmëdhjetës...

„Ata që nuk dashurojnë, urrejnë...“, do t'i thotë Zonja von Braun, ndërkohë që njësoj do t'i vijë edhe ato që Koloneli thoshte për *perëndinë* ose *vrasësin*, e që nuk paraqesin veçse një zbërthim të të menduarit *lart-poshtë*, *ngritje-rënie* dhe ndryshe-ndryshe, por që në përputhje me kundrimin që i bëhet, të sjell tek e njëjta.

Në përpëlitje të tillë për qartësim, që nuk kishte si të mos lidhej me nevojën e *ndijimit të guximit për guximin*, i cili i duhet secilit përcaktim dhe çfarëdo veprimi qoftë që ka të bëjë edhe me pranimin e dështimit më të papranueshëm, që megjithatë i takon dinjiteti, Koloneli sikur do t'i thotë se nuk kishte rrugë tjetër përveç *perëndi* ose *vrasës*, e cila përherë ndjek kahun *lart* ose *poshtë* për të shtuar se „mashtrohen ata që mendojnë se ka diçka të ndërmjetme (*aso dhe këso*)“, ndërsa Zonja von Braun, si rëndom, ato prerje të forta mendimesh ia kthente te dashuria dhe urrejtja. I bëhej se edhe ajo po i thoshte:

„*Dashuri*, ose *urrejtje*?... Rrugë të tjera nuk ka...“

Megjithatë, nëpër kapërcyellin e mundimshëm të përcaktimit, i cili nuk i ndahej dot, *fjala dashuri*, të cilën ia thoshte Zonja von Braun, i vinte fare e butë, sikur të pajtohej me dështimin, me shkatërrimin, rënien, së cilës, sado që i ishte nënshtruar, megjithatë i dukej se e kthente në një gjësend të pavlerë...Ndërkohë, *fjala urrejtje*, edhe pse mund ta lidhte me të ligën dhe me krejt atë që prodhonte ajo rreth të cilave meditonte aq shumë, sikur ia mbushte shpirtin me njëfarë përndezjeje, e cila e nxiste sadopak që të mendonte (ndonëse turbull) për atë që jo vetëm nuk e donte, por edhe do ta luftonte po të kishte mundësi, e cila, ndonëse i përkonte me ndjenjën e hakmarrjes, i vinte si ngushëllim i fundit, prej së cilës nuk duhej të hiqte dorë, pa marrë parasysh mbërthimin në hiç, të cilin e kishte fat...

Por, si t'ia bëjë me ato sprova të rënda të *vetëdëshmimit* dhe të *vetëdështimit*, ai që nuk është as i gjallë as i vdekur, i thoshte vetes mundimshëm Skulptori, sa më shumë që kalonte koha, ku vetmia e vetëmbylljes së pakapërcyeshme në atë labirint ia brente shpirtin tmerrësisht?...

Kjo mëdyshje tepër e madhe, si pranim i vetëdështimit, që shfaqet i pasosur dhe qëllimisht vjen si i përsëritshëm për t'i ndëshkuar ata që nuk i bëjnë ballë vetëdëshmimit, mbase do ta shembte përfundimisht (për këtë as nuk do t'i vinte keq), po të mos ishte njëfarë përfundimi i bëftë i Koloneli, i cili e cyste edhe më tutje ta ndiqte andej nga, para njëzet e pesë vjetësh bashkërisht ishin përfshirë në hapësirën e labirintit të quajtur Shqipëri, në të cilën sikur dëgjonte t'i thuhej edhe më tutje se mund të mbesësh vetëm *vrasës*...

Skulptorit i kujtohej që Koloneli iu kishte qepur të menduarit rreth asaj: *perëndi* ose *vrasës* si një përndjekje e pandashme dhe e hapur, nëpër kutin e një matjeje nëpër të cilën do të kalonte secili dhe çdo gjë dhe kjo do të ndodhë nga çasti që i ishte vrarë poeti Hartman pas takimit të parë me të dërguarin e përfaqësuesit të mbretit, diku midis Mollasit dhe Gurasit, kur ishin në fillim të asaj ndjekjeje gjashtëdhjetë e gjashtë ditësh të përmbushjes së pikave të hartës së sjellë nga Vjena nga konti Sorbah, të cilat kishin kaluar nëpër vijat e fronteve të vëllavrasjeve shqiptare për të mbetur përherë në to deri sa misioni i tyre fatkeq të shpallej njëanshëm i mbyllur prej tij me çka duhej t'i jepej fund atij mashtrimi. I pikëlluar pa masë nga ato që kishte marrë vesh për poetin Hartman, i cili në Shqipëri kishte ardhur me idealin të ngrihej në një poet kombëtar (ai këtë e shprehte me një entuziazëm të papërmbajtshëm nga

bindja se do të krijonte *Iliadën* e parë shqiptare nga mbetjet e mëdha të trashëgimisë shpirtërore nga lashtësia, për të cilat thoshte se nuk duhej bërë tjetër përveç të mblidhen dhe të renditen në përputhje me vjetërsinë), po që kjo megjithatë do t'i kthehej në kob; siç i ishte kthyer në kob edhe sportistit çek Hajek ëndrra që të bëhej pjesëmarrësi i parë i shtetit shqiptar në kampionatin evropian të atletikës, i cili do të mbahej në Romë pas dy vjetësh, ku ai shpresonte se do të ishte fituesi i parë i medaljes në një garë ndërkombëtare; siç do t'i ktheheshin në kob edhe polakut Avramicki projektet për bankënotën e parë shqiptare, të cilën do ta priste Banka e Mbretërisë Shqiptare, pra në atë matje dhe çmatje të tillë, nuk kishte parë tjetër pos perëndive, që ishin të paktë dhe u binte barra ta bënin Shqipërinë Shqipëri, dhe vrasësve, të cilët ishin të shumtë e të pandalshëm, që punonin pareshtur për ta vrarë Shqipërinë, e që, ç'është e vërteta, e vrisnin çdo ditë e më shumë dhe nuk reshtnin të vepronin në atë mënyrë.

„Perëndi ose vrasës“, thoshte Koloneli gjithë tundim kur ndjehej i thyer, por njëherësh i mbërthyer nga një ndjenjë e brendshme mllëfi që sikur me vështirësi e bënte zap të mos shpërthente kotnasikoti aty ku nuk e kishte vendin, dhe kjo sikur u kishte paraprirë bisedave jo gjithaq të qeta me priftin Gjon Lleshi, që ishin bërë pastaj gjatë atyre gjashtëdhjetë e gjashtë ditëve, sa kishin kaluar nëpër atë pjesën e shkretë, e cila kishte ndarë frontet shqiptare.

Edhe prifti Gjon Lleshi kishte qenë më së i shkallmuar nga vrasjet që i kishin përcjellë nëpër atë sorollatje të kotë, e ku vdekjet gjenin përherë dhe njësoj ata që në çfarëdo mënyre qëndrimin e tyre në Shqipëri e lidhnin me ndonjë qëllim të caktuar dhe që shkonte deri te ideali, siç ishte ai i poetit Hartman për thurjen e „*Iliadës* shqiptare“, i sportistit Hajek për medaljen e parë shqiptare në një garë ndërkombëtare, i polakut Avramicki për bankënotën shqiptare e të tjera, por dëshpërimin e madh ishte mundur ta kthejë në një përmbajtje që së paku të ruhej drejtpeshimi shpirtëror, aq i nevojshëm për atë kohë të pakohë. Ndonëse përkatësia e misionarit fetar e shtynte të mbronte mësimet e shenjta dhe frymën e tyre kudo dhe ngado dhe këtë duhej ta bënte në përputhje me përkufizimet e librave të tyre, megjithatë përpjekja që gjërat të shiheshin në kuadër të sjelljeve midis së mirës dhe së ligës, ku edhe duhej të shikohej e gjitha, paraqiste një kundrim jetësor në përputhje me rrethanat dhe pikërisht të tillë dëshironte ta mbante...

„Duhet kërkuar njeriun dhe jonjeriun në përputhje me sjelljet dhe veprimet, pa marrë parasysh se ku bëhen, ngaqë vetëm ashtu ruhejmë nga shkitja në vorbullën e përgjithësisimeve, e cila është e dëmshme dhe e rrezikshme...“

Prifti Gjon Lleshi këtë e thoshte me bindjen se kjo vlente për një pjesë të mirë të popullatës shqiptare, pavarësisht rrethanave tepër të vështira nëpër të cilat kalonte, kur sistemin e rrënuar të vlerave, pa marrë parasysh çfarë ishte dhe mbi ç'shtylla mbahej, e kishte zëvendësuar një rrëmuje e gjithëmbarshme, ku kishin dalë në pah instinktët më të ulëta për të mbijetuar disi, si dhe një egërsi e paparë, po që kishte edhe vetëpërmbajtje, me të cilat megjithatë pamundësohej që i gjithë vendi të kthehej në një log lufte të secilit me secilin dhe secili kundër secilit...

„Duhet pasur parasysh se e keqja nuk ka fund dhe duhet shpresuar që kjo të mos ndodhë...“

„Dhe çfarë del prej kësaj urate?...“ – ndërhynte Koloneli.

„Përmbajtja nga veprimi i ligë... Përmbajtja nga veprimi i palejueshëm dhe në përputhje me këtë pastaj shihet dhe del në pah edhe dobia që të ligës mos t'i shkohet pas...“

„Dhe çfarë përfitohet prej kësaj?...“ - pyeste Koloneli.

„Largimi nga e keqja, që ajo të mos bëhet edhe më e madhe...Të mos përfshijë çdo gjë...“

„A mjafton kjo?...“

„Gjithsesi se jo, por ama është më mirë se t'i bëhesh palë së keqes...“

„Domethënë: kërkohet të bësh sehir?... Të heshtësh?...“ – pyeste Koloneli.

„Kërkohet njeriu-njeri...”

„Edhe aty ku kjo nuk është e mundur?...“

„Kudo duhet kërkuar atë ... Kudo... Ndryshe pajtohem me të kundërtën...”

„Mendon që kështu pushon e liga?...“

„Sigurisht që jo, porse mund të mbahet e rrudhur dhe kjo paraqet shpresën...”

„Ëhë, shpresa?...“

Theksimin e shpresës Koloneli e nxori me mosbesim dhe bukur rrëmbyeshëm, nga shkaku se duhej të mbante për gjuhe me zor fjalën „mashtim“, që do ta thoshte me gjithë dëshirë për t’u çliruar, po të mos kishte parasysh përmbajtjen e kundërtë të kësaj fjalë, të cilën duhej treguar para priftit, mësimet e së cilës, megjithatë kishin mbështetjen e atyre, të cilët fjalët e zotit i përfillnin nga frika e jo nga vlera...

Këtu dhe te kjo pikë, ku thujse përherë shkonte kahu i bisedave, zaten fillonte ajo e cila mund të quhej bindje shkallmuese e Kolonelit rreth atij përcaktimi *perëndi ose vrasës*, e cila në shënimet e teqesë së Leqes ngrihet në dilemën *zot ose bishë* dhe nuk ishte tjetër veçse ligjërim i zëshëm me vetveten, ku me një prerje të ashpër ndaheshin ata që ndiqnin lartësimin nga rrënuesit, ku të parët, të cilët ndiqnin vullnetin për fuqi, ishin të paktë, por tepër të fuqishëm, ndërsa të dytët, ishin të shumtë, shumicë, që nuk kishin ideale, vetëm se u nënshtroheshin instinkteve më të poshtira të së ligës dhe asaj e cila merret për urrejtje shfrenuese, të cilën e derdhnin ngado dhe kurdo me mllef aq të madh, sa nuk ngurronin edhe të vrisnin edhe të vriteshin...

“Perënditë janë të paktë, por të fuqishëm. Ndërsa, vrasësit janë shumë, por të ligë, tepër të ligë, pikërisht pse janë shumicë...”

Më tutje, gjithnjë në përputhje me këtë prerje të ashpër, arrinte në përfundimin, të cilin e nxirrte thujse me dëshpërim:

„Perënditë e bëjnë Shqipërinë, ndërsa shfrytëzuesit e vrasin...”

Me perden bardh-zi në kokë Koloneli thujse ndante çdo gjë. Së voni këtë madje e bënte edhe kur ishte fjala për gjëra fare të rëndomta, që nuk lidheshin me tjetër përveç me nevojat më të thjeshta ditore, të cilave nuk u duheshin fare ngarkesa të tilla.

Mbase kjo e detyronte priftin Gjon Lleshi, që pasi i shmangej dufit të përsiatjeve të tilla të Kolonelit - ku me siguri se po të ndërlidhej me ato që thoshte - fjalën *perëndi* do ta kthente te kuptimi i zotit në përputhje me librat e shenjtë dhe assesit ndryshe, ndërsa atë të vrasësit dhe vrasësve, të mëkatet dhe mëkatarët, që pastaj t’i shtronte siç e kërkonte urdhri i meshës e të tjera si këto - të ndërhynte thujse padiktueshëm me fjalët se si gjithherë duhej kërkuar të mirën, edhe kur ajo duket fare e pamundshme...

„Duhet ushqyer frymën e saj, sepse vetëm aty gjendet shpëtimi...”

Fjala *shpëtim* sikur e ndezte Kolonelin dhe mbase këtë e kishte nga përkufizimi, por edhe më vonë edhe keqpërdorimi i misionit të tyre prej vullnetarësh në Shqipëri, me të cilin kishin ardhur t’i ndihmonin Qeverisë së Përkohshme dhe mbretit që të merrte veten dhe që e gjithë kjo ishte quajtur *shpëtim* i Shqipërisë, porse ndërkohë, si shihet nga shënimet e teqesë së Leqes, atë do ta quajë gabim të madh ngaqë, siç thoshte Shqipërisë i duhej bërja Shqipëri dhe jo mashtimet e shpëtimit, që vinin nga fryma e mëshirës, e cila pastaj nuk kishte si të mos përfundonte me gjendjen e përkuljes dhe të përlules me detyrimin e mirënjohjes së përhershme e të nënshtërimit, që nuk i duheshin...

Skulptorit i kujtohej se këtë bindje Koloneli do ta shprehte për herë të parë me një ashpërsi të madhe edhe gjatë një bisede që ishte zhvilluar me kontin Sorbah ditën e dyzetedytë të sjelljeve nëpër hapësirën, e cila ndante frontet shqiptare dhe do ta mbrojtë deri në fund.

Së voni, edhe Skulptorit, përndezja e dridhërimit që i vinte nga të menduarit për shpëtimin sikur i kishte kaluar në një fanitje në të cilën i bëhej se i fikeshin edhe ato shkëndijimet e flashkëta të shpresës që i duheshin të lirohej disi nga hapësira e atij labirintit, e cila nuk ishte e ngjashme me atë të përmasave të atij të quajtur Shqipëri, ku Koloneli thoshte

se mund të mbetesh vetëm vrasës, por te një tjetër thuajse i pafund, i përgjithësuar, vetëm me të vrarë...

„Kështu ngjet kur mungon guximi i guximit“, kishte folur Skulptori gjithnjë me një mendim të çoroditur për shpëtimin, që i bëhej se ia kërkonte por edhe ia ushqente ai shkallmim i tmerrshëm, i cili i ishte qepur i plotësuar me njëfarë si thirrje nga ana tjetër e botës për dashurinë si shpëtim, ku një zë i brendshëm, me ato që po ia thoshte se „a nuk është urrejtja pjesë e guximit për të mos u pranuar ajo që vret dashurinë“, sikur ia bënte me dije se shpëtimi i dashurisë pikërisht gjendet te mospranimi i asaj që nuk paraqet dashuri dhe si e tillë duhet të luftohet me çdo kusht e gjithmonë derisa të kthehet në dashuri...

IV

Thirrjen e dashurisë si shpëtim, e cila gjendet te mospranimi i asaj që nuk paraqet dashuri dhe duhet luftuar me çdo kusht dhe përherë për t'u mbrojtur dashuria edhe me anën e urrejtjes, e kishte dëgjuar pandërprerë, edhe atëherë kur kishte dashur ta mënjanonte fare, që i kishte ardhur nga Zonja von Braun, si nga pjesëzat e shumta të bisedave të përditshme të bëra gjatë atyre nëntë vjetëve e nëntë ditëve të kaluara, por edhe nga kujtimet e saj, të cilat për gjashtë vjet e tetë muaj me radhë i kishte mbajtur në dorë dhe mendje, me të cilat kishte bërë përpjekje që kuptimin e dashurisë ta gjejë me anën e ushqimit të urrejtjes ndaj asaj që pamundëson dashurinë dhe me këtë të shpëtojë nga fundi i padenjë, nga rrëshqiste gjithnjë më pandalshëm.

„Urrejtja ndaj së keqes shpëton dashurinë“, kishte thënë Skulptori dhe këtë e kishte nxjerrë me asi përkushtimi sa që mendja ia kishte marrë se e gjitha ishte pjesë e atij të menduari që i ishte përpushur gjatë nëntë vjetësh e nëntë ditësh nga ato që kishte dëgjuar t'i thuheshin për kthimin e dashurisë nga Zonja von Braun, të cilat përballë leximit të kujtimeve të saj, të ardhura me postë tri ditë pasi e kishin varrosur në pjesën tjetër të liqenit, çuditërisht i ishin plotësuar me thirrjen që i kishte kaluar në bindje se dashuria mund të kthehet në dashuri të njëmendtë vetëm nëse mbrohet nga përgjithësimet dhe ndjenja e mirësisë po dhe nga të tjera që mund ta shpinë në shpenzimin e saj dhe që këtë mund ta bëjë vetëm veprimi i urrejtjes...

Skulptorit i kujtohet se edhe Zonja von Braun në shkrimet publicistike - të botuara në prag dhe gjatë luftërave ballkanike, kur hapësira shqiptare dhe popullata e saj e pambrojtur kishin qenë pre e sulmeve të Serbisë, Malit të Zi dhe Greqisë dhe thuajse ishte në rrugë të një asgjësimi biologjik - kishte pasur bindjen e plotë se në ato rrethana tepër tragjike duhej bërë çmos që ajo të shpëtohej nga gjenocidi i hapur, qoftë edhe me ndërhyrjen ushtarake të monarkisë, nëse nuk do t'ia dilte të krijohej ndonjë forcë shumëkombëshe për t'i shkuar në ndihmë sa më parë, ku e gjithë kjo (po të zbërthehej me gjuhën e asaj, të cilën ajo më vonë do ta shohë si shpëtim te dashuria), tregon se dashurisë medoemos i duhej urrejtja ndaj asaj, e cila mund ta vrasë, madje edhe veprime të tjera që ajo të kthehej në dashuri të njëmendtë dhe të përherëshme... Shpalimi i pandalshëm në opinion i krimeve që bëheshin ndaj shqiptarëve, si dhe pasqyrimi i tmerreve që linin pas ato, bashkë me fatkeqësitë e shumta, a nuk ishin në shërbim të krijimit të drejtë të ndjenjës së urrejtjes ndaj vrasësve, pa të cilën nuk do të kishte pasur as trysni për ndërhyrje kundër autorëve të krimit dhe as përkrahje të hapur me ata që fati i zi i dënonte aq rëndë?...

„A nuk është urrejtja ndaj vrasësit që vret dashurinë-dashuri e shkuar dashurisë, e cila hetohet dhe vihet në veprim vetëm atëherë kur ajo kthehet në një digë kundër së ligës dhe shpërthimit të saj të papërmbajtshëm“, do të pyesë Skulptori, për të shtuar se „ata që nuk dinë të urrejnë, as nuk mund të dashurojnë“. Këtyre mendimeve, të cilat e kishin lodhur gjatë atyre gjashtë vjetëve dhe tetë muajve të fundit të vetmisë së plotë, ishte munduar sadopak t'ua

kthente kuptimin e humbur dhe me këtë të përpiket që çastet e fundit të jetës t'i nxjerrë nga shkallimi në të cilin kishte sharruar pandalshëm qysh nga mbarimi i asaj lufte të madhe botërore e deri te fundi i së Dytës, kur nga dritarja e mjegulluar e ateliesë në Rudolpplaz kishte parë ushtarët rusë në Ballpplaz me flamujt e kuq sesi po e gjuanin me top emblemën e fundit perandorake dhe po çirreshin me këngët për botën proletare...

„A nuk duhet vepruar që vrasja të parandalohet dhe kjo të bëhet, jo me lutjet për mëshirë, për shpëtim e të ngjashme me këto, por vetëm me betimin ndaj dashurisë për t'u mbrojtur me të gjitha mjetet edhe atëherë kur duket e pamundur?...“

Mbi këtë qëndrim të prerë zaten kishte lindur ideja për dërgimin e vullnetarëve në Shqipëri që, në mos për tjetër, atëherë me praninë dhe sjelljen e tyre atje të vinin në veprim të mëtutjeshëm opinionin tashmë të ndërgjegjësuar për reagime, me të cilat do të ndikohej politika, e cila thuajse ishte pajtuar me veprimet ushtarake të serbëve, malazezve dhe grekëve për spastrime etnike, me të cilat këtë herë shqiptarët, me tytat e armëve dhe çmimin e tmerrshëm të gjakut, do të përjashtoheshin përfundimisht nga trojet e tyre etnike, që, si thuhej në Beograd, Athinë, Moskë dhe vende të tjera, „Ballkani njëherë e mirë të lirohej nga mbeturinat e Perandorisë Osmane“ dhe nga „rreziku i fundamentalizmit islamik“, bartës kryesor të të cilit shiheshin shqiptarët. Kjo, madje duhej të bëhej me arsyetimin e mbrojtjes së krishterimit europian dhe të qytetërimit të saj perëndimor nga një e ligë e madhe, të ngjashme me murtajën, paçka se ishin shkencëtarët gjermanë dhe të tjerë, të cilët prej kohësh kishin dhënë kumtin se shqiptarët ishin popull ndër më të lashtët me të cilët lidheshin themelet e para të qytetërimit antik prej nga kishte filluar çdo gjë!

Në atelienë në Rudolpplaz, pikërisht aty ku tridhjetë vjet më vonë, ditën e nëntë të majit, shikimi i mekur ia kishte zënë ushtarët sovjetikë tek marshonin nëpër qendrën e dikurshme perandorake me flamujt e kuq të shoqëruar me ato këngët për internacionalen proletare, kjo nismë - për të cilën më vonë do të thotë se ishte ndër më të rëndësishmet e atij fundshekulli në mbrojtje të themeleve të qytetërimit të njëmendtë europian, që mendja ia kishte marrë se duhej vazhduar gjithë derisa të rrënoheshin korrigjimet e atyre prishjeve të shkaktuara nga Versaja - pra, atëbotë aty ishte shënuar me një ekspozitë ad hok me fotografi të marra nga burime të ndryshme rreth veprimeve ushtarake kriminale të ushtrisë serbe dhe malaziasë në Kosovë dhe Maqedoni, ku paraqitej i gjithë dhuna vrastare e asaj që Beogradi po edhe përkrahësit e tyre në Paris, Moskë dhe gjetiu mundoheshin ta përshkruanin si „luftë serbo-turke për çlirim“, e cila nuk ishte tjetër pos luftë që bëhej për spastrime etnike, me të cilat do të rrumbullakoheshin e ashtuquajtura „Serbi e madhe“, konturat e së cilës që moti projekttoheshin pa shqiptarë dhe që e gjithë kjo pastaj për pasojë do të kishte krijimin e realiteteve të reja shtetërore dhe etnike në hapësirën e Europës Qendrore dhe Juglindore të parapara si kundërpeshë e boshtit të ri në formim e sipër Berlin-Vjenë-Stamboll, me çka përfundimisht në dobi të ortodoksisë do të zhvleftësohej i ashtuquajturi kufi i dy botëve të kundërta, i vendosur prej një mijë e sa vjetësh dhe që i ishin dashur aq e aq luftëra dhe gjakderdhje, për ta kthyer në një ujdi të qëndrueshme qytetëruese midis Perëndimit dhe Lindjes, të ngjashme me atë të modelit të bashkëjetesës së mrekullueshme të besimeve tek shqiptarët...

Në fjalën e hapjes, ku kishin marrë pjesë intelektualë të njohur, por edhe diplomatë dhe studentë shqiptarë, Zonja von Braun kishte ngritur zërin dhe kishte bërë të ditur për mënyrën e veprimit, kishte thënë se po ndizej një fitil tjetër tepër i rrezikshëm, me të cilin në ato hapësira, pos që i hapej udha kryerjes së gjenocideve me mjete ushtarake rrënohej edhe baraspesha e natyrshme etnike në rajon dhe më gjerë, së cilës i duheshin legjitimitet shtetërore në dobi të mbizotërimit serb, (përvojë kjo që në njëfarë mënyre nga Beogradi kishte filluar qysh nga luftimet që i kishin paraprirë paqes së Shën Stefanit kur nga Toplica dhe Kurshumlia me dhunë të paparë kishte dëbuar popullatën e atjeshme shqiptare, e që ngjashëm mund të veprohej edhe në të ardhmen kundër të tjerëve nga ndonjë vend militarist), prapa të cilit rrinte Rusia, Franca po edhe Anglia, e që kjo nuk do t'i linte të qetë të tjerët,

veçmas Gjermaninë, e cila ndodhej në një hov të madh, pastaj as Austro-Hungarinë dhe Italinë, të cilat nuk do të shikonin duarkryq krijimin e rrethanave të reja që nuk u shkojnë për shtati, e që për pasojë do të kishin një konflikt, i cili do të pasohej nga një rrënim botëror, i paparë deri atëherë.

Por, kur ishte parë se në Konferencën e Ambasadorëve në Londër, pas shumë e shumë kompromisesh dhe pazarllëqesh, të dukshme dhe të padukshme, midis fuqive të mëdha ishte pranuar një Shqipërizë, ndërkohë që gjysma tjetër e etnisë shqiptare me Kosovën dhe Gjirin e Prevezës i ishte lënë në dorë Beogradit dhe Athinës, (si edhe më parë, kjo nënkuptonte edhe të drejtën për spastrime etnike), ishte nxituar me krijimin e misionit të vullnetarëve për në Shqipëri nga bindja se shpëtimi i asaj gjysmë Shqipërie mund të ndihmonte të merrte përsipër mbrojtjen e popullatës së mbetur jashtë kufijve të saj, së paku të shpërngulurit nga Kosova dhe viset e tjera përkohësisht t'i strehojë e t'i ikin më së keqes, por me këtë mision ishte synuar edhe të përhapej alarmi i njëmendtë për faktin se bërja kurban e shqiptarëve nuk paraqiste tjetër përveç hyrje në një fatkeqësi tjetër edhe më të madhe, e cila nuk kishte si të mos i përfshinte edhe ata që e kishin nxitur dhe pranuar...

Në atë ngarendje të madhe me kohën që të shkohet sa më parë në Shqipëri - dhe kjo të përkojë me arritjen e mbretit të dërguar nga Konferenca e Ambasadorëve, që shpresohej se mund të paraqiste një emërues të përbashkët pajtimi për shqiptarët, po edhe si një vërejtje serioze për serbët dhe malazeztë që të ndërpresin gjenocidin ndaj mbetjes tjetër të etnisë shqiptare në përbërje të tyre, e bërë me dhunë dhe me pëlqimin e faktorit ndërkombëtar - ishte vetëm studenti Zenel Xhema që kishte shprehur haptas dyshim rreth shpëtimit të Qeverisë së Përkohshme dhe pasojat që mund të prodhonte ajo. Kishte shprehur bindjen se ashtu vetëm sa i ndihmohej më të keqes, pra veprimeve edhe më të hapura të fqinjve, të cilët e dinin se ç' do të thoshte të merrte veten në çfarëdo mënyre shtetit shqiptar, por misionit megjithatë do t'i bashkohej nga bindja se edhe më keq do të ishte po të bëhej sehir jashtë saj...

“Shqipërinë duhet bërë“, kishte thënë thuajse me gjysmë zëri për të shtuar „se ajo bërje duhej të ishte fryt i të drejtës së saj jetësore për të qenë e barabartë me të tjetër, e jo monedhë kusurritjeje në lojërat që bëhen në kurriz të saj...”

Atëbotë, por edhe më shumë kur kishte shkelur në Shqipëri dhe kishte parë se në çfarë fatkeqësie ishte katandisur vendi nga luftërat vëllavrasëse, në të cilat ishte zhytur me shpejtësi marramendëse, si dhe prapaskenat e hapura që i bëheshin nga ajo pjesë e faktorit ndërkombëtar, që kishte marrë përsipër gjoja mbikëqyrjen e vetëdëshmimit të shtetit shqiptar në formim e sipër dhe bënte të kundërtën, Skulptori kishte pasur bindjen se në atë gjendje të pashpresë, në të cilën ndodhej, Shqipërisë i duhej shpëtimi dhe vetëm shpëtimi i shpejtë para se të vritej plotësisht dhe kjo bile të bëhej edhe me dorën e vetë shqiptarëve, të cilët ishin ngritur me vullnet të madh kundër Qeverisë së Përkohshme dhe mbretit, sikur pikërisht me dështimin e tyre të bëhej ajo, e jo e kundërta. Madje, edhe ato bisedat e gjata rreth domosdosë së shpërthimit të një lufte të madhe, që do ta shpëtonte Shqipërinë nga luftërat e brendshme, të cilat zhvillonte me Kolonelin para dhe në prag të largimit përfundimtar nga Shqipëria në ndjekje të thirrjes së perandorit Franc Jozef për mobilizim në luftë kundër Serbisë të shpallur nga mesi i korrikut, pra ato biseda, të cilat midis tyre gjithnjë më shumë dukeshin dëshpëruese, kishin këtë qëllim, sado që Koloneli i merrte jo gjithaq bindëse. Sepse si ushtarak i lartë i profesionit që ishte, e dinte fare mirë se çfarë do të thoshte për një vend që digjej nga flaka e brendshme e vëllavrasjeve të përfshihej në një luftë tjetër të paqartë nën ombrellën e Komisionit Ndërkombëtar dhe të forcave të tjera të huaja, pikërisht të atyre vendeve, të cilat sa ora mund të ktheheshin në kundërshtarë dhe, e para gjë që u duhej, ishte krijimi i një pikëmbështetjeje për veprime luftarake në një pikë tepër nevralgjike për atë pjesë të botës, siç ishte Shqipëria me bregdetin, por edhe me pjesën kontinentale, prej nga mbikëqyrej nyja Lindje-Perëndim.

Dhe, si do të shihet, druajtjen e kishte me vend, ngaqë edhe misioni i tyre nuk kishte mundur t'i shpëtonte kësaj prirjeje, kur ishte parë qartë se për pjesën e ushtarakëve gjermanë

dhe austriakë në përbërje të njësitit të vullnetarëve, ndjekja e pikave të hartës së kontit Sorbah, e sjellë nga Vjena, nuk kishte qenë tjetër veçse veprim informativ në shërbim të përgatitjes së Luftës së Parë Botërore.

Shpëtimin e Shqipërisë me anën e një lufte të madhe, siç kishte qenë lufta botërore, e kishte dëshiruar dhe e kishte pritur të bëhej sa më parë, që njëherë e përgjithmonë t'i ndalej turri monstrumit të rrezikshëm serb, i cili në pjesën më të rëndësishme të Ballkanit, nga lufta në luftë zgjerohej e zgjerohej me ato që nuk i takonin... Kjo dëshirë, që më vonë i kishte kaluar në ndjenjë hakmarrjeje, Skulptorit i shtoej edhe më shumë nga qëndrimi i njohur i saj prej gjakësori e përbindëshi kundrejt Kosovës dhe pjesëve të tjera shqiptare të grabitura nga okupimi ushtarak, me arsyetimin se kundër Perandorisë Osmane bëhej një luftë e drejtë çlirimtare dhe, mbi të gjitha, që ta „kthente djepin“, që thoshte se e kishte atje, ku në të vërtetë asnjëherë nuk kishte pasur çka të përkundte, pos propagandën e ashpër, të cilën e zhvillonte fuqishëm dhe pandalshëm gjithandej dhe me të gjitha mjetet. Dënimin e merituar Serbisë ia dëshironte edhe për shkak të prapaskenave të vazhdueshme, të cilat ia kishte kurdisur Qeverisë së Përkohshme dhe mbretit dhe që vazhdonte t'ia bënte me anën e dërgimit të agentëve dhe militantëve të tjerë, të futur me mjeshtëri ngado dhe veçmas në mesin e klerit fanatik islamik, të cilët, të shumtën me armë dhe flori që merrnin prej saj, tashmë luftonin me thirrjen për ta kthyer atë, siç thoshin, në një „qilim të gjelbër“, të parin në Europë, e cila do të shfaqej si shëmbëllesë e xhihadit që e priste këtë pjesë të botës, ku pastaj, përballë asaj krijese, e cila tmerronte botën, Beogradit dhe aleatëve të tyre t'u lireshin duart të lira t'i lanin hesapet me të si munden dhe si dinë, e pastaj madje t'i falënderoheshin për atë „shërbim civilizues“, e të tjera si kjo...Pra, po këtë bindje e kishte ruajtur edhe atëherë kur kishte përfunduar Lufta e Parë Botërore dhe i ishte rrënuar atdheu dhe gjithë ajo që ai e merrte si vlerë të madhe qytetëruese, të cilën vetëm Koloneli qysh herët kishte qenë në gjendje t'ia parashihte atë fund, porse e kishte ruajtur edhe gjatë viteve të tjera të asaj ngarendjeje nëpër atë mjegull hutimi dhe në atë ndjenjë të zhytjes në një gjendje amorfe të pafundme, gjithsesi asgjëkundi, që ia kishin lënë pasojat e asaj lufte të madhe dhe ai ishte sjellë si i pa kokë, fare jashtë hapësirës dhe kohës, derisa pas gjashtë vjetësh kishte takuar telegrafistin Bruner, e dy vjet më vonë edhe priftin Gjon Lleshi, kur njëri ia kishte sjellë letrat me njëzet e dy shënimet e Kolonelit, të lëna në teqenë e Leqes, të shkruara në pritje të vdekjes, e cila do t'i vinte nga ai plumb si prej qiellit, që ia kishte gjetur kokën mbështetur për xhami të dritares kur po shikonte gjembat e trëndafilave të tharë, të ngjitur nga jashtë pikërisht ditën kur do të fillonte Lufta e Parë Botërore, ndërsa tjetri ia kishte dhënë betimin e kosovarëve „*Nji besë për Shqipninë*“, të hartuar në tubimin e Verrave të Llukës, i bartur ashtu dorë më dorë, fryma e të cilit edhe më tutje i ballafaqonte me mallkimin për të mos u bërë bashkë, që u vinte nga e gjithë bota...

Hamendjen e parë rreth shpëtimit të Shqipërisë në dobi të bërjes së saj Shqipëri, Skulptori e kishte ndier kur kishte lexuar shënimet e Kolonelit në pritje të vrasjes së paralajmëruar, sado që shikuar nga pikëpamja humanitare dhe qëllimi i misionit të tyre të nisur në pranverën e vitit një mijë e nëntëqind e katërmëdhjetë, me daljen e saj nga Lufta e Parë Botërore dhe në saje të ndërhyrjes amerikane si shtet i njohur në kufijtë e të trembëdhjetës, sikur ishte plotësuar diçka e saj, por jo edhe kryesorja. Sepse ndërkombëtarisht, çfarëdo Shqipërie tjetër në përmasat etnike, shfaqej e papranueshme dhe e palejueshme madje, që arsyetohej me mos ndryshimin e kufijve dhe me pretekste të tjera, të cilat mbështeteshin tek e drejta ndërkombëtare në fuqi, e cila nuk lejonte ndryshimin e dhunshëm të kufijve e as toleronte lëvizjet irredentiste, përkundrazi, ato luftoheshin pa kurrfarë mëshire me të drejtën shtetërore.

Megjithatë, ato që Koloneli kishte shkruar me aq përkushtim gjatë atyre njëzet e pesë ditëve të fundit të jetës, të cilat ishin pasqyruar me njëzet e dy shënimet e lëna, si dhe memoaret „*Zotimi-Shqipëri*“, që ishin gjetur njëmbëdhjetë vjet më vonë me rastin e meremetimit të teqesë së Leqes dhe ishin vlerësuar shumë lart si një platformë për një

program kombëtar qytetërues që i duhej Shqipërisë dhe shqiptarëve për ta bërë së pari atë bashkimin shpirtëror, për të cilin ai thoshte se „ hapej rruga drejt përfshirjes së saj në atë perandorinë e më të mirës“ dhe ishte „domosdoshmëri civilizuese, me çka bota do të nxirrej nga rreziku i shkatërrimit ku shkonte...“ dhe kështu me radhë, Skulptorit pak nga pak ia kishin ndryshuar bindjen që kishte saqë në atë tatëpjetë të kërkimit të vetvetes për të shpëtuar nga hiçi, ku i bëhej se sharronte gjithnjë më shumë, i kishte shkuar mendja se nuk duhej hequr dorë nga bërja e Shqipërisë Shqipëri, pa marrë parasysh ato që tashmë e pengonin të bëhej e tillë dhe që në këtë përplasje të mendimeve të Kolonelit seç i kishte shkuar mendja të vinte lidhje me përfaqësuesit e „Komitetit të Kosovës“ dhe me lëvizje të tjera, të cilat kishin gjithnjë po atë qëllim, përfaqësuesit e të cilave tashmë vepronin në Vjenë, në Grac dhe në disa qytete të tjera, për të parë mundësitë si t’i ndihmohet kësaj çështjeje, pa ngurruar të merrte rrugën e vendeve shqiptare edhe për të dytën herë, jo si vullnetarë bamirës, si para dhjetë vjetësh, kur për gjashtëdhjetë e gjashtë ditë si hije ishin sorollatur nëpër vijat fatkëqija të fronteve ndëreshqiptare, por si luftëtar që shkonte atje për të vdekur dhe kjo do t’i ndihmonte që jetës së humbur t’ia kthente kuptimin...

„Sikur ka edhe më tutje gjëra që mund ta shpëtojnë shpirtin nga rrënimi...“ - kishte thënë Skulptori në ndjekje të atij përdëllimi trandës, edhe pse kapja e jehonës së saj i ishte dukur si pjesë e mëdyshjeve dëshpëruese që u qepen atyre, të cilët vetëm dinë se çfarë nuk duan dhe që këtë e ndiejnë nga pesha e urrejtjes me të cilën ushqehen, por jo edhe çfarë duan.

Gjatë takimit të vetëm me priftin Gjon Lleshi në Grac, kur ai ia kishte dhënë memorandumin e kosovarëve „*Nji besë për Shqipërinë*“, të miratuar në tubimin e Verrave të Llukës në prag të shpalljes së pavarësisë dhe me njëfarë hutimi të pashpjegueshëm i kishte thënë se „*ia vlente me dekë për Shqipërinë*“, sikur tërthorazi ia kishte bërë me dije priftit për atë tatëpjetë marramenthi, e cila heshtazi i ishte ndezur dhe po e detyronte të vepronte disi, por nuk mund të thuhej se ndonjë lëvizje, e cila do të dilte prej saj, paraqiste farë vullneti për jetë a diçka të ngjashme, e cila do të shihej si përpjekje e lirimit nga labirinti i askundjes, në të cilin kishte sharruar përgjithmonë. Me këtë rast prifti ia kishte kthyer se “megjithatë duhet të kërkohet vazhdimisht rruga e shpresës dhe e shpëtimit, qoftë edhe kur duket e humbur nga mjegulla...” në ç’mënyrë ia kishte bërë me dije se kishte kuptuar dilemat e tij, të cilat i kishte nga ai dështimi i madh që nuk kishte pritur të shfaqej pastaj me krijimin e realiteteve të reja dhe, për ta ngushëlluar sadopak, e kishte vënë në dijeni se prej tij priste edhe më tutje përmbushjen e premtimit të dhënë dikur se në Alpet shqiptare do të gdhendte shtatoren e Skënderbeut, të ngjashme me atë të presidentëve amerikanë në Kolorado...

„Ishte një ëndërr e bukur që, për ta kthyer sadopak në realitet, gjithsesi duhet të kihet fuqi...“ - i kishte thënë priftit Gjon Lleshi, i cili në ndarje sërish ia kishte përkujtuar fjalët rreth shpresës që i kishte shoqëruar dhe që kishte të bënte me „qëllimet e qarta që shpëtojnë...“, të cilat, për fat të keq, në atë katrahurë, jo vetëm nuk shiheshin, porse mungonin fare...

Ngjashëm do t’i fliste edhe Zonja von Braun dy vjet më vonë në Berlin, kur kishte shkuar dhe ia kishte dhënë shënimet e Kolonelit nga koha e mbylljes në teqenë e Leqes, të shkruara në pritje të plumbit që, i ardhur si prej qiellit, do t’ia gjente kokën ditën e njëzetepestë dhe, mund të merrej me mend se ai kishte qenë i lumtur që bile, nëse jetën e kishte pasur të shkurtër, të pambikëqyrrur në përputhje me qëllimet dhe të kundërt me to, vdekjen ia kishte kthyer në një qëllim kuptimplotë, që e lidhte me idenë e bërjes së Shqipërisë Shqipëri, e cila nuk do të shuhej kurrë, pa marrë parasysh pengesat që do t’i viheshin...

„Dashuria është qëllim madhor, pa të cilin nuk bën“, i kishte thënë Zonja von Braun kur atij i kishte shkuar mendja të hapte çështjen e ndryshimit të pikëpamjeve për shpëtimin e Shqipërisë, që e kishte dikur, e me të cilin kishte filluar misioni i tyre në Shqipëri në verën e vitit një mijë e nëntëqind e katërmëdhjetë, për ta bartur tek ideja e bërjes së Shqipërisë Shqipëri, në përputhje me qëndrimet e Kolonelit, të cilat ishte i bindur se i kishte dëshmuar koha mrekullisht dhe se me përmbushjen e tyre sikur ktheheshin edhe rrethanat, që më vonë,

gjatë kohës së vetmisë së plotë, do t'ia quajë ndreqje e asaj prishjeje të madhe, e cila bëhej e mundshme vetëm me atë prishje të asaj ndreqjeje, që thoshte se e kishte shkaktuar Versaja, e cila botës do t'ia kthente vlerat e dikurshme, që përkonin me idealet e Kolonelit për vendosjen e perandorisë së më të mirës.

Sikur t'ia kuptonte tundimet, të cilat do ta mbërthejnë të tërin gjatë atyre gjashtë viteve dhe tetë muajve të vetmisë së vetëmbylljes në Rudolpplaz, që do t'ia përfundojë ditën e nëntë të majit, kur shikimi i mekur do t'ia kapë ushtarët sovjetikë me flamur të kuq tek po mbushnin Ballpplazin dhe qendrën e dikurshme perandorake dhe ta ndante disi prej tyre para se të bëhej vonë, po këto do t'ia thotë edhe dy vjet më vonë, kur ia kishte dorëzuar kopjen e kujtimeve „Zot-imi-Shqipëri“, por që këtë herë të theksuara me fjalët se „dashuria shpëton“, të cilat pastaj ia kishte përsëritur thujse çdo ditë gjatë bisedave të rëndomta telefonike prej nëntë minutash, të zhvilluara me të gjatë nëntë vjetësh dhe nëntë ditësh derisa një ditë i kishte ndërprerë vdekja e saj që, sikur t'ia lidhte fatet e dashurive me ato të ngjarjeve të mëdha, kishte ndodhur pikërisht ditën e fillimit të Luftës së Dytë Botërore, në ç'mënyrë ndërkohe prej njëzet e një vjetësh e atyre fatkeqësive botërore njëherësh kishte paraqitur një të menduar të jashtëzakonshëm, që ndijimin e një dashurie të flaktë, të pashueshme dhe të përhershme, siç ishte ajo e Zonja von Braunit me Kolonelin, e kishte ngritur në përmasat e një lidhjeje, e cila mund të quhet edhe e veçantë edhe mbidashuri, madje...

„Dashuria është shpëtim i dashurisë“, i kishte thënë Zonja von Braun dhe kjo sikur sërish ia kishte rrëmbyer dufin e veprimit që kishte ndier me rastin e leximit të shënimeve të Kolonelit, kur i kishte shkuar mendja që nga hiçi, në të cilin po sharronte, të shpëtonte me anën e shkuarjes për të vdekur në Shqipëri pranë atyre, për të cilët, herë pas here shihte ndonjë shkrim ku paraqiteshin „kaçakë që luftonin për jetë a vdekje nëpër malet e Kosovës kundër dhunës serbe dhe soldateskës së saj“, dhunë kjo shtetërore e cila tashmë vepronte me emblemën dhe forcën e shtetit jugosllav me dinastinë serbe në krye, peshën e së cilës kishin filluar ta ndienin edhe nismëtarët më të flaktë të saj, kroatët dhe sllovenët. Domethënë, pikërisht ata, të cilët edhe me armë në dorë fillimisht kishin marrë pjesë në anën e serbëve në luftërat e tyre pushtuese dhe pas atij dëshpërimi ndaj shtetit të përbashkët të sllavëve të Jugut, që nuk i ishte dashur shumë kohë për t'iu parë qëllimet që ishin vetëm në shërbim të interesave të hegjemonizmit serbomadhi dhe që njëherësh puqeshin edhe me qëllimet e boshtit Paris-Londër-Moskë për rirreshtime të reja në këto hapësira, e kishin të qartë se përfshirja e tyre në luftëra të tjera, por këtë herë për hesapin serb dhe vetëm për të, ishte e pashmangshme po aq sa e kotë.

Dhe, përballë këtyre zhvillimeve, kur shpërtheu kryengritja e shqiptarëve në Kosovë kundër Beogradit dhe shikohej jo pa adhurim dhe madje përkrahej edhe nga ata që deri dje kishin ndihmuar të bëhej e tillë dhe të merrte ato përmasa dhe ishte më se e qartë se u duhej për përfitime të tjera, e gjitha sikur ia kishte zgjuar njëfarë mendimi (ndonëse i ishte dukur edhe si andrallë madje) se nëse në Shqipëri e kishte pasur fitilin Lufta e Parë Botërore me të cilën ishte rrënuar monarkia danubiane, ku pikërisht kishte filluar kjo e keqe e madhe dhe kishte prekur çdo vlerë, për të cilën Koloneli kishte thënë se e kishin peshqesh pse nuk ishte mbrojtur bërja e Shqipërisë Shqipëri, por e kundërta, pra meqë ishte kështu, atëherë pse pikërisht në malet e Kosovës të mos dukeshin shkëndijat e para të asaj rindreqjeje të madhe botërore, me të cilën do të shpërbëhej krijesa serbo-jugosllave për të filluar ribërja e perandorisë a e një diçkaje tjetër të ngjashme, pikërisht ashtu siç kishte shkruar edhe Koloneli gjatë mbylljes në teqenë e Leqes kur kishte medituar për atë ribërjen, që shfaqej si rifillim dhe rilindje, e cila bëhej e mundshme vetëm pasi të ishte prekur fundi?...

A nuk do të ishte ajo ribërje e perandorisë (mund të quhej perandori dardane-ilire, perandori e Romës, perandori antike, ose çfarëdo perandorie tjetër), e cila, me barazinë dhe mundësitë që secili të shfrytëzonte hapësirat për ngritje dhe ngjitje deri te majat e saj, do të ishte një shëmbëllesë e pashmangshme civilizimi që mund të shkonte edhe deri tek ajo ide që Koloneli e quan vendosje e pushtetit të më të mirës, meditime, të cilat sikur ia kishin zgjuar

shpresën se përkundër atij tërmeti të tmerrshëm me pasoja të jashtëzakonshme, mbase nuk kishte humbur çdo gjë, se nuk ishte rrënuar gjithçka, se mund të kishte shpresë edhe për ato që dukeshin se nuk ktheheshin më, e të tjera si këto.

E parë nga ky këndvështrim, gjithsesi nyja e të gjitha këtyre përsëritjeve dhe ripërsëritjeve të rëndësishme ndodhej që ndodhej në malet e Kosovës, ku kishte filluar kryengritja kundër pushtimit serb, me të cilën duhet të bëhej me dije se ndonëse kishte ndodhur një prishje e madhe botërore, që për dike duket si ndreqje, ajo megjithatë nuk pranohej, se ajo duhet të ndreqet para se të bëhet vonë dhe kjo është e mundur vetëm në sajë të asaj prishjeje të plotë të “ndreqjes” së quajtur Versajë, me të cilën zaten kishin filluar edhe ato çrregullimet që nuk kanë të ndalur, ku është krijuar mundësia për të dalë në skenë edhe bolshevikët, të cilët kërcënonin me vendosjen e diktaturës së proletariatit në gjithë botën për ta kthyer kështu në një shkretëtirë të kuqe që nuk do të kishte shembull?...

Në këtë përmbysje të madhe që shembte realitetet e papranueshme, i bëhej se flaka e Kosovës sikur u ishte kthyer në njëfarë shprese të gjithë atyre që i dëshironin ato kthesa, e kjo çuditërisht kishte bashkuar edhe rrymat më ekstreme të kohës: nga monarkistët sorollatës e të dalldisur, të cilët të bërë xurxull e me jargë në buzë çirreshin me mallin e saj nëpër kafene dhe bare, por kishte bashkuar edhe anarkistë të ndryshëm, të cilët kërkonin vetëm tym e flakë, siç kishte bashkuar dhe militantë të panumërt majtistë, nga radhët e Internacionales Komuniste, të cilët në një tubim të tyre të vonshëm kishin përkrahur madje edhe „Komitetin e Kosovës“ dhe kërkesat e tij, duke i quajtur „të ligjshme“, ndërkohë edhe njëfarë dege e Kominternit për Jugosllavinë, në kongresin themelues në Drezden kishte nxjerrë një rezolutë, me të cilën quhej „e drejtë lufta çlirimtarëve e popujve që i kishte robëruar mbretëria jugosllave“, madje ajo cilësohej „krijesë artificiale“ dhe thuhej se „duhej rrënuar sa më parë...“

Thuhej e ç’ nuk thuhej, me ç’ rast me dashje a pa dashje Kosovën e kthenin në një skenë të madhe me shfaqje dhe përfytyrime të ndryshme, që të përbashkët kishin atë lojën, me të cilën viheshin në lëvizje aktorë të shumtë, pa marrë parasysh si përfundonin dhe kjo ia kujtonte atë, për të cilën shkruante Koloneli thujse dëshpërueshëm, por me një syçelësi të jashtëzakonshme:

„Bota do t’i kthehet dhe rikthehet Kosovës sa herë të ketë nevojë për të vlarë, por edhe për të shpëtuar nga vrasja...“

Në atë përpëlitse me Kosovën dhe flakën e saj, që ndonëse shumëkush e dëshironte, po edhe shumëkush e ëndërronte t’u shërbente si shkas dridhjeve të reja, por jo edhe të kthehej në qëllim të mirëfilltë, pra t’i kthehej ajo që i ishte marrë me dhunë dhe kishte aminin e politikës, i dukej se megjithatë ajo fasha që i kishte hyrë në mes dhe kishte përligjur prishjet e ndreqjeve të Versajës, e cila kurban kishte bërë monarkinë dhe gjithë atë që ai e kishte quajtur paqe qytetëruese në qendër të kontinentit të vjetër - nuk ishte aq e fuqishme për ta kushtëzuar atë kthesën e madhe dhe që gjërat t’i sillte aty ku ishin dikur. Kjo mbase bënte që në vetminë e vet të thellë, në kërkim të kapërcimit të asaj gjendjeje të rëndë në të cilën sharronte gjithnjë më shumë sa nganjëherë i dukej se nuk kishte shpëtim për të as për ëndërrimtarët dhe dështakët e shumtë, të cilët ngushëlloheshin me përfytyrimin e mrekullive, që ua prodhonte mendja e megjulluar, t’u jepej bredhjeve ndër më të ndryshmet, të cilat ngjanin në gajasje jashtë kohe dhe hapësire, diku ku gjithçka ngatërrohet sa të shlyhet kufiri midis së mundshmes dhe të pamundshmes, asaj që është dhe asaj që nuk është, ku do të mbetej përherë, por ishte skena e dhunshme ajo, e cila prapëseprapë i krijonte një shpërfytyrim të turbullt të vetmisë së Rudolpplazit, që nuk i ndahej dot...

Në të vërtetë, të menduarit e Skulptorit për atë flakën e shpërthyer diku në malet e Kosovë kundër dhunës dhe përpjekjeve serbe, thujse të pashembullta, që kishte ndërmarrë nga koha e kthimit të sërishëm të përgjakshëm në të për ta kthyer në një tokë të pastër serbe, me të cilën krijoheshin rrethanat për shkatërrimin e asaj krijese me të cilën i ishte rrënuar kështjella perandorake, sikur i kishte mbetur i ngrirë jashtë kohës, diku në kokën e megjulluar tek përtërihej dhe ripërtërihej në kërkim të përmbushjes së qëllimit të vënë, edhe pse me

kalimin e viteve lëvizja e Kosovës thajse ishte shuar dhe thuhej se madje kishte dështuar, sa nga pamundësia që nga brenda t'i bëhej ballë një soldateske, e cila kishte përdorur gjithë fuqinë ushtarake për të bërë shkumb e hi viset ku kishte shpërthyer "kryeneçësia" (pa kursyer as gur as dru), sa nga faji i shtetit shqiptar i cili, i shtyrë t'i përmbushte detyrimet ndërkombëtare, kishte nënshkruar marrëveshje mirëkuptimi dhe paqeje pikërisht me vendet që ia kishin përgjysmuar trungun (Jugosllavinë dhe Greqinë), të cilat e detyronin të pranonte në këtë rajon realitete të reja shtetërore dhe etnike, me çka zotohej se jo vetëm që nuk do të ndihmonte me asgjë kurrfarë lëvizjeje irredentiste, por merrte përsipër edhe t'i luftonte, siç kishte ndodhur menjëherë pas nënshkrimit të marrëveshjes shtetërore me Beogradin, kur shumica e krerëve të „Komitetit të Kosovës“, me apo pa paralajmërim, në mënyra të ndryshme ishin paqësuar dhunshëm. Nga ana tjetër, ata që megjithatë edhe më tutje kishin dashur të vepronin në përmbushje të betimit „me dekë për Shqipërinë“, të nxjerrë njëzëri në Kuvendin e Verrave të Llukës, ishin hequr qafe edhe me anën e plumbave që u kishin ardhur nga prapa, pa u kursyer as të merituarit për pavarësinë e Shqipërisë...

„Logjika e mbijetimit dosido është e pamëshirshme, vrasëse dhe vetëvrasëse, njëherësh“, kishte gjykuar si përçart Skulptori, gjithnjë me mundimin e mendimit që lidhej me fatkeqësinë e Kosovës, e cila tash i vinte nga vetvetja, mu pse ishte sjellë nga të tjerët në atë gjendje dhe, ashtu si Koloneli, që në pritje të plumbit, i cili do t'i vijë si prej qiellit gjatë mbylljes në teqenë e Leqes, ku megjithatë kishte medituar dhe në atë meditim kishte gjetur ngushëllim të përfytyrimi i bërjes së Shqipërisë Shqipëri, edhe ai provonte të lirohej disi nga ankthi i hiçit, në të cilin ishte përfshirë dhe që e dinte se atë e kishte dënim të pashmangshëm.

Pra në atë përpëlajtje të pandalshme, e cila nuk kishte qenë tjetër pos sillje në hapësirën e atij labirintit të madh tragjik, sikur nuk kishte qenë në gjendje të pajtohej me shuarjen e lëvizjes kryengritëse në Kosovë, ngaqë ashtu pranonte edhe peshën e asaj hiçgjëje që e kërcënonte ta bënte fare të paqenë dhe, për ta mundur disi apo për ta darovitur paksa atë ndjenjë tepër të rëndë, kishte vazhduar ta përfytyronte dhe ta imagjinonte atë kryengritje tek shtrihej e përhapej gjithandej, pra ashtu si e dëshironte, jo vetëm brendapërbrenda atyre maleve të shkretuara nga dhuna serbe, por edhe gjetiu, saqë flakën e saj ta shihte të ngrihej e lartësohej deri në qiell dhe me të t'i rrënoheshin themelet mbretërisë serbo-jugosllave, krijesës së Versajës, të cilën e konsideronte shkaktare kryesore dhe, siç i thoshte „shkatërruese e harmonisë qytetëruese“ dhe të vlerave të saj, e të ngjashme me këtë. Në atë përfytyrim sikur u ishte futur flaka edhe flamujve të kuq të perandorisë ruse dhe bolshevizmit proletar, pikërisht atyre flamujve që shikimi i tij i fundit i kishte zënë ditën e nëntë të atij maji kur armata sovjetike do të shfaqet në Ballplaz me ato çirrjet e tmerrshme se bota me dhunë do të bëhej internacionale...

„Kosova dhe vetëm flaka e saj shpëton botën nga dhuna e ortodoksisë së kuqe...“

Kështu thoshte Skulptori i përfshirë nga grahami të një deliriumi që i ndizej diku në errësirën e shpirtit, pa qenë në gjendje që kokës së tij t'ia sillte ndriçimin që e kërkonte dhe e dëshironte pareshtur...

Megjithatë, dallimet midis tij dhe Kolonelit ishin shumë të mëdha, thajse të papajtueshme. Këtë e dinte edhe Skulptori, sepse ndryshe nga ai që ishte i mbyllur dhe në pritje të plumbit, i cili do t'i vijë pikërisht pse atë e kishte kthyer në ideal, do t'i shërbejë bërjes së Shqipërisë Shqipëri, si një domosdoshmëri qytetëruese, që pashmangshëm do të shpjerë në mbisundimin e perandorisë së më të mirës, e përfytyrime të tjera gjithfarësh, të cilat sikur nuk kishin fund, pra çdo gjë e tij kishte qëllime dhe lidhej për të. Ndërsa ai nuk kishte tjetër veçse dëshira të flakta urrejtjeje madje, të cilat më shumë ishin pjesë e dëshpërimit dhe e mllefrit të thellë që shfaqeshin si hakmarrje ndaj së humburës sesa pjesë e përfytyrimit dhe e ndërtimit të ardhmërisë, sado që ndonjëherë, gjatë asaj përçartjeje dëshpëruese nuk përjashtonte as mundësinë të vdiste diku në malet e Kosovës dhe këtë ta bënte pa ndonjë dhembje. Por e gjitha, edhe po të ndodhte, nuk ndryshonte fare gjendjen dhe preokupimin me të cilin ëndërronte një shembje të madhe, e cila i duhej botës që t'u

hakmerrej atyre që ia kishin shkaktuar atë rrënim, ku, siç do të kuptojë më vonë gjatë asaj vetmie të vetëmbylljes prej gjashtë vjetësh e tetë muajsh, e gjitha ishte pjesë e asaj urrejtjeje të thellë, e cila ia kishte ushqyer shpirtin të zvarritej ashtu mundimshëm në pritje dhe vetëm në pritje shpenzuese, e kjo mbase edhe e kishte ngushëlluar sado që nuk i kishte ndihmuar të dilte prej atij rrethi të përhershëm, ku edhe do të përfundonte...

Në këto rrethana Skulptori nuk kishte si të mos pranonte thirrjen e Zonja von Braun për dashurinë, por vetëm si shpëtim, e cila megjithatë gjendet në shpërfilljen e asaj që nuk paraqet dashuri, të cilën duhet luftuar me çdo kusht dhe gjithnjë që dashuria të mbrohet madje edhe me anën e urrejtjes, me ç'rast duhej t'i bëhej me dije se ajo ishte pjesë e shpëtimit të dashurisë dhe po qe nevoja, duhej t'i përkujtohej edhe ajo që dikur ishte kërkuar prej saj haptas në ato shkrimet e jashtëzakonshme publicistike, të cilat lidheshin edhe me ndërhyrjen ushtarake në Shqipëri për t'iu ndalur turri së keqes së madhe, kur armë të shumta të soldateskës serbo-malaziasë villnin pareshtur vdekje sy botës, gjëra këto që po të hapeshin pastaj mund të vinin në baraspeshë edhe çështjet e shpëtimit me ato të ndëshkimit, të krimit dhe të dënimit, si pjesë të dilemave të përhershme njerëzore, të cilat duhet pasur parasysh, hamendje këto që nuk i ndaheshin edhe atëherë kur ndiente mundimin e anktheve të tyre...

Megjithatë, kur ajo i fliste në telefon për dashurinë si domosdoshmëri e shpëtimit, kjo sikur ia kthente të menduarit për pranimin e humbjes dhe diçka më shumë madje, që shkon edhe deri te pajtimi me të, që sakaq ia përkujtonte ato të cilat lidheshin me Shqipërinë dhe misionin e tyre të dështuar, i cili kishte përfunduar ashtu, pikërisht pse ishte mbështetur mbi atë që Koloneli më vonë me të drejtë e kishte quajtur mashtrim dhe mbi të cilin pastaj kishte lënë edhe memorien „Zot-imi-Shqipëri“ si model të pakapërcyeshëm të tejkalimit të tij. Sepse, si mund të shpëtohej diçka që nuk ishte fare (mendohej për atë krijesën e marrëveshjeve të Londrës), dhe, ashtu si veprohej, (fala ishte për sjelljen e ndërkombëtarëve në Shqipëri që fund e krye drejtoheshin kundër vetëdëshmimit të asaj pjese të pranuar), nuk kishte gjasa të shkonte tutje një shpërftyrimi, me çka po ashtu, në emër të atij mashtrimi, vendosej një gjendje, e cila pikërisht u hapte mundësi keqkuptimeve dhe keqpërdorimeve që sillnin po atë...?

Skulptorit i kujtohet se në bisedën në verandën e drunjtë të kthyer nga liqeni, të bërë gjatë takimit të tyre të fundit në Berlin, që u kishte paraprirë atyre bisedave të përditshme prej nëntë vjetësh dhe nëntë ditësh nga nëntë minuta, kishte hapur çështjen e shpëtimit të Shqipërisë, të cilën e kishte përkrahur dikur, për të dalë pastaj te qëndrimi i bërjes së Shqipërisë Shqipëri, që e merrte për të drejtë dhe e kishte në saje te meditimeve të Kolonelit, të arsyetuara aq mirë në ato njëzet e dy shënimet e lëna në teqenë e Leqes në pritje të plumbit i cili do t'ia gjente kokën ditën e njëzetepestë të mbylljes. Ndërkohë, edhe pse me një vonesë prej pesëmbëdhjetë vjetësh, ngatërrimin e bërjes me nevojën e shpëtimit, me të cilën kishte filluar misionin i tyre në Shqipëri dhe dihej pse kishte dështuar, e quante gabim të pafalshëm, i cili u kishte paraprirë dështimeve të tjera, për të cilat kishte thënë se u ishin përplasur për kokë dhe më tutje do të prodhonin pasoja të rënda për të gjithë... Do të dëshironte t'i fliste edhe për atë flakën e kryengritjes së Kosovës, e cila kishte filluar menjëherë pas Luftës së Parë Botërore dhe që, përkundër dështimeve që i kishin ardhur nga ndërhyrja e atyre që e kishin krijuar dhe i frikësoheshin (dhe shumëkush e shihte edhe çështje të kryer dhe të harruar madje) ai nuk e merrte për të tillë, por çuditërisht ia shihte flakën atje diku në shpirtin e këtyre njerëzve, e cila një ditë do të marrë hov për t'u kthyer në diçka, e cila mund të shfaqej si prishje e “ndreqjes” së Versajës me ç'gjë kushtëzoheshin edhe prishjet e tjera, të cilat i duhen asaj ndreqjeje të madhe, pa marrë parasysh se a do të quhet urrejtje apo hakmarrje apo çfarëdo qoftë tjetër... Kishte rëndësi që me të i jepej fund asaj gjendjeje që e tkurte dhe e rrudhte deri në përmasa të atilla sa ta quante edhe shpëtim shpirti...

Mendonte t'i shpjegonte se atë flakë të kryengritjes së Kosovës e shihte edhe më shumë se ç'ishte plotësimi i një betimi, të ngjashëm me atë që Deli Braha kishte thënë: „me dekë për Shqipërinë“, me të cilin i lidhej edhe rikthimi a ribërja e atdheut të rrënuar dhunshëm

pikërisht në përmasat e dikurshme si „pasuri dhe domosdoshmëri qytetëruese“ e të tjera, ku e gjithë kjo pastaj përkonte me ato të cilat Koloneli kishte paraparë rreth vendosjes së perandorisë së më të mirës që si parakusht kishte prishjen e asaj “ndreqeje” të Versajës, me të cilën bëhet e mundshme ndreqja e asaj prishjeje të madhe botërore, të nisur gjatë Luftës së Parë, që po ashtu nënkuptonte shembjen e „ndreqjes“ së saj, pra të mbretërisë jugosllave të drejtuar prej serbëve... Dhe do t’i thoshte se për të edhe mund të vdiste, bile këtë herë do ta bënte pa ndonjë hezitim, e të tjera si këto. Por kishte qenë qëndrimi i saj fare i ftohtë, i cili ia kishte ndërprerë dalldisjen dhe, veç kësaj, edhe ndërhyrja e saj me formulimet rreth dashurisë si shpëtim, me të cilat ia kishte bërë me dije troç se ato biseda, jo vetëm nuk i përfillte, por edhe i hidhte poshtë...

Shumë vjet më vonë, gjatë vetmisë së vetëmbylljes prej gjashtë vjetësh dhe tetë muajsh, që kishte marrë fund atë ditën e nëntë të majit me pamjen e parakalimit të ushtarëve sovjetikë në Ballpallaz me flamuj të kuq dhe me çirret e tyre për internacionalen proletare, kishte qenë pikërisht ai përfthimi i qëndrimit të ftohtë të saj, që gjendjet e mllëfit të madh të mbushura me urrejtje, sikur për pak ia kishin zëvendësuar me përpjekjen e fundit që fashën e ndijimit të dashurisë ta ndejë si shpëtim dhe madje ta kërkojë si të tillë, e cila megjithatë kundruall atij rrënimi të pandalshëm, nuk i kishte sjellë tjetër përveç pajtimit me atë se ishte i vetmuar dhe e kishte shkelur koha tmerrësisht, e pa apo nuk e pa këtë, dhe ashtu ia bënte me dije se urrejtja mund të ngushëllonte disi, por assesi të shpëtonte...

Në kujtimet e lëna, të shkruara për ata nëntë vjet e nëntë ditë, të cilat nga Berlioni i kishin ardhur me postë tri ditë pas vdekjes, të dërguara nga i nipi Gynter Hajer, nuk e kishte pasur të vështirë të gjente ato që Zonja von Braun, jo vetëm nuk ia kishte përfillur fare gjatë takimit të fundit të tyre të bërë në verandën e drunjtë me shikim nga liqeni, por edhe pse ia kishte ndërprerë me fjalët për domosdonë e dashurisë si shpëtim, kur ai kishte nisur t’i fliste pse kishte hequr dorë nga qëndrimi i mirëfilltë për shpëtimin e Shqipërisë, me të cilin kishte filluar misioni i vullnetarëve në përkrahje të Qeverisë së Përkohshme dhe të mbretit për të kaluar te mbrojtja e bërjes së Shqipërisë Shqipëri dhe të tjera si kjo. Kishte dashur t’i fliste edhe rreth kryengritjes së Kosovës dhe t’i lidhte të gjitha këto me të dhe vetëm për të si një nyjë që çuditërisht ishte në gjendje të nxiste dridhje botërore e cila, ndonëse dukej e shuar, megjithatë flakën e saj, si një eklips që shfaqej e rishfaqej që t’ua dëshmojë forcën e ligjësisë të natyrshme, të çështjeve që ishin të drejta, por edhe të dobishme për kthesa të mëdha, (qofshin ato edhe fare ëndërrimtare, siç ishte ajo e Kolonelit rreth vendosjes së perandorisë së më të mirës, me të cilën u jepej fund të këqijave të tjera), edhe më tutje e shihte të hapur, e shihte tek ushqehet me mllëfin e brendshëm dhe me të gjitha ato shtresime të tjera që ishin pjesë e atij krimi të madh, të asaj vrasjeje të paralajmëruar haptas, e cila një ditë doemos që do të shpërthejë për t’u përhapur gjithë derisa të ndreqej ajo prishja e madhe botërore me Versajën si nyjë e së keqes së pafalshme, e të tjera si kjo, të cilat asaj i ishin dukur të papranueshme...

„Shqipërisë i duhet dashuria dhe vetëm dashuria, sepse vetëm ajo e shpëton...“- kishte shkruar Zonja von Braun dhe me këtë vlerësim që paraqitej si strumbullar i të menduarit të saj të gjithëmbarshtëm, sikur kishte kërkuar të pajtonte ato që një kohë të gjatë kishin mbetur të hapura midis Kolonelit dhe Skulptorit, po edhe të tjerëve, që dukeshin madje të papajtueshme, kur kishte shkrirë fjalët *shpëtim të Shqipërisë dhe bërje të Shqipërisë në dashuri për Shqipërinë*, e që pa ndonjë arsyetim ishin shfaqur me një frymë të re, (me siguri as Koloneli nuk do t’i kundërshtonte), por njëherësh kishte lënë të hapur çështjen e kthimit tek ajo dhe shkaku të cilit do t’i paraprinte, të cilën Skulptori e kishte parë te krijimi i rrethanave, ku prishja e madhe e asaj „ndreqeje“ të Versajës të mos kthehej në një gjendje të qëndrueshme, por të rrënohej në emër të një ndreqjeje të madhe botërore, e cila nuk ishte e mundur pa atë flakën e kryengritjes së Kosovës dhe fitilin e saj të hapur, që natyrisht se nuk do të shpërthente po të mos ishte urrejtja për pushtuesin dhe ai betimi me madhështi makabre „me

dekë për Shqipninë“ i nxjerrë te Verrat e Llukës dhe që si i tillë mund të merret dashuri e shkuar dashurisë...

Sikur t'ia kuptonte ato që i kishin mbetur t'i bluante nëpër kokë, gjatë takimit të tyre të fundit në verandën e drunjtë të kthyer nga liqeni, rreth flakës së Kosovës diku në malet e Drenicës, të cilën ai e shihte të pashuar dhe si fitil, i cili pashmangshëm një ditë do të shërbente, siç mendonte dhe si dëshironte, për të ndrequr atë prishje të madhe botërore, të shkaktuar nga Lufta e Parë Botërore, pra, vite më vonë, kur të gjitha zhvillimet pandalshëm çonin drejt asaj luftës tjetër të madhe botërore, të dytës me radhë, e cila, sikur të shfaqej për të dëshmuar parashikimet e Kolonelit se „*bota do të digjej dhe do të digjej derisa të bëhej Shqipëria Shqipëri*“, duket se edhe Zonja von Braun kishte qenë e vetëdijshme se në atë pjesë të botës fatin e dashurive përherë e përcaktonin luftërat, gjë që kishte dëshiruar të ishte e kundërta, pra si në antikë, që fatin e luftërave ta përcaktojnë dashuritë...Andaj, ky përcaktim, që ajo nuk e kishte thënë haptas, mbase e kishte shtyrë që te kujtimet të përfshijë edhe një si romancë midis dy të rinjve, të quajtur „*Dashuria Shqipëri*“, ku thoshte se mendohej të luhej diku në malet e Kosovës, të cilat herë i quante „fole perëndish“ e herë „oltar i dashurisë“ që dukej kështu:

Vajza i thotë djalit:

„*Do ta këndojmë atë këngën për dashurinë?*“

Djali i thotë vajzës:

„*Do ta këndojmë...*“

Vajza djalit:

„*Si do t'ia nisim?...*“

Djali i thotë:

„*Si rëndom. Bashkë...*“

Vajza i thotë djalit:

„*Megjithatë, dashuria shpallet vetëm...*“

Djali i thotë vajzës:

„*Ajo tashmë është shpallur...Dhe dihet...*“

Vajza i thotë djalit:

„*Ajo nuk merr fund kurrë...*“

Djali i thotë vajzës:

„*Mirë pra...Po ia nis...*“

Vajza i thotë djalit:

„*Nisja...Sa më parë...*“

Djali i thotë vajzës:

„*Ndihem i huaj pa ty...*“

Vajza i thotë djalit:

„*A nuk është kjo përsëritje?...*“

Djali i thotë vajzës:

„*Dashuria s'është veçse përsëritje e së njëjtës?...*“

Vajza i thotë djalit:

„*Dashuria është edhe urrejtje për atë që vret dashurinë...*“

Djali i thotë vajzës:

„*Do t'i urrejmë vrasësit e dashurisë...*“

Vajza i thotë djalit:

„*Do t'i urrejmë vrasësit...*“

Djali i thotë vajzës:

„*Do t'i luftojmë vrasësit e dashurisë...*“

Vajza i thotë djalit:

„*Do t'i luftojmë vrasësit...*“

Djali i thotë vajzës:

„Rroftë dashuria!“
Vajza i thotë djalit:
„Rroftë dashuria!“
Vajza dhe djali bashkë:
„Do të jetojmë për dashurinë-dashuri...“
Vajza dhe djali bashkë:
„Do të jetojmë dhe do të dashurojmë...“

V

Zotimin „do të jetojmë për dashurinë...“, thënë sikur „do të jetojmë për Shqipërinë...“, Skulptorit i ishte dukur se e kishte dëgjuar para njëzet e pesë vjetësh në Vjenë nga studenti Zenel Xhema, me rastin e takimit me Kolonelin, kur ai për herë të parë kishte ardhur me Zonja von Braun në atelie për të marrë pjesë në ato bisedat që zhvilloheshin aty midis intelektualëve lidhur me qëndrimin ndaj krizave të ngjashme, siç ishte ajo shqiptare në kuadër të atyre ballkanike, të cilat, në prag të kthesave të mëdha, shfaqeshin në një dritë tjetër, ndryshe nga vlerësimet e deriatëhershme bardhë e zi, të cilat u bëheshin lëvizjeve çlirimtare në ato hapësira me plot shqetësime etnike dhe politike.

Zenel Xhema, që me zell të madh studionte historinë në Universitetin e Vjenës dhe, thoshte se këtë e bënte edhe nga dëshira t’i ndihmohej sa më shumë që ishte e mundur ndriçimit të asaj pjese të historisë shqiptare, e cila ishte anashkaluar, madje edhe ishte keqinterpretuar prej atyre që shkencën e kishin kthyer në politikë dhe ua kishin nënshtuar qëllimeve, (fjala vjen ato që u shërbenin projekteve hegjemoniste), pra përkundër atyre të ligave të përjetuara nga familja e tij dhe shumë e shumë peripeci të tjera me rastin e dëbimit nga krahina e Toplicës gjatë luftës së vitit 1877, (po edhe që, siç thoshte „duhet me jetue për Shqipërinë“, „me u ba dhe me e gëzue“), mendohej ta mbante drejtpeshimin mendtor dhe njerëzor edhe atëherë kur dukej se kjo ishte më se e vështirë, veçmas kur ishte më se e qartë se historia përsëriste pandalshëm fatkeqësi të mëdha, të cilat bëheshin edhe më të mëdha nga qëndrimi shpërfillës e gjakftohtë përreth si dhe nga lojërat politike dhe diplomatike mbi të cilat mbështeteshin...

Këtë ia kishte përsëritur edhe Kolonelit gjatë bisedës së parë të zhvilluar me të, kur Skulptori e kishte paraqitur „djalosh që për Shqipërinë është në gjendje të japë çdo gjë, edhe të vdesë madje“.

„Due me jetue për Shqipërinë dhe duhet me jetue për Shqipërinë“ - kishte thënë studenti Zenel Xhema, qëndrim ky që i kishte pëlqyer Kolonelit, i cili po ashtu kishte bindjen se qëllimet e mëdha, siç ishte edhe e drejta e krijimit të shtetit shqiptar në hapësirat etnike, pa marrë parasysh rrethanat e pavolitshme dhe vështirësitë e shumta nëpër të cilat kalonin, gjithmonë duhej të ndiqnin betimin e jetës, e jo të vdekjes, të krijimit, e jo të rrënimit, e këtë ia kishte bërë me dije edhe studentit Zenel Xhema, kur i kishte thënë se „betimi i vdekjes është humbje, është një dështim i plotë, i cili kurrësi nuk duhet të lejohet“, për të shtuar se „vetëm me jetë krijohet ardhmëria e saj, pra, kur i hapen rrugët dhe i shihen shtigjet për breza e breza të tërë, në vend se t’i mbyllen...“

Megjithatë, zotimi „do të jetojmë për dashurinë“, nga kujtimet e Zonja von Braun, i nxjerrë nga qëndrimi i paluhatshëm „kemi me jetue për Shqipërinë“, që i bëhej se ishte shqiptuar prej studentit Zenel Xhema dhe që vinte nga një vend i papërcaktuar si një jehonë e ndrydhur dhe e dridhur tmerrësisht, sikur po i kthehej në brohoritjen: „kemi me luftue për Shqipërinë“ e që djali e vajza, diku në Kosovë po e kthenin në një betim të thellë dashurie, që atij, në atë rrotullim fjalësh dhe kuptimesh, po ia krijonte thirrjen: „kemi me dekë për Shqipërinë“, e cila nganjëherë sikur i kthehej në kërcënim vdekjeje të përsëritshme me shumë

e shumë sosh, ku përfshihej edhe vdekja e Shqipërisë, që shtrihej e përhapej saqë i dukej se ishte në kundërshtim edhe me atë që Zonja von Braun thoshte për dashurinë dhe shpëtimin me anën e saj, të cilën ai tashmë e kishte baraspeshuar me nevojën e urrejtjes për hir të dashurisë, e cila i duhej për t'u kthyer domosdoshmërisht në dashuri të përhershme dhe që përpiquej ta merrte dhe ta kuptonte si të tillë...

Pra, përballë asaj mëdyshje që sa vinte e i shtohej, jo vetëm nuk dëshironte t'i kundërvihej asaj që thoshte ajo, ngaqë e merrte për të drejtë që i duhej përcaktimit me të cilin vetëm ashtu bashkohej dhe njëjtësohej me Kolonelin, por për më tepër, edhe nga shkakut se po ta shikonte ndryshe, atëherë hiqte dorë nga ajo që tashmë i ishte kthyer në bindje, e cila i duhej si ushqim shpirtëror për t'i bërë ballë atij poshtërimit dhe nënçmimi të tmerrshëm nëpër të cilin ishte i dënuar të kalonte atë kohën e viteve të vetëmbjlljes së vonuar nga dita e nëntë shtatorit, kur i kishin pushuar përgjithmonë bisedat telefonike prej nëntë vjetësh e nëntë ditësh, të zhvilluara me Zonja von Braun, për t'i marrë fund ditën e nëntë të majit, pikërisht pas gjashtë vjetësh e tetë muajsh dërgjeje me vetveten, kur nga dritarja e ateliesë në Rudolfsplatz kishte parë ushtarët sovjetikë me flamuj të kuq si vërshonin sheshin e dikurshëm të perandorisë dhe së andejmi me një predhë kishin qëlluar emblemën e vetme të monarkisë, e cila, nga pamundësia për ta arritur atë lartësi, u kishte shpëtuar militantëve serbë ta përdhosnin siç kishin bërë me të gjitha ato, të cilat u kishin dalë para ditën që kishte përfunduar Lufta e Parë Botërore...

Asaj përpëlitjeje, së cilës assesi t'i ndahej, ku i bëhej se edhe padashur kujtimet e Zonja von Braun mund t'i nënshtroheshin një rileximi, që shumë nga to të shihen ndryshe, madje edhe të plotësohen dhe të ndryshohen në përputhje me gjendjen me kthesa të mëdha, të cilën nuk e përcillte vazhdimisht dhe as që e shihte të domosdoshme të bënte një punë të tillë, i ishte frikësuar dhe dukej se po e gjente çastin kur të menduarit për dashurinë si shpëtim, që shihej kudo dhe kurdo dhe pandalshëm ia krijonte përshtypjen se kalonte në një ligjërim të rëndomtë, kishte filluar t'ia ngushtonte hapësirën edhe ashtu të vogël të ateliesë, ku i vetëmbjllur priste fundin (që e dinte se gjithsesi do t'i vinte). Dhe, ky fund, ndonëse nuk do të ishte as i veçantë, (si i Kolonelit në teqenë e Leqes në pritje të atij plumbi, i cili do t'ia gjente kokën ditën e njëzetepetë të mbylljes, kur edhe do të fillojë ajo Lufta e Parë Botërore, dhe ai në shënimet e lëna në pritje të vrasjes së paralajmëruar ai ia kishte parë fitilin në Shqipëri, për të cilin thoshte se do t'i mbetej i ndezur gjithë derisa Shqipëria të bëhej Shqipëri), e as nuk do të ishte i qetë dhe me plot andralla për dashurinë dhe fuqinë e saj magjike të shndërrimit dhe të shërimit të çdo plage, siç ishin ato me të cilat kishte përfunduar Zonja von Braun, ku identifikimi me Kolonelin dhe me idealet e tij i ishte kthyer në një ndijim superior shpirtëror me të cilin kishte mundur çdo gjë, e të tjera si këto, pra çdo gjë e këtij fundi do t'i shfaqej si pjesë e përgjithësimit në atë të keqe, nëpër të cilën pashmangshëm do të sharronte edhe ai fare padiktueshëm, si shumë e shumë të tjerë që fatkeqësinë e marrin si fatalitet...

„Dashuria është urrejtje“ - kishte pëshpëritur Skulptori përçart gjatë rileximit të kujtimeve të Zonja von Braun dhe këtë e kishte përsëritur e ripërsëritur sa e sa herë derisa i ishte bërë se në atë tundim ajo i ishte kthyer në një drithërimë tatëpjete, e cila kishte davaritur edhe ajrin e rëndë të hapësirës së mbyllur të ateliesë dhe e gjitha pastaj kishte marrë formën e një ligjërimi për dhe kundër asaj hamendje, e cila i vinte nga brendia, por që në të merrnin pjesë edhe trajtat thuajse të rrënuara të punimeve të mbetura, qysh moti të papërfunduara, në skajet e ateliesë, të cilat kishin shpëtuar pa u rrëmbyer nga ana e francezëve që do ta bënin me arsytimin se edhe ato „mund të ishin pjesë të propagandës së luftës“ dhe se ato tashmë po i thoshin se „urrejtja ishte dashuri“ dhe këtë mundoheshin ta arsyetonin se „urrejtja ndaj urrejtësve të dashurisë ishte e vetmja levë me të cilën vihej në lëvizje vepruese ajo fuqi, e cila i duhej frymës së krijimtarisë për të mbetur e pasosme...“, fjalë këto që me dëshirë do t'ia kishte thënë edhe Zonja von Braun, po që se do ta pranonte bisedën, me të cilën trajtohej „ajo dashuria ndryshe“ dhe ishte i bindur se që në nisje ajo do t'ia mbyllte të

gjitha shtigjet me ato që do t'ia përsëriste: „çfarëdo baraspeshimi i dashurisë me urrejtjen për hir të dashurisë a për ta parë ndryshe, atë e rrënon pamëshirshëm...”

Mbase, mendimin për dashurinë si urrejtje dhe domosdonë e përfilljes së saj, e cila u duhet atyre që kanë frikë se pa të ajo një ditë gjithsesi mund t'u hakmerrej, dikur e kishte zbutur paksa, kur atë kishte nisur ta shihte në shërbim të dashurisë dhe sikur e kishte mbrojtur me të menduarit se dashuria vetvetiu nuk qëndron, porse ajo duhet të mbështetet që të jetësohet, fillimisht për t'u përjetuar, e pastaj për të marrë vrull sa të bëhet e njëmendtë: e prekshme dhe e shpënzueshme...

Një çast madje kishte thënë se pa urrejtje nuk ka dashuri dhe këtë kapërcim, i cili me ato rënie e ngritje që nuk do t'i ndahen, do t'i mbetet pjesë e të menduarit të mëtejshëm e që i shkojnë asaj gjendjeje amull, me siguri se ia kishte shkaktuar „*Dashuria Shqipëri*“, e luajtur diku në Kosovë midis dy të rinjve, të cilën e kishte parë sikur të ishte e shkruar me përkushtimin „urrejtja, e domosdoshme për ta ruajtur dashurinë Shqipëri“, ku vajza dhe djali në malet e Drenicës kishin biseduar dhe ishin marrë vesh për atë „urrejtjen që i duhet dashurisë Shqipëri“, që ta ushqejë shpirtin e tyre derisa të shfaqet dhe të kthehet në veprim të pandalshëm për të mbetur e tillë deri të jetësohet, e që Skulptori e kishte rindëguar të thuhej e të rithuhej si një betim i përhershëm, i cili i duhet dashurisë Shqipëri, ku vargu „do t'i urrejmë vrasësit e dashurisë“, do t'i vijë si : „do t'i luftojmë vrasësit e Shqipërisë“. Ngjashëm i bëhej se i thoshin edhe shumë e shumë të tjerë, ku pastaj ato përcilleshin me një vallëzim të hijeve, që merrte hov e përhapej në një lartësi të arritshme nga një tis i hollë mjegulle, i cili ngjitej e përngjitej nëpër qiell si një re e lehtë dhe ngado që kalonte linte njëfarë jehone të çuditshme nga e cila sikur liroheshin disa gjysmë tinguj me të cilët provohej të lidhej njëfarë porosit e paqartë, por sikur kapej dhe qartësohej ndryshe e ndryshe, herë si „një dashuri nga Kosova...“ herë si „një urrejtje nga Kosova...“ herë si „një vdekje nga Kosova...“, gjithsesi gjithfarësh...Por, edhe si të tillë, i bëhej se atë e ndiqnin njësoj ata, të cilët tek ajo çuditërisht kishin varur shpresat sikur të ishte fjala për një abrakadabra së cilës i duhej edhe shkopi magjik i iluzionistit të cirkut, në të cilin kapeshin edhe monarkistët e shkallmuar të të gjitha ujemeve dhe nuk pushonin së llomotituri për të kaluarën sikur ta kishin në pronësi, por gjithsesi kapeshin edhe militantë komunistë (stalinistë, trockistë, leninistë dhe kusuri tjetër i së majtës), bashkë me anarkistët e papërmbajtur, që njësoj çirreshin për rrënimin e botës së vjetër, domethënë për rrënimin e botës së padrejtë, për rrënimin e dhunshëm të shtypësve, që pastaj me drapër e çekan në dorë kërcënoheshin me përmbysje të tjera revolucionare, ku do të derdhej gjaku deri në gju, dhe me gjithçka...

Ai përfitim sikur e kishte ndarë dhe shthurur shpërputhshëm në pjesë të ndryshme, të cilat ngatërrueshëm kundërshtonin njëra-tjetrën, saqë kishte dëshiruar t'i ikte sa më parë, por ishte një mbërthim i çuditshëm që e kishte mbajtur të ngujuar, kur i ishte bërë se në pjesën e fundme të ateliesë, të përfshirë nga punimet e papërfunduara bashkë me ca vjeturina të tjera prej vitesh të mbetura në atë vend, kishte hetuar diçka si lëvizje, e cila pak nga pak ia krijonte pamjen e njëfarë skene të vogël, e cila nxirrte pamje të disa hijeve përdëllimtare, që i përvijoheshin dhe si të tilla i formësoheshin, sikur të kishin për qëllim rishfaqjen e pa rëndomtë të të vdekurve, me ç'rast midis tyre i dukej se shihte atë të spanjollit Rafaelo, pastaj shihte edhe të çekut Hajek, atë të poetit Hartman, shihte edhe të polakut Avramicki, po shihte edhe disa të tjera, që i dukeshin sikur të ishin të ushtarakëve, të gjithë të vlarë në Shqipëri gjatë asaj vere të katërmëdhjetëshes në përbërje të misionit të vullnetarëve, të cilët kishin shkuar atje për të ndihmuar Qeverinë e Përkohshme dhe mbretin dhe që e gjithë kjo përhitje, nuk ishte tjetër përveç një përpjekje rikthimi në kërkim të Shqipërisë dhe rivdekjes në të, që Skulptorit iu duk se mund të ishte pjesë e asaj fanitjeje, e cila i kishte ardhur nga të menduarit për fundin e pashmangshëm, të cilin, po të vendoste, do t'ia dëshironte mu atë përfundim, pra të ndodhte diku në Shqipëri me çka do të kursehej nga nënçmimet dhe të gjitha ato që i kishte përjetuar për aq e aq vjet, sikur t'i kishte shpagim të ndonjë mallkimi, të ngjashëm me atë që Koloneli ia kishte parë botës nga mëkatet, të cilat i kishte kundrejt Shqipërisë.

„Sërish do të vdiset në Shqipëri...” - thoshte spanjolli Rafaelo.
 „Do të vdiset...” - ia kthenin të tjerët si me një gojë.
 „Do të vdesim, pse jo...?” - thoshte spanjolli.
 „Sërish do të vritet maratona shqiptare” - fliste çeku Hajek.
 „Do të vritet...” - ia kthenin të tjerët si me një gojë.
 „Do të vritet, pse jo...?” - thoshte çeku.
 „Sërish do të vritet Iliada shqiptare” - thoshte poeti Hartman.
 „Do të vritet...” - ia kthenin të tjerët si me një gojë.
 „Do të vritet, pse jo...?” - fliste poeti.
 „Sërish do të vritet bankënota shqiptare” - fliste polaku Avramicki.
 „Do të vritet...” - ia kthenin të tjerët si me një gojë.
 „Do të vritet, pse jo...?” - thoshte polaku.
 „Sërish vrasje...” - flisnin bashkërisht.
 „Vrasje... Vrasje...”
 „Pse jo?...”
 „Sërish vdekje...”
 „Vdekje... Vdekje...”
 „Pse jo...?”
 „Vrasja-Shqipëri!...”
 „Vdekja- Shqipëri!...”
 „Shqipëria!...”
 „Shqipëri?...”

I dukej se korifeu tashmë fliste haptas rreth *vrasjes Shqipëri*, që do të vazhdonte e do të vazhdonte, do të përsëritej e përsëritej, herë haptas e herë fshehtas, herë ashtu e herë kështu, herë nga jashtë e herë nga brenda, e herë-herë bashkërisht, derisa në Kosovë të mos ri shpërthente ai fitili i kryeneçësisë, i mbetur diku në malet e saj në Drenicë, ose gjetiu, me të cilin do të prishej Versaja...

Madje, në atë kor mortor, që sa vinte e shtoej edhe me hije të tjera të shumta, të cilat përdëlleheshin, sikur shihte të merrte pjesë edhe Koloneli tek fliste për vrasjen dhe vrasjet, madje këtë sikur e vërente te të gjithë, sado që në shënimet e lëna në teqenë e Leqes në pritje të plumbit që do t'ia gjente kokën gjatë atyre bisedave të herëpashershme të përfytyruara me poetin Hartman, me çekun Hajek dhe polakun Avramicki, thuajse pareshtur i kishte trimëruar të vazhdonin punën e tyre, pa marrë parasysh vrasjet që i pritnin, sepse, siç thoshte ai, „*maratona shqiptare do të vazhdojë derisa të bëhet Shqipëria Shqipëri*“, „*Iliada shqiptare do të shkruhet dhe do të shkruhet derisa të bëhet Shqipëria Shqipëri për të dëshmuar se është pjesë e atij shpirti të lashtësisë*“, e „*edhe bankënotat shqiptare do të preheshin një ditë*“, e të tjera si këto që ia krijonin përshtypjen se edhe ai do të përfshihej në atë përdëllim mortor. Dhe mbase edhe do të ndodhte kjo dhe me dëshirë do ta pranonte sfidën e saj po të mos kishte ndier se ishte shfaqja e papritur e Zonja von Braun, e cila gjithë lojës i kishte dhënë kah tjetër me fjalët, të cilat kishte nisur t'i fliste për dashurinë dhe nevojën e ndijimit të saj, kur me një maturi të vënë re, por gjithë tundim i kishte thënë spanjollit Rafaelo se „*në Shqipëri do të dashurohet...*“, „*në Shqipëri do të vinte për dashuri...*“ dhe që sa herë të vinte „*do të gjente një dashuri edhe më të madhe...*“ e ngjashëm do t'i thoshte edhe sportistit çek Hajek rreth vazhdimit të maratonës së dashurisë shqiptare, „*që një ditë do të shpallej kampione e botës në dashuri...*“, dhe njëjtë do t'i fliste edhe poetit Hartman rreth Iliadës shqiptare, „*e cila do të shfaqte shpirtin antik që e kishte përherë...*“, si do të thoshte edhe për bankënotat shqiptare, që i duheshin shtetit shqiptar për t'u bërë shtet, bindje këto, të cilat i kishte shoqëruar me një si këndim të ndjeshëm dhe që pak nga pak hapësirën e vogël të ateliesë e kishte liruar nga mbërthimi i zymtësisë...

„Kështu ndodh kur dashurisë i hiqet jeta...” – i dukej po i fliste Zonja von Braun, zëri i së cilës sikur i vinte qortues nga errësimi i strukur i ateliesë.

Një copë herë kishte përcjellë atë jehonë se si përplasej nga një anë në tjetrën, duke lënë prapa një tingëllimë kërcënimi dhe mbase ishte gati t'i përgjigjej me fjalët se „ndodhte ashtu kur dashurisë i hiqet urrejtja e nevojshme për t'u bërë dashuri e përhershme“, por ishte sërish ai zë, i cili i dukej si i Zonja von Braun, pikërisht ai që për nëntë vjet e nëntë ditë i kishte ardhur nga pjesa tjetër e kufjes së telit, tek po i thoshte se „nuk kishte të drejtë ta gjykonte ashtu dashurinë“, se në atë mënyrë „kishte bërë një mëkat të pafalshëm ndaj saj“. Kishte shqiptuar edhe fjalë të tjera qortimi dhe me siguri se do të vazhdonin me atë frymë po të mos i kishte thënë se „urrejtjen e shihte si pjesë të njëmendtë të saj, si diçka që duhej të kthehej dhe të bëhej dashuri e përhershme dhe e përjetshme...“

Për t'i arsyetuar të gjitha këto konstatime, të cilat i kishte nxjerrë me një shqetësim të ndjeshëm, kishte folur sikur të shtronte pyetjen rreth çështjes se çfarë do të ndodhte me atë vajzën dhe djalin diku në malet e Kosovës, po qe se atyre do t'u flitet e flitet pareshtur për dashurinë që duhet kërkuar, me të cilën harrohet urrejtja, e të tjera, e të tjera si këto, nëse pikërisht në ato rrethana të mungesës së dashurisë, kur ajo u është vlarë tmerrësisht dhe pamëshirshëm, do të mësoheshin të ëndërronin vetëm për të dhe ta përfytyronin si diçka që ua mbush shpirtin me shpresë, që u vjen vetëm nga besimi i dashurisë, në vend se të urrejnë vrasësit e dashurisë, me çka me të drejtë duhet të kundërshtohet gjendja pa dashuri, e krijuar dhunshëm, dhe pasojat e saj...?

„A nuk do të ishte vrasje e tmerrshme e dashurisë ëndrra për kthimin e saj pa u ushqyer urrejtja ndaj vrasësve të dashurisë, të cilët u rrinë mbi kokë dhe nuk pushojnë së rrënuari çfarëdo prirjeje jetësore...“?

„Pse sheh vetëm atë që e shkatërron dashurinë...“?

„Sepse dua ta shoh vetëm atë që e shpëton dashurinë...“

„Sheh vetëm rrënim...“

„Shoh ndërtim...Shoh atë që i duhet shpirtit të mbahet edhe atëherë kur e ka shumë të vështirë...“, kishte folur Skulptori qetas, i kënaqur që më në fund ia kishte dalë të haptë çështjet, me të cilat nxirrej nga nënçmimi i vetmisë, në të cilën sharronte gjithnjë më shumë.

„Po, ç'është, vallë, urrejtja...“?

„Pjesë e dashurisë. Madje, pjesa e saj më e rëndësishme, pa të cilën nuk bën, pa të cilën ajo duket vetëm një mashtrim...“

Sikur të kishte ndier shpagim për ato që nuk i kishte thënë për dashurinë dhe ndijimin e saj, të cilat Zonja von Braun ia kishte përsëritur e përsëritur pareshtur gjatë bisedave telefonike për nëntë vjet dhe nëntë ditë (kur i fliste ashtu ajo edhe do të kishte mundur të merrte me mend se i përplaseshin diku dhe mbase një ditë mund të shpërthenin për ta bartur andej nga nuk kishte shpëtim fare), Skulptori kishte vazhduar të fliste dhe të sqaronte pse dashuria pa urrejtjen është e mangët, pse e merrte për mashtrim, që mund ta kthenin në një ligjërim përgjithësues, ku mund t'i merrej ajo e cila i duhej e t'i lihej ajo që nuk i duhej, e të tjera si këto, për të shtuar pastaj se dashurisë që i besonte me bindje të plotë, ishte ajo e cila dilte nga urrejtja e asaj që e pengon dashurinë, që nuk e lejon të bëhet e përjetshme deri atje sa edhe e vret dhe e rivritet...

Pasi kishte folur e folur me një përkushtim të madh se urrejtjen e merrte për shpëtim dhe ushqim të dashurisë, se asaj dhe vetëm asaj tashmë i besonte me tërë qenien e vet dhe që nëpër atë shoshitje të pandërprerë të saj kishte thënë se pikërisht e ngjashme ishte edhe ajo fryma e romancës së quajtur „*Dashuria Shqipëri*“, të cilën e kishte parë të luhej diku në malet e Kosovës, pra që t'ia bënte me dije se jo gjithçka e ligjërit të saj për dashurinë ishte e njëtrajtshme dhe në përputhje me domosdonë e kërkimit të përhershëm, por kur shikohej mirë e mirë, ishte e mbarsur edhe me të kundërtën e saj që i duhet për t'u bërë e plotë, që gjithë të menduari të saj e ngrinte deri te kërkesa e patjetërsueshme se vetëm dashuritë ishin përgjegjëse për të gjitha, madje të përcaktonin edhe fatin e luftërave, pra në atë përdëllim për ta dëshmuar edhe atë ndijimin e njëmendtë të dashurisë dhe pushtetin e saj të plotë, të cilit nuk mund t'i shmangej, sesi prej vargjeve të saj të nxjerra, kishte krijuar vjershën „*Dashuria*

dhe urrejtja“, të cilën e kishte përsëritur dhe përsëritur gjithë tundim, duke thënë se atë ia kishte krijuar pikërisht të menduarit e gjithanshëm për dashurinë dhe për domosdoshmërinë e ruajtjes së saj:

*„Dashuria pa urrejtjen
Ndaj atij që vret dashurinë
Nuk është dashuri...
Urrejtja ndaj vrasësve të dashurisë
Është dashuri...
Andaj:
Urre vrasësit e dashurisë...
Andaj:
Lufto vrasësit e dashurisë
Gjithmonë
Dhe gjithmonë...
Andaj:
Rroftë dashuria!
Andaj:
Rroftë urrejtja
Që ushqen
Dhe mbron dashurinë!...
Rroftë!...“*

Më pas kishte ndeshur një heshtje trishtuese sa kishte përshtypjen se vargjet e krijuara ashtu nuk kishin qenë tjetër përveçse një vetëshkrim që i duhej për t'i bërë ballë atij shkallmimi nëpër të cilin kalonte. Por, kur kishte marrë veten dhe kishte vërejtur se ai farë vetëdëgjimi paksa i ishte fashitur, ndonëse kjo nuk e kishte qetësuar fare, prapë kishte hetuar përdëllimin e hijeve në fund të ateliesë, nga i ishte dukur se Zonja von Braun edhe më tutje dëshironte t'i fliste për dashurinë dhe lajthitjet për t'ia larguar ato.

Në një trazim të tillë sikur iu bë se kishte folur, duke thënë se nuk kishte arsye për tjetër, përveç të shfaqnin qëndrimet, që të përbashkët e kishin, siç kishte theksuar, pikërisht „mbrojtjen e dashurisë“ po që ajo ia kishte kthyer me vërejtjen se të përbashkët mund ta kishin vetëm „kthimin e dashurisë“ dhe pushtetin e saj të plotë, që tregonte se ishte pikëvështrimi ai që nuk u puqej. Kjo, gjithsesi e kishte shtyrë të thoshte pastaj se tekefundit mendonin njësoj për të njëjtën, pra për atë e cila kalonte nëpër udhë të ndryshme për të arritur deri te caku i përbashkët dhe se me to mbroheshin që të dyja pjesët e asaj e cila quhet dashuri...

„Dashuria është një dhe e pandashme“, i kishte thënë ajo.

„Mbroj atë që dashurisë i duhet për të mbetur dashuri...“, ia kishte kthyer ai.

„Ashtu vetëm sa rrënon dashurinë“, i ngjau se i kishte thënë ajo.

„Dashuria-dashuri duhet parë nga fillon, ku buron...“, ia kishte kthyer ai.

„E shikon tek sosja e saj, te shpenzimi dhe zbrazja, që e zhvlerëson atë“, i kishte thënë ajo.

Pasi kishin përsëritur gjithnjë të njëjtat dhe kur për herë të parë ishte parë se mbeteshin ku ishin e ai kishte thënë se „e mira e së mirës ishte të vazhdonin ta plotësonin dashurinë me ato që i duheshin (as të përgjithësohej, as të kthehej në këshillë e as të tjetërsohet fryma e saj“), kishte përfunduar se „secili duhet të marrë përsipër pjesën e vet të vlerësimit që i duhej dashurisë-dashuri për rikthyer pushtetin e saj...“

Porse, kjo nuk i kishte pëlqyer Zonja von Braun, e cila gjithë shqetësim ia kishte pritur:

„Ata që dashurisë ia shohin urrejtjen si shpëtim dhe hakmarrjen si shkrim përgjithmonë e përjashtojnë atë dhe kjo paraqet njërën ndër fatkeqësitë më të mëdha...“

Në këtë mospajtim të ashpër, të cilin e kishte marrë si qortim, sikur kishte kapur jehun e njëfarë oshtime, me ç'rast thuhej se „për sëmundjen e dashurisë vetë dashuria paraqet shërim, por për dashurinë e sëmurë, nuk ka ilaç...”

VI

Fjalët për sëmundjen e dashurisë dhe shpëtimin që i vinte nga dashuria, Zonja von Braun në masë të madhe i kishte lidhur me çrregullimet e botës shqiptare në prag të pavarësisë, gjatë shpalljes së saj dhe veçmas me ngjarjet që kishin ndodhur në kohën e vetëdëshmimit të dështuar të Qeverisë së Përkohshme, me mbretin e caktuar nga jashtë, kur ajo ishte mbërthyer nga çoroditjet më të pakuptueshme për mendjen e shëndoshë që t'i pengojë bërja dhe, ndonëse ishin nxitur nga jashtë e ishin drejtuar prej shumë qendrave të fuqishme të vendosjes për të qenë të tilla, siç ishte punuar ditë e natë që të merrnin atë kah, megjithatë ato kishin shkuar deri atje sa të dukeshin të pabesueshme. Madje, Koloneli këtë gjendje të shëmtuar e kishte quajtur „vetëngrënie, ndër më të pamëshirshmet që ishin parë ndonjëherë...”

Në një pjesë të kujtimeve, të cilat sigurisht se vinin nga koha kur kishte vendosur lidhjet e para me shënimet e Kolonelit, të lëna në teqenë e Leqes e të shkruara gjatë atyre njëzet e pesë ditëve të mbylljes në pritje të atij plumbi që do t'i vinte si prej qiellit, Zonja von Braun do të thotë se sëmundja e dashurisë - shenjat e para të së cilës do t'i quajë çrregullime të mëdha të humbjes së drejtpeshimit mendor dhe shpirtëror - të shqiptarët do t'i shfaqë me humbjen e besimit, si dhe me mangësinë e shpresës aq të domosdoshme për rrethanat e tronditjeve të mëdha nëpër të cilat asokohe kalonte, jo vetëm bota shqiptare, por gjithë njerëzimi, që ishte dhënë pas një çmendie të përgjithshme, në të cilën do të përfshihej pa gjasa për të dalë prej saj si duhej.

„Humbja e besimit, që është shenja e parë e sëmundjes së dashurisë, sikur kishte kaluar në një epidemi të rrezikshme“, thotë Zonja von Braun, për të shtuar se „përmasat e një tronditjeje të tillë ishin vërejtur çastin që dukej se ishte në përmbysje e sipër ajo ngrehinë e mendjes, e cila sadopak kishte treguar vlera deri atëherë, pa qenë në gjendje të zëvendësohej me tjetrën...”

Më tutje ajo vlerëson se “në pamundësi për t'u gjetur në këtë kthesë vendimtare, kishte shfaqje mosbesimi ndaj gjithëçkajës dhe kjo ishte e keqja më e rrezikshme me të cilën, së pari shihet ajo që nuk është, pastaj dyshohet vend e pa vend, flitet kuturu, fajësohet vend e pa vend, bëhen shpifje, intriga e denigrime dhe ç'nuk bëhet, me ç'rast hapen dyert për dëme të pandreqshme, me të cilat ka mundësi për t'u hedhur në humnerë, nga e cila nuk ka kthim as shpëtim...”

Për të vërtetuar kahet *besim-mosbesim*, si dhe veprimet që kishin pasuar, e gjithnjë duke u mbështetur te shënimet e Kolonelit gjatë kohës së mbylljes në teqenë e Leqes, strumbullar të kësaj nyje me shumë pleksje Zonja von Braun kishte marrë pikërisht teqenë e Leqes, të cilën ai e kishte quajtur „vendi më i përshtatshëm në Shqipëri për vdekje me dinjitet”.

Ai këtë nuk e kishte thënë pa arsye ngaqë ajo, në ato rrethana përnjëmend ishte e vetmja e kursyer nga gjithë të këqijat e luftës ndërshqiptare dhe nga përmasat e saj të kobshme, të shfaqura nga pasojat e alternativës tragjike „për dhe kundër Qeverisë së Përkohshme dhe mbretit” me të cilën deshtë a pa dashtë lidhej edhe ajo çështja „për dhe kundër Shqipërisë...” Dhe e tillë kishte mbetur edhe më vonë, sa kishte zgjatur ajo Lufta e Parë Botërore, kur ajo dhe hapësira e saj ishin anashkaluar edhe nga vrasësit më të pashembullt të shtetit shqiptar, por ishte kursyer edhe nga gjakësorë të tjerë të shumtë dhe matrapazë të luftës, të cilët ishin me bollëk e që, përkundër shfrimeve të tyre të pashembullta

që të preknin atë që ua kapte syri dhe mendja, me asgjë nuk kishin denjuar t'ia prishnin qetësinë e thellë, edhe pse në të kishte qenë Koloneli, i shoqëruar nga telegrafisti Bruner, dhe ndonëse nuk e kishin ditur se ai ishte qëlluar prej atij plumbi të ardhur si prej qiellit ditën e njëzetepestë të mbylljes, pra ditën e fillimit të Luftës së Parë Botërore, kur nga xhami po shikonte trëndafilat që kishin zënë ferra.

Me gjithë bindjen e përgjithshme se teqeja me ato që kishte brenda, jo vetëm se duhej mbajtur larg çfarëdo rrëmuje dhe duhej kursyer nga çfarëdo gjakderdhjeje, porse edhe lypsej nderuar, megjithatë kur të tillët në ato rrethana tregoheshin të përmbajtshëm dhe silleshin ndryshe nga nënshtrimi i prirjeve tepër të ulëta që i shfaqnin pa qarë kokën për pasojat, kjo dëshmon se nuk ishte çdo gjë e humbur në atë botë fatkeqe, por duhej luftuar për rikthimin e saj dhe këtë duhej bërë së pari dhe pashmangshëm me anën e dashurisë...

„Qetësia e teqesë së Leqes dhe ruajtja e saj“, shkruan Zonja von Braun në kujtimet e lëna, të cilat Skulptori i kishte marrë me postë tri ditë pas vdekjes, nga i nipi Gynter Hajer, “bashkë me ruajtjen dhe kujdesin e treguar ndaj trashëgimive të ngjashme në gjithë vendin, nuk ishte çështje frike as nga shpirtrat që rrinin qetë-qetë në to dhe mund të hakmerreshin po të shqetësoheshin, as ishte çështje e ndonjë marrëveshjeje të heshtur midis palëve ndërluftuese dhe forcave të tjera të hurit dhe të litarit, të cilat mbizotëronin dhe mbikëqyrnin atë hapësirë të mallkuar rreth saj se megjithatë andejpari duhej të mbetej diçka e kursyer, ku do të gjenin prehje të çmendurit dhe të gjithë ata që u rinë mënjanë atyre zhvillimeve, po edhe ku mund të vdisej pa frikë nga frika. Përkundrazi, vendet si teqeja e Leqes, xhamitë, kishat dhe konakët e ndryshëm mirëbërës anembanë vendit, që kishin mbetur të paprekura e që për fat nuk ishin të pakta, flasin se jo gjithçka të atij shpirti kishte përfshirë iletin e dashurisë, pra e dobësisë dhe e rrënimit të tij“ dhe për të kjo ishte një dëshmi tjetër se dashuria ishte ilaç i vetëm për sëmundjen e dashurisë, që fillonte dhe mbaronte te besimi i ndërsjellë, të cilit i duheshin tempujt për t'iu ruajtur fryma nga prishja, të cilën mund t'ia shkaktonin njerëzit kur nuk e ndienin sa duhej atë që mund të ishte pjesë e bindjeve të vjetra ndaj hyjit, ku zinte fill *perëndesha dashuri*, si më e rëndësishmja, si më e pranueshmja, për të cilën ajo i kishte folur sa e sa herë gjatë atyre bisedave telefonike prej nëntë minutash, të cilat kishin zgjatur plot nëntë vjet dhe nëntë ditë, sikur të dëshironte t'ia bënte me dije se ç'rëndësi kishte edhe mbetja më e vogël e ndijimit të saj edhe për kohët më të këqija siç ishte ajo nëpër të cilën kalonte bota shqiptare...

Zonja von Braun, gjithnjë duke u përpjekur të tregonte se pse sëmundja kishte përfshirë dashurinë e botës shqiptare dhe pse këtë e lidhte me humbjen e besimit, i cili ishte kthyer në mosbesim, mediton më tutje rreth shkaqeve që kishin sjellë këtë gjendje, kur prapëseprapë do t'u kthehet çështjeve të ngritura, të cilat ajo i quan „këputje të lidhjeve të pjesshme me *perëndeshën dashuri* dhe ndijimin e saj“ për të shkuar deri aty sa të thotë se „në atë kohë kthesash të mëdha, jo gjithçka e asaj që në ato rrethana të vështira të mbijetimit ishte ndërtuar me mundin e mirëbesimit edhe kur dukej se do të ishte e pamundshme, ishte shikuar me syrin e ardhmërisë“, e kjo për pasojë kishte humbjen e shpresës, pa të cilën u hapen udhët rrëshqitjeve dhe bredhjeve të ndryshme, si dhe ecejakeve të paqarta që mund të çojnë në theqafje dhe rënie të pashmangshme.

“Ata që kanë mbetur pa shpresë sikur zhvishen nga të gjitha“, kishte thënë ajo, e bindur se mungesa e saj kishte përjashtuar në tërësi shikimin drejt ardhmërisë, me çka u ishte hapur dera veprimeve të papërmbajtura dhe sjelljeve të tjera që nuk përkojnë me asfarë morali, me ç'rast edhe ajo që dikur është marrë si mbijetim i thjeshtë por i ndershëm, është kthyer në një prirje tepër rrënuese të luftës së secilit me secilin dhe të secilit kundër secilit dhe që kufizohet me egërsinë...

„Është shikuar poshtë, në vend se të shikohet lart“, thotë Zonja von Braun, e kjo lë për të kuptuar se atë gjykim e kishte nga të menduarit e Kolonelit, që me atë „poshtë“ kishte parasysh përndezjen e prirjeve më të poshtira, synimeve të sëmura, verbësisë dhe gjithë asaj që përkon me ndjenjën e smirës dhe të rrënimit, ku pushon çfarëdo autoriteti dhe ndikimi i tij,

qoftë edhe sa për sy e faqe, për t'ua liru vendin veprimeve më të papërmbajtura dhe më të papërgjegjshme dhe të gjitha gjërave të tilla, që kishin gjetur shprehje aq egërsisht në ato rrethana të tronditjeve të mëdha, kaha e të cilave dihet, ndërsa me atë „lart“ pasqyrohet prirja për ngritje, e cila mundësohet në saje të dëgjimit të vullnetit për fuqi, që shkon deri te ndijimi i të madhërishtes, asaj ndjenje ku njeriu njëjtësohet me hyjin, të cilën Koloneli e lidhte me trashëgiminë e vjetër të qytetërimit antik, për të cilën thoshte se „një ditë do të ndriçohet për t'u parë nga fillimi...“

Këto vlerësime dhe të tjera të ngjashme, në njëfarë mase Skulptori kishte pasur rastin t'i dëgjonte edhe nga ligjëratat që një student shqiptar, i dhënë pas publicistikës, atëbotë i kishte mbajtur herë pas here në Klubin Kulturor të Vjenës gjatë krizës shqiptare, kur kishte rrëzuar shumëçka të propagandës antishqiptare, e cila dëndur vinte nga Beogradi, Parisi dhe Moska dhe që synim të pandalshëm të njollosjes kishte kinse prirjet e papërmirësueshme primitive të shqiptarëve dhe „rrezikun që i vinte Europës prej tyre“, me ç'rast shkohej aq larg saqë shfaqja e një shteti të pavarur shqiptar shihej si „përrurim i kanibalizmit“, për të cilin thuhej se duhet ndalur sa më parë që të mos u hapeshin kështu udhë veprimeve të ngjashme, të cilat ishin të mundshme aty „ku përdhoseshin edhe zotat me gjoja bashkëjetesën e tyre...“

Këto dhe shumë e shumë spekulime të tjera, publicisti i ri shqiptar i zhvishte me durim dhe me një përgjegjësi të lartë, gjithë derisa dilyn sheshit të palarat, çfarë edhe ishin. Ai këtë e bënte i ndërgjegjshëm se „shqiptarët, jo që nuk ishin pa sjellje të ashpra, që jo rrallë ishin në kundërshtim me ato të rrethimit, por ato duhej parë si një jeh të lashtësisë antike, të asaj e cila quhet lidhje me hyjin dhe lartësimin në përputhje me lirinë, që nuk kishte gjetur shprehje nga shkaku i robërisë së gjatë dhe përpjekjeve për të mbijetuar me çdo kusht në kushtet e agresivitetit të barbarëve, të ardhur nga Veriu dhe Verilindja (e kishte fjalën për dyndjet sllave), pa kursyer asgjë të qytetërimit të tyre“, për të shtuar pastaj se „atij rrënim i brendshëm, por të pashmangshëm, njësoj i kishin dhënë krah edhe rrethanat e ndarjes së botës dhe kufiri i tyre, të cilat u kishin rënë mbi shpinë më shumë se një mijë vjet“ dhe që çmimi e të gjitha këtyre kishte qenë „mbijetimi me anën e rrudhjes dhe të përshtatjeve të vazhdueshme, herë ndaj njërit kryq e herë ndaj tjetrit...“

Në këto biseda që përcilleshin me vëmendje të madhe, publicisti i ri shqiptar njëherësh ishte tepër kritik edhe ndaj mangësive shqiptare, për të cilat fliste pa paragjykime dhe që i vlerësonte si pasojë e shkëputjeve të dhunshme nga civilizimi i vjetër dhe nga ajo që kishte paraqitur vazhdimësinë e tij dhe, siç thoshte, ishin pasqyruar me *vetë-ikje* të vazhdueshme, e cila i ishte dashur *vetë-mbrojtjes*, gjë që shkëputja e gjatë me anën e mbylljes dhe të rrudhjes së vazhdueshme për pasojë kishte pasur ngurtësimin fizik dhe shpirtëror, që ishte pasqyruar me çrregullime të qarta të atij *vetë-dëgjimi* dhe *vetë-kuptimi* dhe që një ditë pashmangshëm i kishte sjellë edhe deri te mbërthimi i *keq-kuptimit*...

Këto shqyrtime eseistike i mbyllte me atë shakanë domethënëse:

“Ata që ia kanë dalë të shkëputen nga ky mbërthim janë bërë perandorë. Të tjerët kanë mbetur vrasës...Rrugë të tjera nuk kishte...”

Krahasimi midis *perandorit* dhe *vrasësit*, i bërë me aq gjerësi nga publicisti i ri shqiptar, me të cilin ai mbyllte bisedat, sikur të ishte fjala për ndonjë shaka që u duhet trajtimeve të tilla, nuk ishte vetëm alegori, por pjesë e asaj qenieje tepër kundërthënëse, ku shqiptarët në përbërje të hapësirave të mëdha perandorake, qoftë ajo romake, bizantine, po edhe osmane, edhe pse të mundur e të nënshtruar, ia kishin dalë me shpejtësi të merrnin veten dhe të pushtonin majat më të larta të qeverisjeve perandorake sa të bëheshin edhe perandorë. Po, ngjashëm kishte ndodhur edhe me shpirtin krijues të tyre, kur në rrethanat e hapjeve dhe të hapësirave krijuese kishte shprehur përmasa të fuqishme të një gjeniu krijues, i cili ishte pasqyruar me vepra të mrekullueshme të artit anëmbanë botës, saqë edhe sot e gjithë ditën paraqesin vlara të mëdha të qytetërimit...

“Do ta dënojmë një Luan të Parë, i cili ishte nga viset ilire dhe këtë e bënte madje me lavd , që kishte pranuar koncilin e parë të krishterë dhe me këtë atë, që më vonë do të quhet

Seli e Shenjtë, e kishte përfshirë në kuadër të ombrellës së Perandorisë Romake“, thoshte me ironi publicisti shqiptar, për të vazhduar ngjashëm me atë që kishte bërë Konstandini i Madh me rastin e pranimit të krishterimit si besim zyrtar të Perandorisë, me çka në historinë e njerëzimit kishte hapur një faqe të re, për të dalë pastaj te Justini dhe Justiniani, të cilët po ashtu ishin nga Dardania (ata këtë e thoshin kudo dhe haptas si një mburrje), që kishin kodifikuar ligjësinë perandorake drejt njësimi të mendësisë perëndimore dhe vrullit lindor...

“Do ta dënojmë Papë Klementin, i cili po ashtu ishte nga vendet ilire, pse kishte njësuar koncilin e shenjtë...“?

„Do t’i mallkojmë sadriazemët e fuqishëm nga derë e Qyprillinjve të Beratit, që për njëqind vjet rresht drejtuan Perandorinë Osmane drejt ngritjes dhe lulëzimit të saj më të madh dhe shumëçka të saj e afruan me frymën perëndimore...“?

„Do t’i gjykojmë për të keq pashallarët Ali Pashë Tepelena dhe Mehmed Aliun, të cilët me lëvizjet e fuqishme për mëvetësi i paraprinë pavarësisë së Greqisë dhe të Egjiptit...“?

Të tillët, pa hapësirat e perandorisë, me siguri që do të mbeteshin sharrëxhinj dhe do të bridhnin rrugëve të botës për kafshatën e gojës dhe me siguri se do të dukeshin primitivë, siç shihen sot shumë e shumë hallexhinj nëpër metropolet evropiane në kërkim të mbijetimit të dosidoshëm, të cilët, ç’është e vërteta, erdhën në atë gjendje kryesisht edhe në sajë të spastrimeve etnike nga vendet fqinje, të cilat i ushtruan ndaj tyre qysh nga kriza lindore e tutje dhe kursesi të ngopeshin duke ua marrë hapësirën jetësore. Të katandisur e të shkallmuar nga trishtimi poshtë e përpjetë, pa shtet dhe pa mbikëqyrjen e tij, si parakusht të secilit qytetërim, disa nga ta nuk kishin si të mos bëheshin edhe kriminelë, edhe vrasës dhe çka jo tjetër, për t’u njollësuar pastaj zi e më zi...

“Kjo, pra, është ajo e vërteta tragjike për *njeriun perandor* dhe *njeriun vrasës*, që vlen edhe për njeriun shqiptar, siç vlen edhe për të tjerët, kur kalojnë nëpër ato rrethana“, thoshte publicisti i ri shqiptar.

Skulptorit i ishte kujtuar se ato që Zonja von Braun thoshte rreth asaj „poshtë dhe lart“, të cilat i merrte për masë të *shfaqjes së sëmundjes së dashurisë*, por edhe si *domosdoshmëri të shërimit të saj me dashuri*, kishte pasur rastin t’i dëgjonte sa e sa herë nga Koloneli gjatë atyre gjashtëdhjetë e gjashtë ditëve të sorollatjes nëpër hapësirën mbytëse që ndante vijat e fronteve të vrasjeve shqiptare, ku kishin takuar përmasat më të çoroditura të asaj tragjedie, të cilën bota shqiptare ia kishte shkaktuar vetvetes dhe sikur nuk kishte gjasa të lirohej prej saj, me ç’rast lufta e pashpallur e secilit me secilin dhe kundër secilit, e cila njëherësh ishte edhe luftë kundër vënies së themeleve të çfarëdo rendi që mundëson shteti me ato që i duhen, ishte kthyer në një vetëngrënie të pashembullt. Pra, në ato rrethana Koloneli thuajse në tërësi kishte përqafuar mendimin rreth *njeriut-bishë* dhe *njeriut-perëndi*, ku të parët shfaqen të shumtë-shumicë, ndërsa të dytët të paktë-pakicë. Të parët, sapo t’u jepej rasti, pa farë hezitimi, janë në gjendje të bëjnë veprime të atilla rrënuese sa që nuk t’i ha as mendja, ndërsa të dytët paraqiten me të kundërtën, pra veprojnë drejt lartësimi, drejt ngritjes, kanë vullnetin që fuqinë ta përdorin për vepra të dobishme, për të mirë, për lartësime dhe se në përputhje me këtë mendësi ai edhe ato që ndodhnin në botën shqiptare, i shihnte si gjithkund tjetër...

Dhe, kur thoshte se „po vepron kafsha e keqe“, kishte parasysh atë shkrim të papërmbajtur, që i gjasonte vetëngrënies, të cilën Zonja von Braun, (gjithnjë në përputhje me qasjen e ndërlidhjes me shfaqjen dhe ndijimin e *perëndeshës dashuri*, që ndonjëherë të duket edhe romantike) do ta përshkruajë si „shfaqje e sëmundjes së dashurisë...“ Ndërsa, kur thoshte se „perënditë e saj do ta shpëtojnë Shqipërinë“, kishte parasysh idealistët e paepur, të cilët megjithatë do të gjendeshin për ta bërë punën e tyre edhe kur kjo dukej e pamundshme dhe që nënkuptonte edhe flijimin, nënkuptonte edhe vdekjen, madje, e cila u vjen nga vrasjet e paralajmëruara dhe të paparalajmëruara dhe të gjitha ato që në shënimet e lëna në teqenë e Leqes, në pritje të vrasjes, do t’i quajë „të domosdoshme për atë ribërjen, rikthimin dhe rilindjen, e cila i duhej bërjes së Shqipërisë Shqipëri“ e që, siç do të shihet nga ajo biseda e

përfytyruar me spanjollin Rafaelo, mund të ishin të përsëritshme. Por kjo nuk do të pengonte as ripërsëritjen e ripërsëritjes, kur do t'ia thotë edhe ato fjalët rreth rikthimit në Shqipëri dhe rivrasjes si diçka që i duhej asaj ribërjeje, ndaj të cilave spanjolli Rafaelo kishte përgjigjen „se i mjaftonte një vrasje“ e „nuk kishte nevojë për të tjera“, ndërkaq Koloneli do t'i thoshte „se një vrasje ishte pak“, se „bërja e Shqipërisë Shqipëri kërkonte shumë e shumë sosh, se do të merrte shumë e shumë sosh, se ato do të bëheshin dhe do të ribëheshin, por njëherësh do të përsëriteshin edhe bërjet dhe ribërjet“, që ai i quante rikthime të domosdoshme...Dhe ishte e natyrshme që pastaj Zonja von Braun, në kujtimet e saj, si rëndom, *vrasset* do t'i zëvendësojë *me dashurinë* dhe me kthimin e saj, ku pastaj spanjolli Rafaelo, atyre të cilat do t'ia thotë Koloneli për vrasjen dhe rivrasjen në Shqipëri, që i duheshin bërjes së saj Shqipëri, do të pandehë se „u mjaftonte një dashuri“, se „nuk kishte nevojë për tjetër pos për dashuri të dashurisë“ për të shkuar deri te përgjithësimi se „Shqipërisë i duheshin shumë e shumë dashuri për t'u bërë Shqipëri“ dhe se ato, gjithnjë në përputhje me mendimet e Kolonelit, „nuk kishin të ndalur“, pa marrë parasysh pengesat dhe atë „prapë-prapjen“ që do ta përsërisë edhe gjatë bisedës së imagjinuar me kolonel Ibrahim Prevezën, bashkëluftëtarin e dikurshëm të betejave në Liban dhe në një pjesë të Sirisë në krye të forcave të Perandorisë Osmane, kur i kishin komanduar ato kundër trupave britanike që ishin ndër më të fuqishmet në botë dhe ia kishin dalë edhe të shënonin suksese kundër tyre, i cili po ashtu do të vritet në Shqipëri, vrasje kjo që mund të merret me mend se kishte ndodhur gjatë Luftës së Dytë Botërore, së cilës Skulptori, sikur ta kishte mallkim, ia kishte parë fundin atë ditën e nëntë të majit, kur nga dritarja e ateliesë në Rudolfplaz shikimi i mjegullt ia kishte zënë ushtarët sovjetikë me flamuj të kuq tek marshonin hapësirës së Ballplazit me ato çirrjet për internacionalen komuniste, pamje këto të cilat kishin qenë të fundit dhe që koka ia kishte kapur si tingëllima vrastare para se të sharronte në atë paqenësi, së cilës kaheër i ishte dhënë dhe e kishte pritur si shpëtim, qoftë t'i vinte dhe ta gjente edhe ashtu, poshtërisht...

Sidoqoftë, edhe pse në atë ngarendje Skulptori ishte ballafaquar për herë të parë me atë që kishte kundërshtuar misionin e tyre prej vullnetarëve për t'i ndihmuar Qeverisë së Përkohshme Shqiptare dhe mbretit gjerman, të caktuar nga jashtë, që të merrte veten - me ç'rast Koloneli fjalën *shpëtim të Shqipërisë* e kishte zëvendësuar me *bërje të Shqipërisë Shqipëri*, e cila nuk do t'i hiqej nga mendja dhe që pasqyrimin më të mirë do ta gjejë në ato njëzet e dy shënimet e lëna gjatë mbylljes në teqenë e Leqes në pritje të plumbit, i cili do t'ia gjejë kokën ditën e njëzetepestë - megjithatë të menduarit e Zonja von Braun *për sëmundjen e dashurisë*, të cilën në kujtimet e lëna e shihte si shkaktaren kryesor të asaj fatkeqësie, ngaqë, siç thoshte, „nuk ishte dëgjuar sa duhet ndijimi i perëndeshës dashuri“, e pandehma të tjera si këto, pra ajo mënyrë e shtrimit i kishte bërë përshtypje të veçantë saqë disa herë e kishte lexuar dhe rilexuar sikur të ishte diçka me të cilën duhej të maste veten përballë rënies, e cila do ta çojë deri atje sa të bëjë shqyrtime dhe rishqyrtime, thujse të pafundme, se a e kishte urrejtjen, në të cilën ishte mbërthyer dhe assesi t'i ndahej, bindje të mirëfilltë që ka të bëjë me atë e cila përnjëmend i duhej dashurisë për të mbetur dashuri dhe për t'u bërë dashuri, apo fjala ishte për diçka me të cilën kërkohej një shpëtim i dosidoshëm nga ajo gjendje që dukej pa shpëtim dhe tepër nënçmuese, qoftë edhe me diçka që paraqet mllef, të cilit i duhet hakmarrja ose çfarëdo qoftë, që më shumë është shuarje e dufit, kënaqësi e ulët, sesa shpagim për diçka?...

Në përpjekje të tilla të pafundme, të pleksura me hamendje dhe përpëlitse, Skulptorit i ndërli dhej edhe ai krahasimi midis *sëmundjes së dashurisë*, për të cilën Zonja von Braun thoshte se „ilaç të vetëm paraqiste dashuria“ dhe *dashurisë së sëmure*, për të cilën nuk kishte shërim dhe që i bëhej se ajo qëkur ia parashihte dhe mundohej ta mbronte prej saj para sa ta përfshinte të tërin. Zonja von Braun të vetmen herë në kujtimet e lëna ishte marrë me sqarimin e çështjes pse dashuria e sëmure nuk ka shërim dhe si e tillë paraqet rrezik të madh dhe me këtë rast e kishte quajtur „lëngatë vdekjeprurëse për gjithë botën“ (ajo për këtë kishte edhe

konstatime të tjera), por që duhej emërtuar me emër dhe mbiemër, që së paku të mos përsëritet po kjo vazhdimisht.

Me gjasë, për të marrë një qëndrim tillë, të cilin e kishte shprehur tashmë dhe që mund të thuhet se paraqiste njëfarë përjashtimi, e kishte detyruar përkushtimi që kishte ndaj Kolonelit dhe vdekjes së tij, me të cilën ishte njëjtësuar plotësisht, por edhe pse kishte detyrime të veçanta ta zhvishte atë pjesë të qëndrimit zyrtar të rajhut vilhelmist, veçmas pjesën diplomatike-ushtarake e cila, jo vetëm nuk e kishte mbrojtur me sinjeritet pavarësinë e Shqipërisë, (ndonëse dukej se me caktimin e mbretit gjerman për mëkëmbës të shtetit shqiptar sikur këtë do ta bënte haptas dhe pa ndonjë ngurrim), veçse me lojërat e njohura, me çdo kusht Lufta e Parë Botërore projektohej si një mundësi për t'u bërë superfuqi në përputhje me fuqinë ekonomike që kishte, ku haptas ishte shtruar kërkesa për të marrë pjesë në sofrën, e cila drejtonte botën, ishte bërë pjesë e prapaskenave dhe madje e kompleteve më të mëdha kundër qenies së saj dhe nuk ishte për t'u habitur pse kapteri Huber kishte pasur për detyrë ta vriste Kolonelin sapo të arrinin në Shqipëri, që mund të merrej me mend se me atë veprim djallëzor i gjithë misioni i vullnetarëve ishte paraparë të kthehej në një mision informativ, i vënë në shërbim të planeve të Luftës së Parë Botërore, e cila përnjëmend do të shpërthejë ditën që do të vritet Koloneli, vrasja e të cilit assesi nuk ishte rastësi...

„Kapteri Huber kishte dashurinë të sëmurë...”

Ishte akuza e vetme e drejtpërdrejtë e Zonja von Braun që i bëhej kapterit Huber dhe prirjeve që e kishin drejtuar atë, e lënë në kujtime, edhe pse thyente përcaktimin e saj të mos fajësonte, të mos bënte me gisht për asgjë dhe që edhe prirjet për veprimet më të këqija aty për aty të baraspeshoheshin me dashurinë dhe t'i shihte të ndërlidhura me të sikur të ishte fjala për frymën e librave të shenjtë dhe trajtimet e tyre themelore, ku çdo gjë bartet te zanafilla mëkat-pendim, së cilës i parashihet falja pas pranimit që bëhet me anën e pendimit. Pra, e gjithë kjo Skulptorin do ta kthejë tek të menduarit rreth urrejtjes, të cilën e merrte si një pjesë të domosdoshme të diçkaje që i duhet dashurisë-dashuri, si dhe të nevojës që ajo të shihej e pandarë nga veprimet e drejtpërdrejta, sa të shtrojë mëdyshjen se a ishte ajo përnjëmend dashuri e sëmurë, siç e quante Zonja von Braun, apo fjala ishte për të kundërtën, për diçka të domosdoshme dhe të rëndësishme madje, për ta ruajtur kështu dashurinë-dashuri?...

Kjo vërtitje rraskapitëse e pafund, e cila e përplaste sa andej sa këndeje, sikur e kthente tek ai hendeku që i rrinte në mes, me çka rileximi i kujtimeve në atë kohën e vetmisë së thellë prej gjashtë vjet e dhjetë muajsh, e ballafaqonte me përfytyrimin e saj, si hije a përfitim tjetër, që do t'i shfaqej në pjesën e poshtme të ateliesë, kur për herë të parë ia kishte hapur zemrën për t'i folur pse e shihte urrejtjen si shpëtim të dashurisë, ndërkohë që ajo i kishte thënë se nuk guxonte ta gjykonte ashtu dashurinë, (kishte dhënë edhe gjykime të tjera rreth saj), si dhe me rastin e akuzimit të kapterit Huber dhe të oficerëve të tjerë „se e kishin dashurinë të sëmurë“, prej së cilës nuk kishte shpëtim. Pra, mu në atë pahintikë të përfytyrimit të ndërlidhjes me të, do ta shtynjë të thotë se megjithatë „Kolonelin e kishte vrarë urrejtja e thellë që ishte thadruar kudo për Shqipërinë dhe dukej fare e rëndomtë, sikur të ishte diçka me të cilën fillonte çdo urim gjatë ditës, ose përshëndetje fare e thjeshtë...”

Këtë mendim madje e kishte nxjerrë si një të papritur të thekshme, që kishte mbushur hapësirën e ateliesë me një shungullimë shurdhuese, nga e cila do t'i zihej fryma, po të mos shfaqej zëri i saj që do t'i thoshte se „Kolonelin e kishte vrarë dashuria e thellë për Shqipërinë, e cila kishte filluar të ndihej si urim ditor...”

Dhe, pastaj, ai pohim-mohim, herë nga njëra anë e herë nga tjetra, ishte thënë e përthënë thujse pandalshëm saqë gjithçka kishte marrë tingëllimën: „dashuri-urrejtje, urrejtje-dashuri...“, vërvitja e së cilës sikur ishte qetësuar paksa kur ai kishte thënë se „në rastin e Shqipërisë, dashuria dhe urrejtja janë të pandashme...”

Pamja e dashurisë dhe e urrejtjes në Shqipëri dhe përkufizimi i tyre si të pandashme, që Skulptorit i kishte kaluar në njëfarë përndjekje mendore, nga e cila assesi të shkoqej, as

atëherë madje kur nuk kishte nevojë fare për të, sigurisht se paraqiste një veçanti për atë vend dhe botën e tij, që do t'i kthehej në kob të përhershëm dhe të vazhdueshëm, bindje kjo e cila i forcohej edhe më tepër me ato që i kujtohej t'i kishte dëgjuar nga publicisti shqiptar në Klubin e Intelktualëve të Vjenës gjatë shqyrtimeve të njohura për çështjet ballkanike, ku ai ia kishte dalë, ashtu si e shtronte dhe e arsyetonte çështjen shqiptare dhe pleksjen e saj, që "nga handikapi civilizues", (të cilin „duhej penguar gjithsesi që të mos merrte përmasat e rrezikshme me pranimin e shtetit shqiptar“, siç jepej të kuptohej prej qarqeve të caktuara politike, diplomatike dhe kishtare të Beogradit, Parisit, Moskës dhe disa vendeve të tjera, të cilat ua mbanin ison), ta kthente te „përparësia e hapur civilizuese“, e cila dilte madje si kërkesë që duhej ndihmuar dhe me anën e kornizave të shtetit, të cilat do t'i njiheshin, të ndërlihej me lashtësinë nga edhe vinte, që fuqia e madhe dhe vrulli që përherë e ndjente si një shtytje e thellë, t'i merrte drejtimin e krijimtarisë, në vend se të mbetej e pashfrytëzuar, e pambikëqyrrur për t'u kthyer kështu në pjesë të së keqes, e cila një ditë do të veprojë dhe në veprim e sipër s'do të kursejë kë...

Pra, këtu shihej edhe thelbi i ironizimit: *perandor* ose *vrasës*, me çka te shqiptari kërkohej vrasësi, që të vritet, madje kjo të bëhet me pretekstin e bekuar të mbrojtjes prej tij në vend se të ndodhte e kundërta, me çka atij i kthehej vendi i nderit midis të tjerëve, si krijues dhe ndërtues i zellshëm...

Pikërisht mbi këtë përcaktim Skulptori kishte parë ato klithmat e gjata thuajse gulçuese të Kolonelit me atë „*zot ose bishë*“, të lëna në shënimet e teqesë së Leqes, ku i përfshirë nga hamendje shkallmuese, thuajse çdo gjë ia kishte nënshtruar kësaj prerjeje të ashpër dhe sqarimit të saj, shumë herë pa qenë në gjendje të heq vija të qarta midis tyre...

Dhe, mund të ishte pikërisht ajo përshtypja e shpërputhjeve midis asaj „poshtë dhe lart“, që pak më vonë Zonja von Brun do t'i japë shkas t'i shohë ato si çështje të varësisë midis *sëmundjes së dashurisë* dhe *dashurisë së sëmurë* dhe t'i mbajë si të tilla, me çka synohej t'u hiqej fataliteti që ua veshte jo rrallë Koloneli, i cili ka qenë më se i vetëdijshëm se e gjithë kjo që ndodhte në ato hapësira të fatkeqësisë shqiptare ishte e keqe e brendshme, ishte gjithçmos e asaj mbushjeje me të ligën, por njëherësh ishte edhe pjesë e asaj „veçantie“, e cila nuk mund të shihej ndarazi nga të menduarit se në rastin e Shqipërisë dashuria dhe urrejtja janë të pandashme, e cila për pasojë kishte atë përpjekjen e vazhdueshme që realitetet të mos merrnin kahun që ta kthenin „në veçanti“, sepse ajo dilte prej përmasave të kundërimeve të natyrshme dhe, kur ndodh kjo, siç do ta shohë Koloneli në Shqipëri „bashkëjetesën e zotave“, të cilët „fatmirësisht nuk kanë përjashtuar njëri - tjetrin, ku ka pasur vend për të kundërtat“, e të tjera veti të këtilla, nuk kanë paraqitur tjetër veçse atë fatkeqësinë, e cila do t'i kthehet në kob të vazhdueshëm, ngaqë thotë se aty megjithatë është përvijuar ai kufiri i ndarjes, me ç'rast fundi i njëres nuk është parë, siç është dëshiruar, si fillim i tjetrës, e as fillimi i tjetrës nuk është parë si fund i tjetrës, dhe të luftohet për t'u shtyrë këta kufij në përputhje me forcën, por ka mbetur si hapësirë e rrudhur e bashkëjetesës së të kundërtave, si asnjësi, e cila i ka mjaftuar përhapjes së bindjes se nuk është e thënë të kërkohej as „zoti i ndarë“, as „librat e veçantë të shenjtë“, e as „kryqi tjetër“, me të cilin njëri zot lufton tjetrin, „atë që është i rremë“ dhe njëri libër përjashton tjetrin, e kështu me radhë, për t'u mbrojtur e vërteta, por e kundërta...

VII

„Perënditë do ta bëjnë Shqipërinë Shqipëri“, thotë Koloneli në shënimet e teqesë së Leqes, për të shtuar se ndër të tillët shihte studentin Zenel Xhema, Mon Delinë, Brahim Avdylin, Gjon Selmanin, kolonel Ibrahim Prevezën dhe të gjithë ushtarakët e shumtë, të cilët dikur drejtonin armatat e njohura perandorake dhe kishte bindjen se qëllimisht nuk i linin t'i

udhëhiqnin ato luftëra të ngatërruara, në të cilat përfshiheshin shqiptarët, nga shkaku se ata që i fusnin gishtat nga jashtë dhe ua kurdisnin prapaskenat për t'i drejtuar andej nga i parashinin dhe u duheshin, me të tillët e kishin vështirë të luanin, siç luanin me ata që nuk kuptonin gjë prej tyre dhe prej atdhedashurisë, e që mbanin grada të shpifura, me të cilat vetëstoliseshin e i shfrytëzonin për qëllime të ulëta përfitimi pa ngurruar të krekoseshin neveritshëm se kishin bërë diç për vatanin edhe atëherë kur ishte më se e qartë se janë vetëm lojtarë në duart e të huajve...

Skulptori kishte fituar përshtypjen se derisa Koloneli fliste në atë mënyrë, ai kishte mendjen tek ajo plaga e madhe e shpirtit, të cilën ia kishte lënë ajo vrasje e tmerrshme e studentit Zenel Xhema, e bërë nga forcat e Haxhi Qamilit ditën e dyzetekatërtë të bredhjeve nëpër hapësirën, e cila ndante vijat e fronteve ndëreshqiptare, që përfundimisht e kishte kthyer kah të menduarit se vdekja gjente idealistët dhe ata të cilët luftonin për bërjen e Shqipërisë Shqipëri, ndërkohë që kursente po dhe përkrahte vrasësit e saj, që ishin të shumtë. Por njëherësh mbante parasysh edhe vrasjen e Kosovës, që i vinte nga të gjitha anët, për të cilën thoshte „se asaj nuk do t'i shuhej kurrë flaka, edhe po që se këtë do ta pranonte bota, edhe nëse këtë detyrimisht do ta pranonte shteti-torzo shqiptar dhe do ta pranonin edhe të ashtuquajturit ithtarë të shuarjes së kufijve nga tabori i bindjeve se bota edhe ashtu do të bëhej internacionaliste dhe, në mos ideologjia, atëherë logjika e ekonomisë së tregut këtë do ta detyrojë, pra atë vrasje (e cila vazhdonte e vazhdonte, por çuditërisht nuk merrte fund), nuk do ta pranonin kosovarët“, të cilët nuk kishin rrugë tjetër përveç t'i përmbaheshin betimit „*Nji besë për Shqipërinë*“, i dalë në atë tubimin e Verrave të Llukës, për të cilin Brahim Avdyli kishte thënë se nuk ishte asgjë tjetër vetëm se thirrje e pafundme „*me dekë për Shqipërinë*“, që pastaj Zonja von Braun në kujtimet e lëna e kthente në urimin „*me dashunue për Shqipërinë*“, me çka një plage të madhe, e cila kishte mbetur e hapur dhe pareshtur kullonte gjak, mundahej t'i hiqej rrezikshmëria, të cilën ajo e shihte qëllimisht të lënë dhe të paraparë, madje që të jetë e tillë nga ata që e kishin ndarë Shqipërinë dhe ishin të vendosur ta mbanin të tillë, nga shkaku se ajo ishte e vetmja që mund t'u shërbente lojërave të ndryshme të matje-çmatjeve të të mëdhenjve dhe si monedhë kusuri e tyre për mbizotërim, pa marrë parasysh se degjeneronte në një kob të përsëritshëm, i cili nuk kursente as autorët e saj...

S'do mend se për Skulptorin shikimi i kësaj çështjeje midis kundërimit idealist, që i vinte nga Koloneli - me kapjen pas perëndive dhe zotimit të tyre se do ta bëjnë, dhe atij moralizues të Zonja von Braun, e cila çdo gjë e kthente te dashuria dhe ndijimi i saj, paraqisnin më shumë se qasje, të cilat lidhen me gjendje të caktuara që kishin përfshirë njërin dhe tjetrin në ato rrethana tepër tragjike, të cilat thuajse ishin të krijuara për të marrë atë kah dhe atë përfundim, i cili ishte i pashmangshëm, por për herë të parë një fatkeqësi të paraparë (qoftë qëllimisht „të mbetej e mbikëqyrur“), e kthente në shkas të një fatkeqësie të madhe botërore, e cila pastaj, vetëm si e tillë mund të fitonte përmasat e një shqetësimi të madh, të një çështjeje, rreth së cilës duhet dhe ia vlente të meditohej, në mos për tjetër, atëherë ajo të mbahej e hapur në përputhje me peshën e kobëve të prodhuara, të cilat duhej të shtriheshin njësoj në të gjitha anët gjithë derisa të kuptohej domosdoja e zgjidhjes së saj të drejtë, pra për të ardhur deri aty, ku Koloneli thoshte „të kuptohej që nëse digjet ajo digjet e gjithë bota...“

Të ndërgjegjshëm se nuk kishin nga t'ia mbanin, por fillimisht të përfshirë në atë zhvillim thuajse nga anësh dhe për qëllime tepër njerëzore (siç ishte pjesëmarrja e vullnetarëve nga jashtë dhe shkuarja e tyre në Shqipëri që drejtpërdrejt t'i ndihmohej shtetit të sapoformuar dhe Qeverisë së Përkohshme me mbretin e caktuar nga jashtë që të merrte veten dhe me të të parandalohesh një tragjedi e madhe pa kursyer as jetën), Koloneli dhe Zonja von Braun, të cilët me të shpejtë kishin hetuar se në Shqipëri po ndodhte paralaja e asaj lufte të madhe (që atë e rëndonte dhe e ngarkonte edhe më shumë me kob dhe e bënte edhe më të paparashikueshme dhe më të rrezikshme), secili në mënyrën e vet, kishin gjetur mundësi të mrekullueshme t'i kundërviheshin atij zhvillimi, me ç'rast njëri i ishte kthyer idealit dhe idealistëve, të cilët i duheshin bërjes së Shqipërisë Shqipëri dhe në ato rrethana ishin të vetmit

që mund të bënin atë e cila dukej thujtë e pamundshme, ndërsa tjetra këtë e kishte sforcuar me nevojën e ndijimit të dashurisë dhe me domosdoshmërinë e kthimit të saj në dashuri të përhershme, me çka ëndrrave dhe përfytyrimeve të Kolonelit u vinte në ndihmë gjuha e dashurisë, si më e kuptueshmja, më e thjeshta, më e përhapura dhe më e pranueshmja, e cila madje duhej të përcaktonte edhe fatin e luftërave...

Andaj, jo rastësisht, ai betimi i kosovarëve „me dekë për Shqipninë“, i kthyer në atë „me dashunue për Shqipninë“ dhe që shkonte deri te motoja „dashuria Shqipëri“, e cila ishte më e fuqishme se çdo e papritur, klithje, zotim a kërcënim, pa marrë parasysh se prej kujt bëhet dhe nga vinte, kur shikohet ashtu dhe në atë veprim, edhe atë përfytyrimin e idealit me të cilin Koloneli do ta presë atë plumbin, i cili do t'i vijë si prej qiellit në teqenë e Leqes dhe do t'ia gjejë kokën pikërisht ditën që do të fillojë ajo Lufta e Parë Botërore e madhe, e bënte të natyrshëm fare dhe e kthente te përmasat njerëzore, sa të dukej një uratë e rëndomtë, por e pashmangshme...

Megjithatë, druajtja se ashtu çdo gjë merrte kahun e uratave dhe kjo mund të bënte që gjuha e dashurisë, për të cilën fliste aq shumë Zonja von Braun, mu si për një domosdo e cila shpëton, pra e gjithë kjo mund të kthehej në një gjuhë mëshire dhe vajtimi, madje dhe mund të shpinte në pranimin e mëkatit, të cilit pastaj nuk do t'i ndihmonte as pendimi as falja, ky përfitim Skulptorit saora ia rrëronte përmasat e të menduarit që nuk shikon „as poshtë, as lart“, por përpara dhe drejt, në përputhje me ato që shihen e ndjellin frikë dhe saora ia megjullonin pamjen, të cilën nuk do ta dëshironte të tillë, për t'ia kthyer në një mllef prej nga ai, sikur t'i zgjohej ajo „kafsha e zezë“, të cilën ajo shpesh ia kishte zënë ngoje në ato bisedat telefonike prej nëntë vjetësh dhe nëntë ditësh, me porosinë se duhej ruajtur të mos ushqehej me asgjë, ngaqë kur zgjidhet nuk ka të ndalur. Pra në atë vërvitje mllefi nuk kishte si të mos ndiente kafshimin e urrejtjes ndaj atyre të cilët ia kishin shkatërruar atdheun dhe shpirtin, që sakaq bënte t'i kthehej të përfytyruarit për atë flakën e kryeneçësisë së Kosovës të mbetur diku në malet e saj, e cila ndonëse merrej e shuar fare, si diçka e harruar dhe e papërsëritshme, me mendje e ndezte dhe e përndezte dhe e kthente në një zjarr të madh, ku bëheshin shkrum e hi gjithë ato ngrehina të shëmtuara të shfaqura në trupin e saj pas mbarimit të Luftë së Parë Botërore bashkë me ato marrëveshjet e mallkuara të Versajës dhe kjo sikur ia lehtësonte shpirtin saqë në atë vetmi të trishtuar ndiente nevojë të çirrej e të çirrej për njëfarë flake shpëtimtare, e cila ishte e domosdoshme dhe këtë ta nxirrte më zëshëm sesa monarkistët e shteruar fare, sesa anarkistët e papërmbajtur dhe militantët majtistë të të gjitha llojeve (leninistë, trockistë, stalinistë, si dhe kusuri tjetër i internacionales), që po ashtu e dëshironin flakën e saj dhe, si për çdo çështje tjetër e cila ua nxente gurmazin, çirreshin me të drejtën e saj ngoje si „për një të keqe imperialiste“, të cilën duhej ndrequr në përputhje me masën e barazisë proletare dhe me mjete revolucionare, ku nuk ngurrohej të thuhej se „krijesat e Versajës ishin artificiale, burg popujsh dhe duhej shkatërruar sa më parë“ për ta kthyer „të drejtën e vetëvendosjes së popujve...“ e gjithfarë gjepurash të tjera dhe se në atë çirrje e dalldisje humbte mbikëqyrjen fare sa i bëhej se mbërthehej nga një gulçitje e madhe dhe po të mos ishte njëfarë përhitjeje e diçkaje si hije e Kolonelit dhe e Zonja von Braun, që i shfaqeshin dhe kredheshin t'i ndihmonin, sigurisht se do të mbetej pa frymë dhe kjo nuk do ta dëshpëronte, përveç që do ta merrte si fund të domosdoshëm, ndonëse të kotë, por të pashmangshëm me të cilin i përfundonin mundimet dhe nënçmimet me të cilat i dukej se ishte harruar...

„Ktheju dashurisë“, i ngjante se i thoshte Zonja von Braun.

„Ktheju Shqipërisë-Shqipëri“, i bëhej se i thoshte Koloneli.

„Ktheju...“

„Ktheju!...“

Ato ktheju-ktheju, herë dashurisë e herë Shqipërisë, të cilat i vinin nga të gjitha anët dhe sikur paksa e kthjellonin, i shoqëroheshin me fjalët për idealin, që i duhej secilit, si dhe për dashurinë për të shpëtuar kështu nga urrejtja dhe rrënimi i saj.

„Dashuria shpëton...”
„Shqipëria shpëton...”
„Dashuria...”
„Shqipëria...”
„Dashuria-Shqipëri...”
„Shqipëria-dashuri...”
„Dashuria shpëton...”
„Shqipëria shpëton...”
„Dashuria...”
„Shqipëria...”
„Dashuria-Shqipëri...”
„Shqipëria-dashuri...”

I dukej se Koloneli i pëshpëriste diçka rreth perëndive që e bëjnë Shqipërinë Shqipëri, të cilët duhej parë tek dilyn nga flaka e atyre luftërave të tjera, të cilat do të bëheshin dhe do të bëheshin gjithsesi dhe mund të thuhej se bota i kishte mallkim për mëkatet dhe hak ndaj Shqipërisë, ndërsa Zonja von Braun i fliste për domosdoshmërinë që Shqipëria të kthehej në dashuri dhe në atë përsëritje të pandërprerë të dashurisë, që s’e hiqte nga goja, thoshte se Shqipëria ishte vend i dashurisë, se në të dashurohet dhe madje vdiset për dashurinë dhe me dashurinë, gjë që me ato pandehmë serish duhej të vërtetohej bindja se nëse luftërat ishin të pashmangshme, atëherë duhej bërë çmos që dashuritë t’ua përcaktonin fatin...

Këtij ligjërimi që nuk i ndahej, mbase i shërbente edhe një romancë tjetër e dashurisë, e futur në kujtimet e saj, e quajtur „*Një dashuri e përhershme, e mbetur në Shqipëri*“, ku nuk është e vështirë të merret vesh se ajo ishte shkruar në bazë të një dashurie tragjike në Shqipëri, në të cilën ishin përfshirë shkrimtarja e humaniste e njohur bavarase, Amalia Gaudina dhe togeri gjerman Klein, e ndërprerë dhunshëm në afërsi të spitalit fushor gjerman të vendosur në pjesën e skajshme të Lezhës pak ditë pasi kishte filluar Lufta e Parë Botërore. Dhe si gjithëherë në ato anë që gjërave të paharrueshme kahun ua përcaktonin kobet, ishte një plumbi, i cili kishte shkrepur nga ana e malit, me të cilin kufizohej spitali fushor gjerman, me çka mund të thuhej se ajo paraqiste vrasjen e parë të një ushtaraku gjerman në Shqipëri në rrethana fare të paqarta, por njëherësh të dyshimta, të cilave velin e dyshimit edhe më tepër ia kishte shtuar një letër e Amalia Gaudinës e botuar pak kohë pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore të madhe, ku thoshte se në Shqipëri qëllimisht i ishte vrarë dashuria e madhe për të cilën kishte shpresuar se në Shqipëri do të jetësohej...

E gjithë historia e asaj dashurie dhe fshehtësitë e saj, të cilat Skulptori do t’i ndeshë për herë të parë në një shkrim të gazetës „Die presse“, me siguri se nuk do t’i bënte gjithaq përshtypje dhe nuk do të merrej me to, po të mos ishte rikujtimi i saj i veçantë nga ana e Zonja von Braun të kujtimet e lëna „*Një dashuri e përhershme, e mbetur në Shqipëri*“, të cilën qëllimisht e nxjerr nga dhembja e shpallur publike e Amalia Gaudinës ndaj humbjes së dashurisë në një kohë të paqartë lufte dhe ajo këtë thujse do ta marrë si të qëllimshme për ta parë si pjesë të një prapaskene që togerit Klein i ishte thurur pikërisht nga qarqe të caktuara ushtarake gjermane, veprimet e shërbimeve informative të të cilave ajo thoshte se i kishte hetuar edhe në punët humanitare ku nuk e kishin vendin, të cilat ishin të arsyeshme për atë shkrim.

Ndonëse togerin Klein e njihte si ushtarak të përmbajtur nga misioni i tyre i përbashkët prej gjashtëdhjetë e gjashtë ditësh si vullnetar në Shqipëri, ndërkohë që për humanisten bavarase dhe qëndrimin e saj në Shqipëri kishte marrë vesh qysh në Vjenë dhe ajo sikur e kishte frymëzuar edhe nismën e tyre, e cila kishte dështuar, të gjitha këto, të bartura të hapësira e një rikrijimi thujse artistik, ku ajo dashuri e ndërprerë dhunshëm nga ai plumb i padukshëm, i shkrehur në mugëtirën e parë pas perëndimit të diellit nga pjesa kodrinore e Lezhës, çastin që e dashuroara priste të dashurin dhe ai ishte në rrugë e sipër për atë takim me një lule në dorë, në përshkrimin e saj do të përfytyrohen si një betim dashurie, i ngjashëm me

atë të tragjedisë së Romeos dhe Zhulietës, e cila do të duhej të shpallej si e përhershme dhe të kurorëzohej para varrit të Kryeprincit të Shqipërisë mesjetare kur luftohej me sukses kundër Perandorisë Osmane dhe me këtë mbrohej i gjithë krishtërimi europian, në ç'mënyrë të paktën simbolikisht duhej të tregohej se në atë pjesë, ku dikur ishte mbrojtur qytetërimi i vjetër perëndimor, edhe më tutje duhej të kërkohej kuptimi i dashurisë dhe jo i urrejtjes; se ajo botë e meritonte dashurinë e jo urrejtjen, e konstatime të tjera të këtilla, por ajo do të pamundësohet nga një plumb i ardhur si prej qiellit, që do ta gjejë togerin gjerman kur po afrohej me kurorë dafine, të cilën duhej t'ia vinte asaj në kokë dhe me këtë të shpallej botërisht se edhe në atë kohë fatkeqe në Shqipëri kishte vend për dashuri të madhe.

Romanca e dashurisë e përfunduar tragjikisht në Shqipëri në ditët e para të asaj lufte të madhe botërore, të cilën Zonja von Braun do ta paraqesë si „*Një dashuri e përhershme, e mbetur në Shqipëri*“, mund të thuhet se ka shfrytëzuar motivin e një ngjarje që i takonte një kobi të pashmangshëm me të cilat ajo luftë ishte plot e përplot dhe përcaktonte çdo gjë madhe edhe përmasat e dashurisë, por që në sajë të imagjinatës ajo qëllimisht nxirret nga rëndomësia (nëse do të kundrohej si dashuri e një gjermani me një gjermane) për t'u ngritur deri te shkalla e një lidhje të veçantë shpirtërore, që si dashuri midis një infermiereje shqiptare të quajtur Ema dhe një ushtaraku gjerman të mbiquajtur vetëm toger, i cili do të vritet në Shqipëri, ajo medoemos duhej të pengohej dhe me çdo kusht, qoftë me anën e një vrasje, që do të shihet si pre e kurtheve ndërkombëtare kundër çfarëdo të mire në Shqipëri, të cilën duhej pamundësuar me të gjitha mjetet, siç ishte vepruar me mbretin gjerman, dhe siç duhej vepruar ndaj çfarëdo përpjekje që paraqiste çfarëdo shenjash jete në ato rrethana, veçmas nëse ato kishin për qëllim thyerjen e atyre bindjeve me të cilat ata mbaheshin qëllimisht në hapësirën e rrethit tragjik, e në fatkeqësi të tjera të ngjashme...

Pra po të shikohej më për së afërmi, ajo romancë mund të ishte edhe pjesë e autobiografisë së Zonja von Braun, së cilës njësoj do t'i pengohet dashuria me Kolonelin shqiptar dhe, duhet të pengoheshin të gjitha dashuritë e tjera të ngjashme, me çka, sipas saj, ishte arritur e kundërta, sepse dashuritë jo vetëm që nuk ishin penguar, porse me vrasjet dhe ndalesat tjera që u ishin bërë, të shtresëzuara në kujtesë, të rikujtuara dhe njëherësh të kthyer në dhembje, ishin ngritur në dashuri të përhershme shpirti, në diçka me të cilat sa e sa herë fatmirësisht ishte dëshmuar se lidhjet njerëzore nuk njihnin kufij, nuk njihnin pengesa, nuk njihnin tjetër përveçse ndijim të dashurisë dhe të frymës së saj të madhërishtme, të cilën ajo e shihte pjesë të ndijimit hyjnor, dhuratë e mbretëreshës dashuri...

Kështu, Zonja von Braun dashurinë midis infermieres shqiptare Ema dhe togerit gjerman, e kishte parë të nisur diku jashtë, në një vend bregdetar, që mund të merrej me mend se ishte Italia, pse jo edhe Verona e bukur, ku ajo në ndjekje të ditëve të fundit të maturës, ndërsa ai gjatë një udhëtimi të shkurtër prej kadeti, si shpërblim nga familja, (meqë ua kishte përmbushur dëshirën të bëhej ushtarak), ishin takuar në një kafene dhe shkas për këtë takim kishte qenë një pikturë e Van Gogut në kafenë e sheshit të vogël, të cilën e kishin shikuar të dytë, thuajse në të njëjtën kohë dhe me të njëjtin përkushtim dhe ai peizazh i bukur idilik ua kishte bashkuar ndjenjat.

„Sikur shoh mrekullinë e fjetur të vendit tim...“, kishte vërejtur Ema.

„Edhe mua më ngjan në mrekullinë e vendit tim“, kishte thënë togeri gjerman, gjithnjë duke e pushtuar me një shikim tejet të ëmbël.

„Kush do të thoshte se jemi vëndës...“?, kishte vazhduar Ema buzagaz dhe gjithë drithërima të lehta, që ia kishte shkaktuar shikimi i tij.

„Do të thotë se i takojmë të njëjtës hapësirë, të njëjtit ndijim dhe natyrisht të njëjtës botë...“, do t'ia kthente togeri gjerman me të njëjtin shikim të ëmbël.

Kjo sikur i kishte mjaftuar infermieres shqiptare dhe togerit gjerman që t'u ndizeshin përgjithmonë shkëndijat e dashurisë, që Zonja von Braun nuk hyn në imtësi për të ndjekur rrugën e hollësive të cilat mund të merren me mend se çfarë kishin qenë dhe ç'kah kishin marrë në atë ndërkohë prej tre muajsh, e cila u kishte hyrë në mes, kur Ema ishte kthyer në

vendlindje dhe, në përgatitje të asaj lufte të madhe botërore e filluar në fund të asaj vere tepër të nxehtë, ishte përfshirë në punën e spitalit gjerman fushor të hapur diku në afërsi të Lezhës, ndërkohë që togeri gjerman, i dashuruar fund e krye në infermieren shqiptare, kishte bërë çmos që sa më parë të gjente rrugët për në Shqipëri, (edhe pse kjo formalisht i ishte penguar për shkaqe shëndetësore, ngaqë kishte një lëndim të gjurit me të cilin edhe për gjashtë muajt e ardhshëm kursehej nga çfarëdo shërbimi). Rruga i ishte hapur duke iu bashkuar një misioni humanitar, ndër shumë syresh që atëbotë niseshin për Shqipërinë, ngaqë kishte bindjen se atje dhe në atë vend, i cili ziente nga tragjeditë, jetësimi i një dashurie fitonte peshë edhe më të madhe...

Meqë rruga e dashurisë është e pandalshme dhe përballon çdo pengesë, madje shfrytëzon edhe luftërat dhe flakën e tyre në të mirë të saj, ishte fare e natyrshme që togeri gjerman ia kishte dalë të shkelte tokën e përflakur shqiptare dhe aty të shihte atë në të cilën ajo ishte përfshirë aq keqas, por kjo sikur e kishte bërë edhe më të paepur drejt jetësimi të saj.

„Këtu është përmbysur bota shumë keq“, i kishte thënë Ema.

„Dashuria ndreq çdo gjë“, ia kishte kthyer togeri gjerman.

„Edhe dashuria këtu e ka të vështirë“, ia kishte kthyer Ema, sikur të kishte përfytyrimin e asaj që do t’i priste, të cilën e kishte nga parandjenja po edhe nga bindja se në atë vend thuajse që më parë çdo gjë ishte dënuar me dështim, pos të ligës.

Zonja von Braun më tutje do të tregojë se dashuria në kohë lufte fitonte peshë edhe më të madhe dhe bëhej edhe më e zjarrtë, pikërisht nga ai rregulli i pashkruar se, të parën gjë që prekte ajo ishte dashuria, por ishte pikërisht dashuria, dhe pothuajse e vetmja, që bënte të ditur se ajo mund të rrëronte çdo gjë, përveç vetvetes...

Me këtë rast, dashuria midis një shqiptareje dhe një gjermani, nuk kishte për kundërshtarë vetëm luftën dhe paqartësitë e saj të shumta, që shfaqeshin gjithnjë më të mëdha, por ajo, me mish e shpirt kishte kundër të gjithë ata, të cilëve ajo dashuri u pengonte si dashuri e thjeshtë dhe njerëzore dhe është e mundshme, por aty, në atë vend dhe në atë kohë, duhej të bëhej e pamundshme dhe kjo lidhej me ato bindjet të thadruara në mendjet e shumëkujt se dashuritë nuk duhej të ishin të lira e as të shfaqeshin të lira, se ato mbeteshin të drejtuara, të kushtëzuara dhe të mbikëqyrura nga jashtë dhe prej të tjerëve, me ç’rast edhe si të tilla duhej të mbeteshin për t’i treguar si të paafrueshme dhe të papajtueshme dy botë dhe bindjet e tyre, të cilat në ato hapësira ishin të vendosura qëllimisht që t’i shfaqnin të kundërtat, të cilave u ishte paraparë ndeshja, luftërat dhe gjithçmos, por assesi afria dhe bashkimi me anën e dashurisë...

Në këto rrethana, që nuk kishte si të mos i kuptonin edhe të dashuruarit, por që duhej t’i kundërshtonin dhe të dëshmonin me dashuri se dashuria ishte më e fuqishmja, se ajo duhej të fitonte edhe në atë vend dhe madje t’ua përcaktojë fatin edhe kobeve dhe gjithë atyre të ligave që aty me pa të drejtë ishin kthyer në fatkeqësi të pandalshme, të cilat mund të mos ishin të tilla, Ema dhe togeri gjerman kishin vendosur të kurorëzoheshin, as në kishë as në xhami, po pikërisht te varri i Kryeprincit, në kishën e vogël pranë rrënojave të kështjellës së vjetër, ku dukej se ishte mjegulluar edhe kujtimi i motit të madh...

Mu në ditën e parë të vjeshtës, me rreze të zbehta të diellit, që kishin ardhur nga ana e detit, Zonja von Braun përshkruan me shumë ndjenja ato të cilat kishin ngjarë në atë vend të vogël me plot urrejtje, kur infermiera shqiptare, përkundër të gjitha pengesave të vëna nga të gjitha anët, e veshur me të bardha dhe me një tufë lulesh në dorë ia kishte dalë të shkonte pranë varrit të Kryeprincit për të kurorëzuar dashurinë me togerin gjerman, që megjithatë në saje të një plumbi të shkrepur si prej qiellit nga ana e malit, nuk do të bëhej ky kurorëzim, ngaqë çastin kur togeri po i afrohej kishës së rrënuar, ishte qëlluar për vdekje mu në kokë, sado që kishin qenë të qarta përpjekjet mbinjerëzore të bënte edhe pak hapa deri aty ku e priste ajo që të përmbushej ashtu ai betim i dashurisë: se asgjë nuk mund t’i ndalte dhe t’i ndante në atë rrugë...

Gjaku ia kishte përfshirë edhe kurorën e dafinës së thurur për Emën, por çuditërisht togeri gjerman nuk e kishte hequr prej dorës, sikur të dëshmonte se ajo shprehte frymën e gjithëfuqishme të dashurisë, të cilën as vdekja më e egër nuk mund ta shuajë...

Do të ishte e natyrshme, në ato rrethana tepër tragjike, që edhe infermierja shqiptare, që e kishte parë togerin gjerman të zbriste nga pjesa e rrëpirët për t'iu afruar kishës dhe në atë lëvizje magjike kishte dëgjuar fërshëllimën e plumbit i cili e kishte qëlluar për vdekje duke rënë me kurorën e dafinës dhe kishte marrë me mend se me çfarë ishte përpëlitur në ato çaste, siç ishte përpëlitur edhe ajo vetë ashtu e ngrirë në pritje, të plandosej, të merrte kujën dhe të bënte gjithçmos, me të cilën do të shprehej dhembja e tmerrshme ndaj dashurisë së vrarë përpara syve, por ajo as kishte nxjerrë zë as kishte lëvizur, madje edhe atëherë kur kishte dëgjuar plumbin, e edhe kur kishte parë vrasjen, dhe nuk kishte lëvizur vendi gjatë gjithë kohës derisa dielli i lodhur i asaj dite të parë të vjeshtës kishte prekur pjesën e malit dhe hija që kishte rënë, për të mbetur ashtu edhe pas muzgut të parë dhe për të mbetur edhe kur kishte rënë terri i skëterrshëm i natës, i cili kishte fshehur gjurmët e gjakut dhe kishte fshehur edhe kufomën e paprekur të togerit të vrarë me kurorën në dorë, kishte fshehur edhe Emën, (ajo priste ashtu sikur të ishte kthyer në një gur), kishte fshehur edhe kureshtjen e madhe e cila vinte nga të gjitha anët bashkë me smirën e cila kishte prodhuar kobin, por nuk ia kishte dalë të hiqte shqetësimin e dashurisë, e cila sikur ishte kthyer gjithandej në një drithërimë të përgjithshme, të ngjashme me atë të cilën togeri gjerman e kishte përfytyruar kur kishte thënë se „do të jetë një dashuri që do të përfshijë të gjithë, madje edhe kundërshtarët dhe armiqtë e saj...”

Çuditërisht, mëngjesi tjetër, që njësoj kishte filluar me ato rreze të lehta të diellit vjeshtor, të cilat kishin prekur kështjellën e rrënuar dhe sheshin e vogël të kishës para varrit të Kryeprincit, nuk e kishte gjetur aty as Emën, e cila kishte pritur togerin gjerman me të cilin do të kurorëzoheshin pranë varrit të Kryeprincit, dhe nuk e kishte gjetur as gjermanin e vrarë në pjesën e rrëpirët, që lidhte kështjellën gjysmë të rrënuar me malin, siç nuk kishte gjetur as gjurmët e gjakut, që ishin parë prej së largu...

Në vend të tyre ishte parë vetëm ajo kurorë dafinash, e tëra e përgjakur, e vënë pranë varrit të Kryeprincit, e mbërthyer nga një heshtje varri, e cila kishte përfshirë gjithë hapësirën me velin e një kureshtjeje të përgjithshme...

Që edhe romanca të mbetej çështje e dashurisë dhe e pushtetit të saj të pafund, si një shqetësim i madh që sillte e pështillet, siç kishte parë çdo gjë të asaj fatkeqësie shqiptare, Zonja von Braun ishte përkujdesur që atë ta lërë të hapur, pezull. Ajo e kishte bërë këtë me atë fundin thuajse të papërfunduar, ku nuk ishte ditur se çfarë kishte ndodhur me Emën, e cila kishte sharruar në terrin e asaj nate ferri në pritje të togerit të vrarë gjerman nga plumbi i ardhur si prej qiellit derisa i afrohej vendit të kurorëzimit, dhe ajo nuk ishte parë as të nesërmen e as kurrë më, siç nuk ishte marrë vesh as për fatin e kufomës së togerit gjerman, që kishte mbetur pa varr e pa gjurmë...

E gjithë kjo ishte mbyllur në mënyrë të mistershme me atë që ishte thënë dhe pëshpëritur: në Shqipëri kishte mbetur një dashuri e përhershme, së cilës i ishte parë vrasja e dhunshme, por jo edhe fundi, ngaqë ishte fryma e saj ajo që kishte vazhduar ta ushqente atë dhe, sa më shumë që kishte kaluar koha, e kishte bërë më të afërme, më jetësore, sa të mendohet që ajo edhe mund të mos kishte përfunduar tragjikisht, përkundër plumbit, i cili ishte shkrepur diku dhe kishte qëlluar togerin gjerman kur i afrohej vendit të kurorëzimit derisa e priste Ema, ngaqë nuk ishte përjashtuar mundësia që togeri gjerman, i qëlluar nga ata të cilët kishin dashur ta vrisnin me çdo kusht atë dashuri, mbase nuk kishte vdekur fare, por ishte shtirë i tillë gjatë gjithë asaj dite tepër të gjatë për dashnorët, kur terri i natës ishte shfrytëzuar që ajo t'i afrohej atij, t'i jepte ndihmën e duhur, po mund të merret me mend se ajo mund t'i kishte ardhur edhe nga ata, të cilët e kishin dashur atë dashuri, por nuk kishin guxuar ta përkrahnin haptas. Pra, të gjitha këto mrekullisht ishin bashkërenditur brenda asaj nate për ta shpëtuar atë dashuri, e cila thuhej se ruhej diku derisa të kalonte ajo Lufta e Parë

Botërore e madhe, e Dyta dhe luftëra të tjera që do të bëheshin kundër dashurisë, për t'u rishfaqur përfundimisht kur ato të merrnin fund dhe me të të kthehej koha e dashurisë së pafundme, që e kishin shtyrë ta mbyllte romancën me fjalë tepër domethënëse:

„Në Shqipëri mund të vritet gjithçka përveç dashurisë, e cila mbetet e përjetshme...”

Skulptori kishte lexuar dhe rilexuar atë shkrim dashurie, të cilin Zonja von Braun e kishte riparë paksa ndryshe nga i njëmendti midis shkrimtares dhe humanistes së njohur bavarase Amalia Gaudina dhe togerit gjerman Klein dhe e kishte pasur të qartë pse ajo qëllimisht vazhën e kishte përfytyruar shqiptare dhe djalë gjerman, lidhje kjo që shfaqej e njëjtë me atë dashurinë e saj me Kolonelin, por në kahe të kundërta, e cila njësoj ishte vrarë në Shqipëri përballë rrethanave të njëjta dhe nuk kishte kurrfarë dyshimi se ishin pjesë e kurtheve, të cilat i ishin bërë Shqipërisë në atë luftën e re të madhe, ku njësoj mund ta pësonte kushdo qoftë, e që mund të mos ishte fare në anën e kundërshtarëve të hapur, të cilët i shiheshin asaj lufte, por mjaftonte t'ua kuptonin qëllimet për t'u shpallur të dyshimtë dhe të rrezikshëm, në ç'mënyrë vulosej edhe fati i zi i tyre, gjë që në atë përpëlitse ky shkrim dashurie sikur ishte për të përhapur të vërtetën e dhembshme se „në Shqipëri mund të vritet gjithçka përveç urrejtjes, e cila mbetet e përjetshme...”

VIII

„Tek unë mund të vritet çdo gjë përveç urrejtjes së përjetshme“ - kishte thënë Skulptori me mundim në ndjekje të përfuturit që ia kishte lënë përshtypja e romancës „*Një dashuri në Shqipëri, që duhej të mbetej e përjetshme*“, dhe me dëshirë do ta merrte për të tillë siç e kishte përfytyruar Zonja von Braun dhe do ta përjetonte madje me të njëjtat emocione. Por, ç'e do, që hetonte se tek ai nuk kishte vend për dashuri, se moti i ishte vrarë, ndërkohë që ajo përkujdesej për të kundërtën, t'ia vriste urrejtjen, të cilën ai e merrte si ushqim të vetëm shpirti, që i ndihmonte shfritit të dufit për t'u zvarritur sadopak nëpër hapësirën e atij labirinti, që i dukej e ngjashme me atë të Shqipërisë së katërmbëdhjetës, për të cilën Koloneli dikur i thoshte se mund të mbetesh vrasës, nëse nuk kthehesh në perëndi dhe që atij tashmë i tingëllonte si vetë-vrasës...

“Edhe kjo sikur kërkon guxim“ - deshi të thoshte dhe për pak iu kujtua çështja e guximit të guximit, të cilën dikur e kishte sjellë e pështjellë nëpër kokë si një hamendje të natyrshme, që u duhet kthesave, me të cilën bëhen ato kapërcimet e domosdoshme „andej“ apo „këndej“, “poshtë apo lart“, kahun e të cilave Zonja von Braun e shihte të përcaktimi i vetëm për dashurinë dhe kundër urrejtjes... Por e gjithë kjo i takonte një kohe, kur mbase jo gjithçka të saj e merrte për të humbur dhe ndodhte që ndonjëherë terrimin ia davariste ndonjë fije e vogël shprese se ajo prishje e madhe e asaj ndreqjeje të madhe shekullore e bërë në Versajë, megjithatë mund të nxiste vullnetin për ndonjë rindreqje dhe që kahet e asaj rënieje të përgjithshme të shfrytëzoheshin për të kundërtën, e të tjera, që siç do të shihet më vonë, e gjitha kishte qenë vetëm një mashtrim, sepse ato që kishin ardhur kishin dëshmuar se bota jo vetëm nuk kërkonte shpëtim, se nuk mendohej për të, e aq më pak punohej për të, po përkundrazi, sikur kërkohej që rrënimet e bëra gjatë asaj lufte të parë të madhe të çoheshin edhe më tutje dhe e keqja të përkryhej, të përfshinte edhe ato që rastësisht kishin mbetur të kursyera, e të tjera prapësi si këto...

„Sikur lidhen dy çështje të kundërta, që nuk i shkojnë njëra-tjetrës...” - i kishte thënë një herë si me gjysmë goje Zonja von Braun gjatë atyre bisedave të përditshme telefonike, të bëra përherë në orën nëntë të mërkurës për nëntë vjet e nëntë ditë, të cilat kishin zgjatur nëntë minuta.

„Pikërisht pse janë të tilla duhet t'u shihet varësia e përjashtimit të përhershëm që t'u hiqet mashtrimi, me të cilin mund të mjegullohet qartësia e përcaktimit sa të dihet se ai i cili

dashuron duhet të jetë edhe kundër çfarëdo urrejtjeje, meqë vetëm ashtu dashuria bëhet e gjithëfuqishme“, ia kishte kthyer ajo.

„Dashuria është dashuri, ndërsa urrejtja është urrejtje... Secila ka hapësirën, ka drejtimin dhe pushtetin e vet, e edhe po të dëshirohet, nuk kanë si rrinë bashkë, ngaqë janë të ndryshme për nga natyra, janë të kundërta për nga qëllimet dhe të papajtueshme për nga synimet... Dhe mirë është që është kështu, sepse kjo i shërben asaj shtyese që i dallon gjërat përfundimisht drejt përcaktimit mirë-keq...“

Kur ia kishte thënë këto kishte pasur mendjen te njëra nga ato bisedat e shpeshta që Koloneli kishte zhvilluar me priftin Gjon Lleshi gjatë bredhjeve të tyre gjashtëdhjetë e gjashtë ditëve nëpër atë hapësirën e nemur, e cila ndante frontet e vëllavrasjes shqiptare, kur me rastin e ballafaqimit me disa kufoma të masakruara, të lëna të pavarrosura, (që po s'u ranë në sy jevgjve të Kavajës, të cilëve u ishin dhënë mushkat të përkujdeseshin për të vrarët, mbeteshin ashtu për t'u bërë kërma), prifti kishte kërkuar gjithë dëshpërim, sikur të lutej, një mëshirë të madhe për të gjithë me arsyetimin se „nga urrejtja e tmerrshme që i ka përfshirë dhe nga verbimi i saj, nuk dinë se ç' bëjnë...“

Natyrisht se Kolonelit sikur i ishte nxehur gjaku nga qëndrimi që baraspeshonte vrasësin dhe viktimën në mungesë të dijes, humbjes së arsyes a për çfarëdo shkakut tjetër, dhe kështu vihej kundër asaj që predikonin librat e shenjtë, ndaj mësimëve të të cilëve kishte njëfarë mirëkuptimi kur ato mbeteshin tek të menduarit se qenia njerëzore i përkiste një sistemi të ndërlidhur me krijuesin e pashmangshëm, të cilin duhet njohur dhe zbërthyer në saje të diturisë dhe përpjekjeve të saj të hapura, por jo edhe kur çështjet e besimit shfrytëzohen për ta mbikëqyrur njeriun, gjoja për ta përmirësuar me urdhra dhe për të vënë pushtet të përhershëm mbi të, me çka ata që flasin „në emër të zotit“ e përvetësojnë edhe të drejtën e gjyqimit për të gjitha, gjithnjë në përputhje me atë që lejohet dhe nuk lejohet, bile këtë e bëjnë gjithmonë me kërcënimin e ndëshkimit. Andaj, gjithë hidhërim kishte thënë se nuk duhej kërkuar falje dhe as mëshirë për vrasësit, por vetëm dënim që, ndonëse në ato rrethana ishte i pamundshëm, atëherë së paku me ato që thuheshin në përputhje me frymën e librave të shenjtë, të mos i pranohet e keqja...

Edhe pse prifti Gjon Lleshi ia kishte bërë me dije se mëshirën e të madhërishtit e meriton çdo krijesë, pa marrë parasysh si sillet, nuk e kishte parë të rrugës që atë çështje ta shpjegonte në përputhje me frymën e misionit, sepse druante se realiteti tragjik shqiptar, me të cilin përballeshin, çfarëdo shpjegimi do t'ia jepte ngjyrimin e mbrojtjes së vrasësve dhe të atyre që vepronin zi e më zi në ato rrethana, në vend se të ndodhte e kundërta.

Kjo megjithatë nuk e kishte penguar Kolonelin të përsëriste për të satën herë atë që tashmë i ishte pjekur për koke e nuk i hiqej, se kohët e liga, siç ishte edhe ajo nëpër të cilën kalonte bota shqiptare, qitnin në pah *njerëzit-bisha* dhe *njerëzit-perëndi* dhe që me këtë rast gjithnjë duhet të kihet parasysh ajo shtyssa e brendshme me të cilën ato viheshin në lëvizje për veprime të tilla.

Thoshte se kundrimet tjetërfare, pa marrë parasysh se nga vijnë dhe me çfarë qëllimi bëhen, shpiejnë tek mashtrimi dhe thellimi i fatkeqësisë...

Sikur ta njihte këtë mendim, Zonja von Braun, ato që ai ia kishte thënë rreth qartësimit të hapësirës midis dashurisë dhe urrejtjes dhe për mosngatërrimin e saj, e kishin shtyrë të thoshte „se fjala është për baraspeshimin e keqkuptimit, i cili u hyn në mes saqë ndijimi i njëres të kthehet në kuptim të tjetrës, e kjo ua ndryshon gjendjet rrënjësisht dhe për pasojë ka atë mashtrimin e madh, kur në përputhje me këndvështrimin, ngjet që e mira duket e keqe dhe e keqja e mirë dhe anasjelltas dhe kësisoj kjo mund të na çojë pandalshëm në krim dhe në kob për t' u parë madje edhe këto si të ndërlidhura“, mendim ky që disi i ishte dukur i ngjashëm me atë të priftit Gjon Lleshi.

Gjatë pjesës tjetër të bisedës, e cila kishte marrë atë kohun e caktuar e që i kishin mbetur ata nëntë minuta, sa rëndom zgjaste, sikur të dëshironte t'ia parandalonte çfarëdo pyetjeje me të cilat shtroheshin mëdyshje, të cilave ua njihte shkakun dhe dukej se nuk ishte e

gatshme të bënte kurrfarë lëshimesh, Zonja von Braun kishte vazhduar të arsyetonte atë varësinë e domosdoshme të përcaktimit për dashurinë dhe kundër urrejtjes për ta përmbyllur me qëndrimin e prerë se „aty ku mungon ndijimi i dashurisë shfaqet urrejtja, se ku nuk ka dashuri atëherë gjithsesi ka urrejtje, se kush nuk dashuron doemos urren“, që të nesërmen, gjithnjë në përputhje me atë përcaktimin për dashurinë dhe kundër urrejtjes , të thoshte:

„Dashuria është jetë, ndërsa urrejtja vrasje...“

Nga ajo prerje Zonja von Braun nuk kishte hequr dorë madje as kur Skulptori i kishte thënë se mos ashtu gjykonte rëndë ata të cilëve u është marrë dashuria, ose gjykonte ata që në këtë apo atë mënyrë e kanë humbur atë pa pasur kurrfarë faji,se mund t’u jetë vrarë ajo madje njëanshëm dhe, kështu poshtë e përpjetë për të shtruar pastaj mëdyshjen se pse duhej të merrej për urrejtës e që njëherësh shihet edhe si vrasës, ai që ka humbur dashurinë, ose që është privuar dhunshëm nga ajo, në ç’mënyrë me të fiton të drejtën të urrejë vrasësin e dashurisë dhe ashtu të mbrojë dashurinë nga shuarja. Kishte nxjerrë një nga një edhe përfundime të tjera të kësaj natyre, sikur të ndiqte fillin e një mendimi të qëndrueshëm, i cili i kishte kaluar në bindje të pandashme, nga çasti që do t’ia thotë haptas pse urrejtjen e merrte për të domosdoshme, ndërkohë që ajo kishte ndërhyrë me fjalët se „dashuria nuk mund të merret e as të humbet, e aq më pak të vritet, ngaqë ajo është ndijim hyjnor. Përshtypjen e humbjes së saj, të marrjes apo të vrasjes mund ta kenë vetëm ata që nuk e kanë qartësuar mirë ndijimin e njëmendtë të saj. Ajo që është dashuri mbetet dashuri... Dashurinë e rrezikon vetëm urrejtja...“

„Nëse ajo që është dashuri mbetet dashuri, atëherë pse të rrezikohet nga urrejtja kur ajo vetëm sa mund ta forcojë?...“ - i kishte thënë ai.

Sikur të priste pikërisht atë pyetje, ajo i kishte thënë se fjala ishte për një mëdyshje të gjithëhershme, të cilën e kishte arsyetuar me faktin se edhe ajo (urrejtja) është pjesë e ndijimit, e cila për fat të keq te njeriu ka hapësirën e vet thuajse të barabartë që i takon së ligës, me të cilën duhet të kacafytet vazhdimisht dhe kjo mund të bëhet vetëm me anën e dashurisë dhe duke iu nënshtruar plotësisht pushtetit të saj...

Kjo sikur ia kishte përkujtuar thëniet e Kolonelit për atë „poshtë ose lart“, të cilën e zbërthente me atë kahën e përcaktimit „perëndi apo bishë“, së cilës i nënshtrohen të gjithë dhe kishte bindjen se ishte e vetmja masë me të cilën vlerësoheshin ata që ishin për bërjen e Shqipërisë Shqipëri dhe, ndonëse ishin të paktë, punonin për të ditë e natë me mish e me shpirt, dhe kundërshtarët e saj, që ishin të shumtë, dhe që po ashtu punonin ditë e natë edhe ata me mish e me shpirt për ta vrarë sa më parë dhe përgjithmonë.

Rrugë tjetër nuk kishte për Kolonelin dhe as që mund të kishte kur shihte vetëm ndërtues të paktë dhe rrënues të shumtë, krijues të rrallë e vrasës të panumërt...

Ai madje nuk pranonte as të përmbajturit as përmbajtjen, nuk njihte as hutimin dhe as të hutuarit, siç nuk pranonte mashtrimin dhe të mashtruarit, për të cilët prifti Gjon Lleshi i thoshte se ishin e shumta dhe duhet pasur mirëkuptim për ta, siç duhet pasur kujdes edhe ndaj atyre që nuk i janë bashkuar të ligës, qoftë edhe nëse me sehirin e bërë apo heshtjen kanë mbetur mënjane.

“Të tillëve duhet ndihmuar të kthehen në rrugën e drejtë, që edhe po zgjati, ia vlen për të të punohet me mish e me shpirt“, thoshte ai, ndërkohë që Koloneli ia kthente se „ka disa gjëra ndaj të cilave nuk lejohet sjellje dhe qëndrim prej deledashi“, me çka bënte të ditur se nuk e kishte ndër mend të ndiqte arsyetimet që lidheshin me librat e shenjtë dhe me frymën e tyre, të cilët edhe më parë nuk kishin pasur gjithaq vend në hapësirën e tij të të menduarit për çështjet e shpirtit, por realiteti tragjik shqiptar dhe ato që ndodhnin në të, (ku kishte zënë të keqpërdorej tmerrësisht edhe ajo e cila për shumë shekuj ishte ruajtur si shenjtëri), edhe më tepër ia kishin përjashtuar.

Edhe Zonja von Braun, kur pashmangshmërinë e ndijimit të dashurisë e lidhte me atë përcaktimin kundër urrejtjes, pa ngurruar të thoshte se dashurinë e vret urrejtja, se dashuri do të thotë jetë, ndërsa urrejtja nuk paraqiste veçse zanafillën e vrasjes, se me dufin e hakmarrjes dhe me mllefet e tjera që e mbarsin çon pikërisht andej dhe në veprime të ngjashme, e të tjera

si këto,pra kur fliste ashtu me siguri që ndiqte qëndrimet e Kolonelit rreth thënies „perëndi ose bishë“, të trajtuar me aq ngulmim tek ato njëzet e dy shënimet e teqesë së Leqes në pritje të plumbit, i cili do t’ia gjejë kokën ditën e njëzetepestë derisa në dritare i mbështetur për xhami shikonte degët e trëndafilave të kthyer në gjemba,që mund t’i ishin dukur pjesë e pashmangshme e atij fundi të cilit i duheshin edhe ndryshimet e natyrës.

Kjo mbase ishte edhe e kuptueshme për njërin dhe tjetrin, të cilëve dashuria u kishte ndihmuar të përballonin fatkeqësinë, së cilës nuk mund t’i ikej, me çka ajo jo vetëm nuk ishte pranuar, por edhe përmasat e saj më të rënda, nëpër të cilat kalohej, sikur ishin parë si zhvillime të natyrshme, të domosdoshme, madje, për t’u liruar nga barra e madhe e së ligës, e të tjera, e të tjera, me të cilat bëhet pastrimi i pashmangshëm dhe në ç’mënyrë pastaj i hapet rruga asaj që shpie kah ajo ribërja, rikthimi a rilindja, e cila i duhet atij rifillimi, ku në njërën anë shihej mbizotërimi i perëndive, që do të jenë në gjendje ta bëjnë Shqipërinë Shqipëri, ndërsa në anën tjetër ndijimi i plotë i dashurisë-dashuri dhe shtrirja e saj e gjithanshme, ku nuk do të ketë vend as për urrejtje e as për të gjitha ato të tjerat që sipas saj e mbarsin atë dhe ndihmojnë vendosjen e perandorisë së më të mirës, të cilën Koloneli e merrte si domosdoshmëri, e cila i duhej botës për të shpëtuar nga të ligat dhe fatkeqësitë e mëdha, në të cilat ishte futur dhe nuk do të ndaleshin ndryshe.

„Po mua, çfarë më ka mbetur tjetër, përveç urrejtjes ? “, i thoshte vetes Skulptori gjithë shkallmim dhe kjo oshëtimë e thellë shpirti sikur sa ora ia kthente ndijimin e atij që gjendet poshtë, te fundi, të cilit nuk i ndihmon gjë prej gjëje përveç dufit të urrejtjes ndaj çdo gjëje,që e kishte mbërthyer në atë gjendje as gjallë as vdekur, nëpër të cilën zvarritej ashtu mundimshëm qysh nga ajo mbrëmja e nëntë e shtatorit, kur nuk kishte rënë më zilja e telefonit dhe ai e kishte kuptuar se tiktaku i orës dhe heshtja e zymtë, e cila kishte pllakosur më pas u kishte dhënë fund bisedave të përditshme prej nëntë vjetësh dhe nëntë ditësh me Zonja von Braun, për t’ia lëshuar vendin asaj vetëmbylljeje në atelie, që do të zgjasë gjashtë vjet dhe tetë muaj, e cila do të marrë fund ditën e nëntë të majit me rreze të ndritshme kur shikimi i turbullt në Ballpllaz do t’ia kapë ushtarët sovjetikë që derdheshin nëpër qendrën e dikurshme të monarkisë me flamuj të kuq me ato çirrjet në gojë për botën proletare, e cila nuk do të kishte kufij...

Sidoqoftë, në atë ndërkohën e shpenzimit të pandalshëm me vetveten prej gjashtë vjetësh dhe tetë muajsh,që po të zbërthehej në ditë do të shtrihej në dymijë e katërqind e tridhjetë e një sosh,Skulptori do ta ketë pranë Kolonelin dhe Zonjën von Braun,të cilët do ta shoqërojnë err e terr gjatë atyre pesëdhjetë e tetë mijë e treqind e dyzet e katër orëve,njërin me ato njëzet e dy shënimet e lëna gjatë kohës së mbylljes në teqenë e Leqes, në pritje të plumbit, i cili do t’ia gjejë kokën ditën e njëzetepestë,ndërsa tjetrën me *Kujtimet* e lëna, të shkruara gjatë nëntë vjetësh dhe nëntë ditësh, të cilat tri ditë pas vdekjes dhe varrosjes në anën e kundërt të liqenit, nga Berlini i kishin ardhur të dërguara me postë nga i nipi Gynter Hajer, që asaj vetmie të thellë herë pas here do t’ia davarisin gjendjen e kotësisë, në të cilën sharronte dhe atij, me anën e ushqimit dhe pulsimit të urrejtjes, e cila po i kalonte në ngathtësi, i shërbenin të përtërinte dufin në sosje, me të cilin i bëhej se pastaj qëllimisht notonte disi nëpër ato ujërat e gjendjes së paqartë as gjallë e as vdekur.

Në atë vërvitje të pafund drejt fundit të pashmangshëm sikur hetonte se edhe fryma e Zonjës von Braun, e derdhur në ato *Kujtime* pak nga pak merrte kahun e mbrojtjes së mundimshme me anën e dashurisë, në përputhje me dëshpërimin dhe fikjen e shpresës që, ndonëse nuk e thoshte dhe ndonëse nuk e pranonte, prapëseprapë ajo ishte e pranishme dhe hetohej, e kjo e gjitha i shërbente si njëfarë ngushëllimi gjatë atij rrënimi, të cilin e shihte të përbashkët, pa marrë parasysh kohën që u kishte hyrë në mes dhe ua ndante vdekjet, të cilat jo vetëm që lidheshin me ngjarjet e mëdha sikur të përkonin rastësisht me to (vdekja e Kolonelit lidhej me ditën e fillimit të Luftë së Parë Botërore, ndërsa e Helenores po ashtu lidhej me ditën e fillimit të Luftës së Dytë Botërore), por pse si të tilla parashiheshin prej tyre dhe, megjithatë, secili në mënyrën e vet përpiquej t’i kthente në kundërime gjithëpërfshirëse dhe në

kuptime, të cilat i duheshin atij rikthimi dhe ribërjes, që Koloneli e quante rilindje dhe me të cilën bota i kthehej ardhmërisë...

Natyrisht se në këtë rrjedhë të ngjarjeve prej një çerekshekulli, që botës i ishte dashur të përfshihej në dy luftëra të mëdha shkatërrimtare, të cilave Koloneli mbase njëanshëm ua kishte parë fitilin në Shqipëri dhe kishte paraparë se aty do t'u mbetej përderisa të kuptohej bërja e saj Shqipëri, (të cilën do ta quajë „domosdoshmëri civilizuese, që botës i duhet për t'u pranuar bashkëjetesa e të kundërtave, jo si kufi i ndarjes, i grindjeve dhe i luftërave, siç kishte qenë prej dy mijë e sa vjetësh, por i puqjeve dhe i lidhjeve të domosdoshme, ku përjashtohen zotat e ndryshëm në dobi të të përgjithshmit, krijuesit të njëmendtë, i cili duhet të njihet e të kuptohet me mendje dhe me arsye, atij që i duhet vendosjes së perandorisë së më të mirës, e të tjera si këto“), pra, ishte për t'u pritur që edhe ligjërimi i Zonjës von Braun për dashurinë të ndiqte kahun e këtyre zhvillimeve dhe të theksohej në përputhje me frymën e tyre, gjë që edhe kishte ndodhur, për të qitur kështu në shesh të vërtetën se edhe ajo njësoj kishte qenë e dëshpëruar dhe e thyer dhe mbase këtë edhe do ta shprehte me zbrazjen e ndonjë dufi, ose disi ndryshe po të mos ishte mbështetja te dashuria dhe njëjtësimi me bindjet e Kolonelit se nuk duhet të ketë humbje që meriton adhurimin e pranimit dhe, pa marrë pasys gjendjen dhe rrethanat e krijuara, e gjithë kjo duhet të kthehet në bindje për fitoren, së cilës i duhet të menduarit rreth rikthimit, rreth ribërjes dhe rreth rilindjes...

Ndryshe nga Koloneli - të cilit plumbi ia kishte gjetur kokën shumë herët, ditën kur do të fillonte ajo Lufta e Parë Botërore me bindjen se ashtu po i nënshtrohej një gjykim të pashmangshëm, ku fundin e kishte parafytyruar si pjesë të atij rikthimi, që i nevojitej rifillimit të pandalshëm drejt bërjes së Shqipërisë Shqipëri, së cilës i duhen idealistë të paepur, pra vetëm ata që janë në gjendje me mish e me shpirt t'i jepen çështjes së saj - Skulptori kishte hetuar se edhe Zonja von Braun që moti i ishte nënshtuar rrugës së pakthim, se vitet e tjera pa Kolonelin (kishin qenë gjithsej njëzet e pesë sosh) as që i kishte numëruar a shikuar ndryshe përveç që i kishte quajtur „bredhje të pandalshme në kërkim të dashurisë“. Por edhe përballë asaj gjendjeje thuajse jashtë vetes dhe jo rrallë me thyerje të rënda, ajo kishte ndjekur me vëmendje të madhe zhvillimet që kishin rrymuar midis dy luftërave botërore, qoftë edhe pa u futur në gjuhën e tyre shoqërore dhe politike, sa të tregojë mirëkuptim për ato zhvillime të përgjithshme, me të cilat dukej se mund të krijoheshin parakushtet, të cilat Koloneli ia parashihte vendosjes së perandorisë së më të mirës, në një kohë që ajo i baraspeshonte me pushtetin e dashurisë.

„Dashurisë i duhet fryma e së mirës së përgjithshme, e hetuar njësoj dhe kudo, që t'i përfshijë të gjithë, sepse vetëm ashtu përgjithësohet dhe ngrihet tek ai përfytyrimi i domosdoshëm jetësor, pa të cilin nuk bën“, i kishte thënë ajo diku në fillim të bisedave të përditshme me telefon prej nëntë vjetësh dhe nëntë ditësh, me ç'rast kishte hetuar ngjyrimin e njëfarë shprese, që linte për të kuptuar se jo gjithçka e saj ishte ndrydhur gjatë internimit të gjatë francez. Sepse, ashtu si i kishte folur, kjo sikur ia kishte përkujtuar ngjashmërinë me rrymimet e shumta të cilat preokuponin qarqet e ndryshme intelektuale lidhur me ardhmërinë, që në përputhje me kahun e tyre, tashmë pasqyronin dy këndvështrime kryesore: atë të barazisë sociale, pa klasa dhe me internacionalizmin proletar si postulat kryesor, (ky tashmë ishte shpallur prej bolshevikëve sovjetikë). Dhe atë të demokracisë perëndimore, me pluralizmin dhe tregun e lirë, i shpallur prej amerikanëve, (si fitues të vetëm të Luftës së Parë Botërore), pa ndërhyrjen e të cilëve ajo kasaphanë e përgjithshme vështirë që do të ndalej, e aq më pak të përcaktonte fituesit dhe humbësit që dolën prej saj.

Dukej se të dyja këto rryma, të cilat ishin bërë realitete shoqërore e politike dhe pak nga pak merrnin kuptimin e një gare të hapur me përmasa gjithnjë më të mëdha, kishin qenë të mundshme vetëm në sajë të luftës së parë të madhe, e cila ishte kthyer në botërore, kur në njërën anë, bolshevikët sovjetikë kishin ardhur në pushtet me ndihmën e revolucionit, të kryer kundër carit, i cili nuk kishte qenë në gjendje t'i bënte ballë luftë së nisur dhe me këtë drejtpërsëdrejti i kishte ndihmuar përrurimit të shtetit të parë të proletarëve me idenë

komuniste të barazisë sociale, dhe në tjetrën anë, gjithashtu kishin qenë të mundshme pasi që amerikanët kishin ndërhyrë në atë luftën e parë të madhe, në të cilën ishin përfshirë europianët, pa gjasa për t'ia gjetur fundin. Ajo që nga presidenti amerikan Uilson do të shpallej si demokraci botërore - me synimin se do të ishte në gjendje t'i kundërvihej iluzionit të barazisë sociale në përhapje e sipër, që vinte nga Rusia dhe si ide tashmë kishte nisur të gjente ithtarë të shumtë dhe që nëpër qendra të rëndësishme të intelektualëve të së majtës merrte përmasat e internacionales botërore - ishte dashur Luftës së Parë Botërore t'i jepte epilogun me përcaktimin që rrënimi i monarkisë danubiane, i rajhut gjerman villhelmist dhe me të edhe i Perandorisë Osmane të bëhej në dobi të demokracisë pluraliste, me shtetin nacional si pikënisje kryesore. Dhe kjo, siç do të shihej, kishte qenë një gabim i madh, i cili as nuk kishte çuar përpara demokracinë as nuk kishte penguar përhapjen e bolshevizmit, përveçqë kishte përshpejtuar atë luftën tjetër të madhe botërore, kahun dhe pasojat e së cilës Koloneli i kishte paraparë me përpikëri të madhe në shënimet e teqesë së Leqes.

Zonja von Braun, e cila kishte përcjellë me aq interesim zhvillimet në prag të luftërave botërore dhe me shkrimet e saj thuajse pareshtur kishte tërhequr vërejtjen se ç'synohej prej boshtit të ri Paris – Londër – Moskë - i cili i kundërvihej atij në formim e sipër Berlin – Vjenë – Stamboll dhe çka mund të dilte sikur e gjithë kjo të merrte rrugën e një ndeshjeje të hapur, siç kishte ndodhur - në fillim sikur kishte treguar më shumë vëmendje ndaj atyre që vinin nga tabori i së majtës sesa i së djathtës së re, të cilën e kishte marrë për luftënxitëse, nga shkaku se paqja e Versajës dhe vendimet që ishin marrë aty nga fitimtarët europianë nuk ishin parë si rast i demokracisë pluraliste dhe i shtrirjes së saj në të mirë të hapjes së tregjeve dhe të kapërcimit të frymës së asaj, e cila kishte sjellë Luftën e Parë, pra t'u jepej fund edhe përçarjeve dhe mospajtimeve mbi të cilat ajo ishte vendosur dhe zhvilluar, siç e kishte paraparë Uashingtoni. Por e gjitha kishte marrë kahun e një hakmarrjeje tepër kryeneçe ndaj perandorive të rrënuara dhe vlerave që kishin, duke mos u kënaqur me shpërbërjen e tyre, e cila ishte plotësuar me krijesa të dhunshme shtetërore, që siç do të shihet, shumë prej tyre nuk do t'i bëjnë ballë kohës dhe do të kthehen në sherre të mëdha. Ajo hakmarrje historike ishte zgjeruar edhe më tutje me dënime dhe përcmime të tjera të popujve që kishin humbur luftën, siç kishte qenë sjellja e papërgjegjshme dhe ofenduese e francezëve ndaj gjermanëve, të cilën ajo e kishte parë si një fitil për atë luftën tjetër të madhe, e cila edhe do të ndodhë dhe do të fillojë pikërisht ditën e nëntë të shtatorit, kur edhe ajo do të vdesë e pikëlluar pse megjithatë urrejtja ishte treguar më e fortë se dashuria...

„Druaj nga shpërthimi i një urrejtjeje të madhe“ - do të thotë ajo në një rën nga bisedat e hershme, edhe pse ato nuk kishin arritur deri aty sa ai t'ia thoshte troç ato që mendonte rreth urrejtjes, e cila i duhej dashurisë për t'u ruajtur e ndezur dhe për të qenë në shërbim të dashurisë-dashuri, siç do t'i thotë kohë më vonë, kur ishte shuar ajo flaka e kryengritjes së Kosovës, tek e cila ai kishte varur shpresat se mund të ishte e vetmja, e cila do të ndizej për ta djegur botën, për të cilën Koloneli thoshte se e kishte si dënim nga mëkatet ndaj saj, ndërsa Skulptori kishte bindjen se mund të rrënoheshin ato ndreqjet e prishjeve të shkaktuara në Versajë, pa të dalë çka të dalë, ndërkohë që ajo, edhe pse kishte njohuri për kahet e asaj kryeneçësie dhe fatin e saj, që paraqiste përpjekjen e parë të madhe të përgjakshme kundër marrëveshjeve të Versajës, e cila botës me të shpejtë do t'i kthehen në një plagë të pashërueshme, atë nuk e shihte si shkaktare të luftës së re e as ia parashihte fitilin, por e merrte vetëm si pjesë të një fatkeqësie të madhe, së cilës thoshte se i duhej dashuria nga druajtja e hapur se në një luftë të re të madhe botërore mund ta pësonte edhe më keq se në të parën, ngaqë e dinte se në kuadër të fatkeqësive të mëdha, të voglat, jo vetëm nuk pushonin, jo vetëm nuk zgjidheshin, po përkundrazi, ktheheshin në fatkeqësi edhe më të mëdha...

Andaj, ishte i kuptueshëm edhe ai anashkalimi i kujdesshëm i asaj bisede që Skulptori e kishte zënë ngoje tërthorazi me rastin e takimit të tyre të fundit kur ajo i kishte thënë se

Kosovës, më shumë se çdo gjë tjetër, i duhej dashuria, siç i duhej edhe Shqipërisë dhe gjithë botës...

Shumë vjet më vonë, në *Kujtimet* e lëna prej saj, të cilat i kishin ardhur me postë tri ditë pasi ishte varrosur, në kërkim të mëdyshjeve të para që asaj i ishin shfaqur sa të shprehte atë druajtjen rreth shpërthimit të urrejtjes së madhe, me çka ajo kishte rrahur telin tek parakushtet e fillimit të një lufte tjetër të madhe, e cila mund të ishte vetëm botërore e assesi ndryshe, Skulptori nuk do ta ketë të vështirë të lidhet me atë e cila asaj do t'i shfaqet si brengë, të cilën jo rastësisht sikur do t'ia përsërisë dhe përsërisë gjithnjë më shpesh sa më shumë kishte kaluar koha, që i kishte afruar me atë të fillimit të Luftës së Dytë Botërore, kur ajo edhe atë ditën e nëntë të shtatorit do të vdesë me bindjen se edhe një herë urrejtja kishte qenë më e madhe sesa dashuria dhe ia kishin tumirur atë përcaktimin dëshpërues se tek ai mund të vritej gjithçka përveç urrejtjes, me të cilin kishte mbetur i ngujuar dhe e kishte kob...

„Ata që nuk kanë dashuri, të parën gjë që ngrenë në virtyt është urrejtja, nga pastaj i japin shfrim hakmarrjes së tmerrshme, pa ngurrar të kthehen edhe në vrasës të dashurisë dhe pa çarë kokën se me veprime të tilla përhapet murtaja e çmendisë, së cilës i duhen një mijë vjet dashuri që sadopak t'i hiqet helmi...“

Të thëna në këtë mënyrë, mendimeve të këtilla dëshpëruese nuk ishte e vështirë t'u shihej aludimi te fitimtarët e rastësishëm të asaj lufte të fundit, por edhe te humbësit, që po ashtu ishin të rastësishëm, dhe që ajo përmasë e rastësisë, të cilën e kishin përcaktuar amerikanët me ndërhyrjen e tyre ushtarake të bërë pas katër vjetësh gjakosjeje të tmerrshme pa fitues dhe humbës të njëmendtë, me siguri se kishte ndikuar që fitimtarët të mos ndiheshin të sigurt me fitoren e dhuruar, ndërsa humbësit e ndienin veten të nënçmuar prej humbjes së pamerituar që, kur zbërthehej mirë e mirë, nuk kishte si të mos dëshmohej thënia, të cilën ajo do ta quajë „murtajë të çmendisë“, nga helmet e së cilës mund ta lironte vetëm dashuria-dashuri...

Ndonëse ruhej nga kurthimi në të përditshmen, e cila sa vinte bëhej më e qartë se çdo gjë e saj ishte në shërbim të një fatkeqësie tjetër edhe më të madhe, Zonja von Braun edhe më tutje meditonte për dashurinë dhe urrejtjen si çështje me të cilat thoshte se lidheshin gjithë ato rrugë dhe përcaktime që Koloneli do t'i përshkruajë si „lart - poshtë“, të cilat pashmangshëm shpijnë te pasqyrimi „perëndi ose bishë“. Dhe, në atë përpëlitje të vazhdueshme me to, me një gjuhë të hollë eseiste mrekullisht pasqyronte përmasat e një shqetësimi të thellë, të ngjashëm me atë të shfrimeve të Kolonelit, të shfaqur në ato njëzet e dy shënime të kohës së mbylljes në teqenë e Leqes e të shkruara në një gjendje thuajse halucinacioni në pritje të plumbit që do t'ia gjejë kokën ditën e njëzetepestë, ku fundi dhe ai rrënimi i pashmangshëm, i cili i priste dhe nuk kishin si t'i iknin, njëherësh shiheshin si mundësi për atë rifillimin dhe ribërjen, e cila doemos i duhej botës për ta gjetur rrugën e shpëtimit që, megjithatë, do të ishte e vështirë dhe me shumë e shumë sakrifica, të cilat mund të përballoheshin vetëm në sajë të idealistëve të paepur...

„Hakmarrja është e keqja më e madhe, së cilës edhe dashuria më e madhe e ka vështirë t'ia presë rrugën“ - do të theksojë Zonja von Braun në kujtimet e lëna, duke parë demonin e saj të dalë nga urrejtja, si një shfrim i pandalshëm rrënues që gjen hapësirë në përputhje me nënshtrimin ndaj mashtrimit të së ligës. Më tutje, gjithnjë duke pasur mendjen tek ajo, e cila do të quhet „ide botërore e barazisë me pushtetin e proletariatit“, që tashmë si model shtetëror në Rusi ishte promovuar me gjak prej bolshevikëve dhe për habi nga shumëkush shihej si ilaç i vetëm, i cili njerëzimin mund ta shpëtojë nga dhuna e shfrytëzimit dhe dobësi të tjera, ajo do të vlerësojë se „betimi i hakmarrjes me moton e zhvlerësimit të vlerave me anën e rrënimit, që të kthehen në vlera të reja, është më shumë se një kob me të cilin nuk krijohen kurrfarë vlerash të reja e as arrihet barazia shoqërore, e cila është e paarritshme, përveçqë i hapet rruga zhvlerësimit të pandalshëm, i cili një ditë merr përmasat e shfrimeve të egra, ku prirja për barazi, për krijimin e njeriut të ri kthehet në një tirani mizore, me të cilën, pastaj, nga masa e mashtruar dhe të dëgjueshmit krijohen të tepërtit, ata me tru dhe shpirt të shpëlarë,

të cilët janë në gjendje të veprojnë sipas urdhrave, madje dikur edhe të mendojnë sipas urdhrave...”

Që ta frenojë paksa rrëshqitjen në gjuhën e përditshmërisë dhe në ato që do ta shtyjnë t’u japë përgjigje sfidave të saj, të cilave u ikte, Zonja von Braun sërish do t’i kthehet ligjërimin për domosdoshmërinë e dashurisë dhe të ndijimit të saj, në mënyrë që edhe çështjet më të papajtueshme t’i barazojë me të.

„Vetëm dashuria bën të mundur vendosjen e pushtetit të më të mirës...” - do të gjykojë ngjashëm si atëherë kur do të përkrahë qëndrimet e Kolonelit rreth bërjes së Shqipërisë Shqipëri, të cilën do ta shohë të mundshme si dashuri në kuadër të pushtetit të më të mirës, për të cilën ai thoshte se „është e vetmja që botën do ta shpëtojë nga e keqja në të cilën ishte mbërthyer...”

Kështu, edhe atë që quhet „synim i barazisë“, edhe atë „vendosjen e pushtetit të proletarëve“, edhe kërkesën gjithnjë më të hapur „për krijimin e njeriut të ri“ dhe luftën e klasave - madje si njërën ndër veçoritë kryesore „të botës së barabartë“, që tashmë ishte shënuar në programin e internacionales komuniste dhe thuajse njësoj dehte edhe zemrat e shumë e shumë intelektualëve dhe krijuesve ëndërrimtarë, të cilët thuajse të papërmbajtur i bashkoheshin asaj dhe ngjyrën e kuqe të flamurit të proletariatit kishin nisur ta kthenin në emblemë identifikimi, por edhe në teori të shpresës dhe të optimizmit njerëzor, me të cilën tashmë i ishte shpallur luftë edhe „artit dekadent...” dhe “prirjeve të pandalshme shthurëse në krijimtari...”, e shpikje të tjera - ajo do t’i kthejë te gjuha e dashurisë, sepse e dinte se vetëm ashtu një mashtrimi të madh të gjithmonshëm dhe gjithënjëzor (të përhapur nga librat e shenjtë dhe të përqafuar me aq zell nga ideatorët e proletariatit dhe të ideologjisë, e cila ishte në rrugë që të kthehej në një dogmë të ngjashme me atë të librave të shenjtë), mund t’ia ndalte paksa hovin. Andaj, kur thotë se “vetëm tek dashuria dhe ndijimi i saj është e mundur barazia dhe askund tjetër” për të shtuar se „ata që kërkojnë barazinë jashtë dashurisë pikërisht vuajnë nga mungesa e ndijimit të dashurisë...” (pa shtuar se ishin të pushtuar nga urrejtja), kjo vetëkupton më shumë se një vërejtje ndaj rrezikut të dhunës së totalitarizmit, ku për herë të parë ideologjia dhe religjioni, jo vetëm se përdornin thuajse të njëjtën gjuhë, porse ngjashëm synonin të njëjtat qëllime me të cilat kërkohej i dëgjueshmi, kërkohej i përkulshmi dhe i përulshmi, kërkohej ai që do të drejtohej përherë dhe pandalshëm dhe kjo do të bëhej në emër të atyre mësimëve, të cilat vinin nga lart dhe nga librat e paprekshëm, me porosi që nuk mund t’u hiqej as pika e as presa, pra të pranoheshin dhe të ndiqeshin gjithnjë me bindjen më të madhe si gjëra të pandryshueshme, domethënë, fjalë perëndie...”

Ngjashëm do t’i përgjigjet edhe asaj që merrej për „pushtet të proletarëve“ (që ndonjëherë në atë ngatërrim e sipër e quante edhe „pushtet të peshkopëve“) dhe të vendosjes së asaj, e cila trumbetohej me zhurmë si „ardhmëri e botës“, e marifete të tjera, me të cilat ushqeheshin shpresa e njeriut të rëndomtë për „parajsën e kuqe“, e cila duhej të arrihej nga shpronësimi i domosdoshëm, me çka ai vetëm sa mashtrohej për t’u kthyer në një masë të përdorshme dhe asgjë tjetër, siç ishte vepruar edhe me rastin e përhapjes së frymës së librave të shenjtë, me të cilët predikohej barazi, e cila arrihej „në parajsën e botës së amshuar“, ku do të preheshin përgjithmonë vetëm ata që vuajnë në këtë botë dhe kjo mundësohet në saje të ndëshkimit të shkaktarëve të vuajtjeve të tyre...

Ajo do të thotë se „vetëm pushteti i dashurisë është i gjithëpushtetshëm dhe i përhershëm, ku ndodh ai shpronësimi i domosdoshëm nga smira, nga urrejtja, nga hakmarrja dhe nga vese të tjera që ngarkojnë shpirtin me të liga...”

Edhe për luftën e klasave, e cila do të kalojë në ideologji dhe së andejmi do të marrë përmasat e asaj që më vonë do të quhet „diktaturë e kuqe“, “murtajë” dhe çmos, Zonja von Braun do të shkruajë:

„Aty ku mungon dashuria dhe ndijimi i saj, lind nevoja për krahasime dhe dëshmime në përputhje me përmasat e urrejtjes dhe me shfrimin e hakmarrjes, me ç’gjë rrënohet

gjithçka, ku pastaj është e natyrshme të krijohen edhe shtresa në bazë të fuqisë së të keqes dhe të mbështetjes në të“.

Kësaj çështjeje do t'i përgjigjet me vlerësimin pothuajse moralizues:

„Me ndijimin e dashurisë dhe vetëm të dashurisë të gjithë pasurohen dhe kthehen në të lumtur...“

Skulptorit do t'i kujtohet se në njërën ndër ato bisedat e hershme me telefon nga ato që ishin zhvilluar çdo ditë në orën nëntë të mbrëmjes për nëntë vjet dhe nëntë ditë ajo i kishte thënë se vetëm me dashurinë ishte e mundur barazia dhe me asgjë tjetër, ndërkohë që urrejtja matej në përputhje me shkallëzimin e shfaqjes së hakmarrjes dhe të shpërthimit të dufit të saj, si një dëshmim egërsie, të cilat ia kishte përsëritur dhe stërpërsëritur disa herë, por ai nuk ua kishte vënë gjithaq veshin, ngaqë i kishte marrë për moto të atyre që ajo i lidhte me dashurinë dhe nevojën që përherë të baraspeshoheshin me të, me ç'rast i bëhej se ashtu vepronte që ta mbronte nga ndjenja e urrejtjes, të cilën sikur ia kishte vërejtur ngaherë, qysh nga takimi i tyre i parë në Berlin, por ai për herë të parë ia kishte pohuar haptas pas katër vjetësh dhe katër muajsh të atyre bisedave me telefon, kur i kishte thënë „se urrejtjen e merrte për shpëtim të dashurisë aty ku dashuria vritej me dhunë dhe duhej të mbrohej vetëm me të“, gjë që ia kishte bërë me dije „se ajo ishte e vetmja dhe e fundit që e mbronte nga ndjenja e nënçmimit, në të cilën zvarritej që prej vitesh dhe nuk kishte shpëtim prej saj...“

Në *Kujtimet* e lëna, të cilat do t'i vijnë me postë tri ditë pas vdekjes dhe varrosjes së saj në anën e kundërt të liqenit, do të shohë se çështja e refrenit „për barazinë të dashuria dhe me dashuri“ kishte qenë më shumë se një brengë dashurie, e cila lidhej me atë që tashmë kishte kaluar, jo vetëm në një realitet shtetëror, siç ishte ai i modelit të sovjetikëve në Rusi, por edhe në ide gjithëpërfshirëse, e cila sikur ia merrte anën asaj të demokracisë botërore, të shpallur prej amerikanëve dhe kjo ndodhte edhe në sajë të perceptimit të përfytyrimit të saj në një formulë për mbikëqyrjen e botës, e cila nuk kishte se si të mos kthehej në një garë për mbizotërimin e saj të njëanshëm që, si e tillë, ishte ngritur nga vendet europiane të ashtuquajtura fituese të Luftës së Parë Botërore, prirje kjo e cila i shkonte shumë për shtati „idesë së barazisë botërore të proletarëve“ të shpallur nga sovjetikët dhe të përquafuar thuajse duarhapur nga qarqe të fuqishme intelektuale majtiste në Perëndim, të cilat sikur ishin përcaktuar „për botën e re të barabartë“ dhe kundër „prirjeve hegjemoniste dhe imperialiste“, të cilat nuk fshiheshin nga francezët dhe britanikët dhe që tashmë quheshin „imperializëm i ri botëror...“

Natyrisht se ngarendjen pas zhvillimit tekniko-teknologjik, në njërën anë, që shihej si çështje e krijimit të rrethanave për mbizotërim të botës, dhe përhapjes së iluzioneve për barazinë botërore, në anën tjetër, që ishte kthyer në një garë të hapur, e kishte më të lehtë ta drejtonin ata që e përdornin dhe e joshnin masën me mashtrimin e barazisë, duke e shndërruar atë në një mjet të fuqishëm përvetësimi, të ngjashëm me religjionin dhe me parimet e njohura të premtimit të barazisë së përsëritshme me çka edhe vlerat më të qëndrueshme të njerëzimit, të krijuara me mund nga brezat, sikur anashkaloheshin dhe zhvlerësoheshin sakaq para iluzionit të parajsës, e cila i pret të varfrit dhe të përvuajturit e shumtë, mashtrim ky i nisur që nga shpallja e mësimave të librave të shenjtë dhe kthimi i tyre në armë të fuqishme për pushtet që, jo një herë, njerëzimit i kishte kushtuar shtrenjtë...

Zonja von Braun këto zhvillime do t'i përcjellë me keqardhje, për të paralajmëruar se „mungesa e ndijimit të dashurisë, në kohën e mashtrimeve të mëdha të tmerrshme, do të krijojë rrethanat për rikthimin e tiranisë, e cila do ta përmbysë keqas botën për ta bërë pre të së ligës së pandalshme që kthehet në gllabërim të përgjithshëm...“

Kur kishte thënë kështu, ajo sigurisht se kishte pasur parasysh shfaqjen e atyre rrymimeve dhe zhvillimeve të pashmangshme në ato pjesë që dikur përfshiheshin në përbërje të perandorive të mundura gjatë Luftës së Parë Botërore, të cilat kishin si moto „kthimin e dinjitetit të nëpërkëmbur nacional“, frymë, e cila, ndonëse me synime të drejta, pak më vonë do të merrte kahe dhe përmasa rrënuese, të cilat do t'i duheshin asaj luftës së re botërore, të

dytës me radhë, që edhe ajo do t'ia shohë fitilin te prishjet e Versajës dhe ato të Moskës, kur fitimtarët e dalë nga lufta e parë ishin sjellë gjithë mllef, hakmarrje dhe nënçmim ndaj kundërshtarëve të tyre me synimin që t'i mbanin përherë të lidhur për prangat e dënimit dhe të poshtërimit historik, të përcaktuara prej tyre, në ç'mënyrë kishin ushqyer hakmarrjen e të mundurve dhe domosdonë e shpërthimit të saj nga ana e tyre.

Tekefundit, kështu edhe kishte ndodhur, bile pa kaluar shumë kohë, ishin hetuar shpërthimet e atyre që njësoj do të quhen ndreqje të prishjeve të Versajës, që do të nisnin me thirrjet për rikthimin e dinjitetit për të shkuar deri te e kundërta... Ndërkohë që edhe bolshevikët me fushatën e mashtimit të barazisë proletare, me premtimin „e parajsës qiellore“, e cila me anën e revolucioneve dhe shpronësimeve të përgjakshme duhej të kthehej në njëmendësi jetësore, njësoj kishin paraqitur shqetësim dhe shkas që i ishin dashur asaj çmendie të pandalshme...

„Vetëm dashuria e madhe mund urrejtjen e madhe“, do t'i thotë gjithë shqetësim gjatë gjithë bisedës telefonike Zonja von Braun në prag të fillimit të Luftës së Dytë Botërore, që të përseritur dhe ripërseritur me një zë që kishte ngjyrën e vajit, i kishin tingëlluar hiç ndryshe pos „nënshtrim ndaj urrejtjes së madhe“, me çka ajo sikur do të pranojë me dëshpërim mbizotërimin e saj, por pa hequr dorë nga bindja se „vetëm dashuritë e mëdha janë në gjendje të shërojnë plagët e mëdha“, fjalë këto të lëna si amanet, me të cilat do të mbyllë *Kujtimet, që*, megjithëse edhe si të tilla ruanin frymën e shpresës, Skulptorit i kishin mjaftuar përfundimisht t'ia kthejnë atë dëshpërimin shkallmues, sa të thotë se tek ai mund të vritej gjithçka përveç urrejtjes, me të cilin do t'i kalojë ata gjashtë vjet dhe tetë muaj të vetëmbylljes, ku çuditërisht vetëm ajo flaka e kryengritjes së fikur të Kosovës, e mbetur diku në malet e Drenicës, do t'i ndezej e përndezej përderisa të përhapej dhe përhapej që ta përfshinte botën si hakmarrje ndaj atyre që kishte sjellë Versaja...

Dhe kështu, gjithnjë me ato përçapje të ndrydhura me Kosovën dhe flakën e saj, si diçka me të cilën do të ndodhte një fund i fundeve, që nuk e kishte të qartë se çfarë ishte dhe çfarë paraqiste, por që mendja, e shteruar me ato pjesëzat e flashkura që po i shuheshin, ia thoshte se gjithsesi do të ndodhte aty dhe vetëm aty dhe në saje të asaj flake të mbetur në të, pra me ato do të notojë natë e ditë në atë përmbetje të ngadalshme, derisa të vijë ajo dita e nëntë e majit, kur nga atelieja në Rudolfplaz, shikimi i lodhur do t'ia kapë ushtarët sovjetikë tek përhapeshin nëpër sheshin e Ballplazit me flamujt e kuq dhe me ato çirret për botën proletare, që tashmë po bëhej...

IX

„Vetëm urrejtja e madhe shpëton dashurinë e madhe nga rrënimi“ - kishte pëshpëritur Skulptori sa e sa herë, gjithnjë duke u përpjekur me dufin e saj ta përballojë gjendjen e shkallmimit të rëndë që sa vinte e i thellohej gjatë vetëmbylljes prej gjashtë vjetësh dhe tetë muajsh, të cilën e shihte si labirint, të ngjashëm me atë të Shqipërisë së katërmëdhjetës, për të cilin Koloneli i kishte thënë se mund të mbetesh vrasës nëse nuk ia del të kthehesh në perëndi, me të vetmin ndryshim se në të kishte vend vetëm për vetë-vrasje dhe vetë-vrasës, dhe që e gjitha i shfaqej si e mundshme, fare pranë, po të mos ishte ndjenja e urrejtjes që ia ushqente dufin edhe atëherë kur dukej se çdo gjë merrte atë kah...

Megjithatë, sikur të kishte për detyrë t'ia vazhdonte pafundësisht këtë gjendje të shpenzimit të pandalshëm me vetveten, edhe kur dukej se i ishte afruar atij fundi të pashmangshëm, ndërhynte Zonja von Braun me *Kujtimet*, por edhe me përfytyrimin herë si hije, herë si zë, që i shfaqej bashkë me atë të Kolonelit dhe që kjo ndodhte pikërisht në kulmin e asaj rraskapitjeje, kur ndiente se nuk ishte as gjallë as vdekur, në një gjendje kollofitjeje, të ngjashme me atë sharrimit në një askundje jashtë kohe dhe hapësire.

Në atë mbërthim të rëndë ankthi, ajo sikur i ndihmonte të merrte veten dhe të parat fjalë që ia thoshte, ishin ato për ndijimin e dashurisë:

„Deri kur pa dashuri...?“ - i drejtohej ajo gjithë dridhma.

„Deri kur pa urrejtje...?“ - ia kthente njësoj.

„Ktheju dashurisë... Kurrë nuk është vonë për të...“ - i thoshte ajo fare butë, sikur dëshironte ta mëshironte.

„Ktheju urrejtjes, nëse do ta shpëtosh dashurinë...“ - i kthente ai me mundimin e frymës së fundit.

„Vetëm dashuria e shpëton dashurinë...“, i fliste ajo butësisht.

„Vetëm urrejtja e shpëton dashurinë nga vrasja...“, ia kthente ai.

„Dashuria nuk vritet...“

„Qëmoti e kanë vrarë...“, i thoshte.

„Ajo është e pavdekshme...“

„Kështu flasin ëndërrimtarët e papërmirësueshëm, ata që e shohin të përdorshme dhe të shpenzueshme, madje...“, ia kthente.

„E ke nga urrejtja...“, i thoshte ajo.

„Ajo po më mban as gjallë as vdekur...“, i thoshte ai.

„Mashtrohesh...“, ia kthente ajo.

„Pengu i saj kërkon shpagim për atë që ma kanë vrarë...“, i thoshte ai.

„Shpagimi i dashurisë është heqja e urrejtjes...“, ia kthente ajo.

„Kështu vritet dashuria...“, i thoshte ai.

„Kështu mbrohet dashuria...“, ia kthente ajo.

Herë me fjalët për vrasjen e dashurisë e herë me ato për mbrojtjen e dashurisë, herë për urrejtjen e herë kundër urrejtjes, herë ashtu e herë kështu, të cilat shkëmbeheshin pa fund sa të dukeshin pjesë e së njëjtës, sikur i bëhej që ateliesë për pak i hiqej mbërthimi i atij gulçimi të pandalshëm dhe i kthehej diçka e asaj fryme, në të cilën megjithatë nuk mund t'ju ikej kaheve të tjera të përpëlitjeve për dashurinë dhe ndijimin e saj.

„Do ta shtrojmë sofrën e dashurisë“, sikur i thoshte Zonja von Braun dhe kjo sa ora e ballafaqonte me përpjekjet e njohura për përgjithësimin e mëtutjeshëm të saj, të cilat i njihte qëmoti.

„Sofrën e dashurisë...“?

„Sofrën e dashurisë...“

„Bah!“

„Pse jo...“

„Do ta hamë edhe atë që nuk është?...“

„Dashuria nuk hahet...“

„Eeee... po...“?

„Do ta rishqyrtojmë dashurinë...“

„Bah!“

„Ajo ka nevojë për dëshmim të përhershëm...“

„Po nëse nuk është më...“?

„S'ka si të mos jetë...Duhet parë se çfarë ka ndodhur me të?... Ku është strukur për ta rikthyer...“

„Për ta rikthyer...“?

„Gjithsesi...“

„Mund të rikthehet ajo që nuk është, që është vrarë...“?

„Ajo as vdes as mund të vritet...“

„Prapë me andralla...“?

„Dashuria është më shumë se ideal, që duhet hetuar, duhet ushqyer edhe kur duket se shuhet a tretet fare, sepse e ruajnë shtresimet e struktura në thellësi, të cilat nuk mund të merren me mend që mund të jenë të tilla, vullkan shpërthyes...“

„Atë e ushqen urrejtja ndaj vrasësve të saj...Pa urrejtje nuk ka as dashuri të njëmendte...Vetëm urrejtja është në gjendje ta mbrojë dashurinë nga shkatërrimi dhe mashtrimet e tjera që e rrezikojnë në të gjitha anët...”

„Lëre urrejtjen...”

„Po çfarë më mbetet tjetër...”?

„Dashuria...”

„Por, ajo nuk është më...E di mirë se më është vrarë, siç i është vrarë edhe Kolonelit, siç t’u ka vrarë edhe ty dhe si i është vrarë gjithë botës...Kërkimi me çdo kusht i saj edhe aty ku nuk mund të jetë, e dëshmon këtë mashtrim me të cilin duhet të jetohet...”

„E ke nga dëshpërimi...”

„E kam nga bindja...”

„Lëre bindjen që nuk është bindje se na pret sofa e dashurisë...”

„Na pret sofa e urrejtjes...”

„Sofra e dashurisë dhe vetëm dashuria...”

„Sofra e urrejtjes dhe vetëm urrejtja...”

„Dashuria...”

„Urrejtja...”

„Dashuria dhe vetëm dashuria...”

„Mjaft, se plasa me ato proçka të dashurisë...”!

Me ato psherëtima, që i lëshonte me mund, i dukej se ndërpritej ajo biseda e përsëritshme me përfitim të Zonjës von Braun, e cila i shfaqej përherë e njëjtë, por sikur ishte mësuar me të dhe mbase ishte e vetmja që sado pak e shkundte nga kllapia, nga gjendja as gjallë as vdekur.

Përçapjen megjithatë ia trandte përfytyrimi i pandalshëm i asaj sofe, silueta e së cilës i shfaqej mu në mes, me shumë e shumë hije përdëlluese që i shtroheshin përreth, me të cilat dikur kishte kaluar ato gjashtëdhjetë e gjashtë ditët e paharrueshme në Shqipëri, ku dallonte spanjollin Rafaelo, poetin Hartman, sportistin çek Hajek, bankierin polak Avramicki, studentin Zenel Xhema, togerin Klein dhe të tjerë, që secili në mënyrën e vet ishte aty të fliste për atë udhëtimin në Shqipëri, i cili nuk ishte bërë, po do të bëhej, jo në mbrojtje të Qeverisë së Përkohshme as të mbretit, po në kërkim të një dashurie, e cila ishte e mundshme vetëm atje, me ç’rast zinin ngoje *Urën e Shenjtë* dhe *Kështjellën e Hijës* diku në majë të Pashtrikut, rreth së cilës Koloneli kishte medituuar gjatë mbylljes në teqenë e Leqes dhe kishte thënë se në të ndodhej fryma e hyjit nga kohë e lashtësisë, sado që telegrafisti Bruner nuk kishte qenë në gjendje t’ia gjente ndonjë dëshmi në ato hapësira, qoftë edhe si gjurmë të harruara dhe që për këtë kishte marrë guximin ta quante pjesë të atyre mynxyrave të pandalshme, të cilat e kishin përcjellë gjatë ditëve të fundit të mbylljes në teqenë e Leqes...

„Tek Ura e Shenjtë nuk është ndarë bota, por është bashkuar nga dashuria e përjetshme”, fliste spanjollu Rafaelo dhe thoshte se atje shkonte për ta kërkuar betimin e dashurisë, mbi të cilën ishte ndërtuar ai bashkim dhe qëndronte si i tillë, pa marrë parasysh të pabërat që ia sillnin pas shpine.

Andaj, kjo edhe e shtynte spanjollin që me një përkushtim të çuditshëm të thoshte :

“Ajo dhe vetëm ajo ka qenë në gjendje t’u bëjë ballë të ligave të urrejtjes që i janë përplasur pandërprerë nga njëra anë në tjetrën për t’u kthyer pastaj në një tempull të përhershëm të dashurisë...”

„E sheh, i dashur Rafaelo, se ç’është në gjendje të bëjë dashuria...”?, ndërhynte gjithë qesëndi Zonja von Braun.

Poetin Hartman sikur e zinte frymëzimi i muzave, për të cilat thoshte se janë pjesë e dashurisë dhe këmbëngulte se vetëm në atë vend luajnë vallen e amshueshme.

„Baladave dhe legjendave u duhen dashuritë e mëdha, ato të përhershmet, që nuk i mund as vdekja as çfarëdo urrejtje, të cilat kalojnë në shëmbëllesë...E tillë është vetëm ajo që ka mbetur tek ajo urë...”

Më tutje ai fliste dhe tregonte se ishte thirrja e mijëra e mijëra vargjeve, të mbetura dhe të shkapërderdhura andejpari si pjesë të një krijimtarie të jashtëzakonshme, tepër të lashtë, që duhej mbledhur, thirrje kjo e cila assesi t' i ndahej dhe që do ta ndiqte pareshtur.

„Legjenda shqiptare është njëra ndër dashuritë më të mëdha të botës...Aty mrekullisht mundet vdekja...”

„Në të vërtetë, i dashur Hartman, aty as që ka vdekje dhe as që ka pasur ndonjëherë... Ka vetëm dashuri dhe dëshmim të përhershëm dashurie...“, thoshte Zonja von Braun dhe këtë e përsëriste dhe e stërpërsëritste pareshtur.

„Dëshmimi i dashurisë është dhunti hyjnore, njësoj si përpjekja e vazhdueshme për fitoren, e cila kërkon përkushtim të përhershëm“, fliste hovshëm sportisti çek Hajek dhe shtonte se “ndijimi i dashurisë i gjason asaj gare të pandalshme, me cak të përhershëm, që duhet synuar vazhdimisht...”

„Ç’ndjenjë mrekulluese është flijimi për dashurinë...“, ndërhynte togeri Klein dhe shtonte se ajo është tepër e madhërishtme...

Dhe, për ta dëshmuar këtë, ato që i thoshte, i shoqëronte me njëfarë si këndim për „dashurinë që m’ka nxanë përgjithmonë“, të ngjashme me atë „vajzë mos qaj me lot...“, e cila Koloneli i ishte bërë si psherëtimë shpirti, me të cilën kishte kaluar çastet e fundit të jetës...

„Dashurisë i duhet jeta-dashuri“, fliste Zonja von Braun.

„Urën e Shenjtë, megjithatë, e ka ngritur flijimi...Pa të nuk ka as dashuri...“ - i thoshte togeri Klein, të cilit i bëhej se edhe ai plumbi i panjohur që e kishte qëlluar diku në Shqipëri sapo kishte filluar ajo Lufta e Parë Botërore ishte pjesë e atij flijimi që i duhej dashurisë.

„E ka ngritë dashuria, toger...“ - i thoshte Zonja von Braun - “Pa të nuk do të kishte asgjë...”

„Konstantini del prej varrit dhe ecën si shpirt...“ - ndërhynte poeti Hartman thuajse i përhumbur, gjithnjë duke shqiptuar disa vargje që flisnin për fjalën e dhënë dhe përmbushjen e saj, të cilën herë e thoshte besë, e herë betim...

„Pa besim nuk ka dashuri...“ - thoshte polaku Avramicki dhe shtonte se - “besimi është tharmi i dashurisë...”

„Asaj i duhen ngrehina të mëdha për t’u pasqyruar shlrshëm...Ato që nuk shemben dot...”

„Pa dashuri nuk ka jetë...“, flisnin të tjerët si me një gojë...

„Dashuria...”

„Jeta...”

„Jeta-dashuri...”

„Dashuria-jetë...”

„Jeta-Shqipëri...”

„Dashuria-Shqipëri...”

„Shqipëria-dashuri...”

„Dashuri-jetë!”

„Jetë-dashuri!”

„Dashuri-jetë!”

Jehu i fjalëve „dashuri-jetë“ bashkë me „Shqipëria-dashuri“, që Skulptorit i vinin si „jetë-urrejtje“ dhe „Shqipëri-urrejtje“ dhe që si të tilla i shpërndaheshin nëpër hapësirën e mbyllur të ateliesë, përfytyrimin e „sofrës së dashurisë“ dhe gjithë ato që thuheshin në të sakaq ia kthente në një ankth, të ngjashëm me kredhjet kalimtare që i duheshin në situata të herëpashershme, me të cilin gjendja as gjallë as vdekur i bëhej e përhershme, si një mallkim që nuk i ndahej, me ç’rast sërish ndiente mbërthimin e vetmisë se vetëmbylljes dhe kjo mbase i pëlqente të lirohej nga ato që i takonin frymës së urrejtjes, me të cilën ushqehet dhe kishte bindjen se, ndonëse ia zgjaste zvarritjen e mundimshme, megjithatë ishte e vetmja e cila sikur ia bënte me dije se ishte pikërisht fuqia e urrejtjes dhe ushqimi i saj që dashurinë e kishte

mbrojtur, por edhe shpëtuar nga kurthet e mëdha të mashtrimeve, të cilave ajo u nënshtrohet së pari dhe më së lehti pikërisht pse e gjitha kthehet në ndjenjë...

„Kujt i duhet mashtrimi *dashuri-jetë* kur mungon edhe njëra edhe tjetra...? A nuk është kthyer Shqipëria në urrejtje të madhe, që i vjen nga të gjitha anët“, thoshte Skulptori dhe në atë shkallim ishte përfundimi i asaj flakës së fikur të kryeneçësisë së Kosovës, e cila i ndizej e i përndizej furishëm sa të hetonte përplasjen davaritëse të dufit të urrejtjes që, përkundër vullnetit të tij, e rikthente tek ai realiteti i hidhur i mbushje-zbrazjeve të pafundme me vetveten dhe kundër vetvetes, ku *Kujtimet* e Zonjës von Braun ishin të pakapërcyeshme, edhe pse sa më shumë i lexonte dhe rilexonte, herë nga fundi e herë nga fillimi, herë ashtu si ishin e herë çfarë do të dëshironte të ishin, pa rend dhe pa mbikëqyrje, i dukej se edhe ajo - në përputhje me zhvillimet që gjithnjë më shumë çonin në përmbushjen e parashikimeve të Koloneli rreth luftërave të mëdha botërore, të cilat nuk do të kishin të ndalur dhe kjo do të ndodhte përderisa të kuptohej se vetëm bërja e Shqipërisë Shqipëri ua shuante flakën, e kështu me radhë - humbte mbikëqyrjen (mbase këtë e bënte qëllimisht) për t'iu nënshtuar bredhjeve, të ngjashme me ato që Koloneli do t'i përshkruajë në tri shënimet e fundit të lëna në teqenë e Leqes në pritje të atij plumbi, i cili do t'ia gjejë kokën ditën e njëzetepestë, kur me mendje do ta thejë vetëmbylljen dhe do të shihet të shkojë në Kosovë, sa në një teqe të Gjakovës, sa në Çabrat, e sa te Kështjella e Hijes në Pashtrik për të vendosur lidhje, siç thoshte, „me frymën e lashtësisë“, me atë „pjesën e panjohur të vetvetes“ dhe me „kujtesën e shkëputur“, pa të cilën nuk ka rikthim dhe ribërje, që i duhej atij fillimi të ri, i cili kishte bindjen se çonte tek bërja e Shqipërisë Shqipëri.

Kështu, në njërin ndër ato shkrime të ditëve të fundit të jetës, përballë një gjendjeje thuajse halucinacioni, të ngjashme me atë të Kolonelit, kur po i afrohej fundit të pashmangshëm, edhe Zonja von Braun do të flasë për ato që i quan „bredhje të çuditshme në Kosovë“, pa sqaruar me asgjë në mos ishin vërvitje dëshpëruese në kërkim të dashurisë së Kolonelit të mbetur atje dhe, ndonëse arsyetoheshin se „vetëm në atë pjesë të botës dashuria dëshmohej mrekullisht - pa marrë parasysh se sulmohej keqas në të gjitha anët dhe kjo ishte për adhurim, por edhe për mësim“ - Skulptorit ia kishin futur mëdyshjen se ato që ajo thoshte për dashurinë dhe mbizotërimin e saj të plotë, të cilat ia kishte përsëritur e stërpërsëritur thuajse pareshtur gjatë bisedave telefonike prej nëntë vjetësh dhe nëntë ditësh, si dhe ato të tjerat, të shtuara në *Kujtime*, të cilat i kishin ardhur me postë tri ditë pas vdekjes dhe varrimit të saj në anën e kundërt të liqenit, pos përcaktimeve me të cilat disi të anshkalohej dufi i asaj së keqeje të madhe botërore që nuk kishte të ndalur dhe do të shkonte deri në fund, pra të gjitha linin përshtypjen se ishin edhe pjesë e dëshimit dhe e përkushtimit të ethshëm ndaj dashurisë së thellë dhe të pashueshme për Kolonelin, për atë dashuri të madhe e të pafundme, të filluar diku në Berlin e të ngulitur pastaj përgjithmonë në Shqipëri, ku e kishte vendin dhe duhej të përfundonte, qoftë edhe në atë mënyrë, (siç do të pasqyrohet në ato çastet e fundit të jetës së saj). Sepse pa atë bredhje dhe pa atë fund ajo dashuri do të mbetej e përgjithësuar fare, e ngjashme me frymën e mirësisë, e cila dashurinë e kthen në ndjenjë të thjeshtë përkujdesjeje, që i shkon mëshirës dhe prirjes së bamirësisë së rëndomtë, e cila sikur shtohet në përputhje me rritjen e përmasave, të cilat shfaqen në kohët e fatkeqësive të mëdha, çfarë ishin ato nëpër të cilat kalonte njerëzimi...

Pra, me kërkimin e dashurisë ajo nuk kishte bërë tjetër përveçse kishte mbrojtur dashurinë, me të cilën ishte munduar t'ua bënte ballë gjithë atyre fatkeqësive, të cilat ia kishin sjellë rrethanat tragjike të Luftës së Parë Botërore dhe fatkeqësi të tjera që do të pasojnë aq marramendshëm si theqafje të pandalshme, kur pa Kolonelin do të ndihej e vetmuar fare dhe e humbur në një rrëmujë që s' kishte shembull, së cilës nuk i shihej fundi, por megjithatë nuk dëshironte ta pranonte si të tillë, siç nuk e kishte pranuar edhe Koloneli përballë realitetit tepër dëshpërues shqiptar, kur kishte parë se fundin e kishte si dënim të pashmangshëm, të ngjashëm me atë kobin e asaj bote, që në pamundësi ta parandalonte, e kishte kthyer në një parafytyrim thuajse ëndërrimtar, me të cilin lidhte atë farë rikthimi, ribërje dhe atë rifillimin

e domosdoshëm, që e quante rilindje dhe ndryshe-ndryshe dhe që pareshtur thoshte se çonte në bërjen e Shqipërisë Shqipëri, me çka nga nënçmimi nxirreshin gjithë ato vrasje dhe të liga të tjera që vazhdimisht e kishin mbërthyer tmerrësisht atë botë, së cilës, për të dalë nga një gjendje e tillë, mund t'i ndihmonin vetëm idealistët e paepur.

Tekefundit, a nuk përkonte kjo edhe me atë që ajo ia kishte thënë kur ia kishte dorëzuar shënimet e Kolonelit të lëna në teqenë e Leqes me rastin e takimit të tyre të parë në Berlin dy vjet pasi ajo ishte kthyer nga internimi gjashtëvjeçar francez - „se kishin qenë pjesë e të njëjtit shqetësim të madh dhe do të mbeteshin bashkë në të për të ndjekur të njëjtat shtigje, të cilat çojnë nëpër ndijimin e dashurisë dhe vetëm të dashurisë, e cila nuk ka të sosur dhe që paraqet zanafillën e çdo gjëje që lidhet me shpresën dhe ardhmërinë...”

Që t'ia përforconte atë përkushtim, në ndarje, jo rastësisht i kishte thënë:

„Për fat, dashurinë e kemi të pasosme...”

Përballë një çekuilibrimi të pandalshëm dhe atyre që ditë e natë i përhiheshin gjatë asaj vetëmbylljeje prej gjashtë vjetësh dhe tetë muajsh, ku kishte përjashtuar realitetin dhe gjithë ato që ndodhnin gjatë Luftës së Dytë Botërore të madhe, të cilën Koloneli e kishte paraparë dhe çuditërisht ia kishte treguar përmasat dhe zhvillimet, duke ia përshkruar edhe ilačin, pra në atë mbërthim me vetveten sikur të ishte jashtë kohe dhe hapësire, kur ishte ballafaquar me bredhjet e Zonjës von Braun andej nga kishin përfunduar edhe ato të Kolonelit, dhe në atë përhumbje, duke u përplasur pandërprerë me mendime, Skulptori thuajse kishte ardhur në përfundimin se Zonja von Braun nuk kishte si të mos merrte të njëjtën rrugë, pra atë të ndjekjes së Kolonelit. Dhe do ta bënte atë udhë të gjatë dhe të pakëthim, sepse ajo ishte pjesë e kërkimit të dashurisë së madhe, të pasosme, së cilës megjithatë i ishte futur në mes shkëputja, qoftë edhe fizike, që për t'u lidhur duhej përballuar edhe atë hapësirën e përbashkët, ku do të shfaqej dhe rishfaqej edhe si sofër e dashurisë dhe si ndryshe-ndryshe, për t'u bërë pjesë e të njëjtit realitet dhe të njëjtit ideal, e së njëjtës frymë dhe, madje, e të njëjtave qëndrime, me çka ajo e shihte dashurinë si ilaç të vetëm për shpëtimin e gjithë botës, e në kuadër të saj edhe të Shqipërisë, ku edhe kuptimet më të errëta të kthyer në realitet, fjalët më të papërballueshme nga pesha e të ligave dhe të fatkeqësive, që rëndonin ngado, i zëvendësonte me dashurinë, e që këto në përfytyrimet e saj mrekullisht ndryshonin edhe gjendjet, në dukje të pandryshueshme...

Te *Kujtimet* e ditëve të fundit Skulptori kishte parë se bredhjet e Zonjës von Braun në Kosovë, ndonëse të imagjinuara fund e krye, (ajo nuk kishte qenë në gjendje të ndërmernte kurrfarë udhëtimi nga pasojat që ia kishte lënë interenimi prej gjashtë vjetësh me ngarkesa të mëdha psikike, të cilat përgjithmonë e kishin ngujuar në Berlin), megjithatë ia forconin bindjen se gjithçka e jetës së saj ka qenë përpjekje e pareshtur për t'u njëjtësuar me Kolonelin dhe frymën që e quante „të pasosme“ e „të përsëritshme“ dhe ky përcaktim ishte më shumë se ngushëllim, ngaqë në saje të këtij përkushtimi të jashtëzakonshëm, një fatkeqësi të rëndë, e cila mund të mbetej e pavërejtur dhe e rëndomtë, si shumë e shumë të tjera që ndodhin në kohët e tragjedit të mëdha, do ta ngrejë në përmasat e një çështjeje të hapur, të një rëndësie të madhe për të gjithë, së cilës vetëm kundrimi i dashurisë si e mirë, mund t'ia parandalojë fatkeqësitë e mëtejshme dhe përmasat e pandalshme rrënuese nëpër të cilat ishte përfshirë dhe mund të mbahej pafundësisht...

Natyrisht se këtij përcaktimi i është dashur ajo që quhet „njësim i dashurisë“, me të cilin ajo shfaqet e natyrshme dhe njëherësh ndijore, në ç'mënyrë Zonja von Braun është ballafaquar me domosdoshmërinë e bredhjeve për „prekje“ dhe fërkime të tjera që kishte ndjekur edhe Koloneli drejt „njohjes me vetveten“, dhe do t'i shohë si çështje të idealit, të cilat i duhen bërjes së Shqipërisë Shqipëri, të cilat në atë përfytyrim, qoftë qëndërrimtar, ndihmojnë të shihen si çështje të hapura dashurie drejt sendërtimit të një të mire dhe si të tilla të mbesin në përbërje të frymëzimeve të mëdha dhe të përgjithshme, siç ishte ai i Kolonelit për vendosjen e perandorisë së më të mirës, përfytyrim ky që thuajse në atë ngarendje botërore pas të keqes, që nga lufta në luftë bëhej edhe më e madhe dhe më e

paparashikueshme dhe sikur nuk i shihej fundi, shfaqej si më i mundshmi dhe më i besueshmi për t'i shpëtuar tragjedisë së përgjithshme.

„Aty ku mungon ndijimi i dashurisë ndodh më e keqja...“, do t'i thotë Zonja von Braun në njërin ndër ato bisedat telefonike, pak kohë para se të merrnin fund përgjithmonë me vdekjen e saj, ditën e fillimit të Luftës së Dytë Botërore të madhe.

Edhe sikur të kishte pranuar dështimin me këtë hamendësim, që nuk mund t'i ikej, e as të fshihej, bredhjet e saj mendore, por edhe shpirtërore pas atyre të Kolonelit në Kosovë dhe gjetiu nëpër hapësirën e botës shqiptare, Skulptori i kishte parë edhe në shërbim të përballimit të kësaj dhembjeje me anën e një ngushëllimi, që me hetimin dhe gjetjen e dashurisë - pikërisht aty ku ajo më së shumti ishte qëlluar nga urrejtja dhe dufi i pandalshëm me të cilat ishte ushqyer, (të cilat Koloneli thajse dëshpërueshëm do t'i quajë „mallkim i sjellë nga kufiri i ndarjes së ngahershme të botës“ dhe thoshte se „i ishte paguar një çmim i madh gjaku“) - të dëshmojë se aty ku kërkohet dashuria dhe forca e saj nuk mund të fitojë urrejtja, pa marrë parasysh përmasat e saj dhe pa marrë parasysh se nga vjen...

Dhe, ajo bredhje në kërkim të ndijimit të dashurisë dhe pasqyrimin të saj, për të cilën Zonja von Braun kishte thënë se „kur mungon ndodh më e keqja“ dhe që atë e lidhte me tragjeditë e mëdha botërore, të cilat ishin në zhvillim e sipër, nuk kishte si të mos niste dhe soste tek Ura e Shenjtë, pikërisht aty ku puqeshin edhe ato përvijimet e asaj „sofre të dashurisë“, që sa herë i vinte përpara sikur i thoshte se „dashurisë i duhej dëshmimi i përhershëm me anën e rishqyrtimit dhe sprovave të saj“, e që edhe ata të cilët ishin vrarë mizorisht në Shqipëri gjatë asaj bredhjeje prej gjashtëdhjetë e gjashtë ditësh në verën e katërmëdhjetës dhe që kishin arsye të qaheshin se aty u ishin vrarë edhe idealet që kishin me vete, ta shihnin si tempull të dashurisë, përpara të cilit duhej përkulur gjithmonë...

Kjo edhe mund të merrej me mend në atë kohë çmendie të madhe dhe fatkeqësish të pandalshme, kur dukej se nuk kishte mbetur gjë pa u prekur dhe pa u rrënuar, kur gjuha e urrejtjes kishte përfshirë gjithçka dhe linte përshtypjen se edhe për shumë kohë do të mbetej mbizotëruese... Andaj, në atë rrëmujë të madhe, çfarëdo ikjeje prej saj, qoftë edhe me aso bredhjes që nuk i ha mendja e shëndoshë, paraqiste më shumë se shpresë...

Në njërin nga shkrimet në *Kujtime* që u takon këtyre „bredhjeve“, Zonja von Braun do të thotë:

„Është një *Urë* e mrekullueshme, e cila jo rastësisht quhet *e shenjtë*, që lidh dy brigje, në dukje të buta, por me shtrihe të ashpër, ku ka filluar ndarja e dhunshme e dashurisë dhe më pastaj kthimi i saj në urrejtje botërore, edhe pse nuk do të duhej të ndodhte ajo, meqë aty dhe në atë vend është bërë kallëzimi i parë i hapur i *Librit të shenjtë* dhe i leximit të tij para se perandoria ta pranonte si të tillë...

Arsyet pse *Libri i shenjtë* i përkthyer nga hebraishtja në latinisht dhe i sjellë nga toka e shenjtë do të hapej për herë të parë mbi atë *Urë*, janë të qarta: është dashur të luftohet hyji dhe besimi tek ai, si pjesë e lirisë, që kishte përcaktuar gjeniun krijues të botës së lashtë gjithandej nga shtrihej hapësira ilire, nëna e antikës...

Libri i shenjtë duhej t'ua mbyllte rrugën atyre që quheshin „ngatërresa të hyjit“ dhe pasqyroheshin me paganizmin dhe shumësinë e kulteve për ta kthyer vëmendjen te një zot, me çka besimi kthehej në mjet të fuqishëm mbikëqyrjeje dhe sundimi, ku pushteti dhe religjioni përcaktonin çdo gjë, madje përshkruanin edhe atë që duhej të merrej për dashuri, me çka ajo e njëmendta përjashtohej, meqë nuk duhej të ndihej, por të përcaktohej, nuk duhej të hetohej lirshëm e as të gjurmohej, por të pranohej si pjesë e mëkatit të zanafillës, nga pastaj kërkoheshin rrëfimi, kërkoheshin pendesa dhe pendimi, kërkoheshin falja, të cilave u duhej mëshira dhe përkujdesja e përhershme me kujdestarin, pra bariu me shkop në dorë të mbrojtë nga mëkatet dhe mëkatarët, të mbrojtë të mos preket kufiri i së palejueshmes dhe të ndalueshmes, që quhet herezi, e kështu me radhë...

Libri i ri i mbyllur, si dhe urdhri i përshpirtjes sikur nuk ia kishin dalë të pranoheshin duarhapur dhe të ktheheshin në besim të ri, edhe pse nuk ishin kundërshtuar haptas.

Përkundrazi, kishte vazhduar shikimi nga hyji dhe besimi ndaj tij si çështje e një ndërlidhjeje të hershme shpirtërore, së cilës nuk i duheshin dekrete as urdhra, por përkushtimi i përhershëm.

Kjo mbase kishte krijuar atë pakënaqësinë e parë të koncileve të shenjta, qoftë në Lindje, qoftë në Perëndim, të cilat kishin bërë t'i shpallej luftë e hapur dhe e pandalshme „ngatërresës së hyjit“ dhe mashtrimit të paganizmit, me të cilin besohej në shumë perëndi, të cilën e kishte dekretuar Konstantini i Madh, që vinte nga ato vise dhe thujse asnjëherë nuk kishte hequr dorë nga adhurimi idhujve, por kishte qenë i detyruar ta bënte këtë për hir të pushtetit perandorak, i cili shfaqej gjithnjë më i paqëndrueshëm përballë rrethanave, kur përmbysja e skllavërisë kishte liruar një energji të madhe njerëzore, e cila mund të mbikëqyrej vetëm me premtimin e barazisë së plotë në jetën e përshtatshme, të cilën tashmë krishterimi e kishte shpallur si të vetmen shpresë me të cilën pa ndonjë vështirësi masat paqësoheshin, josheshin dhe bëheshin për vete pa ndonjë mund të madh.

Para se të fillonte fushatën ushtarake kundër tempujve dhe idhujve të shpërndarë anembanë vendeve ilire, që u faleshin i madh e i vogël, perandori kishte dërguar ndërmjetësuesit perandorakë, të shoqëruar nga misionarë të shumtë me detyrën që t'i kthenin në udhën e drejtë ata të cilët edhe më tutje, siç thuhej, kishin mbetur të mbërthyer për mashtrimin e hyjit.

„Besimi te hyji është pjesë e lirisë sonë“, u kishin thënë ata misionarëve të shoqëruar nga ndërmjetësuesit perandorakë që pareshtur vringëllonin armët.

„Duhet flakur mëkatet që vijnë nga mashtrimi i shturjeve të pafundme...“, flisnin ata me gjuhën e urdhrave dhe tregonin se çka duhet dhe çka nuk duhet, çka lejohet dhe çka nuk lejohet.

„Besimi nuk është mëkat“, ua kishin kthyer.

„Kështu përjashtohet krijuesi i vetëm dhe nuk pranohet zoti!...“ u kishin thënë me kërcënim dhe me këtë misionarët ua kishin bërë me dije se fillonte koha e detyrimit, e shtrirjes së besimit me dhunë, gjë që ashtu edhe kishte ndodhur kur legjionet e para perandorake në Dardani dhe në pjesë të tjera të mbetjes së botës ilire u ishin sulur tempujve, u ishin sulur amfiteatrove dhe gjithë asaj që bie ndesh me besimin e ri dhe me Librin e shenjtë për t'i rrënuar pamëshirshëm...

Nuk ishin kursyer as orakujt dhe faltoret e tjera, të cilat u shërbenin thellimeve të lira shpirtërore dhe thithjeve të njohurive të reja, të cilat mund të bëheshin në përputhje me të menduarit e lirë personal...

Gjaku i derdhur dhe dhuna e egër që ishte ushtruar nga Lindja dhe Perëndimi, sikur nuk kishte mjaftuar ta rrëronte besimin te hyji dhe shenjtëria, sepse ajo ishte e lidhur me dashurinë dhe ndijimin e saj dhe kësaj në ato rrethana tepër të vështira, besimi ishte kthyer në dashuri ndaj dashurisë së lirisë, që ishte fuqizuar edhe më shumë...

Andaj, ja pse atje tempujt janë pjesë e dashurisë së amshueshme...

Ura e Shenjtë është njëra ndër dashuritë më të mëdha, ngase e ka ngritur flijimi si dashuri dhe jo flijimi i dashurisë për hir të jetës së përshtatshme dhe për hire të tjera, të cilat thuhën në emër të librave të shenjtë, që pastaj dikush ishte munduar, me përhapjen e thashethemeve, kinse të aftësive shëruese të ujit të kroit të saj, besimin tek hyji ta kthejë në mëshirë ndaj atyre që besojnë...”

Zonja von Braun më tutje do të tregojë pse ai tempull i madh i dashurisë kishte mbetur i tillë dhe si kishte qenë e mundur kjo, përkundër gjithë atyre ndeshtrashave të jetës që kishin ndodhur në atë hapësirë.

„Ishte dhuna e përdorur, ishin përmasat e tmerrshme të rrënimeve të dekretave perandorake, të cilat dashurinë e bënë edhe më të fuqishme dhe e kthyen në ideal të përhershëm shpirti dhe lirie...”

Dhe, sa më shumë që derdhej gjak andejpari, sa më shumë koka vendoseshin në parmakët e saj për t'i frikësuar ata që edhe më tutje vazhdonin ta ndiqnin atë që quhej hutim i

ngatërresës së hyjit, sa më shumë krijime shpirti gjymtoheshin haptazi, aq më shumë shtohesh lidhja me besimin e lirë, që ishte kthyer në çështje lirie...

Atë besim, s'ka dyshim që e kishte shtuar dhe forcuar edhe më tepër ndarja e kishës, që jo rastësisht kishte zënë fill mu aty, sikur të ishte të dëshmonte, në njërin anë, pafuqinë e dekreteve dhe të urdhrave ndaj besimit të lirë dhe, në tjetrën anë, varësinë e librit të shenjtë në përputhje me gjendjen e forcave, e cila kishte kushtëzuar shfaqjen e asaj vije të ndarjes, që ishte kthyer në kufi të dy botëve, nga kishin filluar përjashtimet dhe më vonë kundërshtitë, të cilat ishin ngritur në armiqësi dhe në luftëra të përgjakshme, ku njëri kryq kishte luftuar tjetrin edhe libri i shenjtë nuk kishte qenë më i përbashkët, në ç'mënyrë as zoti nuk ishte më i tillë, por shfaqej në përputhje me atë që kishte pushtet, me atë i cili ishte më i fortë dhe këtë e shprehte dhe e dëshmonte me anën e armëve dhe duke ushtruar dhunë pa ngurruar që përfytyrimin e tij ta kthejë në emblemë lufte..."

Që aty nuk kishte ndodhur ajo që Zonja von Braun e quan „ndarje të dhunshme të dashurisë“, me çka çdo gjë do të kthehej në pjesë të asaj urrejtjeje të madhe, e cila kishte frymëzuar luftërat e pandalshme për mbizotërim të botës nga njëra apo tjetra palë, kjo i detyrohet ndijimit të dashurisë dhe besimit të saj që buron nga perëndësia dashuri, përfytyrimin e së cilës ajo e sheh të flijimi për dashurinë, siç ishte ai i nuses për urën, i vëllait për kështjellën dhe ndryshe-ndryshe, me çka ato ishin kthyer në besim të përhershëm, që u duheshin të gjitha veprave për të përfunduar me sukses, i cili pashmangshëm nënkuptonte ngadhënjimin mbi të ligën...

„Koha e urrejtjes dhe zbrazjet e saj të tmerrshme sikur nuk kishin pasur të ndalur andejpari, por njëherësh edhe dashuria nuk kishte reshtur ta mbronte shpirtin nga fatkeqësitë dhe të ligat që i vinin herë nga njëra anë e herë nga tjetra..."

Mbase, edhe përpjekjet e pandërprera për mbijetim të thjeshtë kishin qenë pjesë e ndijimit të asaj dashurie të pafundme që kishte ruajtur frymën e vet edhe atëherë kur ishte dashur të kalohet nëpër rrethanat e vazalitetit të gjata dhe të pushtimeve, të cilat kishin kërkuar sjellje të dyfishtë dhe ç'nuk kishin kërkuar për t'u ruajtur vazhdimësia dhe ajo shtysa e përhershme e ndijimit të fuqisë së hyjit, e cila vepronte qoftë edhe e pavetëdijshme për ta ushqyer qenien?...“

Me atë „sjellje të dyfishtë“, me të cilën ruhej vazhdimësia e qenies dhe e qenësisë, Zonja von Braun kishte nënkuptuar pranimin e besimit, por pa iu përfillur ndasitë, pa iu njohur përjashtimet, pa iu pranuar ajo që quhet luftë e njërit zot kundër tjetrit dhe që bëhet në emër të atij të veçantit, pra „më të mirit“, i cili përcaktohet nga fitimtari, e kështu me radhë, që ajo i kishte quajtur „pjesë të ndijimit të hyjit dhe të ruajtjes së lidhjeve me të“, me çka mrekullisht brendapërbrenda asaj dhuntie kishin bashkëjetuar besimet, ku njëri kryq me tjetërin, (më vonë madje edhe gjysmëhëna, si dhe rrymime të tjera të ardhura nga Lindja), ishin strehuar nën të njëjtën çati, pa ndodhur të përçanin e të përçaheshin, pa ndodhur të ndanin dhe të ndaheshin dhe të ktheheshin në grindje dhe gjakderdhje. Kjo kishte qenë prova më e madhe dhe më e rëndësishme e asaj që ajo e quan „dëshmim të mrekullueshëm të ndijimit të dashurisë edhe në rrethanat më të vështira dhe për shumëkënd të pakapshme..."

Duke ndjekur gjurmët e kësaj bashkëjetese të mrekullueshme të besimeve, të kushtëzuar nga ndijimi i veçantë i dashurisë dhe dhuntia e saj, Zonja von Bran në një pjesë që e quan „*Letra nga Ulpiana*“, thotë se „*Orakulli i pavërejtur i dashurisë*“ ishte shfaqur e rishfaqur si përfitim njëherë në njëqind vjet andej ku shtriheshin fushat e pafundme të Dardanisë për t'i përsëritur porosinë e dashurisë, të cilat ishin përhapur si lulëkuqe dhe ato kishin mbrojtur nga urrejtja..."

Pa sqaruar se a ishte fjala për ndonjë legjendë apo diçka të ngjashme, me të cilat ajo botë ishte plot e përplot, thotë se edhe më tutje „lulëkuqet e Dardanisë shpërthejnë, jo krye çdo qindvjetori, siç ishte dikur, por çdo pranverë, për të vërshtuar hapësirën e saj mrekullisht, që të mbrohet dashuria nga e keqja e urrejtjes, e cila asaj bote thuafe pandalshëm i vjen nga të gjitha anët..."

Më tutje ajo shpjegon se lulëkuqet e Dardanisë nga vendasit shikohen si lule të shenjta, ndërsa nga pushtuesit si shenjë armiqësie, gjë që ato, në një rën anë janë parë si shenjë e veçantë shprese, ndërsa nga ana tjetër, janë shikuar me mosbesim dhe është kërkuar të zhduken.

„Po endem nëpër një mjegull të dendur skaj asaj fushe të pafund të lulëkuqeve, në të cilën dikur për herë të parë është provuar urrejtja më e madhe njerëzore e ardhur nga Lindja dhe Perëndimi kundër dashurisë...”

Ndiej sikur skaj asaj fushe të madhe të lulëkuqeve edhe më tutje shtrihet ajo frymë që nuk ka dashur ta pranojë urrejtjen e madhe me të cilën duhej të vritej dashuria e madhe, ajo e cila buronte nga ndijimi i hyjit...

Ajo frymë nuk pajtohej që në emër të urrejtjes të vritet dashuria, siç nuk pajtohej që dashuria të mbetej peng i urrejtjes...

Ajo frymë nuk pajtohet që dashuria mund të qëllohet ashtu nga urrejtja dhe nga zbrazjet e saj të tmerrshme...

Ajo frymë nuk pranon se ia vlen të vdiset për urrejtjen dhe thirrjen e saj kundër dashurisë, pa marrë parasysh se me çfarë mashtrimi bëhej, kur duhet të jetë e kundërta, pra të jetohet për dashurinë dhe kundër urrejtjes.

Fryma e asaj thirrjeje, që shpërndahet nga brezi në brez, nuk do të ishte e tillë pa ndijimin e porosive të *Orakullit të pavërejtur të dashurisë*, që shfaqej te lulëkuqet dhe flet me praninë e tyre.

Para se të kthehej në lulëkuqe, *Orakulli i pavërejtur i dashurisë* rrinte në Dardani dhe këshillonte ditë e natë për domosdonë e ndijimit të dashurisë dhe ruajtjen e përhershme të gjuhës së saj. Më vonë erdhën legjionet perandorake dhe pasi ia rrënuan faltoren, e masakruan dhe menduan se me këtë kishin arritur atë që dëshironin.

-Nuk do të shpërndash më mashtrim dhe helm, i thanë me mburrje.

Orakulli dardan megjithatë nuk treti përgjithmonë. Këshillat e tij u kthyen në tinguj, u kthyen në shushurimë uji, u kthyen në puhizë ere dhe, mbi të gjitha, u kthyen në lulëkuqe, të cilave rrënja u përtërihej çdo njëqind vjet nga shkaku se legjionet perandorake, aty ku ato shfaqeshin me dhunë, shpopullonin vendin, ngaqë ua dinin porosinë...”

Në atë shkrim, Zonja von Braun edhe më tutje do të ndjekë gjurmët e *Orakullit të pavërejtur të dashurisë* për të treguar shfaqjen e fundit para se fryma e tij të kthehej në lulëkuqe.

Pasi ia rrënuan faltoren, pasi rrënuan të gjitha kështjellat e Dardanisë, pasi shkatërruan të gjitha veprat që ishin krijuar me mundin dhe përkushtimin e madh të gjeniut krijues të njeriut të lirë, pra kur dukej se shpirti i antikës ishte shkatërruar njëherë e përgjithmonë bashkë me atë që quhej ngatërresë e shumë zotave dhe mashtrim i hyjit, *Orakulli i pavërejtur i dashurisë*, në kohën kur legjionet e pafundme perandorake kishin nxirë fushat përreth Ulpianës dhe në kullat e saj tashmë kishin ngritur flamujt e bardhë me kryqe të zeza, papritmas do të shfaqej në qendër të Ulpianës dhe do të nisë të flasë se nuk ishte shuar as mundur besimi te hyji, se lidhja me të do të thoshte mbrojtje e lirisë...

Orakulli i pavërejtur i dashurisë do të thotë se librat e mbyllur ishin libra urdhrash me të cilët ndalohej dashuria dhe hapej urrejtja, domethënë se njeriu nuk ka kurrfarë arsyeje të ndihet i mëkatshëm e as pjesë e mëkatit të zanafillës, por pjesë e asaj dashurie të madhe që i vjen ng perëndesha dashuri...

Me porositë e vazhdueshme thoshte se nuk duhej të hiqej dorë nga fryma e hyjit dhe ndijimi i saj, se asaj duhej kthyer përherë, pa marrë parasysh ato që thuheshin rreth barazisë, rreth mëshirës dhe premtimeve të tjera që vijnë nga të katër anët, me të cilat qenia njerëzore shihet poshtë, dëshirohet të mbahet poshtë, të mbikëqyret poshtë dhe të përdoret poshtë e më poshtë dhe kjo të bëhet kinse për qëllime të larta të përshtypjes dhe për hire të tjera, të cilat përhapen si thashetheme të frikshme...

Si në kohën e ligjërimeve të dikurshme të lira, tha se nuk duhet harruar prirjen e përhershme të ngritjes lart e më lart në kërkim dhe ndijim të krijesit dhe kjo do të thotë dashuri e madhe, pa të cilën nuk mund të ketë as liri të madhe dhe as qenie të lirë...

Kur e kapën dhe e ngulën në heshta dhe pasi e lidhën për kryqi filluan ta qëllonin nga të gjitha anët, *Orakulli i pavërejtur i dashurisë* përkrahësve të shumtë u tha se nuk duhej ta qanin, por ta adhuronin...

Tha se porositë dhe gjithë ato, të cilat lidhen me shpirtin e lirë dhe me frymën e dashurisë do t'ua kthente në lulëkuqe, të cilat, kur t'i shihnin, kur t'i kishin përpara si det të pafund purpuri, ta ndienin fuqinë e dashurisë me të cilën i bëhet ballë egërsisë detyruese të urrejtjes dhe të ligave të tjera, të cilat ua predikojnë përditë si porosi që vijnë nga librat e shenjtë...

U kishte thënë se kur t'i shohin lulëkuqet nëpër fushat e tyre duhet ta dinë se në to shfaqet fryma dhe porositë e tij për dashurinë e përhershme, bashkë me shpresën, të cilën nuk duhet humbur kurrë..."

Në „*Letrën nga Ulpiana*“, Zonja von Braun, gjithnjë duke përshkruar një bredhje nëpër një mjegull, të ngjashme me atë fantazmën e kalorësit të pandalshëm që çan natën e pafund për ta arritur dritën shëruese diku në largësi, do ta përshkruajë hyrjen në Ulpianë, të cilën do ta quajë „tempull të dashurisë“, ku thotë se është sprovuar pandalshëm dhe përherë dhe ka dhënë dëshmitë më të fuqishme...

„Për ta dëshmuar epërsinë e madhe ndaj atyre që e ndiqnin dhe me varrosjet e zhvarrosjet që ia bënin dëshironin ta tregonin të mundur përgjithmonë, pjesë të atij mashtrimi të madh, e kështu me radhë, *Orakulli i pavërejtur i dashurisë* shfaqej sërish në Ulpianë krye njëqind vjetësh dhe sërish fliste ato fjalët për hyjin, fliste të njëjtat fjalë për lirinë e besimit që përjashton detyrimin për të besuar, me të cilin njeriu mbikëqyrej dhe përdorej prej atyre, të cilët ushtronin pushtet dhe dhunë në emër të librave të shenjtë, fliste për dashurinë dhe lulëkuqet, edhe pse sërish pasonte kryqëzimi i përgjakshëm sy botës dhe varrosja e fshehtë. E gjithë kjo bëhej që mos t'i faleshin varrit të tij...

Por, në kohën e masakrave të mëdha që bëheshin ndaj atyre të cilët nuk hiqnin dorë nga ndijimi i hyjit dhe kultet, të cilave edhe më tutje u faleshin, *Orakulli i pavërejtur i dashurisë* befas ishte shfaqur aty ku ishte vendosur kufiri i ndarjes së kishave e librat e shenjtë tashmë luftonin njëri-tjetrin dhe kjo kishte ndodhur pa u bërë qindvjetori nga paraqitja e fundit.

- Keni dashur ta vrisni dashurinë, u kishte thënë atyre që e kishin rrethuar dhe bënin çmos t'ia ndalonin fjalën.

- E keni nxitur urrejtjen dhe këtë e keni bërë në emër të librit të mbyllur, me të cilin kërkohet robi, kërkohet i dëgjueshmi, kërkohet përkulja dhe i përkuluri, kërkohet shërbëtori, i cili është në gjendje të futet edhe në flakë me mashtrimin e parajsës dhe nga ato që i thuhet rreth jetës së përshpirtshme...

Ndjekës të shumtë më kot ishin munduar ta pengonin të fliste. Edhe pse e kishin qëlluar nga të gjitha anët, edhe pse kishin bërë çmos që para masës të mos i dëgjoheshin ato që fliste, fjalët e tij jehonin në të gjitha anët sikur të ishin të pandalshme...

Pasi kishte folur e folur dhe kishte thënë ato që i kishte përsëritur çdo krye qindvjetëshi, edhe pse i lidhur dhe i mbërthyer për kryq, ia kishte dalë të lirohej.

- Jam pjesë e dashurisë, u kishte thënë ndjekësve.

- Dashuria as nuk lidhet as nuk vritet...

- Jam pjesë e dashurisë...

- Urrejtja juaj nuk më bën gjë...Veçse më forcon...

- Jam pjesë e dashurisë...

Me fjalët, se edhe më tutje fryma e tij mbetej te lulëkuqet e Dardanisë, kishte tretur...

Thuhet se në hapësirën e sheshit të Ulpianës jehona e këtyre fjalëve kishte mbetur derisa kishte ardhur pranvera dhe fushat përreth ishin mbushur me lulëkuqe, që dukeshin si një det i pafund purpuri...

Po ashtu thuhej se jehu i këtyre fjalëve nuk u ishte ndarë edhe ndjekësve gjithë derisa shumë syresh ishin çmendur, sa nga frika e tmerrshme prej një krijese që herë dukej e herë nuk dukej dhe ishte në gjendje t'i shpëtonte edhe kryqëzimit më të egër, por edhe nga ato që kishin dëgjuar rreth dashurisë dhe ndijimit të saj, të cilat u ishin qepur sa më shumë që i kishin marrë si një thirrje, të cilën nuk kishin pasur guximin ta përdhosnin nga shkak i frymës së herezisë..."

Zonja von Braun tregon se përfytyrimi i *Orakullit të pavërejtur të dashurisë* me ato që thoshte për *librin e hapur* dhe ndërlihdjen e drejtpërdrejtë me krijuesin, që duhej bërë me anën e ndijimit shpirtëror dhe jashtë çfarëdo urdhrash, të cilët besimin e kthejnë në detyrim dhe përcaktohet nga ata që kanë përçarë dhe kanë ndarë zotin në shërbim të forcimit dhe të ushtrimit të pushtetit mi njerëzit, kishte vazhduar të shfaqej nga koha në kohë, nga vendi në vend. Ndonëse ishte ndjekur edhe me më shumë tërbim. Ndonëse ishte quajtur pjesë e herezisë së tmerrshme, e kështu me radhë dhe se ndikimi i tij kishte qenë aq i madh e aq i fuqishëm, sa që më vonë ia kishte dalë mrekullisht t'i pajtojë zotat dhe besimet brenda të njëjtës çati dhe nuk kishte qenë tjetër përveçse frymë e *perëndeshës dashuri*, e bartur brez pas brezi, pa marrë parasysh rrethanat tepër të vështira, të cilat kishin rënduar mbi ta...

Shkrimin e kishte mbyllur me vlerësimin:

„Ata që njëherë i prek fryma e dashurisë, nuk i ndahen më atij ndijmi të lartë..."

Në shënimin „*Letër nga Dukagjini*“, Zonja von Braun sikur ishte e prirë që përfitim e porosive të *Orakullit të pavërejtur të dashurisë* (më vonë do ta quajë edhe pjesë e frymës së *perëndeshës dashuri*), të asaj e cila dikur në lashtësi u kishte shërbyer perandorive si themel shpirti, ta shohë si pjesë të qenies dhe të qenies, të asaj e cila është në gjendje t'u bëjë ballë të gjitha rrëtimeve, të gjitha të ligave, pa marrë parasysh përmasat e tyre, dhe të rikthehet edhe atëherë kur duket se urrejtja ia ka dalë të vendosë pushtetin e saj të përhershëm, nga edhe del porosia:

„Këtu nuk vdiset edhe kur duket se asaj nuk mund t'i iket...Këtu jetohet edhe kur duket se pushteti i dhunës është i jashtëzakonshëm sa të nënshtrojë çdo gjë e, kjo ndodh pikërisht nga ndijimi i përhershëm i dashurisë së madhe..."

Se e gjitha ishte pjesë e një bindjeje të thellë që nuk kishte si të mos lidhej me porositë e *Orakullit të pavërejtur të dashurisë* dhe të atij ndijimi për frymën e dashurisë, në „*Letër nga Dukagjini*“ sillet një lloj bisede thujse e papërcaktuar e mbretit ilir Glauk me një shtatore të rrënuar, e shpëputur dikah (pa dhënë sqarime), e bërë diku në afërsi të *Kështjellës së Hijës*, pikërisht andej nga kishte bredhur edhe Koloneli në çastet e fundit në pritje të atij plumbi, i cili do t'ia gjejë kokën ditën e njëzetepetë të mbylljes në teqenë e Leqes:

- Ku më mbeti Kështjella? - foli Glauku i dëshpëruar.

- Ku?...

- Kuuuuuu?...

- Ta shembën, i tha një zë që sikur i vinte nga brendia. -Ta shembën deri në themel...Nuk e sheh këtë, vallë?...

- Ajo nuk ishte si çdo kështjellë tjetër dhe nuk mund të shembej, meqë themel kishte në shpirtin e mbushur me dashuri, foli Glauku.

- Ishte urrejtja më e madhe se dashuria, i tha zëri që i vinte nga brendia.- Ajo ishte e pandalshme, ishte e pasosme...

Pas atyre që tha dëgjoi një të qeshur kredhëse që hapej jehonë anembanë vendit. Qeshja shpejt u kthye në një krakëllimë sa ai mori ikën.

Iku e iku dhe në atë ikje kërceu ditët dhe kërceu netët, kërceu stinët dhe kërceu mote të panumërta, por ngado që kaloi takoi rrënoja dhe kufoma të shumta, të cilave u rrinin korbat përmbi...

Dikur e la forca. Mbeti në një hapësirë gjysmënebuloze, që iu bë se ishte e tillë për t'ia fshehur Damastionin e dashur...

- Edhe ai qenka rrënuar, oshtiu Glauku dhe deshi t'i afrohej qytetit, por ishte mjegulla lozanjare që po ia ngatërronte rrugën. Dikur mjegulla u ngrit pak, por hetoi se ishte në një pirg, nga nuk mund të lëvizte.

- Do të vdes këtu në kërkim të dashurisë së madhe, sepse vetëm ajo bën të mundur rikthimin dhe ribërjen, atë që shpi drejt majave-pëshpëriti dhe nuk diti pse kërkoi Mounin t'i ndihmonte të lirohej nga ai ngujim, kur mendja ia thoshte se edhe ai tashmë ndodhej nën gërmadha...

I bindur se nga ajo mynxyrë nuk do të shpëtonte ndryshe veçse me kërkimin e dashurisë së madhe, asaj që është shtysë e së mirës, mbylli sytë dhe deshi t'i jepej kërkimit të saj.

Por, ndodhi që pikërisht atëherë kur ndihej i çekuilibruar, sesi vërejti që kishte zbritur nga pirgu, se po lëvizte dika drejt një sheshi të madh dhe fare të qetë, se andej nga shkonte nuk kishte mjegull as errësirë, përveç një fashe të lehtë, që gjithë hapësirës i jepte një ndriçim të zbehtë, i cili e joshte tej mase...

- Mbase paskam fjetur shumë, njëqind apo mijëra vjet, deshi të thoshte dhe ishte i bindur se ishte kohë e papërcaktuar, e futur në mes, kush e di se kur, si mjegullim, që e kishte ndarë nga rrjedha e ngjarjeve, të cilave duhej t'u kthehej dhe t'ua gjente fillin...

Por, shpejt u bind se ndodhej fare i pafuqishëm jashtë kohës dhe se ato që i shfaqeshin ishin vetëm pjesë të përfitimeve mashtruese...

Me ndjenjën e të përhumurit, zuri të sodiste hapësirën gri dhe ishte i bindur se ajo ngrirje do ta fuste në akullsi të përhershme, por pikërisht atëherë kur i bëhej se kishte humbur çdo shpresë, ndieu një lëvizje të lehtë, e cila pak e nga pak po e prishte qetësinë absolute.

Së pari iu bë se dëgjoi disa si hapa të lehtë e më vonë një zë të rëndë kumbues, që i vinte i njohur, por për një çast denjoi se mbase burim i asaj lëvizjeje dhe i atij zëri ishte vetë...

Nga ai ngatërrim u lirua kur pa se dikur përpara iu shfaq një funeral i çuditshëm që bartte arkivole të bardha. Funerali nuk kishte fund as fillim dhe pareshtur sillej në shesh...

- Ç'mortje paska ndodhur, tha?

- Ç'mynxyrë paska sjellë kaq shumë vdekje, oshtiu Glauku dhe deshi t'i afrohej funeralit, por sërish ndjeu se ishte i mbërthyer...

Megjithatë, ndanë mbrëmjes, funerali treti si të mos ishte, ndërkohë që në shesh mbetën arkivole të shumta dhe vetëm kur hëna lëshoi disa rreze të sedefta dhe ia prekën bebëzat e syrit, hetoi se ishte zbërthyer, por e gjithë kjo i krijoi bindjen se ishte pjesë e asaj vdekjeje, se përnjëmend kishte vdekur qëmoti dhe kjo kishte ndodhur para shumë e shumë shekujsh, sa bile iu kujtua edhe viti që kishte tre tresha, iu kujtua edhe ajo lufta afër Damastionit, iu kujtua edhe shpata e Aleksandrit të Madh si ia pat shpuar kraharorin, iu kujtua që të mbytur në gjak mezi e kishin bartur Taulantët deri te Qerrja e Diellit...

- Më ktheu ndijimi i dashurisë së madhe, ajo fryma që përherë mbetet e pashueshme dhe pret ndërlidhjen, tha.

Me fjalët ngoje për dashurinë dhe për frymën e saj të pashueshme iu afrua arkivoleve që ta shpërndante atë kudo. Kur hapi të parin hetoi se ishte plot e përlot me libra.

- Ç'është kjo, vallë - tha dhe duart e tij të thata i prekën fletë dhe kopertina të shumta të këputura dhe të ngatërruara.

- A thua, të vdekurit qenkan kthyer në libra?

Edhe në arkivolin e dytë kishte libra. E, libra, bashkë me teste dhe shumë e shumë pergamenë dhe karta të ndryshme hasi thuajse kudo që prekte. Ca prej tyre ishin të grisura, ca të përshkëllira, e ca të ruajtura mirë.

Në arkivolin e fundit pa një shtatore të madhe prej mermeri të kuqërremtë, e tëra e plasaritur. Ndonëse e gjymtuar, pa njërën dorë dhe pa disa pjesë të tjera, iu bë se shtatorja po merrte jetë dhe nga sytë e dëmtuar, kush e di se kur, po flakëronte një shikim i butë. Bile, iu duk se atë shikim e njihte, se e kishte takuar sa e sa herë dhe se e kishte shoqëruar gjatë, shumë gjatë madje...

- E dija se do të më gjeje - i thotë shtatorja-e dija...

Glauku mend brofi nga shqetësimi. Por, shikimi i butë i saj e ndali.

- Më ka shpëtuar dashuria- i tha. -Ndijimi i saj i bën ballë çfarëdo urrejtjeje, pa marrë parasysh shpërthimin e saj.

Glauku kurrresi t'u besonte syve. Deshi të thoshte diçka për vdekjen dhe atë kohën që u kishte hyrë në mes, por ishte zëri i shtatores që e ndërpreu:

- Këtu nuk vdiset edhe kur duket se asaj nuk mund t'i iket...Këtu jetohet edhe kur duket se pushteti i dhunës është i jashtëzakonshëm sa të nënshtrojë çdo gjë. Kjo ndodh pikërisht nga ndijimi i përhershëm i dashurisë së madhe...

X

„Ndijimi i dashurisë së madhe“, kjo nuk mund të jetë tjetër përveç „pjesë e ndijimit të urrejtjes së madhe me të cilën mbrohet dashuria“, kishte pëshpëritur Skulptori sa herë kishte lexuar ato që Zonja von Braun i lidhte me Kosovën dhe bredhjet e saj në ndjekje të përfytyrimeve të Kolonelit që ishin shtrirë nëpër atë hapësirë për të përfunduar atje ku edhe pritej.

Dhe, kur gjykonte kështu, mendja i thoshte se „vetëm aty ku ishte përjashtuar urrejtja mund të kishte vend për zotat që pranonin krijuesin e përbashkët pa u luftuar mes veti“, ku edhe kryqi dhe gjysmëhëna dhe çkado qoftë tjetër të merreshin si pjesë e frymës së dashurisë së përbashkët dhe nxitje për kërkimin e saj, e gjitha pra do të thoshte pranim i urrejtjes së madhe kundrejt përkufizimit të dashurisë, kundrejt pengesës që i bëhej asaj, në emër të parimeve të dashurisë dhe kështu me radhë...

Ndonëse me vështirësi të mëdha, të cilat ia shkaktonte barra e vetmisë së thellë dhe ato zbrazje-mbushjet e pandalshme me vetveten dhe kundër vetvetes, me të cilën mendohej ta shpupuriste disi atë gjendjen as gjallë as vdekur, Skulptori ndiqte fijet e atij gjykimi sikur të kishte para Zonjën von Braun, me ç'rast hapej shqyrtimi, të cilit i duhej edhe e kundërta dhe, ndonëse çonte tek e njëjta, fliste për atë që edhe ai udhëtimi drejt fundit, të cilit moti i ishte dhënë dhe assesi të mbaronte, nuk ishte as i thjeshtë e as i njëtrajtshëm, pa marrë parasysh se i tëri i ishte dorëzuar frymës së urrejtjes dhe hakmarrjes me bindjen se ashtu do të përmbushte qëllimet e përcaktimit, që e merrte për të drejtë dhe të domosdoshëm.

„A sheh se edhe të urresh nuk është gjithaq lehtë... Mbërthimi i saj me mllafe dhe ngarkesa të tjera, që vazhdimisht kërkojnë shpërthim, është një vetëdëmtim i rëndë dhe i papërballueshëm, është vetëdënim i pandalshëm...“, i thoshte ajo.

„Ç'e do, kur ndijimi i dashurisë së madhe dhe nevoja e përmbushjes me të mundësohet vetëm me ndijimin e urrejtjes së madhe...Ndryshe nuk bën...“, ia kthente ai.

„Ndijimi i dashurisë së madhe mundësohet vetëm me përjashtimin e urrejtjes së madhe...Kjo duhet të kihet parasysh përherë...“, fliste ajo.

„Nëse përjashtohet urrejtja, atëherë shuhet edhe dashuria e njëmendtë, ajo që ushqen shpirtin me shpresë...“, ia priste ai.

„Përkundrazi, ashtu ajo bëhet edhe më e fuqishme...“, ndërhynte ajo.

„Ligjërimi për dashurinë, pa ngacmimin e urrejtjes ndaj vrasësve të dashurisë, sikur kthen te mirësia, te mëshira dhe ato që e shpenzojnë dashurinë...“, ia kthente.

„Dashuria dhe urrejtja nuk shkojnë bashkë...“, i thoshte ajo.

„Mund të mos shkojnë, por ato janë të ndërlidhura, të ndërvarura...“, ia kthente.

„Ato përjashtohen...“, këmbëngulte ajo.

„Në atë që merret si përjashtim, ato ndihmohen, plotësohen...“, vërente ai.

„Ashtu luftohen...“, kundërshtonte ajo.

„Përkundrazi, ndodh që ai sqarimi i domosdoshëm, shpien te afria, te e vërteta...“, ia kthente.

„Leri proçkat, or...“, thoshte ajo.

„Në këtë ndeshje ndodh ajo që dashurisë ia heq mashtrimin e urrejtjes dhe urrejtjes ia heq mashtrimin e dashurisë...“, sqaroi ai.

„Mllef i urrejtjes ta ka ngatërruar mendjen sa të mos dallosh gjë prej gjëje...“, sikur e qortoi ajo.

„Po si do të shpjegohej ajo dashuria e madhe, që thuhet se ka penguar përçarjen e zotave, sa në të njëjtën çati të bashkëjetojnë kryqi dhe hëna, pos ndjenjë e thellë urrejtjeje ndaj asaj përçarjes së zotave dhe mospranimi të mësimëve që kanë ardhur si urdhra me të cilët është dashur të përjashtohet ndijimi i hyjit dhe ato të cilat i kanë takuar lirisë së shpirtit?...A do të ishte e mundur kjo mrekulli pa ndjenjën e urrejtjes ndaj asaj së keqeje që ka përçarë dhe vazhdon të përçajë shekuj me radhë dhe është pjellë e të gjitha fatkeqësive...?“, i drejtohej ai.

„Shpërfillja e diçkaje nuk do të thotë urrejtje...Ajo është çështje e mbrojtjes, e cila vihet në veprim pa rrënuar gjë...“- fliste ajo për të shtuar se - „aty zaten qëndronte ndryshimi midis dashurisë, si krijim i përhershëm i së mirës që shpie në përmbushjen e idealit, dhe urrejtjes, si rrënim i përhershëm...“

„Rrënimi i së keqes është pjesë e krijimit të së mirës, apo jo...? Kjo duhet parë dhe vlerësuar drejt...“, vërente ai.

„Lëri rrënimet, ktheju ndërtimeve...“ - sikur e këshillonte ajo. -“Ato i bën të mundshme vetëm dashuria e thellë dhe e përhershme...“

„Ta lësh qetë të keqen të veprojë e të veprojë, derisa t’i përmbush qëllimet e veta dhe këtë ta bësh duke u shtirë se kjo mund të merret dashuri, s’të duket që fut ujkun në vathë...?“, ndërhynte ai paksa rrëmbyeshëm.

„Mjafton t’i kthehesh të mirës dhe shtrirjes së saj për ta parë dallimin midis të kundërtave, si gjendje të ndryshme...“, ia kthente ajo.

„Shpirti i vrarë kërkon hakmarrje dhe këtë ia mundëson vetëm ushqimi i pareshtur i urrejtjes ndaj vrasësve të dashurisë...“, thoshte ai.

„Dashuria nuk njeh hakmarrjen dhe kjo është fuqia e saj kryesore. Betimi i dashurisë është ndërtimi i të mirës, ngritja e përhershme, qëllimi, majat...Ajo nuk ndalon gjë përveç urrejtjes dhe hakmarrjes...Nuk përkufizon gjë përveç mospranimi të kufizimit...“, ia kthente ajo.

„As urrejtja nuk ndalon gjë...Rroftë urrejtja që bëhet për ta shpëtuar dashurinë...!“-brohoriti ai si të ishte ndonjë gazmend të madh.

„Pse nuk thua rroftë urrejtja kundër urrejtjes?...Mbase do ta kesh më të lehtë...?“, i drejtohej ajo.

„Do të ishte njësoj sikur të thuhej: rroftë dashuria pa dashuri...!“, ia kthente ai.

Fjalët për urrejtjen që bëhet për ta shpëtuar dashurinë sikur i ngjanin në përmbysje, të cilat, sa më shumë që i shqiptonte aq më tepër ia pasqyronin përmasat e shembjeve në të cilat kishte sharruar saqë i dukej se ashtu shkonte drejt atij fundi dhe hiçi, i cili gjithnjë më shumë i pasqyrohej si një zhytje në mjegullim të thellë të askundjes së pafund, ku çdo gjë i nënshtrohej njëfarë heshtjeje trishtuese dhe zhbërjes.

Që t’i shmangej kësaj përhumbjeje të trishtë, nganjëherë seç i qepeshin ato që i bëhej se ia kërkonte Zonja von Braun për thirrjen e urrejtjes kundër urrejtjes dhe që i fliste se pastaj do ta kishte më të lehtë...

Mendja ia thoshte se pranimi i urrejtjes kundër urrejtjes jo vetëm nuk i ndihmonte për të dalë nga ai labirinti, në të cilin ishte mbyllur përgjithmonë, por as nuk do ta ngushëllonte,

ngaqë do t'ia rrëmbente dufin e hakmarrjes, e vetmja që i kishte mbetur në ato rrethana tragjike me të cilën ushqehet pareshtur, ku ajo flaka e shuar e kryengritjes së Kosovës, e strukur diku në malet e saj, i ndizej e i përndizej për ta djegur botën, por sikur vonohej pafundësisht ta ndezte të tërën, ashtu si e meritonte.

Dhe, kur nxirrte thirrjet përçapëse për flakën e Kosovës dhe domosdonë e ndezjes dhe të përndezyes së saj, me të cilën ishte ushqyer thujse pareshtur gjatë vetmisë së asaj vetëmbylljeje prej gjashtë vjetësh dhe tetë muajsh, kishte parasysh Versajën dhe prishjet e saj të tmerrshme, të cilat nuk kishin kufij... Kishte parasysh po ashtu edhe ato rrëtime të pandreqshme, të cilat ishin kthyer në një mallkim të përgjithshëm, të ngjashëm me atë që kishte përfshirë Shqipërinë e katërmbëdhjetës, të cilat nuk mund të kapërceheshin ndryshe përveç me një flakë të përgjithshme, siç ishte ajo e Luftës së Parë Botërore, dhe me gjithë zemër e kishte uruar Shqipërinë të lirohej nga vetëngrënia, në të cilën kishte rënë. Ngjashëm mendonte edhe për mbarë botën – se për t'u liruar nga dufi i më të keqes që ia kishin sjellë prishjet e atyre marrëveshjeve, të cilat sa vinin e thelloheshin, i duhej një luftë e madhe, të cilën ishte në gjendje vetëm flaka e Kosovës ta vinte në veprim...

Në atë terrinë të thellë, në të cilën i bëhej se përfshihej dhe sharronte gjithë bota, vetëm përfytyrimi i flakës së Kosovës, të cilën e shihte të shpërthente si një vullkan i madh që shkrumonte çdo gjë para vetes, ia ndalte pak zhytjen drejt askundjes, ku e dinte se pashmangshëm do të bëhej pjesë e asaj hiçësie trishtuese...

Me mendimet se „vetëm flaka e Kosovës shpëton“, se vetëm ajo ishte në gjendje ta prishte atë farë ndreqjeje të Versajës dhe gjithë ato të liga që kishte sjellë dhe vazhdonte të sillte pareshtur, kridhej e kridhej për të gjetur qoftë edhe për pak çaste njëfarë prehjeje të lehtë, e cila i duhej aq shumë, por e gjitha i prishej nga njëfarë ndërhyrjeje shushuritëse, e cila i dukej se i vinte nga Zonja von Braun dhe, për t'ia zgjatur agoninë, i thoshte se „vetëm dashuria e Kosovës shpëton“, e cila ndonjëherë i tingëllonte se si „vetëm dashuria shpëton Kosovën“, porosi kjo e përhershme, ose porosi këto të përhershme, e cila nuk i ndahej dot, ose që nuk i ndaheshin dot as atëherë kur kishte bindjen se i ishte afruar kotësisë së atij fundi, që nuk mund të ishte tjetër veçse e tillë.

„Pse po më mundon...“? - përçapej thujse me dëshpërim sikur të kërkonte t'i merrnin fund mendimet.

„Po të ndihmoj...“

„Ka një mijë vjet, ndoshta gjithmonë që më flet njësoj...“

„Të duhet qartësia, apo jo...“?

„Më duhet flaka, ajo flaka që do ta ndizte botën... Vetëm ajo ma ngroh shpirtin... Vetëm ajo më shpëton...“

„Të duhet dashuria...“

„Më duhet urrejtja... Më duhet mllefi i saj... Më duhet Kosova...“

„Kosovës i duhet dashuria...“

„I duhet flaka... Siç më duhet mua... Siç i duhet gjithë botës... Apo jo...“?

Me flakën e Kosovës në mendje, të mbetur si ngjizje e asaj çirrijeje të thellë, e cila nganjëherë assesi t'ia lirohej prej gojës, Skulptori kishte numëruar ditët e fundit të vetmisë prej gjashtë vjetësh dhe tetë muajsh që e kishte nga vetëmbyllja, së cilës i ishte dhënë çastin që kishin përfunduar ato bisedat e përditshme telefonike prej nëntë vjetësh e nëntë ditësh me Zonjën von Braun dhe kjo kishte ndodhur ditën e fillimit të asaj Luftë të Dytë Botërore të madhe, të cilën ai do ta presë dhe do ta përcjellë në atelienë në Rudolfsplatz, ashtu deri në mëngjesin e nëntë të atij maji me rreze vezulluese dielli, kur në Ballplatz shikimi i mekur fare për herë të parë dhe të fundit do t'ia kapë ushtarët sovjetikë si marshonin me flamuj të kuq në dorë, që pasi kishin përdhosur emblemën e fundit të Habsburgëve të mbetur në ndërtesën perandorake, çirreshin me ato këngët për botën proletare, me çka një muzg i papërballueshëm në sy dhe një pikë ndriçimi në kokë kishin paraqitur shqitjen e pandalshme në zhytje të asaj

përhumbjeje, së cilës i ishte dhënë pa qenë në gjendje me asgjë ta parandalonte sharrimin nënçmues të asaj shuarjeje...

Por, para se të vinte ai çast, të cilin e kishte pritur moti dhe kishte uruar të ishte në përputhje me përcaktimin për frymën e urrejtjes, ku çdo gjë do të merrte fund me atë ndezjen dhe përndezen e flakës së kryengritjes së Kosovës të mbetur diku në malet e Drenicës, që do ta përfshinte gjithë botën për ta bërë shkumb e hi dhe e tillë të mbetej përgjithmonë si dënim nga marrëveshjet e Versajës dhe prishjet e mëdha dhe të pandreqshme të ardhura prej tyre, pra ajo ditë, e cila ishte e nënta e majit, për Skulptorin megjithatë do të fillonte ndryshe nga të tjerat prej gjashtë vjetësh dhe tetë muajsh, të cilat i kishte kaluar në terrinën e vetëmbjlljes, ku plotësisht kishte përjashtuar kohën dhe hapësirën, sikur të ishin të tepërta dhe të paqena fare, dhe kjo kishte mjaftuar t'ia fuste parandjenjen se ajo ditë, si e veçantë, sigurisht se do ta kishte edhe fundin që do ta dallonte prej pararendëseve saqë për një çast t'i jepte vetes të drejtën të dyshonte se mos e gjithë kjo e këtij fundi të pashmangshëm mund të lidhej me atë që Kolonelin e kishte shtyrë të thoshte „*po perëndoj si lajmëtar*“, fryma e së cilës edhe kishte përshkuar ato njëzet e dy shënimet e lëna në teqenë e Leqes në pritje të atij plumbi, i cili do t'i vijë si prej qiellit ditën e njëzetepestë, në ç'mënyrë shmangte kotësinë dhe nënçmimin e dështimit që të shkohej madje drejt një qëllimi madhor...

Kjo mëdyshe megjithatë nuk ishte në gjendje ta mbante dhe ta çorientonte me ndonjë përftim sado të vogël kuptimësie nga shkaku se Koloneli në të vërtetë edhe kishte perënduar si lajmëtar i asaj që quhet ide e bërjes së Shqipërisë Shqipëri, së cilës i duheshin perënditë dhe sakrifica të vazhdueshme bashkë me ato që do ta përcillnin gjatë e më gjatë për ta penguar qëllimisht atë bërje, pa përjashtuar vrasjet, të ligat dhe ato që prodhonte urrejtja e hapur kundër saj. Por mendja ia thoshte se ato nuk mund t'ia ndalnin jetësimin, pa marrë parasysh zvarritjen, pikërisht nga shkaku se ajo, së pari ngrihej si kërkesë madhore shpirti, si ideal, jashtë atyre prirjeve gjithfarëshe, me të cilat pavarësia shqiptare ishte shikuar si përfitim, me të cilin ishte ushqyer e keqja e brendshme dhe e jashtme dhe, së dyti, pse ajo shfaqej si kërkesë gjithëpërfshirëse civilizimi, e cila shtrohej prej tij aq bindshëm dhe me ngulm dhe, kur t'i shtoej edhe çështja e dashurisë, të cilën ia gërshetonte me aq përkushtim Zonja von Braun, shfaqej e pandalshme...

Ky farë kundrimi megjithatë nuk e kishte penguar të shikonte edhe atë „anën tjetër“, atë që lidhej me paraljamërimin e të perënduarit si lajmëtar, ku si pjesë të pandashme me të drejtë kishte „*zot-imin-Shqipëri*“ të Kolonelit dhe „*zot-imin-dashuri*“ të Zonjës von Braun, e, së këtejmi, pse të mos plotësohej edhe me atë „*zot-imin-urrejtje*“, pa të cilin nuk bën...

Tekefundit, a nuk ishin këto të tria preokupime që nëpër rrugë të ndryshme ndiqnin të njëjtin qëllim, ku fundi nuk paraqiste fund, por një vazhdimësi të natyrshme jetësore, në ç'mënyrë ajo vërtitja e përhershme Lindje-Perëndim dhe anasjelltas i shërbente vazhdimësisë, e cila quhet rilindje?...

A nuk kishin qenë ato bisedat prej nëntë minutash - të bëra çdo ditë me telefon gjatë nëntë vjetësh dhe nëntë ditësh, bashkë me përsiatjet e Kolonelit të shkruara në teqenë e Leqes në pritje të atij plumbi që do t'ia gjejë kokën ditën e njëzetepestë të mbylljes, si dhe Kujtimet e Zonjës von Braun, të cilat i kishin ardhur me postë tri ditë pas vdekjes dhe varrosjes ndanë liqenit - pjesë të atij shqyrtimi të pandalshëm drejt qartësimit, ku gjithsesi se bënte pjesë edhe përcaktimi i tij për urrejtjen, (të cilën e kishte lidhur me atë flakën e kryengritjes së Kosovës të mbetur diku në malet e Drenicës, të cilën me mendje e ndezte dhe e përndehte pareshtur si hakmarrje ndaj prishjeve që kishte shkaktuar Versaja dhe marrëveshjet e saj), që i duheshin dashurisë për të shpëtuar nga mashtrimet e mirësisë dhe hiret e tjera, të cilat i kërcënohen gjatë paqartësive të kohëve kalimtare dhe atyre që sjellin ato, të cilat jo rrallë përfundojnë me mashtrime tepër të mëdha...?

Kur e kishte ushqyer urrejtjen dhe ia kishte bërë me dije Zonja von Braun se vetëm ajo mund ta shpëtonte atë dashurinë e njëmendtë, nëse do të urreheshin vrasësit e dashurisë, a

nuk kishte ushqyer dhe mbrojtur dashurinë në mënyrën më të drejtë dhe më fisnike nga prishja e saj...?

Dhe, po të veprohej me të kundërtën dhe me atë që të drejtën e saj e kthen në kuptim, atëherë a nuk kishte qenë në të njëjtën anë me Zonjën von Braun dhe me Kolonelin, përkundër qëndrimeve të ndryshme që pasqyroheshin në përcaktimet: kush me domosdonë e idealit, kush me ndijimin e pafund të dashurisë, e kush me urrejtje ndaj vrasjes së dashurisë...?

Çuditërisht, atë mëngjes - që e kishte pritur me shqyrtime të hapura, të cilat i ishin dukur se nuk kishin ndjekur kahun e ashpërsimeve, të cilat kërkonin atë mbushje-zbrazje të rëndomtë të urrejtjes me vetveten dhe kundër vetvetes - kishte hetuar një rreze drite që i kishte depërtuar nga dika dhe kjo kishte qenë hera e parë që diçka e jashtësisë së përjashtuar me qëllim ia kishte dalë sadopak t'ua kthente përmasat e rëndomta gjësendeve, me të cilat kishte kaluar ato vite dhe që kjo, në vend se ta dëshpëronte, në vend se t'ia kthente atë neverinë që ndiente ndaj çdo gjëje që i takonte përditshmërisë dhe lidhjeve me të, për pak ia kishte kthyer ndjenjën e njëfarë afrie me ato që e kishin rrethuar, sa t'i dukej se po ia bënin me dije që ishin pjesë e tij, se pa të drejtë i kishte përjashtuar, se ashtu i kishte dënuar rëndë e më rëndë, e kështu me radhë, saqë për një çast madje i ishte bërë se disa nga punimet e lëna të pakryera kishin nisur t'i qaheshin dhe t'i thoshin se ndaj tyre kishte bërë një mëkat të pafalshëm...

Ato që i dukej se i thuheshin rreth mëkatit, i cili nuk falej, e që njëherësh ishte mëkat ndaj krijimtarisë, sikur nisën ta mbushin me një ndjenjë të veçantë, të ngjashme me fajësinë dhe, mbase do t'i nënshtrohej, po të mos ndiente dufin e urrejtjes që e kishte shtyrë të fliste e të fliste për rrënimin e shpirtit, porse, sa më shumë që kishte folur kishte hetuar se fjalët i kishte me një ngjyrim tepër të zbehtë dhe ato i vinin sikur të kërkonte falje në vend se të mbrohej, saqë për një çast iu duk se ishin pikërisht punimet ato që i thoshin se „urrejtja nuk kishte tempull“. Në një vërtitje të tillë të kësaj hamendje e gjithë kjo i ishte kthyer në bindje se megjithatë „dashuria kishte tempull“, mendime këto që i ishin sjellë vërdallë nëpër kokë dhe, sikur pa dashje gjithë këtë ia kishin ndërlidhur me ato që dikur, para dy mijë e sa vjetësh, ishin thënë në bisedën e njohur në Akropol midis sundimtarit të Athinës Perikleut dhe skulptorit të madh antik Filias me rastin e marrëveshjes për ndërtimin e Partenonit, kur i pari kishte thënë se tempulli i hyjneshës Atena më shumë duhej të spikaste përpjekjet dhe sakrificat e bëra në luftë kundër persëve, si vërejtje se urrejtja dhe e keqja që del prej saj nuk flenë, ndërsa skulptori i njohur i kishte thënë se asgjë tjetër përveç dashurisë nuk meritonte tempull të përjetshëm...

„Po unë, me urrejtjen ndaj vrasësve të dashurisë, a nuk kam mbrojtur dashurinë nga rrënimi i saj...“? - foli me mund, sikur t'u arsyetohej punimeve.

„A thua, nuk e paskam mbrojtur dashurinë...“? - tha prapë dhe bëri të ngrihej që t'ia thoshte këtë secilës veç e veç.

Por, atë përpjekje për lëvizje, që kishte qenë e fundit, ia kishte lënë përgjysmë një uturimë e shkaktuar jashtë, e përcjellë me gjithfarë dridhjesh dhe të çarash të papara ndonjëherë, të cilat kishin trandur çdo gjë, sa t'i shkonte mendja se ndodhej para asaj shembjeje të madhe dhe të pashmangshme që i duhej atij fundi.

Dhe, vërtet, pas pak, ajo dridhje dhe ato uturima sikur ishin qetësuar fare për t'ia lëshuar vendin një fashe të pashpjegueshme, nëpër të cilën duhej të ndiqte lëbyrin e një drite, ku në drithërimën marramendëse të shpejtësisë së saj pushonte çdo gjë, madje edhe ajo fryma në dukje e pasosme, bashkë me atë shpërthimin e brendshëm, të fundit, i cili i kishte mbetur i ngrirë çastin që shikimi i mekur i hedhur mbi Ballplaz ia kishte nxënë ushtarët sovjetikë tek derdheshin sheshit perandorak me flamujt të kuq në dorë me çirrjet e pandalshme për botën proletare, që thoshin se nuk kishte të ndalur përderisa anembanë rruzullit tokësor të shtrihej qilimi i saj nga ngjyra e gjakut...

Bon, 2005

.....